# monumentet

## GJIROKASTRA

## 10 vjet në Listën e Trashëgimisë Kulturore Botërore të UNESCO-s



DO NOT COPY

53/2015

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Monumentet

DO NOT COPY

DO NOT COPY

MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
"GANI STRAZIMIRI"
TIRANË

DO NOT COPY

# Monumentet

Kushtuar 10-vjetorit të shpalljes së Qytetit-Muze të Gjirokastrës,
***Pasuri Kulturore***, në ***Listën e Trashëgimisë Botërore*** nën mbrojtjen e UNESCO-s

**53**/ 2015

# Redaksia


| | | |
|---|---|---|
| Prof. dr. | Pirro THOMO | Kryeredaktor |
| | Arta DOLLANI | Anëtar |
| | Edlira ÇAUSHI | Anëtar |
| | Marsela PLYKU | Anëtar |
| | Elio HOBDARI | Anëtar |
| Ass. prof. | Florian NEPRAVISHTA | Anëtar |
| | Mimoza ZERECI | Anëtar |
| | Stela Haxhiu | Anëtar |
| | Anduela ARBANA | Sekretare |


© Copyright: Instituti i Monumenteve të Kulturës.
Botim i Institutit të Monumenteve të Kulturës, Tiranë 2015

ISSN 0253-1607

Në kopertinë: Pamje nga Gjirokastra

DO NOT COPY

Shtëpia Botuese
Shtypshkronja MORAVA

**Adresa**: Rr. Gjon Kastrioti (ish-shtëpia e Pionierit)
Laprakë, Tiranë
**Tel.**: 04 22 27 202 / **Cel.**: 068 20 13 121
**E-mail**: botimemorava@yahoo.com
botime.morava@gmail.com
**HHp:** www.botimetmorava.com

# PASQYRA E LËNDËS

## ARTIKUJ

Faqe

Arta DOLLANI
Koncepte të reja zhvillimi për qendrat historike....11

Emin RIZA
Gjirokastra në rrjedhë të vlerësimit të saj....15

**Vështrim retrospektiv**

Gani STRAZIMIRI
Gjirokastra dhe vlerat e saj kulturore....35

Aleksandër MEKSI
Dy kisha bizantine në rrethin e Gjirokastrës....53

Thanas KAMBERI
Disa të dhëna mbi teknikën e ndërtimit të banesës gjirokastrite....83

Valter SHTYLLA
Ujësjellësi i vjetër i kalasë së Gjirokastrës....89

Emin RIZA
Arkitektura dhe restaurimi i banesës së Zekatëve - Gjirokastër....103

Fatbardha SHKUPI
Zbukurimorja e disa banesave gjirokastrite....219

**Gjirokastra. Artikuj dhe Studime**

Pirro THOMO
Manastiret e krahinave të Gjirokastrës....147

Gjerak KARAISKAJ
Gjurmë mesjetare në kalanë e Gjirokastrës....171

Joli MITROJORGJI
Kodet ndërtimore në Shqipëri. Procesi qytet-formues i vendbanimeve
të traditës. Gjirokastra....179

DO NOT COPY

Lejla HADZIC
Elena MAMANI
Kreshnik MERXHANI
Restaurimi i banesës Babameto, monument kulture i kategorisë I, Gjirokastër.....201

Dashmir ÇUBERI
Motivet trashëgimore të ornamentikës në banesën gjirokastrite..... 217

Elena Mamani
Kreshnik MERXHANI
Sterat në monumentet e kulturës në Gjirokastër.....225

Agron DORACI
Restaurimi i banesës Kadare, Gjirokastër.....235

**Recensione**

Emin RIZA
Ali MUKA, K*ultura popullore dhe koha - V*ështrim*e etnologu,* Vëllimi I, II
(recension) ..... 243

Zyhdi DERVISHI
Ali MUKA, *Studiues dhe Studime për Etnokulturën Shqiptare, Mbresa e urime, shënime e vlerësime*, 2014
(recension).....245

Ali MUKA
Pirro Thomo, *Korça-Urbanistika dhe Arkitektura*, 2012
(recension).....249

Rregullore për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur në qytetin e Gjirokastrës, 2015.....251

Harta e Zonifikimit ..... 265

Vendimi: 29 COM 8B.48
Shpallje e pasurive kulturore në listën e trashëgimisë botërore (Qyteti-Muze i Gjirokastrës) 2005..... 267

Vendimi: 32 COM 8B.56
Shqyrtimi i shpalljeve dhe modifikime të vogla të kufijve të pasurive naturore, të përziera dhe kulturore në listën e trashëgimisë botërore - Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës (Shqipëri) 2008.....269

DO NOT COPY

# TABLE OF CONTENTS
## ARTICLES

Page

Arta DOLLANI
New conceptions for the development of historical centers ..... 13

Emin RIZA
Gjirokastra in the course of its evaluation..... 34

**Retrospective overview**

Gani STRAZIMIRI
Gjirokastra et ses valeurs culturelles..... 50

Aleksandër MEKSI
Deux eglises byzantines du district de Gjirokastra..... 79

Thanas KAMBERI
Donnes sur la technique de contruction appliqué dans l'habitation
type de Gjirokastra..... 88

Valter SHTYLLA
L'ancien aquaduct de la citadelle de Gjirokastra ..... 100

Emin RIZA
Architecture et restauration de la maison des Zekat a Gjirokastra..... 125

Fatbardha SHKUPI
L'ornementation de quelques habitations de Gjirokastra..... 143

**Gjirokastra. Articles and Research**

Pirro THOMO
Monasteries in the provinces of Gjirokastra..... 170

Gjerak KARAISKAJ
Medieval traces in the castle of Gjirokastra..... 176

Joli MITROJORGJI
Building codes in Albania. City -forming process of traditional
settlements. Gjirokastra..... 198

DO NOT COPY

Lejla HADZIC
Elena MAMANI
Kreshnik MERXHANI
Babameto 1st category monument restoration, Gjirokastra ..... 215

Dashmir ÇUBERI
Inherited ornamental motives of Gjirokastra's house..... 224

Elena MAMANI
Kreshnik MERXHANI
Water cisterns in historical houses, Gjirokastra.....234

Agron DORACI
The restoration of the Kadare House.....242

**Recensions**

Emin RIZA
Ali MUKA, *Folk culture and time - Ethnologist's Insights*, Volume I, II
(Recension) .....243

Zyhdi DERVISHI
Ali MUKA, *Researchers and Studies for the albanian etno culture. Impressions, congratulations, notes and assesments*, 2014
(recension)..... 245

Ali MUKA
Pirro THOMO, *Korca-City Planning and Architecture*, 2012
(recension) .....249

Regulation on the protection, conservation and integrated management
of the historical and the protected area in the town of Gjirokastra, 2015 ..... 251

Gjirokastra. Map of Zonification .....265

29 Session of the World Heritage Committee, Durban, July 2005
Decision : 29 COM 8B.48
Nominations of Cultural Properties to the World Heritage List
(Museum-City of Gjirokastra) .....268

32nd Session of World Heritage Committee, Durban, July 2008
Decision: 32 COM 8B.56
Examination of nominations and minor modifications to the boundaries of natural, mixed and cultural properties to the World Heritage List - Historic Centres of Berat and Gjirokastra (Albania) .....271

DO NOT COPY

Arta DOLLANI*

DO NOT COPY

# KONCEPTE TË REJA ZHVILLIMI PËR QENDRAT HISTORIKE

Në këtë përvjetor të 10-të të shpalljes së qytetit të Gjirokastrës, Pasuri Botërore e UNESCO-s, ngjarje me rëndësi të jashtëzakonshme për Shqipërinë, i cili fatmirësisht përkon me gjysmë shekulli pune të Institutit të Monumenteve të Kulturës, dëshiroj të shpreh mirënjohje të thellë e të sinqertë për të gjithë kontribuesit e palodhur, restauratorë të njohur e të heshtur, mes nesh e të larguar, ata që bënë të pamundurën të mundur, për Heronjtë e Monumenteve.

Në këtë shekull të ri, sfidat janë të gjithanshme në zhvillimin e pandalshëm, porse mbi gjithçka qëndron me madhështinë e tij hijerëndë, qyteti i gurtë.

## Potenciali i pashfrytëzuar i trashëgimisë kulturore

Qytetet i japin Shqipërisë markën e saj ndërkombëtare, shfaqin identitetin, jetën e vrullshme ekonomike dhe kohezionin social. Nëse janë qytete, qendra të banuara apo fshatra kanë një emërues të përbashkët: janë qendra historike, pasuri kulturore dhe karakteri i tyre formëzohet nga cilësia e peizazhit historik.

Pjesa më e madhe e materialit të çmuar të pasurive kulturore, përmbledhur në qytetet e vendet e veçuara të Shqipërisë, përbën kontekstin e jetës dhe përçon ndjesi tek banorët e vizitorët.

Kjo vlerë unikale e vendit stimulon qytetarët dhe biznesin që të vetëidentifikohen dhe të angazhohen në qytetin e tyre dhe e bën "monumentin e kulturës" një burim kyç, mbi bazën e të cilit zhvillohen strategji afatgjata për zhvillimin ekonomik të vendit.

## Koncepti i ri për administrimin e qendrave historike

Ky koncept lidhet me hartimin e "Planit të integruar të menaxhimit". Ai është politikë inovative për planifikimin e hapësirës në qendrat historike. Ndihmon efektivisht në administrimin e këtyre qendrave si hapësira atraktive, shumëfunksionale dhe konkurente. Kjo qasje e integruar ka si qëllim balancimin dhe koordinimin e kërkesave të qendrës historike dhe nevojave të banorëve të tyre me interesat e organit administrues.

Problematika e menaxhimit të pasurive kulturore lidhet pazgjidhmërisht me gamën e gjerë të kompetencave të organeve administruese dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me planifikimin hapësinor, i cili përfshin si përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimit ekonomik, ashtu edhe mbrojtjen e ruajtjen e trashëgimisë kulturore, turizmit, kulturës dhe muzeve.

Pra, qasja e integruar është domosdoshmëri për të evituar problemet dhe konfliktet, të cilat rëndom hasen si rezultat i administrimit sektorial të institucioneve të ndryshme.

Domosdoshmëri për suksesin e "Planit të integruar të menaxhimit" është strategjia ku përcaktohen qëllimet konkrete dhe të arritshme, plani i qartë i veprimit dhe mjetet e realizueshmërisë së objektivave për secilin institucion, me qëllim që të ruhet trashëgimia kulturore dhe paralelisht të shfrytëzohet potenciali i saj i gjerë si atut për zhvillimin ekonomik të popullsisë lokale.

* Drejtore e Përgjithshme e Institutit të Monumenteve të Kulturës.

**Rruga e suksesit**

Institucionet qendrore dhe pushteti lokal duhet t'i japin prioritet të lartë trashëgimisë kulturore, në mënyrë që potenciali kulturor të shërbejë plotësisht për zhvillimin e qytetit. Kjo do të thotë së pari, kuptimi i karakterit dhe individualitetit të qytetit, dhe më pas sigurim i vëmendjes kryesore në politikën e zhvillimit.

**Detajim i "qasjes së integruar"**

Plani i integruar i menaxhimit për trashëgiminë kulturore është angazhim konkret i të gjitha hallkave të pushtetit qendror dhe lokal, si e vetmja rrugë e efektshme e arritjes së rivlerësimit të tij. Është shumë e rëndësishme përfshirja në këtë plan e komunitetit dhe përdoruesve direktë të këtyre objekteve, përmbushja e nevojave dhe detyrimeve që janë të pashmangshme në këtë proces.

Për të përforcuar dhe garantuar zbatimin në praktikë të këtij plani, është i domosdoshëm aprovimi politik, institucional dhe shoqëror.

**Qytet urban bashkëkohor me qendër historike**

Qendrat historike ose monumentet e kulturës, prej atyre hallkave institucionale e shoqërore që pak e njohin fushën e trashëgimisë kulturore, perceptohen si një tërësi problematike për zhvillimin e qytetit; të merresh me të shkuarën trajtohet si një çështje kufizuese, penguese për inovacionin dhe zhvillimin.

Është krejtësisht e kundërta, qendrat historike u ofrojnë qyteteve veçori unikale. Trashëgimia kulturore është një shans i papërsëritshëm, në pikëpamjen shoqërore dhe ekonomike, duhet vetëm ta mbrojmë dhe ta përdorim atë në të mirën e përbashkët. Në këtë vështrim, akti i përfshirje së Qytetit-muze të Gjirokastrës në listën e pasurive Botërore të mbrojtura nga UNESCO, që konfirmon vlerat universale të këtij qyteti, përbën njëkohësisht një detyrim për mbrojtjen e këtyre vlerave nga tërësia e shoqërisë shqiptare, nga banorët dhe pronarët e banesave të shpallura monument kulture, nga institucionet e specializuara për mbrojtjen e monumenteve dhe nga organet e pushtetit vendor dhe atij qendror.

DO NOT COPY

Arta DOLLANI*

DO NOT COPY

# NEW CONCEPTS FOR DEVELOPING HISTORICAL CENTRES

On this special anniversary, which marks the 10th anniversary of nomitating the city of Gjirokastra, "Cultural Property to the World Heritage list" from UNESCO, an event of exceptional importance for Albania, which fortunately coincides with a half century tremendous work of the Institute of Cultural Monuments, I would like to express profound and sincere gratitude to all indefatigable contributors, to the well known and silent restorers, who are still contributing actively with us and those who have gone away, all those who made the impossible possible, the Heroes of Monuments.

In this new century, the challenges are comprehensive in the impartible development, but the stone city, stands by with all its imposing grandeur.

## The untapped potential of cultural heritage

Cities give Albania its international brand, they display the identity, the vigorous economic life and social cohesion. Whether they are cities, towns or villages they have a common denominator: they are historical centers, cultural wealth and their character is shaped by the quality of the historic landscape.

The major part of the precious material of cultural assets, summarized in cities and separate places of Albania, constitute the context of life and conveys sensation to residents and visitors.

This unique value stimulates country's citizens and businesses to engage in identifying themselves and their city and makes "the monument of culture" a key source on the basis of which are developed long-term strategies for the economic development of the country.

## The new concept for the management of historic centers

This concept relates to the design of "Integrated Management Plan". It is an innovative policy for spatial planning in the historic centers. It effectively assists in the management of these centers as attractive spaces, multifunctional and competitive. This integrated approach aims to balance and coordinate the requirements of the historic center and the needs of their residents with the interests of the administering body.

The issue of managing cultural assets is linked inextricably with the wide range of powers of the management authorities and directly to spatial planning, which includes improving the infrastructure and economic development, as well as the protection and preservation of cultural heritage, tourism, culture and museums.

So, integrated approach is necessary to avoid problems and conflicts, which often occur as a result of the sectoral administration of various institutions.

Imperative for the success of "Integrated Management Plan" is the strategy where concrete and accessible goals, the clear plan of action, and means for achieving the objectives for each institution are well defined, in order to preserve cultural heritage and simultaneously to use its wide potential atut for the economic development of local population.

* General Director of the Institute of Cultural Monuments.

**The road to success**

Central and local authorities should give high priority to the cultural heritage, in order that cultural potential fully serves city growth. This means firstly, understanding the character and individuality of the city, and then provizioning of the main attention in development policy.

**Details of "integrated approach"**

Integrated Management Plan for the cultural heritage is a concrete commitment of all levels of central and local government, as the only effective way of achieving its revaluation. It is very important to include in this plan the community and direct users of these facilities, meeting the needs and obligations that are inevitable in the process.

To reinforce and guarantee the practical implementation of this plan, the political, institutional and social approval is indispensable.

**Modern urban city with an historical center**

Historic centers or monuments of culture are perceived as a problematic entirety from those social and institutional links that know little about the field of cultural heritage, for the development of the city; dealing with the past is treated as a restrictive matter, a barrier to innovation and development.

But is quite the opposite, the historic centers offer unique features to the cities. Cultural heritage is an unrepeatable opportunity concerning the social and economic outlook, we need only to protect and use it to the common good. In this regard, the act of incorporating the Museum City of Gjirokastra in the "Cultural Property to the World Heritage list" from UNESCO, which confirms the universal values of the city, constitutes, at the same time, an obligation to protect these values from the entire Albanian society, by residents and owners of the houses declared "monument of culture", specialized institutions for the protection of monuments as well as by the local and central government.

DO NOT COPY

Prof. dr. Emin RIZA

DO NOT COPY

# GJIROKASTRA NË RRJEDHË TË VLERËSIMIT TË SAJ

Vlerësimi i veprave apo ngjarjeve kulturore dhe historike, është një dukuri e cila zë fill që prej konsideratave të para dhe vijimisht më të reja njohëse, gjithë duke shtrirë në hapësirë dhe kohë, vendin e tyre në bashkësinë e krijimtarisë njerëzore. Veprimtaria studimore, në fushën e trashëgimisë ndërtimore në përgjithësi, e cila synon t'i afrohet përherë dhe më shumë të vërtetave absolute mbi tiparet e këtyre veprave, nuk është, sepse s'mund të jetë e arritshme, ashtu siç shfaqet rëndom në fushën e shkencave të sakta. Për këto arsye edhe fusha e gjurmimit, identifikimit, dokumentimit, vënies në mbrojtje, njohjes dhe restaurimit të trashëgimisë ndërtimore, në tërësinë e veprimtarive të mësipërme, mund të përmblidhet në termin e gjerë studim. Ky artikull, i cili i kushtohet 10-vjetorit të shpalljes së Qendrës historike të Gjirokastrës, "Pasuri Botërore", synon të paraqesë një kumtim përmbledhës mbi veprimtarinë shumërrafshëshe, emërtuar vlerësim, për vendin e Gjirokastrës në historinë e urbanistikës dhe arkitekturës qytetare shqiptare dhe më gjerë.

Qendra historike e Gjirokastrës, me fillesa rreth gjysmës së dytë të shek. XIII dhe zhvillim krahasimisht të shpejtë, pas shek. XV, është objekt studimi, me shkallë të ndryshme gjerësie dhe thellësie. Ashtu si mbarë studimet në përgjithësi dhe ato në fushën e trashëgimisë ndërtimore në veçanti, mbështeten kryesisht mbi materialin faktik, pra në ndërtimet, të cilat i kanë qëndruar kohës, deri rreth mesit të shekullit të kaluar. Thelbi i këtyre studimeve, qëndron në klasifikimin e vlerave të ruajtura ndërtimore, sipas kriteresh të njohur kompozicionalë arkitekturorë, në rrafshet e elementeve funksionalë, teknikës dhe materialeve të ndërtimit. Më tej, brenda të njëjtit kriter klasifikues, vihen në pah dukuritë thelbësore, shpesh më të përhapurat në hapësirë dhe kohë. Duke pasur parasysh materialin faktik, të ruajtur deri në fillesat e veprimtarisë vlerësuese për monumentet, theksojmë se për disa arsye, ndër të cilat kryesorja është mospërshtatja përherë dhe në rritje e funksioneve fillestare me ato bashkëkohore, ruajtja e mbarë vlerave të së kaluarës është e pamundur. Ashtu si përgjithësisht edhe në këtë problematikë, zgjidhja i përket rrugës së mesme. Është fjala për ruajtjen e vlerave më përfaqësuese të trashëgimisë ndërtimore, pra shembujve më autentikë të cilët i përkasin mbarë tipologjisë së kompozimit dhe bashkëpërbërësve të prekshëm funksionalë dhe teknikë të kësaj trashëgimie. Këto vepra, të cilat fitojnë emërtimin *monument kulture* dhe si të tillë vihen në mbrojtje shtetërore, i qëndrojnë gjatë kohës, nën kujdesin e posaçëm profesional të ndërhyrjeve restauruese. Këto vepra, në saje të kritereve përzgjedhëse dhe shkallës së përfillshme të autenticitetit, vijimisht janë objekt i veprimtarisë studimore, përherë në rritje, si në rrafshin e saktësimit të vlerave, ashtu dhe në atë krahasues, përherë në zgjerim.

Qendra historike e Gjirokastrës (Fig. 1), më tej thjesht Gjirokastra, përfshihet në kategorinë e siteve, apo qendrave të banuara qytetare. Ajo përfshin kategoritë ndërtimore të fortifikimit, apo kalasë (Fig. 2), banesave (Fig. 3), ndërtimeve të kultit (Fig. 4) dhe qendrës zejtaro-tregtare (Fig. 5). Ndërtimi i fortifikimit, shpesh gjatë periudhës mesjetare, nuk ka qenë domosdoshmërisht pjesë e qytetit dhe përgjithësisht fillesa e tij. Kompozimi i siteve dhe përgjithësisht i ndërtimeve bashkëpërbërëse të tyre, i përkasin krijimtarisë popullore, pra nuk paraprihen prej projektesh të specialistëve të shkolluar.



*Fig. 1. Pamje e përgjithshme e Gjirokastrës*



*Fig. 2. Pamje e Kalasë së Gjirokastrës*



*Fig. 3. Pamje e banesës së Bakirit*



*Fig. 4. Pamje e Xhamisë së Pazarit*

DO NOT COPY

Vlerësimi i sitit të Gjirokastrës në kuadrin kombëtar është natyrshëm veprimtari paralele me atë të siteve të tjerë të Shqipërisë dhe Kosovës. Ende, për arsyet e njohura jashtëshkencore, studimet e monumenteve shqiptarë, site, apo ndërtime të veçantë, jashtë kufijve të sotëm politikë, nuk janë përfshirë në studimet përkatëse. Studimet për Gjirokastrën, ashtu si për mbarë monumentet, janë pjesë e veprimtarive studimore, të mbarë trashëgimisë sonë ndërtimore, në trojet tona të sotme dhe ato që ende banohen me shumicë të popullsisë shqiptare. Si pasojë, për të kuptuar më qartë veprimtarinë studimore për Gjirokastrën, duhet, së pari, të kemi parasysh veprimtarinë vlerësuese të trashëgimisë ndërtimore në Shqipëri dhe në Kosovë, pas pavarësimit të kësaj të fundit. Kjo për arsye se, vlerësimi i Gjirokastrës si sit historiko-kulturor, nuk shfaq veçanti lidhur me parimet themelore të veprimtarisë vlerësuese, por vetëm veçanti lidhur me gjerësinë dhe thellësinë zbatimit të këtyre parimeve.

Vlerësimi i trashëgimisë kulturore ndërtimore, në rrafsh europian, është një dukuri me fillesa rreth fundit të shek. XVIII, natyrshëm me rritje dhe saktësime shkallësore të bashkëpërbërësve të termit vlerësim. Fillesat e vënies në pah të vlerave ndërtimore të së kaluarës së etnosit shqiptar, i kanë nismat rreth fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX.



*Fig. 5. Pamje e Pazarit*

Autorë të këtyre trajtesave parësore kanë qenë intelektualë të huaj dhe vendas, pa qenë specialistë të ngushtë të fushës së vlerësimit të trashëgimisë ndërtimore. Këto fillesa kanë vlera të rëndësishme për sensibilizimin e shoqërisë shqiptare të kohës dhe organeve shtetërore, për mbrojtjen e këtyre vlerave të papërsëritshme historiko-kulturore. Ndër emrat e studiuesve të huaj përmendim G. Han, Nopça, Shuflai, Prashniker, Shober etj. Vend të veçantë në fushën në trajtim, zë dijetari dhe patrioti i shquar shqiptar At Shtjefën Gjeçovi. Në rrafshin shtetëror, dokumenti i parë i Shqipërisë së pavarur është "Qarkore e Ministrisë së Arsimit", e datës 19.06.1922, në të cilën urdhërohet gjurmimi dhe ruajtja e pasurive kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme. Dekret-ligji për mbrojtjen e "monumenteve kombëtare", siç emërtohen në këtë akt ligjor veprat e trashëgimisë kulturore, shfaq koncepte të qarta dhe më tej të përparuara për kohën, lidhur me problematika themelore të vlerësimit të monumenteve në Shqipëri. Ky akt nuk gjeti zbatim, sepse ende realiteti shqiptar i kohës nuk kishte bërë të vetin këtë fushë të rëndësishme kulturore. Viti 1944 shënon fundin e periudhës së parë të periodizimit të përkujdesjeve për trashëgiminë kulturore në Shqipëri. Periudha e dytë, e cila përfshin hapësirën kohore ndërmjet viteve 1944-1965, shënon arritjen e nismave për zbatimin e vlerësimit të monumenteve. Siç kemi përmendur, termi vlerësim përfshin aktet normative ligjore dhe veprimtaritë praktike për ruajtjen e vlerave të monumenteve. Periudha e dytë e jetës së monumenteve në Shqipëri është e një rëndësie të veçantë, sepse gabimet eventuale në të, mund të kishin pasoja vështirë të korrigjueshme, veçanërisht lidhur me kriteret e vënies në mbrojtje të monumenteve dhe ndërhyrjeve restauruese në to.

Dekreti 568, datë 17.03.1948 "Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe sendeve natyrore të rralla", është një vendim me vlera themelore në fushën e monumenteve në Shqipëri. Ngarkimi i Institutit të Shkencave për problematikën e monumenteve, i jepte zbatueshmëri dekretit të përmendur. Në vitin 1957, me krijimin e Universitetit Shtetëror të Tiranës, mbrojtja e monumenteve i ngarkohej Grupit të Kulturës Materiale, pranë Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë, i cili varej prej Universitetit të Tiranës. Dekret-ligji i vitit 1948 pasohet në vitin 1955, me vendimin nr. 30 të Këshillit të ministrave për miratimin e rregullores "Mbi mbrojtjen e monumenteve kulturore dhe historike dhe pasurive natyrale të rralla". Në kushtet e diktaturës pseudokomuniste të Shqipërisë së viteve 1944-1990, e cila formalisht vetëemërtohej Republikë demokratike (sundimi i popullit, popullor), drejtimi i shtetit në kahe thelbësore, ishte në vartësi të diktatorit, i cili sundonte nëpërmjet Partisë. Në këto rrethana, për të ardhmen e trashëgimisë kulturore në Shqipëri, vendimet e Partisë ishin me rëndësi të veçantë. Viti 1961, shënon një ngjarje me rëndësi të veçantë për trashëgiminë e kulturës ndërtimore në Shqipëri. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 172, datë 02.06.1961, u vunë në mbrojtje shtetërore qytetet e Gjirokastrës dhe Beratit, nëntoka e Durrësit dhe Pazari i Vjetër i Krujës. Me një vendim të posaçëm, të së njëjtës datë, miratohet dhe "Rregullore mbi administrimin e qytetit-muze të Beratit". Në të njëjtin vit shpallej lista

DO NOT COPY

e dytë e monumenteve të kulturës në Shqipëri, e cila përfshinte 88 monumente të gjinive të ndryshme, në qytetin muze të Beratit. Një rrallësi, duhet cilësuar, pjesëmarrja e një delegacioni shqiptar në Kongresin II Ndërkombëtar të arkitektëve dhe teknikëve të monumenteve, mbajtur në Venecie, prej 25-31 maj të vitit 1964, në të cilin u miratua dokumenti historik për të ardhmen e monumenteve: "Karta e Venecies". Ky dokumente, ashtu si përgjithësisht, qe dhe mbeti baza, mbi të cilin u mbështet koncepsioni profesional shqiptar, mbi vlerësimin e monumenteve.

Periudha e tretë mendojmë se i ka fillimet në vitin 1965 me themelimin e Institutit të Mbrojtjes dhe Restaurimit të Monumenteve, i cili u zëvendësua shpejt me emërtimin më të ngjeshur, Instituti i Monumenteve të Kulturës. Thjesht për kujtesë, pohojmë se vendimi për cilësimin e këtij institucioni kërkimor-shkencor, u arrit vetëm në vitin 1990. Shkaqet se pse ky institut nuk ishte cilësuar si i tillë më parë, duhen kërkuar së pari në formimin diletant të drejtuesve kryesorë të Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë, prej nga varej Grupi i Kulturës Materiale, të cilët e konsideronin restaurimin si merematim ndërtimor. Që në fillesat e veta, madje dhe vite më parë themelimit të Institutit, veprimtaria e tij, u konceptua dhe u zbatua si veprimtari e vërtetë studimore, e cila përmblidhte dy fusha paralele, atë kërkimore dhe krahas, atë restauruese. Kjo qartësi konceptuale do të jepte përfundime sa të shpejta, aq dhe vijimisht në rritje. Një prej detyrave kryesore të këtij institucioni ishte veprimtaria e vënies në mbrojtje të monumenteve. Kjo veprimtari, kuptueshëm ,ishte themelorja në kuptimin se identifikonte vlerat, të cilat përmbanin treguesit më të lartë të vlerave ndërtimore dhe zhvillimit të tyre, në hapësirë dhe kohë në Shqipëri, dëshmi autentike historiko-kulturore. Ky cilësim parakuptonte shkallën në nivelet e kërkuara profesionale të përzgjedhësve të këtyre vlerave. Më tej, çdo propozim për shpalljen e një ndërtimi monument, duhej të kalonte nëpër njësi të ndryshme të kualifikuara, për të verifikuar vlerat e propozuara. Kjo praktikë ngushtonte ndjeshëm mundësitë për vlerësime të pasakta, lidhur me kërkesat për të cilësuar një kategori ndërtimore monument. Kriteret bazë teorikë, mbi të cilët mbështet dhe vazhdon të mbështetet veprimtaria për gjurmimin dhe përzgjedhjen e vlerave të monumenteve, janë arritje sa të rëndësishme, aq edhe të qëndrueshme. Këto kritere janë: kriteri gjinor, kriteri tipologjik dhe kështu radhazi, ai i autenticitetit, vlerave arkitekturore, kriteri kohor, kriteri i shpërndarjes hapësinore të dukurisë ndërtimore, kriteri i ruajtjes paraprake dhe ai i bashkëekzistencës së veprës ndërtimore me veprën e artit. Këto kritere parakuptojnë njohjen e tre tipareve të tre gjinive kryesore ndërtimore, atyre mbrojtëse, të kultit dhe banesës popullore. Është e rëndësishme të ripohojmë se në Shqipëri, trajtimi i monumenteve në kuptimin e gjerë të fjalës, ka qenë dhe një zbatim përgjithësisht rigoroz i parimeve ndërkombëtare të restaurimit, synues të ruajtjes së vlerave origjinale të monumenteve. Kjo e vërtetë ka lehtësuar veprimtarinë për mbrojtjen e monumenteve në Shqipëri, në mbarë përbërësit e termit mbrojtje, pra kryesisht identifikimi, dokumentimi, studimi dhe restaurimi.

Në rrafshin organizativ, sistemi i vlerësimit të monumenteve, qe sa i thjeshtë, aq edhe efikas. Centralizimi i veprimtarive vlerësuese për monumentet, në rastin shqiptar ishte më i drejti, kryesisht për dy arsye. Së pari, hapësira territoriale e shtetit shqiptar, është krahasimisht e vogël dhe së dyti centralizimi administrativ, pasohej me atë profesional. Ky i fundit ishte veçanërisht me vlera, në kushtet e kuadrit studimor-restaurues, në formim e sipër. Qendra e veprimtarisë studimore-restauruese qe Instituti i Monumenteve të kulturës, i cili kishte një sërë njësish vartësie, ateliesh dhe degësh, në disa qytete, të cilat ishin pjesë organike e Institutit të Monumenteve. Këto organizma, përveç personalit administrativo-teknik, kishin një numër të konsiderueshëm mjeshtërish dhe punëtorësh ndërtimi, të cilët zbatonin punimet restauruese në hapësirat respektive, që mbulonin atelietë dhe degët e monumenteve. Hartimi i projekteve të restaurimit dhe zbatimi i tyre prej së njëjtës njësi, me personel të kualifikuar në punë dhe nëpërmjet saj, qe një arritje sa e vetme, aq edhe tejet pozitive. Ajo u admirua prej kolegëve të vendeve fqinj, në kuadër të pozitivitetit të dukshëm të centralizimit profesional. Instituti formohej krahas sektorëve administrativë edhe prej një sërë sektorësh kërkimorë sipas kritereve tipologjiko-kohorë.

Monumentet e kulturës, sipas gjinive kanë pasur, mbas ndërtimit të tyre, funksionet fillestare, vijueshëm deri më sot, ndërsa të tjerë i kanë humbur këto funksione. Monumentet mbrojtës ruhen si dëshmi historiko-kulturore të pashfrytëzueshme, ndërsa ata të kultit dhe banesat popullore, ruajnë funksionet fillestare, gjithë duke ruajtur në shkallë të

DO NOT COPY

ndryshme origjinaliteti, përbërësit origjinalë. Këto funksione, nuk duhet të cenojnë vlerat, për të cilat veprat ndërtimore janë vënë në mbrojtje shtetërore, në cilësinë e monumenteve. Kemi përmendur theksueshëm se regjimi totalitar i viteve 1944-1990, tregoi kujdes të veçantë për vlerësimin e monumenteve. Kjo dukuri shpjegohet kryesisht me prirjet, deri në qëndrimin e skajshëm, të ashtuquajturin "mbështetje në forcat tona", në thelb një vetizolim i skajshëm. Në këtë kontekst, synohej që edhe trashëgimia historiko-kulturore shqiptare të kthehej në të vetëmjaftueshëm, duke e shkëputur artificialisht prej kontekstit ballkanik dhe evropian më gjerë. Me këtë veprim, pasojat e të cilit po i vuajmë në shumë rrafshe, edhe monumentet shqiptare në disa këndshikime pësuan zhvleftësime. Më tej, kur parimet politike të periudhës diktatoriale, plotësisht, apo pjesërisht binin në kundërshtim me kriteret e vlerësimit të monumenteve, këto pseudoparime profesionale potencoheshin dhe menjëherë shfaqeshin veprues. Përmendim përparësitë e njohura për kategorinë e monumenteve historikë, të lidhur me ngjarje dhe figura historike shqiptare,të cilat mbisundoheshin kapilarisht prej pseudopikëpamjeve historike të Partisë-shtet. Lufta vëllavrasëse për marrjen e pushtetit, me dëshmitë e saj materiale, krijoi një fond tejet të gjerë vlerash, larg së qeni merituesheëm monumente. Viti 1967, shënoi një ngjarje të pashembullt në historinë njerëzore, duke lënë mënjanë një ndalesë, pak mujore, për ushtrimin e besimit fetar në Francën e revolucionit të shek. XVIII. Në këtë vit, në Shqipëri u ndalua me ligj ushtrimi i fesë, duke i dhënë regjimit diktatorial të kohës një vend të parë antinjerëzor, të cilin nuk e pat arrirë as çifti unikal Lenin-Stalin i diktatorëve. Shumica e veprave të kultit të pambrojtura u shkatërruan, apo u tjetërsuan, ndërsa ato më të shquarat, të cilat ishin cilësuar monumente, ishin përpara një rreziku shkatërrues unikal. Pa hyrë në hollësi, intelektualë profesionistë dhe atdhetarë, me pjekuri dhe guxim arritën të zvogëlojnë ndjeshëm numrin e ndërtimeve të kultit që synoheshin të hiqeshin prej mbrojtjes. Enverizmi me aktin e trajtuar, këmbëngultas vërtetoi se përfaqësonte bolshevizmin e skajmë, në hapësirë dhe kohë.

Viti 1971, si për të nxitur harresën për ndodhitë dramatike të vitit 1967, shënoi një ngjarje me rëndësi në veprimtarinë kulturore shqiptare, atë të fillimit të botimit të revistës shkencore gjashtëmujore, "Monumentet". Kjo revistë, e mbuluar kryesisht me artikuj të punonjësve kërkimorë të Institutit të Monumenteve, krahas vlerave madhore për studimin e trashëgimisë sonë kulturore në shekuj, i dha shtysë veprimtarisë vetëkualifikuese të kuadrit studimor. Që rreth viteve 1980, filloi dhe veprimtaria botuese e gjinive të monografive dhe albumeve, krahas botimeve fillestare përgjithësuese, si "Historia e arkitekturës shqiptare". Vënia në mbrojtje, krahas siteve të Beratit dhe Gjirokastrës dhe të qendrave të tjera historike, me hapësira më të kufizuara të Korçës, Elbasanit, Shkodrës dhe Vlorës, qe arritje dhe me vlera madhore.

Një kategori e rëndësishme ndërtimore e së kaluarës shtrihet edhe në zonat e gjera fshatare, me numrin më të madh të popullsisë, ende sot. Në këto vendbanime, vendin kryesor të gjinive ndërtimore e zënë banesat popullore. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 229, datë 01.11.1974, "Mbi gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve popullore", ishte me rëndësi të posaçme, për të përmbyllur veprimtarinë e gjurmimit të këtyre vlerave, në qytete dhe veçanërisht në fshatin shqiptar. Vendimi, vendoste si kufi kohor të përfundimit të kësaj veprimtarie, vitin 1978. Ekspeditat e shumta të kryera gjatë katërvjeçarit të përmendur, qenë me vlera të veçanta për vënien në pah të kësaj pasurie, veçanërisht të vlefshme në historinë shqiptare. Është rasti për të theksuar të vërtetën se, procesi i gjurmimit dhe vënies në mbrojtje të monumenteve ka fillesa, por asnjëherë fund. Kjo dukuri shpjegohet si me shfaqjen e ndërtimeve të reja, prej të cilave gjithashtu përzgjidhen më përfaqësueset, ashtu edhe me zbulimin e ndërtimeve të lashta, ende të pagjurmuara. Prej viteve 1949 deri në vitin 1988, qeveritë shqiptare kanë miratuar 14 lista monumentesh, të cilat përfshijnë 1134 monumente. Kjo shifër, komplekset ndërtimore dhe qendrat e ndryshme të banuara, i përfshin në një numër të vetëm, ashtu si monumentet e veçantë. Krahas botimeve shkencore dhe atyre popullore, Instituti i Monumenteve, që prej vitit 1969, ka organizuar një sërë konferencash kombëtare dhe ndërkombëtare, mbi problematikat e vlerësimit të monumenteve në Shqipëri.

Siç përmendëm, periudha e tretë e përkujdesjeve të kualifikuara për trashëgiminë e kulturës materiale në Shqipëri, fillon me vitin 1965 dhe vijon si e tillë. Edhe në këtë kontekst, fatkeqësisht lind nevoja e përdorimit të lidhëses por, duke u pasuar me pohimin se viti 1990, i kësaj periudhe në vijim, shfaqet negativisht i rëndësishëm për

DO NOT COPY

fushën e monumenteve dhe trashëgimisë sonë kulturore në përgjithësi. Të vërtetat, veçanërisht për fushën e trashëgimisë kulturore, duhet të jenë sa më të sakta, për arsye se vlerat e këtyre dëshmive historiko-kulturore janë të papërsëritshme. Ashtu siç kemi shkruar, që prej vitit 1992, ndryshimet thelbësore të llojit të pushtetit politik në Shqipëri, do të thoshim pakuptueshëm, u shoqëruan me një indiferentizëm të skajshëm për vlerat e trashëgimisë sonë. Ajo veprimtari e gjerë, sipas parimesh thellësisht profesionale mbi 25-vjeçare, përherë dhe më dukshëm, po tjetërsohet negativisht, duke shpërfillur sistematikisht veprimtaritë shumërrafshëshe, të cilat i përmbledh termi vlerësim, në fushën e monumenteve. Gjendja e monumenteve, veçanërisht e atyre jashtë qendrave të banuara, kryesisht qytetare, njihet shumë pak. Dokumentacionet, vijimisht pasqyruese të gjendjes në ndryshime të monumenteve, gjithashtu janë munguese. Ndërhyrjet restauruese, janë në prag të zerimit të tyre, dhe përfshirja e monumenteve në jetën e sotme kulturore ka rënie të theksuar. Shteti shqiptar, i shfaqur me ndryshime qeverish, në lidhje me përkujdesjet për trashëgiminë kulturore, këto institucione bazike janë në garë për t'iu shmangur detyrimeve ndaj kujdesit për monumentet. Përgjigja, s'kemi fonde, është shumëfish absurde, sepse prej fondeve ekzistues monumentet duhet të jenë ndër të parët të cilëve duhet t'iu akordohen, sepse çdo dëmtim i tyre pjesor deri në rrënim, është i pakthyeshëm.

Ashtu di në çdo veprimtari njerëzore edhe në fushën krahasimisht të re, të vlerësimit të pasurisë ndërtimore, shkalla e nivelit profesional të punonjësve të kësaj fushe, është e lidhur drejtpërdrejt me përfundimet e kësaj veprimtarie komplekse. Në Shqipëri, fillesat e formimit profesional të punonjësve të vlerësimit të trashëgimisë kulturore, janë krahasimisht të reja. Ato shfaqen pas Luftës së Dytë Botërore, me një ecuri të shpejtë, kryesisht lidhur me përkujdesjet shtetërore për këtë fushë. Do të pohonim pa mëdyshje se, centralizmi i theksuar administrativ, në nivelet e diktaturës së mirëfilltë, në rastin shqiptar, lidhur me vlerësimin e monumenteve, ka qenë efektiv sepse ka konsoliduar centralizmin profesional. Ky centralizëm profesional, mirëkuptonte zbatimin e parimeve të vlerësimit të monumenteve, të interpretuara prej specialistësh të fushave dhe të detyrueshme për zbatim.

Historiku i krijimit të kuadrit studimor-restaurues të monumenteve, i cili, shkallërisht do të udhëhiqte vlerësimin e monumenteve në Shqipëri, është një dukuri e kryer krahasimisht shpejt dhe me rritje të përfillshme profesionale. Kjo dukuri, e pati bazën në parimin, e përvetësimit të profesionit në punë dhe nëpërmjet saj. Kjo dukuri u diktua prej rrethanave të veçanta të vendit tonë, që prej sensibilizimit për këto vlera, prej elitës sonë intelektuale dhe shtetërore. Fillesat e krijimit të kuadrit profesional, për vlerësimin e monumenteve, kanë lidhje të përfillshme me emrin e ark. Gani Strazimirit, drejtuesit të institucioneve përkatëse deri në vitet 1988. Ai, me ide të qarta metodike, vlerësues i përgatitjeve profesionale dhe përkushtimit në punë, qe nismëtari i emërtimit të tre inxhinierëve, të cilët për herë të parë u përfshinë në institucionin fillestar, ngarkuar edhe me vlerësimin e trashëgimisë kulturore ndërtimore, atë të grupit të Kulturës Materiale. Këta ishin Aleksandër Meksi, Pirro Thomo dhe Emin Riza. Madje si rrallë edhe në vende të zhvilluara, fill prej këtij emërtimi, G. Strazimiri, nuk i emërtoi të tre këta studiues restaurator të ardhshëm, mbulues të mbarë fushave të trashëgimisë. Konkretisht, ai ngarkoi A. Meksin me gjininë e ndërtimeve inxhinierike, P. Thomon me monumentet e kultit dhe E. Rizën me banesën popullore. Të dy kolegët e parë, pas krijimit të Institutit të Monumenteve, i zgjeruan fushat e tyre. Kjo zgjidhje ishte, thellësisht frytdhënëse për thellimin e studimeve në fushat respektive dhe më tej, ngritjes së nivelit profesional të ndërhyrjeve restauruese. Këto ndërhyrje parakuptonin njohjen sa më thellë të vlerave dhe historikut të monumenteve të veçantë dhe shumësisë së tyre në hapësirë dhe kohë. E ardhmja e këtyre nismëtarëve të krijimit të brezit të parë të profesionistëve, në fushën e monumenteve, lidhet së pari me vetëformimin profesional, në mbarë veprimtaritë vlerësuese të monumenteve, duke filluar prej gjurmimit dhe propozimeve për vënie në mbrojtje, deri te botimet, lidhur me vlerat dhe ndërhyrjet restauruese në to. Veprimtaria për vënien në mbrojtje të monumenteve dhe dokumentimi i tyre grafik, fotografik dhe përshkrimor, rritën numrin e punonjësve ndihmës, gjithashtu të zgjedhur me kritere kryesisht profesionale. Prej tyre me kohë, u formua brezi i dytë i restauratorëve, rreth dy dhjetëvjeçarësh pas formimit të Institutit të Monumenteve. Edhe ky brez, për disa vjet, pas kthesës politiko-shoqërore të viteve 1990, punoi me profesionalizëm, duke qenë pasardhësit e tyre, larg kërkesave në këtë fushë. Shkaku, natyrshëm duhet kërkuar në

DO NOT COPY

shpërkujdesjet, tejet dëmprurëse, për trashëgiminë kulturore prej shtetit dhe shoqërisë sonë. Vënia në mbrojtje e vlerave ndërtimore, përfaqësuese të drejtpërdrejta të kontekstit ekonomiko-shoqëror të kohës dhe hapësirës ku janë ngritur, është e lidhur ngushtas me ndërhyrjet restauruese në këto vepra. Interesimet e para, në rrafsh evropian dhe më gjerë për vlerat e monumenteve, janë dukuri e shek. XIX, duke përmendur kryesisht Francën, Italinë, Anglinë etj. Vënia në mbrojtje e vlerave të spikatura, së pari tipologjikisht, domosdoshmërish lidhej me përkujdesjet për ruajtjen e tyre, përgjithësisht në momentin e vënies në mbrojtje. Si fushë e re studimore, ajo e vlerësimit të monumenteve, përfshinte dhe restaururimin, veprimtarinë që synonte ruajtjen e vlerave origjinale kompozicionale, arkitekturore dhe teknike të këtyre veprave[1]. Parimet e restaurimit, gjithë duke qenë ndërkombëtare, në drejtimet thelbësore të tyre, kërkojnë interpretime në çdo rast të dhënë. Me interpretim kuptojmë shkallën dhe mënyrën e zbatimit të këtyre parimeve, në çdo përballje me problematikat konkrete restauruese. Ky interpretim, domosdoshmërish, duhet të kryhet prej restauratorit të kualifikuar dhe të fitojë zbatueshmërinë prej organesh të specializuara kompetente, për të mos lejuar gabime eventuale. Restauratori, kuptueshëm, duhet të jetë domosdoshmërisht specialist i fushës së cilës i përket monumenti për t'u restauruar dhe njohës i thellë i vetë atij. Monumentet ndërtimorë vijnë në ditët e sotme, apo më saktë, në momentin kohor të vënies në mbrojtje, me ndryshime të llojeve dhe përmasave të ndryshme, të cilat shtrojnë problematika lidhur me qëndrimin ndaj tyre. Parimet e përgjithshme të restaurimit rekomandojnë që fazat e ndryshme të ndërtimit të një monumenti, duhet të ruhen, sepse ato përfaqësojnë tregues kompozicionalo-teknik të hapësirave, apo periudhave të ndryshme kohore, pra janë dëshmi. Ndërkohë kur këto faza janë shtesa vëllimesh, apo ndryshime që cenojnë treguesit tekniko-arkitekturorë të veprës, sipas rastit, mund të hiqen pjesërisht, apo plotësisht. Pjesët munguese të veprës, përgjithësisht nuk rindërtohen me përjashtim të rasteve kur ky rindërtim siguron qëndrueshmërinë e pjesëve origjinale të monumentit. Në çdo ndërhyrje, duhet që brenda mundësive, të respektohen teknikat origjinale dhe ndërhyrjet të kryen me materiale origjinalë. Pa hyrë në hollësi, do të pohonim se restaurimi synon ruajtjen e gjendjes ekzistuese, pra atë të momentit të vënies së saj në mbrojtje, me cilësinë e monumentit dhe jo detyrimisht, kthimin e tij në gjendje origjinale, apo fazës së parë të ndërtimit. E përfundojmë këtë temë, me sentencën e teoricienit të shquar të restaurimit Çezare Brandi: "Restaurimi i drejtohet vetëm materies, sepse akti krijues i veprës është i papërsëritshëm".

***

Vlerësimi i trashëgimisë kulturore ndërtimore, në Shqipërinë e pasluftës së Dytë Botërore, duke pasur parasysh përvojën evropiane, pati përparësinë për të ndjekur metodikën bashkëkohore në këtë fushë. Kjo metodikë, me hapësira kohe krahasimisht të vogla, kryesisht me fillesa rreth viteve 1960, shfaqi edhe në sferën zbatuese, përfundime të gjera në rrafshin tipologjik dhe atë të shtrirjeve hapësirore dhe kohore të veprave ndërtimore. Kuptueshëm, ky barastrajtim, nuk mund të ishte përpikmërisht i barasshpërndarë. Në këtë kontekst, Qendra Historike e Gjirokastrës, shfaqet si siti me përkujdesje të dallueshme në disa rrafshe parësore. Do të pohoja, tashmë profesionist i vlerësimit të gjinisë së ndërtimeve popullore, se dukuria e mësipërme, bart shkaqe lidhur me shfaqjet praktike të fushës studimore. Interesimet për Gjirokastrën, lidhen kështu kryesisht me vlerat e saj, të panjohura dhe angazhimin për njohjen profesionale të tyre, së pari prej një specialisti. Më tej, pas Qendrës Arkeologjike të Butrintit, Qendra Historike e Gjirokastrës në vitin 2008 u shpall "Pasuri botërore", duke fituar kështu vlerësimin më të lartë në rrafsh planetar. Viti 2015, duke shënuar dhjetëvjetorin e kësaj ngjarjeje, shfaq njëherazi një rast për të kthyer vëmendjen, ndaj kësaj vlere madhore të kulturës shqiptare, e cila, për llojin e saj, është njëherazi dhe dokument i prekshëm i mënyrës së jetesës të kombit tonë, gjatë mesjetës së vonë. Ky përvjetor, njëherazi besojmë se do të jetë shtysë për dy veprimtari paralele në rrafshin e përkujdesjeve për këtë trashëgimi. Së pari theksojmë veprimtarinë restauruese, e cila duhet zgjeruar dhe thelluar dhe së dyti, atë studimore dhe përhapëse të këtyre arritjeve, për ndërgjegjësimin përherë dhe më të gjerë dhe të thellë, të dijeve për vlerat e kësaj vepre madhore të krijimtarisë

[1] Riza, E., *Teoria dhe praktika e restaurimit të monumenteve të arkitekturës*, Tiranë 2002; Meksi, A., *Restaurimi i monumenteve të arkitekturës*, Tiranë 2004.

DO NOT COPY



*Fig. 6. Banesë gjirokastrite*

shqiptare në shekuj. Duke qenë se në qendrat historike të vëna në mbrojtje shtetërore, banesat përbëjnë pjesën kryesore të tyre, atëherë, veçanërisht shfrytëzuesit e tyre për banim, për të mos ndërhyrë për përshtatje të dëmshme, duhet që të kenë njohuri përherë dhe në rritje, për vlerat e tyre të papërsëritshme.

Gjirokastra për vlerat e saja urbanistike dhe ndërtimore, kryesisht të spikatura në fortifikimin e saj dhe gjerësisht në banesën tipike të saj, ndërtime këto mbi troje të aksidentuara shkëmborë, kanë tërhequr me kohë edhe vëmendjen e vizitorëve të huaj, kryesisht studiues. Këta të fundit, me veprat e tyre mbi të kaluarën shqiptare, veçanërisht në fushën ndërtimore e gjejnë Gjirokastrën me tipare të veçanta. Pa qenë specialistë të fushës ndërtimore dhe njëherazi, bartës të teorisë së importimit të dukurive ndërtimore, veçanërisht në kombe të vegjël si iliro-shqiptarët, dukurinë e shquar ndërtimore Gjirokastër, e lidhin madje me ndikime perëndimore. Kuptueshëm, këto impresione të figurave të njohura të kohës, kryesisht të shek. XVIII-XIX, janë jashtë rrafshit ngushtësisht studimor, por përmendja e sitit Gjirokastër, prej këtyre intelektualëve ka qenë dhe mbetet një vlerësim i përfillshëm për këtë qendër. Themi i përfillshëm, sepse ai ka ndikuar pozitivisht, në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar për vënien në pah të vlerave të kësaj qendre.

Fillesa e kthimit të sitit të Gjirokastrës, një vendbanim, me vlera të veçanta, duhet mbajtur shpallja e tij "qytet-muze" krahas Beratit, me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave më 2.6.1961. Ky vendim, veçanërisht pas krijimit të Institutit të Monumenteve të kulturës më 1965, u pasua natyrshëm me ndërmarrjen e veprimtarive për zonifikimin e këtij siti, klasifikimin e monumenteve, forcimin administrativo-profesional të Degës së Monumenteve në Gjirokastër etj. Këto veprimtari, në fillesat e tyre, të kryera kryesisht prej sektorit të arkitekturës popullore të IMK, qenë të lidhura me rritjen profesionale të kuadrit studimor-restaurues për këtë gjini ndërtimore dhe posaçërisht të specialistëve që do të kishin nën kujdes këtë qendër. Siti i Gjirokastrës iu ngarkua për përkujdesje profesionale, autorit të këtij artikulli, i cili që prej krijimit të IMK qe përgjegjës i sektorit të banesës popullore. Njëherazi, që prej vitit 1965 deri në vitin 1975, drejtori i IMK, ark. Gani Strazimiri, si kreu i institucionit dhe specialist i fushës, qe mbikëqyrës i veprimtarive sistematike për vënien në mbrojtje, dokumentimin, restaurimin dhe barazisht atyre studimore. Me termin e fundit në rastin në shqyrtim, kuptohet njohja e gjerë dhe përherë më e thelluar e vlerave ndërtimore të qytetit, kryesisht banesa. Veprimtaria studimore në Gjirokastër, në kategorinë e banesës popullore, i pati fillesat rreth viteve 1970, duke qenë njëherazi kjo veprimtari, në funksion të temës së disertacionit të Emin Rizës. Zonifikimi i Qendrës historike të Gjirokastrës u krye prej ark. Gani Strazimirit dhe ark. Misto Mele, ndërsa përcaktimi i monumenteve të kategorisë së parë, iu ngarkua E. Rizës. Kjo veprimtari bashkëplotësuese, në shërbim të identifikimit hapësiror dhe sipas monumentesh të veçantë, shfaqej si veprimtari tipikisht studimore. Kjo e fundit, si synuese për afrim përherë dhe në rritje ndaj të vërtetave. Fillimet e prekshme të veprimtarisë studimore, shfaqen me botimet e karakterit kërkimor, të cilat në formë artikujsh, monografish dhe albumesh, i ofrohen studiuesve, universitarëve dhe të

DO NOT COPY



*Fig. 7. Banesë gjirokastrite*

interesuarve për tematikat e trajtuara. Në dy numrat e parë të revistës Monumentet botohen dy artikujt e parë për Qendrën historike të Gjirokastrës[2]. Artikulli i parë në titullin e tij përcakton karakterin e njësisë themelore ndërtimore të qytetit, atë të banesës, duke vënë në pah tiparet mbrojtëse të saj shfaqur dukshëm në pamjen e saj, veçanërisht atë kryesoren. Sot, pas dyzet e katër vjetësh, kur studimet për banesën shqiptare dhe veçanërisht atë qytetare, kanë ecur ndjeshëm, me profesionalizëm në rritje, mund të pohohet pa mëdyshje, se klasifikimi i banesës gjirokastrite, nuk ka pësuar ndryshime. Kjo për dy arsye bashkëplotësuese, sepse kriteri i klasifikimit tipologjik ka qenë parësori dhe se vrojtimi i kësaj qendre, lidhur me zhvillimin në kohë të banesës, ka rrokur shfaqjet thelbësore. Më konkretisht, tipi i banesës gjirokastrite u ndesh i shfaqur në tre variante, ai perpendikular, me gjysmëkat (Fig. 6), me dy nënvariante, sipas zhvillimit në lartësi, si dhe varianti qoshe (me një krah) (Fig. 7) dhe varianti divitli (me dy krahë) (Fig. 8). Emërtimet në kllapa, janë ata të monografisë së parë për ndërtimet e Gjirokastrës[3]. Në këtë artikull rikonfirmohen tiparet mbrojtëse të banesës gjirokastrite dhe mbahet qëndrim ndaj shkaqeve ekonomiko-shoqërore që kushtëzuan lindjen e këtij tipi origjinal, në përbërësin e tij kryesor, atë të kompozimit. Duke iu referuar zhvillimit në kohë të banesës gjirokastrite, hidhet hipoteza për tiparet kombëtare të këtij tipi, e cila është konfirmuar prej specialistëve të fushës. Në numrin 2/1971 të revistës "Monumentet", siç përmendëm, gjallëruesi i veprimtarisë për vënien në mbrojtje të trashëgimisë ndërtimore shqiptare G. Strazimiri, ka shkruar artikullin e përmendur. Në këtë punim të hershëm, duke konsideruar vetëm ata prej profesionistësh, autori shfaq përpjekjet e para për të vënë në dukje, në gjini e rrjedha kohore, pasuritë ndërtimore të Gjirokastrës. Më tej, në këtë artikull parashtrohet zonifikimi i qytetit për efekte të

[2] Riza, E., "Banesa e fortifikuar gjirokastrite", *Monumentet*, 1/1971; Strazimiri, G., "Gjirokastra dhe vlerat e saj kulturale", *Monumente*t, 2/1971.

[3] Riza, E., *Qyteti-muze i Gjirokastrës*, 1980, 2004.

DO NOT COPY



*Fig. 8. Banesa e Skëndulajve*

DO NOT COPY

mbrojtjes dhe restaurimit të kësaj pasurie unikale. Edhe kalaja e Gjirokastrës, fillesa e qytetit, është trajtuar në treguesit e saj kryesor prej studiuesit Apollon Baçe[4].

Akti me vlera të rëndësishme metodiko-praktike qe "Rregullorja mbi mbrojtjen, restaurimin dhe administrimin e qytetit-muze të Gjirokastrës", hartuar prej G. Strazimirit[5]. Kjo rregullore, e shoqëruar me zonifikimin e Qendrës historike dhe listën e monumenteve të kategorisë së parë, në parimet e saj nuk bie të reja, në krahasim me rregulloren e parë të këtij lloji, hartuar dhe miratuar në vitin 1961. Për këtë rregullore dhe në përgjithësi për identifikimin e vlerave urbanistiko-arkitekturore të Beratit, ndihmesa me vlerë, pat dhënë dhe arkitekti çek Kostka. Ashtu si për Beratin dhe për Gjirokastrën, dy qenë kriteret thelbësorë për vënien në pah të vlerave urbanistiko-arkitekturore. Kështu, dhe për Qendrën Historike të Gjirokastrës në rrafshin urbanistik, rregullorja përkatëse shfaqej me ndarjen hapësinore të Qendrës historike në zonën-muze dhe atë të mbrojtur, duke pasur pranë, apo përreth, hapësirën cilësuar zona e lirë. Vetë monumentet sipas vlerave, kryesisht kompozicionale, ndahen në monumente të kategorive të para dhe të dyta. Zona muze dhe monumentet e kategorisë së parë ruhen në mbarë treguesit e tyre kompozicionalë dhe teknikë, ndërsa përbërësit e tjerë hapësinorë dhe monumentet e veçantë të kategorisë së dytë, mund të pësojnë ndryshime të pjesshme. Këto të fundit gjithmonë pa cenuar vlera të rëndësishme dhe me miratime të domosdoshme prej institucionit të specializuar të fushës. Në vitin 1984, të dy rregulloret e Qendrave historike të Beratit dhe Gjirokastrës, përmblidhen në një të vetme, duke çliruar të parën prej konsideratash dytësore. Ndryshimet e këtyre dy qendrave në rrafshet urbanistike dhe ato ndërtimore, madje të përfillshme, deri në ndryshueshmëri të spikatura, brenda të njëjtave përbashkësi funksionale, nuk cenohen prej së njëjtës rregullore.

Studimi i qytetit të Gjirokastrës, ashtu si mbarë trashëgimisë sonë ndërtimore dhe studimore albanologjike në përgjithësi, u ndesh prekshëm me marrëzitë ç'njerëzore dhe antikombëtare njëherazi, të imitimit të pseudorevolucionit

[4] Baçe, A., "Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër)", *Monumentet*, 4/1972.

[5] "Rregullore mbi mbrojtjen, restaurimin dhe administrimin e qytetit-muze të Gjirokastrës", *Monumentet*, 5-6/1973.

kulturor kinez. Ishin vitet 1967, kur Shqipëria enveriste, pas qenies bisht i serbëve, pas vitit 1948 i rusëve dhe pas viteve 1960 i kinezëve, po vijonte rrugën e vetnënshtrimit, e cila subjekt të tij kishte, në radhë të parë dhe mbi të gjitha, popullin e përvuajtur shqiptar. Fill pas themelimit të Institutit të Monumenteve dhe në këtë institucion, zhvleftësimi deri në rrënim i trashëgimisë kulturore të kulteve, u shoqërua, ndërmjet të tjerash dhe me pezullimin e veprimtarive studimore për marrjen e titujve shkencorë. Synohej pra dhe barasrrafshimi i profesionistëve, apo barasshpërndarja e mediokritetit. Pa hyrë në hollësi, kjo gjendje unikale, në Europën e prirjeve gjithëkohore të përparimit, u kalua krahasimisht shpejt në Shqipëri. Kështu, autori i këtij artikulli, rifilloi veprimtarinë përnjohëse të vlerave urbanistiko-ndërtimore të Gjirokastrës me synimin e hartimit të një studimi, i cili do të paraqitej për të mbrojtur kërkesën për shkallën e parë të klasifikimit shkencor, atë të "Kandidatit të shkencave". Gjatë viteve 1977-78, u kryen pesë ekspedita dyjavore në Gjirokastër. Në këto hulumtime përnjohëse, u vrojtuan me kujdes të veçantë profesional, mbarë banesat e Gjirokastrës, Kalaja dhe ndërtimet e pakta të kultit dhe ato shoqërore. Ky vrojtim, u shoqërua me konsiderata shkrimore, mbi variantet tipologjikë, tipat e ndërtimit, elementet arkitekturorë, materialet dhe teknikat e ndërtimit, si dhe shkallën e autenticitetit të ndërtimeve, ritheksojmë duke qenë me përparësi të dukshme numerike, banesat popullore. Cilësori popullore, lidhet me dukurinë, thuajse të vetme në mbarë vendbanimet shqiptare, se ndërtimet konceptoheshin prej porositësit dhe realizoheshin prej grupimeve tradicionale të mjeshtërve, të cilët e fitonin profesionin në punë. Kjo përnjohje thelbësore, kuptueshëm jo e vetmja, por tejet afruese ndaj të vërtetave mbi këtë veprimtari, ishte arritja e parë në fushën krahasimisht të re të studimit të ndërtimeve popullore, së pari banesës. Madje edhe në vendet e tjerë ballkanikë dhe më tej evropianë, dukuria e studimit të



*Fig. 9. Pamje e Ujësjellësit të Kalasë. Gravurë nga E. Lear (1851)*



*Fig. 9. Pamje pjesore e Ujësjellësit të Kalasë*

ndërtimeve popullore është sa e vonë, ashtu si në Shqipëri e gjysmës së dytë të shekullit XX, aq edhe ende larg njësimit metodik dhe vlerësues më gjerë. Ideja e gabuar, se për t'u përfillur janë vetëm veprat e shquara, është në bazën e këtij qëndrimi. Ky i fundit edhe shkencat historike, i lidh

DO NOT COPY

praktikisht me ngjarjet "kulmore", duke lënë mënjanë dukuritë thelbësore, ato të lidhura me përditësitë e tejgjata kohore, në po aq hapësira të tejmëdha.

Njohja e përqendruar në sitin e Gjirokastrës, pas një përvoje mbi dhjetëvjeçare me veprimtari përnjohëse dhe restauruese me monumentet, tashmë ishte e mjaftueshme për një studim përmbledhës për këtë sit. Erdhi kështu, përballja me synimin për sistemimin, përzgjedhjen dhe renditjen e konsideratave mbi këtë qendër, e cila vijueshëm po më bindte për rëndësinë e këtyre vlerave për kombin dhe rrethanat që i krijoi. Më tej, njohja me vlerat paralele funksionale, po ma shfaqte këtë qendër unikale, në treguesit thelbësor të saj. Udhëheqësit metodikë për vrojtimet e kësaj qendre, kanë qenë të lidhur me pikëpamjen se të dhënat e vrojtuara, me shkallë të përfillshme në mbarë shfaqjet dhe përbërësit e saj kompozicionalë dhe materialë, përbëjnë dukurinë e patjetërsueshme burimore, krahas atyre paralelë. Këta të fundit lidhen me historinë e rajonit dhe përgjithësisht të shoqërisë shqiptare në hapësirë dhe kohë. Më tej problemi, apo pseudoproblemi i huazimeve ka qenë përfillshëm i konsideruar, duke pasur parasysh dukurinë diletanteske se çdo krijimtari, pra edhe ajo ndërtimore lidhet me etnosin sundues, në rastin shqiptar kryesisht atyre romakë dhe turk. Mbetemi në pikëpamjen tonë se s'ka lidhje shkak-pasojë të pushtetit politik me veprimtaritë ndërtimore dhe më prektas, me banesë shqiptare kuptojmë banesën e ndërtuar nga shqiptarët për shqiptarët. Edhe studiuesi i njohur turk Reha Gunai, në një vepër të rëndësishme të vitit 1998 shkruan: "Banesa turke mund të përcaktohet si tipat e banesave, në të cilat turqit kanë jetuar përgjatë historisë"[6]. Më tej, materialet dhe teknikat e ndërtimit kanë përhapje pa lidhje të drejtpërdrejtë me llojin e etnisë. Elementet e ornamentikës, përgjithësisht pjesë e banesave të shtresave të pasura e kanë theksuar dukurinë e huazimit. Shpesh vlerësuesit diletantë të banesës popullore, i shohin këto huazime si paracaktuese për vlerat e kësaj tipologjie ndërtimore. Kështu, madje ende, ndeshim pohime pseudocilësuese të banesës gjirokastrite, si banesë turke. Është rasti për të ripohuar se vetëm popujt thellësisht të prapambetur, janë krejtësisht origjinalë. Iliro-shqiptarët, mbarëshekujsh janë treguar përthithës të arritjeve bashkëkohore të zbatueshme në kontekstin e dhënë historiko-shoqëror, pa qenë kjo dukuri, përcaktuese për trashëgiminë shumëshekullore të njësisë së parë ndërtimore, asaj të banesës.

[6] R. Günay, *Tradition of the Turkish house and Safranboulu houses*. 16.

Monografia "Qyteti-muze i Gjirokastrës", fryt i studimeve trevjeçare, së pari trajton tiparet e kësaj qendre të banuar, e cila i ka fillesat në periudhën e vonë mesjetare. Ashtu si shumica e qendrave qytetare shqiptare dhe më gjerë, fillesa dhe pjesa kryesore e këtyre qendrave, ka qenë fortifikimi, apo kalaja. Ky ndërtim mbrojtës, i cili që në krye, ka pasur edhe funksione të pjesshme banimi, i përket gjysmës së dytë të shek. XIII[7]. Ai ka pasur, herë pas here, ndërhyrje për rindërtime të pjesshme dhe më tej për zgjerime. Është fjala për vitet 1811-12, kur Ali pashë Tepelena, pas një qëndrese të spikatur të bashkësisë së gjirokastriteve, përfshiu në hapësirat nën administrimin e tij edhe Gjirokastrën. Ai fill pas marrjes së drejtimit të Gjirokastrës, shtoi vëllimin jugperëndimor të Kalasë dhe kreu punime ripërtëritëse në pjesën ekzistuese të saj. Më tej, ai urdhëroi ndërtimin e ujësjellësit monumental të Kalasë (Fig. 9).



*Fig. 10. Pamje e pazarit të Gjirokastrës*

[7] *Burime për historinë e Shqipërisë*, dk. 91, VII, II, Tiranë 1962; *Histori e Shqipërisë*, Vëll. II, 231, Tiranë 1959.

DOKTORATURA

Nga të dhënat e derisotme mbi Gjirokastrën, mendojmë se në fillim të shekullit XV, përbri hyrjes veriore të saj, ka qenë një hapësirë e banuar dhe një zonë ku zhvilloheshin veprimtari tregtare. Pazari, i cili emërtohej "Pazari i Kalasë", sipas të dhënave të E. Çelebiut (mesi i shek. XVII), rreth fillimit të shek. XVII fillon të shtrihet në zonën e sotme. Vetë qyteti, fill pas ngritjes së Kalasë, kthehet në një qendër të rëndësishme administrativo-ushtarake, e cila prej një kronisti të kohës, emërtohet qytet dhe kështjellë. Në gjysmën e dytë të shek. XIV Gjirokastra u bë qendër e zotërve feudalë Zenevisë, ndërsa në vitin 1419, u pushtua nga Osmanët, dhe caktohet kryeqendër e Sanxhakut të Shqipërisë.

Gjirokastra në përqasje me karakterin e saj si qendër e banuar qytetare, cilësorin qytetar e shpreh kryesisht, gjatë mbarë shek. XIV-XIX, si qendër administrative rajonale. Gjirokastra nuk qe një qendër e mirëfilltë zejtaro-tregtare. Pazari i saj (Fig. 10) qe kryesisht qendër tregtie, ndërsa prodhimi zejtar vendas qe i vogël. Edhe në rrafshin urbanistik, lagjet e banuara shfaqin vlerat më të rëndësishme të kësaj qendre. Zhvillimi i qytetit të hapur, në thelb vetë qytetit, për arsye historike, shfaqet ndjeshëm gjatë shek. XVI, duke pasur ai, në fund të tij, 302 banesa[8]. Emërtimet e lagjeve të kësaj periudhe, kryesisht mbanin emërtime kryefamiljarësh. Shek. XVII shënon rritje të mëtejshme të qytetit, siç mund të ndiqet prej të dhënave të E. Çelebiut[9]. Ai përmend emërtime lagjesh, që ruhen ende sot, duke na mundësuar të pohojmë se rreth çerekut të tretë të shek. XVII, Gjirokastra arriti shtrirjen e sotme, me njësi ndërtimore rreth Kalasë, natyrisht me dendësi më të vogël ndërtimesh. Ngritur mbi një truall tejet të aksidentuar, bashkësi lartësish, luginëzash, kurrizesh kodrinore, gjithë duke ruajtur afri të ndryshme, Gjirokastra shfaq një lidhje të përkryer me truallin, duke qenë njëherazi sa e larme, aq dhe unike (Fig. 11) Kalaja dhe bashkësitë e banesave, madje dhe disa shembuj të veçantë, shquajnë Gjirokastrën e papërsëritshme shqiptare, si arritje madhore e krijimtarive ndërtimore të mesjetës së vonë.

Siç përmendëm, gjinitë ndërtimore mbrojtëse dhe ato të kultit, kanë qenë objekt trajtimesh, të themi anësore edhe para mesit të shekullit të kaluar. Vetëm gjinia e banesës popullore i ka fillesat rreth viteve 1960, duke qenë monografia, "Qyteti-muze i Gjirokastrës", e para e llojit, njëherazi mbi kritere profesionalizmi. Banesa popullore e qytetit të Gjirokastrës, kuptueshëm ka shfaqur në këtë vepër, kategorinë ndërtimore më thelbësore të qytetit dhe njëherazi, dukurinë ndërtimore me arritje sa unikale, aq edhe madhore në mesjetën e vonë (sh. XV-XIX) shqiptare dhe më gjerë. Kjo vepër, është mbështetur mbi vrojtimet sistematike të banesës gjirokastrite, me shembuj të shumtë të fundit të shek. XVIII, atij të XIX dhe më vonë. Prej tyre, shembuj të shumtë, përsërisin variante dhe nënvariante të thjeshtë, apo fillestare të tipologjisë së kësaj banese. Renditja e vijimësisë tipologjike të banesës gjirokastrite, identifikimi dhe konsiderimi i kësaj ecurie thelbësore për karakterizimin e saj, është e shpjegueshme. Ky pohim, lidhet me bindjen tonë të thellë, në vërtetësinë e aksiomës, se dukuritë ndërtimore, ashtu si ato që lidhen me veprimtarinë njerëzore, në treguesit e tyre thelbësorë, pasqyrues të shkallës së zhvillimit të shoqërisë, brenda hapësirash të caktuara. Këto



*Fig. 11. Pamje banesash lidhur me truallin*

[8] Pulaha, S., *Qytetet shqiptare nën regjimin feudal ushtarak gjatë shekujve XV-XVI.*

[9] Çelebi, E., "Shqipëria 350 vjet më parë", *Horizont* 2000.

DO NOT COPY



*Fig. 12. Tavan dekorativ i Skëndulit*

hapësira dhe faktorë të tjerë, përcaktojnë mënyrat e sigurimit të jetës dhe përbërësit thelbësor të saj banesës. Qendra e banuar e Gjirokastrës, shfaq një veçanti të dalluar, duke mos qenë, si përgjithësisht qendër zejtaro-tregtare, por qendër administrative dhe siç e cilëson J. G. Han[10], "vendqëndrimi i pronarëve të tokave". Pronat e latifondistëve gjirokastritë edhe në Dropull shpjegojnë ndërtimin e kullave në fshatrat e kësaj zone[11]. Këto shtresa të përmendura, kuptueshëm shfaqin gjendjen e tyre edhe nëpërmjet karakterit të banesës. Ato ishin krahasimisht të mëdha dhe synonin të ishin edhe sa më të mbrojtura. Tiparet mbrojtëse i vë në dukje Hani dhe të tjerë, si Pukëvili i cili shkruan: "Shtëpitë janë si kala dhe kanë rreth e rrotull frengji. Këta njerëz jetojnë si në luftë". Më tej Hani vëren se feudalët gjirokastrite, kishin fituar një farë pavarësie, duke përfituar prej dobësimit të centralizmit të pushtetit turk dhe kur ishte çështja për ta ruajtur atë :

[10] Hahn, J. G., *Albanesische Studien*, Jena 1854,41.

[11] Riza, E., Kamberi, Th., "Kullat në fshatin Goranxi", *Monumentet*, 3/1972.



*Fig. 13. Oxhak i odës së mirë (Zekatët)*

"atëherë luftimet private pushonin, dhe partitë kundërshtare bashkoheshin, kur e kërkonin interesat e qytetit. Më tej, ai e cilëson Gjirokastrën[12] një lloj republike aristokratike, feudalët e së cilës i bindeshin deri diku pashait të Delvinës". Tiparet e theksuara mbrojtëse të banesës gjirokastrite, janë shkaku i emërtimit të saj sot, dhe besojmë gjithëheri, "kullë qytetare", apo "banesë e fortifikuar". Banesa gjirokastrite në rrafshin kompozicional, është trekatëshe me ndarje të kohshme funksionale sipas kateve. Kështu kati përdhe, shërbente për kafshët e ngarkesës, dhe ndërtimin e depozitës së ujit të shiut (sterës), kati i ndërmjetëm i shërbente familjes gjatë stinëve të ftohta, ndërsa i sipërmi gjatë verës. Materialet kryesore ndërtimore ishin guri dhe druri të përdorura sipas teknikave mbarë shekullore. Elementet funksionalo-arkitekturorë

[12] Hahn, J. G., *Vep. cit*. 52.

DO NOT COPY

në rrafshin e trajtimit shfaqen me ecuri në kohë. Së fundi ornamentika (Fig. 12, 13) dhe më pak trajtimi i elementeve shfaqin edhe dukurinë e huazimeve. Kjo e fundit është më e spikatur, në banesat e shtresave të pasura.

Vitet 1960, shënojnë edhe ndërhyrjet e para në banesat gjirokastrite, duke filluar prej veprave më me vlera, njëherazi të rrezikuara prej dëmtimeve në strukturat mbajtëse. Parimet e restaurimit, veçanërisht pas ngritjes së Institutit të Monumenteve, gjejnë zbatim përherë dhe më rigoroz, me synimin e ruajtjes së vlerave origjinale të këtyre monumenteve, kryesisht si dëshmi të mirëfillta historiko-kulturore. Veprimtaria njohëse dhe studimore për banesën gjirokastrite, kuptueshëm qe një ndihmesë përherë dhe në rritje, për zbatimin e drejtë të kritereve të restaurimit për çdo banesë-monument. Në vitet e para, pas krijimit të Institutit të Monumenteve u ndërhy dhe në banesat me vlera të spikatura tipologjiko-arkitekturore si ato të Zekateve (Fig. 14), Skëndulajve, Kikinos (Fig. 15), Totozanit, Angonatëve, Pazarit të qytetit dhe vëllimit të kullës veriore të Kalasë (Fig. 16). Forcimi i Degës së monumenteve të Gjirokastrës, rritja e numrit të mjeshtërve dhe ndihmësve të ngarkuar me zbatimin e projekteve restauruese, e shfaqin dhjetëvjeçarin 1980-1990, si më të vlerësueshmin për rigjallërimin e banesave gjirokastrite.

Shqipëria pseudokomuniste dallohej për lidhjet e skajme me shtetet diktatoriale dhe pas viteve 1980 për vetizolimin e plotë. Në këto kushte, edhe në fushën e kërkimeve albanologjike, bashkëpunimi me studiues të huaj, madje edhe konsultimi i botimeve të huaja, ishte i ndaluar. Në këto rrethana, punonjësit e Institutit të Monumenteve nuk patën dijeni për aktin e rëndësishëm: "Konventa për mbrojtjen e Pasurisë Botërore Kulturore dhe Natyrore" të vitit 1972, të UNESCO-s. Ky akt, hidhte një hap të rëndësishëm dhe të sigurt mbi konsiderimin e vlerave të shquara të trashëgimisë njerëzore dhe asaj natyrore, pasuri që i tejkalon vlerat kombëtare, drejt atyre të mbarë bashkësisë njerëzore, në hapësirë dhe kohë. Në vitin 1989, Shqipëria anëtarësohet në Konventën e përmendur. Viti 1990 shënon një ngjarje me rëndësi për kulturën shqiptare, pjesë e kulturës botërore, e cila për shumë arsye të paarsyeshme, ishte e pavlerësuar deri në shpërfillje. Me nismën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në vitin 1990, Instituti i Monumenteve u ngarkua me plotësimin e dosjeve përkatëse për kërkesën e Shqipërisë



*Fig. 14. Pamje e banesës së Zekatëve*

ndaj UNESCO-s, për cilësimin e Qendrave historike të Beratit dhe Gjirokastrës, Qendrës Arkeologjike të Butrintit, Amfiteatrit të Durrësit dhe Varreve të Selcës, "Pasuri Botërore". Për hartimin e dosjeve respektive u ngarkuan specialistët e fushave përkatëse. Të dy dosjet e para i hartoi Emin Riza, të tretën dhe të katërtën Gjerak Karaiskaj, ndërsa të fundit Neritan Ceka. Dosjet, për çdo sit dhe qendrat e objektet arkeologjike, duhet të përshkruanin ngjeshur dhe saktë, vlerat, historikun, gjendjen dhe arsyet e propozimit për Pasuri Botërore. Ato u dorëzuan në emër të qeverisë shqiptare në UNESCO, në vitin 1990. Hapësira kohore e dërgimit të kësaj kërkese, me vlera të veçanta për trashëgiminë kulturore shqiptare dhe më gjerë, qe tepër e papërshtatshme, sepse e lidhur me ngjarjet madhore për përmbysjen e regjimit më diktatorial të shek. XX në Evropë, atij të emërtuar

DO NOT COPY



*Fig. 15. Pamje e banesës së Kikinos*



*Fig. 16. Kulla veriore e Kalasë së Gjirokastrës*

DO NOT COPY

enverizëm. Turbullitë qeveritare e bënë të vështirë, deri në pamundësi, ndjekjen e kërkesës për cilësim Pasuri Botërore, të pesë monumenteve shqiptarë. Kujtesa më thotë se pas disa muajsh, prej dërgesës sonë në UNESCO, erdhën kërkesat e para për të dhëna të reja dhe shtjellime më të gjera, të dosjeve të dërguara. Përsërisim se, konsiderimi i tyre qe i pamundur. Në këto rrethana, praktikisht nuk mundësohej asnjë lidhje e palës shqiptare me UNESCO-n, për përmirësime eventuale të kërkesave. Ndërkohë, vënia në mbrojtje e Qendrës Arkeologjike të Butrintit, si "Pasuri Botërore", në vitin 1992, qe një ngjarje madhore për kulturën shqiptare. Më tej rifillimi i bashkëmarrëdhënieve Shqipëri UNESCO u nxit dhe prej krijuesit dhe intelektualit tonë të shquar Ismail Kadare, i cili shfaqi edhe me këtë rast mëmëdhetarin e tij, duke ndërhyrë për riparaqitjen e dosjes për cilësimin e sitit të Gjirokastrës "Pasuri Botërore". Kërkesa zyrtare e Qendrës së Pasurisë Botërore të UNESCO-s, drejtuar qeverisë shqiptare për riparaqitjen e kërkesës për Gjirokastrën, në vitin 2001, shënoi fillesat e përgatitjes së dosjes. Hartimi i saj iu ngarkua studiuesit të banesës qytetare dhe sitit të Gjirokastrës Emin Rizës. Theksojmë se, kërkesat për cilësitë e dosjeve për cilësimin e monumenteve Pasuri Botërore, tashmë në prag të shekullit të ri ishin tejet më të gjera dhe njëherazi të thella. Arsyet duhen kërkuar në rritjen e numrit të kërkesave për cilësimin "Pasuri Botërore", e cila kuptueshëm kërkonte vlerësime sa më profesionale dhe njëherazi në kufij bashkëbarazie, ndaj mbarë kërkuesve. Krahas, njohja e pakët e vlerave kulturore të Shqipërisë dhe më tej të arkitekturës sonë popullore, do të shtonin kategori ndërtimore, madje pak të njohur, duke shfaqur kuptueshëm kërkesën shqiptare, së pakti problematike.

Bindja jonë, për vlerat urbanistiko-arkitekturore të Gjirokastrës, nuk ishte impresion, as një vlerësim i sipërfaqshëm, por njohje, madje thelbësore, e cila ishte bërë e njohur, veçanërisht me monografinë: "Qyteti-muze i Gjirokastrës". Kjo njohje, kuptueshëm ma lehtësoi këtë ndërmarrje, por theksoj se kërkesat e ngjeshura dhe njëherazi thelbësisht përgjithësuese, krahas atyre të themi të rëndomta, kërkonin dije dhe aftësi shprehëse të koncentruara. Bindja jonë, përndjekëse e vijimësisë pesëvjeçare të përmbushjes profesionale të kërkesave prej UNESCO-s, është se specialistët e kësaj organizate, madje dhe drejtues të saj, kanë treguar vijueshëm përkujdesje të përfillshme për kërkesat shqiptare. Përmendim z. Françesko Bondarin,

drejtor i Qendrës së Pasurisë Botërore të UNESCO-s, i cili në takimin që pati me mua, të organizuar me përpjekjet e çmuara të koleges Tatjana Gjonaj, përfaqësuese e Shqipërisë në UNESCO, shfaqi përkujdesje të veçanta për kërkesën tonë. Më tej, do të do të doja të vë në dukje përkujdesjet e dalluara profesionale të z. Azedin Beçaush, për ndihmesa të rëndësishme lidhur me përmirësime të dokumentacionit të përgatitur prej palës shqiptare, për cilësimin e Gjirokastrës dhe më pas Beratit "Pasuri Botërore".

Dosja e kërkesës së Shqipërisë, ndaj UNESCO-s, për përfshirjen e sitit të Gjirokastrës në vlerat e cilësuara Pasuri Borërore, u dorëzua në fillim të vitit 2000. Nisi kështu ndërlidhja, do të thoshim profesionale, ndërmjet UNESCO-s dhe Shqipërisë, për thellimin e të dhënave të dosjes, kërkesave të reja dhe rregullimeve të karakterit formal, të cilat zgjatën rreth pesë vjet. Në muajin shtator të 2001, Gjirokastrën e viziton drejtori i përgjithshëm i UNESCO-s Koishiro Matsura, të cilit I. Kadare, sipas tij i kish thënë: "Shko në Gjirokastër dhe shikoje atë". Matsura në kthim tha: "Unë erdha, ajo që pashë më kënaqi pa masë". Ndërkohë, pas përmbushjes së disa kërkesave për zgjerimin e të dhënave për Gjirokastrën, Shqipëria riparaqet kërkesën në maj të vitit 2002. Edhe kjo kërkesë, pasohet me nevojën për të dhëna të tjera, kryesisht lidhur me menaxhimin e këtij siti. Për të ndihmuar konkretisht në përmirësime të dosjes, në janar të 2003 vjen në Shqipëri, specialisti i UNESCO-s, Alkiviadis Prepis. Atë, në gusht 2003 e pason specialisti F. Brugman, të cilët lanë sugjerimet e tyre për plotësime më të gjera të dosjes , në përputhje me vendimet e reja të Komitetit të Pasurisë Botërore. Pasi u kryen këto plotësime, dosja u ridërgua në janar të vitit 2004. Në vijimësinë e ndihmave për përgatitjen sa më profesionale të dosjes, dhe njëherazi të vrojtimeve të Gjirokastrës për të gjykuar sa më drejt për shpalljen e saj eventuale Pasuri Botërore, në maj të vitit 2004, Komiteti i Pasurisë Botërore të UNESCO-s, dërgon në këtë qytet një grup të tij, prej pesë ekspertësh të fushës. Grupi përfshinte, ish drejtorin e UNESCO-s për Europën Juglindore, Horst Godike, arkeologun Pier Kaban, sekretarin e përgjithshëm të ICOMOS Dino Bamburu, bizantologun Xhanklaudio Maçiareli dhe përfaqësuesin e UNESCO-s në Venecie Damir Dijakoviç. Ky grup hulumtoi Gjirokastrën, pasi ishte njohur me kërkesën tonë dhe shprehu mendimin e tij në Komitetin përkatës të UNESCO-s. Në tetor të 2004 në qytetin e Sarandës organizohet një konferencë e përbashkët shkencore, organizuar prej UNESCO-s dhe Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë. Në këtë veprimtari Horst Godike dhe Koishiro Matsura, rikonfirmojnë sensibilitetin e UNESCO-s, për shpalljen e Gjirokastrës Pasuri Botërore. Në vijim të veprimtarive për vlerësimin e sitit të Gjirokastrës, përmendim vendimin e ICOMOS (Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet) të marsit 2005, për të përcjellë me qëndrim pozitiv, dosjen për shpalljen e Gjirokastrës Pasuri Botërore, pranë Qendrës së Pasurive Botërore për vendimmarrje në sesionin e 29 të saj, që do të mbahej në Durban të Afrikës së Jugut në qershor 2005. Siti i Gjirokastrës u përzgjodh prej ICOMOS, nga grupi prej 40 kandidaturave, duke u përfshirë në atë prej 15 monumentesh, të cilët do të shqyrtoheshin në mbledhjen e radhës të sesionit 29 të Asamblesë të Komitetit të Trashëgimisë Kulturore Botërore. Ky Komitet formohet prej 21 anëtarësh të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të cilët zëvendësohen me rotacion. Në sesionin e 29 të Durbanit, Gjirokastra u shpall "Pasuri Botërore". Ky akt ishte i rëndësisë së veçantë për Shqipërinë dhe shqiptarët, sepse edhe në fushën e trashëgimisë kulturore, kombi iliro-shqiptar po shfaqte fillesat e shpërfaqjes së vlerave të tij, mbështetëse të identitetit shumëshekullor kulturoro-etnik.

Siç kemi përmendur, në kërkesën e parë të Shqipërisë për shpalljen Pasuri Botërore të pesë monumenteve shqiptarë, përfshihej edhe Qendra historike e Beratit. Shpallja e Gjirokastrës, si vlerë e jashtëzakonshme universale, shtronte bindshëm detyrimin për ripërsëritjen e kërkesës prej palës shqiptare për marrjen e të njëjtit vlerësim edhe për Qendrën historike të Beratit[13]. Kjo qendër, padyshim një prej më të vjetrave në Ballkan dhe më gjerë, ruan me gjurmë të pandërprera historinë e saj 24 shekullore. Fillesat si qendër e banuar lidhen me fortifikimin e gjerë, me shumë faza ndërtimi, sepse gjithherë deri më sot, i banuar dhe deri në shek. XIX me funksione mbrojtëse. Në dallim prej vendbanimit të Gjirokastrës, me fillesa në shek. XIII, pra krahasimisht të vonë, ai i Beratit është rreth 17 shekuj më i hershëm.

[13] A. Meksi., A. Baçe., E. Riza., *Berati, historia dhe arkitektura,* Tiranë 1988, 2011.

ROMHOOK

Më tej Kalaja e Beratit ruan faza ndërtimi, gjurmët e të cilave ruhen dhe disa presin të zbulohen. Ndërtimet e kultit në Berat janë sa të hershme, aq edhe me vlera të spikatura që i kalojnë hapësirat tradicionale dhe të sotme shqiptare. Monumentet shoqërore gjithashtu ndeshen në Berat. Banesa beratase, në dallim prej asaj gjirokastrite, qartazi e veçantë tipologjikisht, formohet prej një bashkësie tipologjike, duke përfshirë banesat e hapura me çardak dhe banesat e mbyllura me gjysmëkat, ndërtuar prej guri dhe zgjidhjeve të veçanta. Këto të fundit, ashtu si mbarë ndërtimet e qytetit u shkatërruan rëndë prej Tërmetit Katastrofik të vitit 1851. Për arsye të kuptueshme, banorët beratas të këtij brezi, të lidhur ngushtas me këto troje, i rindërtuan banesat e shkatërruara. Këto rindërtime u kryen sipas koncepteve të reja, të cilat lidheshin me degradimin e shpejtë të kërkesave ndaj banesës tradicionale. Siç e shohim në tre lagjet-muze të Beratit, Kala, Mangalem (Fig. 17) dhe Goricë. Përvetësimi i teknikave të reja të kohës, si strukturat me skelet druri, prunë risi në tipologjinë e banesës. Ndërtimi i gjerë i konsolave në ballet e katit të banesave, për të mundësuar zgjerimin e sipërfaqeve të banuara, në trojet e pjerrët shkëmborë, mbi të cilët ngriheshin, ia ndryshoi ndjeshëm pamjen e Beratit shumëshekullor. Në përqasje me qytetin e Gjirokastrës, kryesisht vendqëndrim i pronarëve të mëdhenj dhe të mesëm të trojeve, Berati qe deri rreth mesit të shek. XIX, qendër e mirëfilltë zejtaro-tregtare, ndër më të shquarat në Shqipërinë Mesjetare dhe atë të Mesjetës së Vonë. Prej studimeve të derisotshme mund të rikonfirmojmë se Berati dhe Gjirokastra, gjithë duke pasur dallime të kuptueshme, më gjerë janë dy vendbanime bashkëplotësues (komplementarë), në tiparet e tyre thelbësore që prej lindjes dhe vijimisht në rrjedhë të historisë shqiptare. Kjo e fundit, e kuptuar së pari dhe mbi të gjitha si bashkësi e veprimtarive mbarëkombëtare, përfshirë në to edhe atë prej më kryesoreve, të ndërtimeve të lidhura drejtpërdrejtë me banimin, në kuptimin e ngushtë të termit dhe më gjerë të jetesës njerëzore.



*Fig. 17. Pamje e Gjirokastrës*

E pohojmë që në krye se ashtu si për Gjirokastrës, edhe për Beratin, organet përkatëse të UNESCO-s, treguan mirëkuptim deri në dashamirësi për vlerësimin e kësaj pasurie, natyrisht duke zbatuar me saktësi të skajme, kriteret për caktimin e një qendre, Pasuri Botërore.

Fillimi i vitit 2006, shënon përgatitjen e dosjes për kërkesën pasuese lidhur me shpalljen e Qendrës historike të Beratit, Pasuri Botërore. Kjo detyrë iu ngarkua Emin Rizës. Përvoja pararendëse dhe njohja e vlerave të Beratit, e shfaqi më të lehtë dhe më afatshkurtër përgatitjen e kësaj dosje. Në Sesionin e 31 të Komitetit të Pasurisë Botërore, të korrikut 2007, Berati nuk u shpall Pasuri Botërore. Në vijim të konsiderimit të vlerave të kësaj qendre prej Komitetit të lartpërmendur, u sugjerua një zgjidhje, e cila gjithë duke qenë në përputhje me rregullat në fuqi, praktikisht i hapte rrugën cilësimit të Beratit, Pasuri Botërore. Në Sesionin e përmendur u formulua rekomandimi pasues: "emërtimi i Qendrës historike të Beratit, Shqipëri (qytet me vijimësi kulturore 25-shekullore dhe bashkëekzistencë fetare) i kthehet shteteve pjesëtare duke i dhënë asaj të drejtën për të përgatitur,

DO NOT COPY

si rast të jashtëzakonshëm, një emërtim seria, bazuar në vlerësimin e mëparshëm të ICOMOS-it, përfshirë dhe një plan të përbashkët menaxhimi, për të dy qytetet, i cili do të trajtohet në sesionin 32 më 2008". Hapësira e re formale, për riparaqitjen e dy qendrave historike shqiptare, Beratit dhe Gjirokastrës, si bashkësi, me sa dimë, rasti i dytë pas një rasti pararendës, për dy fshatra në Spanjë, ishte një zgjidhje, e cila shprehte qartë vlerësimet e këtyre dy siteve prej specialistëve të UNESCO-s. Kjo zgjidhje eventuale, nëse miratohej do ta bënte Shqipërinë me dy njësi të shpallura Pasuri Botërore, Qendrën arkeologjike të Butrintit dhe sitet e Gjirokastrës dhe Beratit. Ky rast, ishte një zgjidhje, e cila mund të cilësohet respektuese e formalizmit burokratik dhe më tej e vlerësimit të prekshëm të dëshmive madhore historiko-kulturore, të dy siteve shqiptare. Më pas, mësuam se kjo zgjidhje ishte kushtëzuar dhe prej ankesave të vijueshme të vendeve afro-aziatikë, për përkujdesje të shpërpjestuara ndaj pasurive evropiane. Për të katërtën herë, Shqipëria po përgatiste paraqitjen e një dosje-çifte që bashkëpërfshinte sitet e Gjirokastrës dhe Beratit. Hartimi i dosjes-çifte, iu ngarkua Emin Rizës, ndërsa plani i menaxhimit u hartua prej ark. Karlo e Françeska Blazi dhe ark. Rosana Gabalio. Pas përfundimit të hartimit të dosjes dyshe, në janar 2008, UNESCO dërgon në Berat specialistin e njohur Azedin Beçaush, i cili e rishikoi atë përfundimisht, duke kryer disa përmirësime. Ai u largua, duke marrë me vete dy kopje të dosjeve, për t'ia dorëzuar UNESCO-s. Në Sesionin 32 të Komitetit të Pasurive Botërore, të mbajtur në Kebek të Kanadasë, korrik 2008, Gjirokastra (Fig. 17) dhe Berati (Fig. 18) shpallen "Pasuri Botërore". Kështu Shqipëria, pas këtij akti, së bashku me Qendrën arkeologjike të Butrintit, kishte tashmë tre njësi të cilësuara, Pasuri Botërore.

Rishpallja e Gjirokastrës, Pasuri Botërore, ishte një rikonfirmim i vlerave të saj të jashtëzakonshme universale. Akti i rivlerësimit të Gjirokastrës, duhet të ishte një shtysë e përfillshme për ruajtjen e saj, në përbërësit urbanistiko-arkitekturorë, prej qeverisë shqiptare. Kur përmendim qeverinë shqiptare, natyrshëm kemi parasysh mbarë bashkësinë e popullit të kryesuar prej kësaj, apo këtyre qeverive. Themi kështu, sepse sa më të ndërgjegjësuar të jenë, bashkëpjesëtarët e popullsisë së Shqipërisë politike, për domosdoshmërinë e vlerësimit të monumenteve, aq më të detyruara do të jenë qeveritë e njëpasnjëshme, për të ruajtur këto vlera të papërsëritshme. Në bashkësinë e gjerë popullsi, rëndësi të posaçme zënë pronarët dhe banorët e banesave të shpallura monument, të cilët duhet të njohin ligjshmërinë dhe forcën detyruese të tij, për të mos cenuar mbarë vlerat e kësaj pasurie historiko-kulturore. Realisht dhe aspak fatkeqësisht, pra përfillshmërisht, me vendosjen e rendit të emërtuar sundimi i popullit apo demokraci, në fushën e monumenteve, rrënimet, tjetërsimet deri në shembje, janë të pranishme, do të shpreheshim antikulturalisht. Në këtë kontekst, edhe ne specialistëve, kuptueshëm na kërkohet të ngremë zërin dhe më gjerë të dendësojmë veprimet, për të penguar këto qëndrime shpërfillëse për të kaluarën, e cila është njëherazi pjesë e së sotmes dhe së ardhmes, jo vetëm të shqiptarëve, por të mbarë njerëzimit.



*Fig. 18. Pamje e Beratit*

DO NOT COPY

Prof. dr. Emin RIZA

DO NOT COPY

# GJIROKASTRA IN THE COURSE OF ITS EVALUATION

The historic center of Gjirokastra is a major value in the urban-architectural plan of Albania and of the world area. The interest on Gjirokastra's values is comparatively earlier.

Thus, since 1961, alongside with Berat, the Old Bazaar of Kruja and subsoil of Durrës underground, Gjirokastra was proclaimed a *museum-city* and was put under state protection.

As many other ancient and medieval Albanian cities, the strands of Gjirokastra as a civil inhabited center belong to the second half of the XIII century, with the construction of the Castle. The establishment of the city outside the walls of the castle belongs to the XV century.

In terms of construction categories, Gjirokastra includes: the castle, the bazaar, the religious buildings, and the dwellings, grouped in neighborhoods.

The Castle has two main building stages, the first stage is that of the 13th century, whereas todays look is inherited after the construction made during the years 1811-12, conducted by Ali Pasha, who put the city in his possession. This is the second stage.

Gjirokastra was mainly an inhabited center of large landowners and state officials. The city had also a comparatively small bazaar. Religious buildings in Gjirokastra do not stand out as in field cities.

The construction category with greater prevalence, surely is the tradicional house.

Gjirokastra preserves numerous examples of important values in space and time, from the perpendicular houses to the more developed version with two wings,

For understandable reasons related with the time of construction, local materials had been main for all categories of construction.

Firstly, The stone was used in wall structures and protective walls, in layers and in roof coverings, alongside with timber, lime and sand.

Gjirokastra's house distinguishes for its three stories high composition, sometimes it is four stories high, has simple functional schemes and a perfect connection with the land.

The values of the historical center of Gjirokastra have already passed the albanian borders because now they have become part of world culture.

At the 29th session of the World Property Committee in Durban, South Africa, in 2005, Gjirokastra was declared "Cultural Property to the World Heritage list" from UNESCO.

In 2008, at the 32nd session of the same committee, Gjirokastra and Berat, for their exceptional universal values were declared Cultural Property to the World Heritage list, because "these two fortified historic centers are remarkably well preserved, and this is particularly true of their vernacular buildings. They have been continuously inhabited from ancient times down to the present day. Situated in the Balkans, in Southern Albania, and close to each other, they bear witness to the wealth and diversity of the urban and architectural heritage of this region".

Gani STRAZIMIRI

DO NOT COPY

# GJIROKASTRA DHE VLERAT E SAJ KULTURORE*

Qyteti i Gjirokastrës ruan në gjendje të mirë, një pasuri të madhe monumentesh të kulturës materiale, të krijuar gjatë shekujve të kaluar nga gjenia popullore. Ato përbëjnë një burim autentik për ndriçimin e historisë e veçanërisht të krijimtarisë popullore në lëmin e arkitekturës. Monumentet e gjinive të ndryshme ruajnë në vetvete vlera shumë të çmuara, por qenia pranë njëri–tjetrit, kompozimi në ansambël dhe trajtimi në një gjuhë të përbashkët arkitektonike, ua rrisin shumë më tepër vlerën (fig. 1). Gjirokastra ruan pothuaj të paprekur pamjen mesjetare, si e tillë, studimi i saj do t'u japë pa dyshim zgjidhje shumë problemeve që shtron qyteti mesjetar shqiptar, e tërthorazi dhe atyre që dalin në kuadrin ballkanik. Duke çmuar vlerat e rëndësishme që ruan Gjirokastra, Këshilli i Ministrave e shpalli atë, më 1961, qytet – muze.

Studimi në fjalë synon të japë një vlerësim të pasurive kulturore që ruhen në qytetin e Gjirokastrës dhe, në bazë të këtij vlerësimi, të përvijëzojë kufijtë e zonifikimit të pjesës muze që do të përbëjë qendrën historike te qytetit.

Si qytet, Gjirokstra lindi nga nevoja për një qendër shkëmbimi në luginën bujqësore të Drinos dhe malësisë blegtorale të Kurveleshit dhe Zagorisë. Treva e Drinos ka qenë një zonë e banuar që nga koha e lashtë; këtë na e dëshmojnë dhe gjurmët e shumë qendrave të banuara antike, që ruhen sot në këtë luginë. Se kur u ndërtua kalaja dhe se kur lindi qyteti mesjetar nuk dihen, mbasi mungojnë njoftimet historike. Mendimet se në truallin ku shtrihet



*Fig. 1. Pamje e përgjithshme e qytetit*

Gjirokastra ngrihej në kohën antike një qytet me emrin Argyreion - minierë e argjendtë[1], si dhe mendimi se kalaja e Gjirokastrës u ngrit në shek. VI[2] nuk vërtetohen, mbasi deri më sot nuk është hasur asnjë gjurmë antike. Edhe gjatë mesjetës së hershme emri i Gjirokastrës nuk ndeshet në asnjë burim. Për të parën herë Gjirokastra përmendet me emrin Argyrokastron në shek. XIV nga kronisti bizantin J. Kantakuzeni[3], kur bën fjalë për kryengritjen e arbëreshëve kundër Bizantit më 1336. Ai e quan një herë qytet e pastaj kështjellë.

Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV, Gjirokastra u bë selia e zotërve feudalë Zenevisë[4]. Por sundimi i tyre i pavarur u ndërpre disa herë deri sa më 1419 Gjirokastra ra përfundimisht në duart e pushtuesve turq[5] dhe u caktua kryeqendër e sanxhakut të Shqipërisë "Sanxhak i Arvanid". Caktimi i ri i Gjirokastës si kryeqendër i një njësie administrative që shtrihej nga krahina e Çamërisë deri në lumin e Matit flet për rëndësinë e madhe që kishte ky qytet. Që kalaja në këtë kohë ruhej në gjendje të mirë nuk vihet në dyshim, mbasi caktimi i Gjirokastrës si kryeqendër sanxhaku pa pasur mure mbrojtëse për garnizonin turk nuk do të kishte kuptim. Veç kësaj, historiani bizantin i shek. XV Laonik Halkokondili, në përshkrimin që i bën kryengritjes që ndodhi në këtë zonë në vitet 1432 – 1435, e quan Gjirokastrën qytet dhe thotë se ajo përfshihej brenda mureve rrethuese[6]. Si qendër ekonomike në atë kohë Gjirokastra kishte një rëndësi të veçantë, mbasi taksa e pazarit që feudali turk nxirrte nga tregu i saj ishte, më 1432, më e lartë sesa taksa e qyteteve të tjera të këtij sanxhaku[7].

Se sa banorë ka pasur Gjirokastra në shek. XIV – XV është e vështirë të përcaktohet. Popullsia duhet të jetë rritur nga fundi i shek. XIV ose nga fillimi i shek. XV, kur u bë qendër e zotërimeve të Zenevisëve. Më vonë, më 1419, kur qyteti u pushtua nga turqit[8], popullsia duhet të ketë pasur rënie ashtu si dhe qytetet e tjera të Shqipërisë. Më 1432, simbas defterit turk[9], qyteti kishte 121 shtëpi të krishtere kryefamiljarësh (hane). Deri në fillim të shek. XVI, si shumica e qyteteve të Ballkanit të pushtuara nga turqit, Gjirokastra nuk kishte bërë ndonjë hap të dukshëm përpara, kishte vetëm 43 shtëpi të tilla[10]. Gjatë shek. XVI zhvillimi i Gjirokastrës ishte i ngadalshëm, kryesisht për shkak të karakterit natyror që sundonte ekonominë fshatare[11]. Kështu, në fund të shek. XVI qyteti kishte 380 banesa[12]. Rritjen më të shpejtë Gjirokastra e njohu gjatë shek. XVII, kur filloi shthurja e ekonomisë natyrale të fshatrave dhe rritja e shpejtë e qyteteve[13]. Pikërisht këtij shekulli i takojnë njoftime më të pasura që kemi për qytetin. Këto njoftime na i jep udhëtari i njohur turk Evlija Çelebiu, i cili e vizitoi qytetin më 1672[14]. Sipas tij, Gjirokastra, pasi kaloi në duart e shumë shteteve, u pushtua prej vetë sulltan Bajazitit. Për kalanë, që ishte bërthama e qytetit, ai shkruan: *Fortesa është ndërtuar krejt prej guri të gdhendur në kohë shumë të moçme mbi një shkëmb që ka formën e kurrizit të peshkut... ka 600 hapa gjatësi dhe 100 hapa gjerësi, perimetrin e ka 1400 hapa. Kalaja shtrihet për së gjati nga lindja në perëndim dhe ka trajtën e një anijeje. Në mes të fortesës është një rrugë e gjerë me drejtim nga lindja në perëndim. Në të dy anët e kësaj rruge ka 200 shtëpi të mbuluara me rrasa të ndërtuara me gurë të gdhendur... Brenda në fortesë ndodhet xhamia e Bajazit Hanit e mbuluar me rrasa me një minare të stilit të vjetër... Afër minares së kësaj xhamie ka një saranxhë të madhe... ku mblidhen ujërat e shiut që kullojnë nga rrasat e pullazeve të fortesës, në të cilën pijnë ujë të gjithë banorët e kalasë. Veç kësaj, çdo zotni ka në shtëpi të vetë një saranxhë të veçantë... Fortesa ka dy porta... Në portën nga lindja hipet me shkallë... Porta nga perëndimi është përballë namazgjahut. Në këtë krah, ndërmjet namazgjahut e fortesës, ka një hendek 100 hapa të gjatë dhe 20 hapa të gjerë. Tri anët e tjera nuk kanë nevojë për hendek pasi kanë përrenj natyral*. Nga sa u tha më sipër, del qartë se kalaja,

[1] P. Aravantinos. *Hronografia tis Epeiron*. Athinë 1856, f. 17. *Encicloped. Ital*. Treccani. S. V. Argirocastra. Vëll. IV, f. 267.
[2] G. Valentini. *Contributi alla cronologia albanese.* Roma 1957.
[3] J. Kantakuzemos II, 34.
[4] L. Chalkokondiles II . f. 23 – 30.
[5] *Historia e Shqipërisë*, Vol. I, Tiranë 1954. f. 244.
[6] L. Chalkokondiles II .
[7] H. Inalcik. *Suret – i Defter - i Sancak – i Arvanid.* Ancara 1954, Timari Nr. 1.
[8] Shih shënimin Nr. 5.
[9] Shih shënimin Nr. 7.
[10] *The Encyclopedia of Islam* - London. 1958, I. f. 656.
[11] *Historia e Shqipërisë*, Vol. I, Tiranë 1954. f. 344.
[12] *Po aty.*
[13] *Po aty.*
[14] *Shqipnija para dy shekujsh,* përkthim i "Evlija Çelebi Sejjahatnamesi". Tiranë 1930, f. 29 e vijim; F. Babinger *Evlia Tschelebi' s Reisewege in Albanien,* Berlin 1930.

DO NOT COPY

siç ruhej në çerekun e tretë të shek. XVII, i përkiste periudhës para pushtimit turk dhe se muret rrethuese ruheshin në gjendje të mirë. Vetë udhëtari turk nuk bën fjalë për ndonjë rindërtim apo forcim të saj nga turqit.

Se kur filloi të zgjerohej qyteti jashtë mureve rrethuese të qytezës mesjetare, fortesës, dhe cilat qenë lagjet e para që u ngritën dhe u zhvilluan pas këtij zgjerimi, në mungesë të të dhënave, mund të përcaktohen me rrugë të tërthorta. Po të marrim parasysh se në fund të shek. XVI, qyteti kishte 380 shtëpi dhe nga ana tjetër se Çelebiu në shek. XVII shkruan se: *Brenda kësaj fortese ka 200 shtëpi, të mbuluara me rrasa e të ndërtuara mbi bedenat e fortesës*, del se brenda mureve rrethuese të kalasë mund të vendoseshin jo më shumë se 200 shtëpi. Pra, zgjerimi i qytetit jashtë mureve duhet të ketë ndodhur gjatë shek. XVI, gjë që përputhet me fillimin e një farë stabilizimi të pushtetit turk në vendin tonë.

Në çerekun e tretë të shek. XVII Gjirokastra kishte jashtë mureve rrethuese 2000 shtëpi. Çelebiu, i cili e vizitoi Gjirokastrën më 1672, shkruan: *Varoshi shtrihet mbi tetë kodrina e përrenj rreth e qark fortesës... Përbëhet nga tetë lagje: Varoshi i Vogël, Palo, Vutosh, Manalat, Haxhi Beu, më e madhja e të gjithave, Dunavat, Memi Beu, më e zhvilluara". Tre prej këtyre dhe pikërisht Palorto, Manalat dhe Dunavat, ruajnë edhe sot këto emra. Megjithëse emrat e lagjeve të tjera nuk ruhen, ato mund të identifikohen lehtë në bazë të orientimeve që jep Çelebiu. Lagjet Varosh i Vogël dhe Haxhi Bej njihen sot respektivisht me emrat Pllakë dhe Hazmurat, (Tab. II, 2). Varoshi i Poshtëm identifikohet me qendrën e qytetit (Tab. III, 1) dhe me lagjet Teqe e Meçite ndërsa lagjja e shtatë me emrin Vutosh mendojmë se është lagjja e sotme Varosh. Lagjja e tetë, e cila nuk emërtohet, duhet të jetë lagjja Cfakë (Tab. II, 3). Të gjitha lagjet që ruhen sot në qytetin e Gjirokastrës me përjashtim të Lagjes Pazar i Vjetër (Tab. II, 1), e cila në atë kohë përbënte tregun pranë kalasë, ishte krijuar që në çerekun e tretë të shek. XVII. Kjo vërteton se Gjirokastra në fillim të gjysmës së dytë të këtij shekulli kishte pothuaj shtrirjen e sotme*.

Me rëndësi është edhe njoftimi i Çelebiut për ekzistencën e pazarit të vjetër pranë kalasë. Ai shkruan: *Në veri të fortesës*[15] *nën muret e saj është tregu i vjetër, që ruhet pazari i kalasë me 40 dyqane të vogla. Ky treg, në të dy anët ka dy porta druri si të bezistanit, të cilat çdo natë mbyllen*. Tregu i vjetër, pazari i kalasë, për të cilin shkruan Çelebiu është tregu që përmendet për herë të parë më 1432[16]. Nga këto të dhëna del se pazari pranë kalasë ekzistonte përpara pushtimit turk; mund të themi se ai lindi njëkohësisht me ngritjen e fortesës, në fillim si qendër shkëmbimi i fshatrave përreth qytezës. Nga ana tjetër, vendosja e këtij pazari pranë kalasë dhe ngjitur me të, vërteton në mënyrë bindëse se pikërisht mbi këtë kurriz kodrinor ishte ngritur që në fillim qyteza mesjetare e Gjirokastrës. Vetëkuptohet se edhe lagjet e para duhet të kenë qenë vendosur sa më afër qytezës së pazarit, me rrugët që vinin nga drejtime të ndryshme drejt zonave fushore e malore përreth dhe që lidhnin këto zona me kalanë dhe pazarin e dikurshëm pranë saj. Për përcaktimin e tyre, mund të na ndihmojnë dhe disa elemente të tjera siç janë emërtimet e lagjeve, lashtësia e ndërtimit të godinave të kultit, forma e terrenit dhe afërsia e qytezës me pazarin përbri saj. Nga këto të dhëna mund të arrijmë në përfundimin se shtrirja dhe zhvillimi i qytetit, pas zgjerimit të tij jashtë mureve rrethuese të qytezës, është kryer në formë radiale me epiqendër fortesën dhe pazarin përbri saj. Lagjja që doli jashtë mureve rrethuese të qytezës duhet të ketë qenë lagjja Pllakë. Në dobi të këtij mendimi flasin vendosja e kësaj lagjeje në vijim të kurrizit kodrinor mbi të cilin ngrihet qyteza, shumë afër mureve rrethuese të kalasë; shtrirja e saj gjatë rrugës kryesore që të çonte nga kjo anë në sheshin përbri mureve rrethuese të kalasë, aty ku zhvillohej dhe pazari i fshatrave përreth përpara zgjerimit të qytetit jashtë mureve rrethuese; përcaktimi i saj nga Çelebiu si lagje e të krishterëve dhe, së fundi, cilësimi i banesave si shtëpi të këqia d. m. th. të vjetra, në krahasim me ato të lagjeve të tjera të qytetit.

Fill pas kësaj lagjeje, para shek. XVII duhet të jenë ngritur dhe zhvilluar me radhë lagjet Teqe, Meçitë, Hazmurat (Tab. II, 2), Varosh, Palorto, Dunavat dhe Manalat. Në shek. XVII sipas njoftimeve që jep Çelebiu, kuptohet se poshtë mureve të kalasë, atje ku ndodhet qendra e qytetit (Tab. III, 1) ishte ngritur një treg i ri me 80 dyqane të reja dykatëshe, i cili quhej Pazari i Ri ose Pazari i Memi Beut. Rreth e rrotull tij ishin ndërtuar rreth 150 shtëpi të reja të bukura që

[15] Kalaja, në fakt, gjendet në pozicionin VL - JP

[16] Shih shënimin Nr. 7.

DO NOT COPY

përfshiheshin në lagjen Varosh i Poshtëm. Po në këtë lagje ndodhej dhe pallati qeveritar i Zyrës së Sheriatit. Nga kjo kuptohet se qyteza e vjetër mesjetare në këtë kohë kishte filluar të humbiste pjesërisht funksionin e saj shekullor dhe se pazari i ri e kishte dobësuar aq tepër fuqinë e pazarit të vjetër, sa që ky i fundit më vonë u zhduk krejtësisht duke u zëvendësuar me një lagje të banuar (Tab. II, 1). Kjo duhet të jetë dhe lagjja më e re, që për mendimin tonë i takon fundit të shek. XVII dhe fillimit të shek. XVIII. Në bazë të këtyre të dhënave qendra e re u shpërngul nga kalaja mesjetare në Varoshin e Poshtëm, si rrjedhim, prej kësaj kohe nuk ishte më kalaja por qendra e re dhe pazari i ri që shërbenin si qendër për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit.

Interes të veçantë paraqesin edhe njoftimet për ndërtesat e banimit, për të cilat Çelebiu shkruan se: *Shumë shtëpi të Gjirokastrës duket se janë themeluar nga venedikasit, sepse në to shihet figura e Shën Markut... Shtëpitë e ndërtuara brenda fortesës mbi bedenat janë pajisur me qoshke e shanishane për të soditur qytetin në të djathtë e në të majtë dhe të gjitha fushat e lulëzuara... Shtëpitë janë të larta, të ndërtuara me gurë të gdhendur, të mbuluara me rrasa dhe të rrethuara me vreshta dhe kopshte...Janë stolisur e zbukuruar me oborre të rrethuara me mure, të cilët janë ndërtuar me gurë të bardhë...të punuar me mjeshtëri të hollë...* Këto të dhëna tregojnë qartë se në këtë shekull ruheshin ende ndërtesa të periudhës para pushtimit turk, se tradita e kompozimit, trajtimit dhe teknikës së ndërtimit vazhdoi dhe gjatë pushtimit turk, si brenda qytezës mesjetare në periudhën e parë, ashtu edhe jashtë saj mbasi qyteti u zgjerua dhe u zhvilluar jashtë mureve të kalasë.

Duke marrë parasysh mungesën e gjurmëve të lashta në truallin e qytetit dhe të mos përmendurit e tij në burimet e shkruara të shek. XIV mund të arrijmë në përfundimin se Gjirokastra është një qytet që lindi gjatë mesjetës dhe se ashtu si shumica e qyteteve mesjetare shqiptare duhet të jetë themeluar gjatë shek. XII – XIII.

Nga e kaluara nuk trashëgojmë ndonjë studim mbi Gjirokastrën. Të vetmet materiale dokumentare janë përshkrimi i Çelebiut dhe disa pasazhe të Hanit dhe Pukëvilit. Punimin tonë e kemi mbështetur kryesisht në materialin e grumbulluar për disa vjet me radhë në terren, ku jemi munduar të njihemi nga afër me strukturën, kompozimin dhe zhvillimin e qytetit gjatë shekujve, me ansamblet, monumentet dhe ndërtimet e gjinive të ndryshme që e përbëjnë, me vlerën që përfaqësojnë dhe vendin që zënë në lindjen dhe zhvillimin e këtij qyteti gjatë shekujve.

Gjirokastra shtrihet në shpatin e Malit të Gjerë mbi një sërë kurrizesh kodrinore, kreshtash shkëmbore e shpatesh, të ndërprera nga përrenj stinorë të rrëmbyer, që përfundojnë në lumin Drinos (fig. 1). Qytetit kufizohet nga jugperëndimi dhe verilindja respektivisht me lartësitë e Malit të Gjerë dhe fushën e Drinosit, ndërsa nga juglindja dhe veriperëndimi me përrenjtë stinorë të Bufames dhe Çullos.

Dëshmitë e kulturës materiale të së kaluarës në qytetin e Gjirokastrës janë: kalaja (Tab. I 1, 2); rrugët embrionale që lidhin zonat përreth me qytezën dhe pazarin përbri; skema e rrjetit rrugor dhe e zhvillimit të qytetit pas zgjerimit të tij jashtë mureve rrethuese të qytezës; lagjet dhe tregu i qytetit, si dhe ansamble, monumente e ndërtime të gjinive të ndryshme.

Kalaja ngrihet në qendër të qytetit, në pikën më dominuese të tij (fig. 1), në kuotën 360 m mbi nivelin e detit dhe rreth 200 m mbi fushën e luginës së Drinos, që shtrihet përpara. Është e vendosur mbi një rrafsh shkëmbor që ngrihet thikë mbi kurrizin e stërzgjatur kodrinor (fig. 2), i cili zbret nga mali i Gjerë dhe përshkon qytetin nga jugperëndimi në verilindje, duke e ndarë diagonalisht më dysh. Në krahasim me kalatë e tjera mesjetare të vendit tonë, kalaja e Gjirokastrës ruhet në tërësi në gjendje mjaft të mirë. Ajo ka një gjatësi prej 500 m dhe gjerësi prej 75 m; në pjesën jugperëndimore ngushtohet deri në 15 m. Muret rrethuese ruhen pothuaj të padëmtuar në tërë perimetrin e saj prej rreth 1300 m. Në pjesën më të madhe të tyre muret ngrihen mbi shkëmbin e thepisur e të pangjitshëm; ata ndjekin konfiguracionin e terrenit me vija të drejta, por herë pas here pësojnë thyerje për arsye konstruktive ose për qëllime mbrojtjeje. Kullat janë të rralla dhe janë përdorur kryesisht për të forcuar hyrjet apo ndonjë pikë tjetër të dobët; skaji jugperëndimor formon një kullë të madhe ose një bastion më vete (Tab. I, 2). Në kala hyhet nëpërmjet tre portave: njëra në anën verilindore, kurse dy të tjerat që ndryshojnë nga përmasat e trajtimi nga e para, në anët gjatësore, pothuajse përballë njëra tjetrës.

Bërthamën e kalasë e përbën kalaja e periudhës para pushtimit turk, e cila zë pjesën verilindore dhe qendrore. Zgjerimi i kalasë ka ndodhur në drejtimin jugperëndimor të

DO NOT COPY




*Fig. 2. Planimetria e kalasë së Gjirokastrës*

saj, gjë që kuptohet nga gjatësia më e madhe në krahasim me atë që na kumton Çelebiu, si dhe nga teknika dhe trajtimi i ndryshëm i mureve në këtë pjesë. Në këtë kohë është mbyllur porta jugperëndimore e kalasë dhe në vend të saj janë hapur dy portat anësore. Ky zgjerim duhet të ketë ndodhur në kohën e Ali Pashë Tepelenës në vitet 1813 – 1814 pasi ai pushtoi me forcë qytetin. Për këtë na njofton edhe Hani[17], por në vend të termit rindërtim ai përdor termin ndërtim, që është bërë shkak për përhapjen e pikëpamjes së gabuar, sipas së cilës kalaja e Gjirokastrës është ndërtuar prej Ali Pashës. Ka shumë mundësi që edhe akuadukti që furnizonte me ujë kalanë (fig. 3, 4), prej të cilit sot ruhen vetëm disa gjurmë të zbehta, të jetë ndërtuar në vitet 1813 – 1814. Megjithatë një dyshim lind për këtë nga një pasazh i Pukëvilit, i cili duke përmendur luftën që bëri Ali Pasha për pushtimin e qytetit shkruan se, *ushtritë e Vezirit ndër të tjera prenë ujësjellësat*[18].

Pjesa verilindore e kalasë nuk ka pësuar transformime të rëndësishme. Në të ruhen: hyrja verilindore (Tab. 1, 3) dhe në të djathtë të saj nga ana e jashtme disa ambiente për strehimin e rojeve, si dhe në vazhdim të tyre dy kulla katrore. Nga pastrimet dhe gërmimet e kryera vitet e fundit kanë dalë në dritë, një burg mesjetar dhe disa galeri e ambiente, destinacionin e të cilave nuk e përcaktojmë dot. Në këtë pjesë të kalasë ruhen gjurmë të rrugës gjatësore, si dhe mbeturina ndërtesash banimi që shtrihen deri në buzë të rrugës. Rindërtimit të kalasë në këtë pjesë i përkasin dy kulla poligonale të pajisura me qitje me artileri, të cilat nga trajtimi dhe teknika kanë ngjashmëri me kullat e fortifikimeve të

[17] I. G. Hahn. *Albanesische Studien* - Jena 1854, f. 53.

[18] F.C.H.L. Pouqueville. *Voyage de la Grèce*, Paris 1820, vol. I, lib. II: Kap. V.

DO NOT COPY



*Fig. 3. Kalaja dhe akuadukti, gravurë e shek. XIX*



*Fig. 4. Gjendja e akuaduktit para rrënimit total që pësoi në vitin 1932*

njohura të Ali Pashë Tepelenës. Pjesa tjetër e kalasë pësoi rindërtime e transformime me rëndësi. Nga këto ruhen një sërë galerish (Tab I, 4) e ambientesh që mbulojnë tërë sipërfaqen. Megjithëkëtë, edhe në pjesën qendrore ekzistojnë dëshmi të ndërtimit të parë, që veç pjesëve të murit rrethues janë rruga gjatësore dhe një furrë e hershme.

Qyteti, siç e pamë, u zgjerua jashtë mureve rrethuese në gjysmën e parë të shek. XVI, u zhvillua në çerekun e tretë të shek. XVII dhe arriti kulmin gjatë shek. XVIII. Ashtu siç trashëgohen sot, ndërtimet e gjinive të ndryshme që e përbëjnë i takojnë kryesisht shek. XVII – XIX. Pas zgjerimit të saj, Gjirokastra u zhvillua në bazë të një skeme radiale. Këtë e vërteton rrjeti rrugor, i cili përqendrohet në formë rrezesh në qendër të qytetit (fig. 7). Si çdo skemë e zhvillimit të qyteteve mesjetare, dhe skema e Gjirokastrës nuk është rrjedhim i një dëshire ose studimi. Përkundrazi, rrjeti kryesor rrugor ishte krijuar disa shekuj para zgjerimit të qytezës mesjetare jashtë mureve rrethuese. Ai është dëshmi e gjallë që tregon se si qyteza e lashtë me pazarin përbri saj dhe rrugët që e ndërlidhnin me trevën përreth diktuan skemën koncentrike të shtrirjes dhe zhvillimit të tij. Megjithëqë gjatë shek. XVII qendra ekonomike kulturore dhe administrative e qytetit ishte shpërngulur nga kalaja në vendin e sotëm, skema dhe zhvillimi i tij nuk pësuan ndryshime thelbësore. Rrugët e vjetra që lidhnin kalanë me trevën përreth përbëjnë sot e kësaj dite arteriet kryesore të qytetit (fig. 5). Rrugët e Gjirokastrës thyhen e lakohen për të ndjekur relievin. Mjeshtrit popullorë shqiptarë që e ndërtuan gjatë shekujve ditën që në përputhje me kushtet e jetesës, konditat e terrenit dhe mundësitë teknike, t'u japin zgjidhje të drejtë problemeve të ndryshme dhe të vështira që shtronte qyteti.

Nga pazari i dikurshëm pranë kalasë nuk ruhet asnjë gjurmë. Të vetmet dëshmi janë emri i lagjes Pazari i Vjetër dhe rrugët e zonave përreth që drejtohen njëkohësisht edhe në këtë pikë të qytetit. Ndër këto, rrugët e zonës fushore janë rrugët kryesore të lagjeve Pllakë dhe Pazari i Vjetër si dhe rrugët e lagjeve Hazmurat, Meçite, Varosh dhe Palorto; rrugët e zonave të shpatit të malit të Gjerë janë rrugët kryesore të dy lagjeve Dunavat dhe dy lagjeve Manalat. Për rrugët e zonës fushore dëshmojnë gjithashtu edhe tre urat prej guri mbi lumin e Drinos në afërsi të qytetit.

Të gjitha lagjet e qytetit që lindën dhe u zhvilluan gjatë shekujve të kaluar trashëgohen në gjendje shumë të mirë. Ato ruajnë rrugët kryesore dhe sekondare si dhe ndërtimet që i përbëjnë. Kjo i kushtohet kryesisht faktit se para çlirimit qyteti nuk pati ndonjë zhvillim ekonomik–social, kështu që ato nuk pësuan transformime. Mbas çlirimit, megjithë zhvillimin e qytetit, në sajë të masave të marra për mbrojtjen e monumenteve, transformimet nuk e ulën në mënyrë të

DO NOT COPY

ndjeshme vlerën e tyre historike e kulturoro - artistike. Ndër lagjet e qytetit që paraqesin interes dhe vlerë të veçantë janë: lagjja Pllakë, Pazari i Vjetër (Tab. II, 1) dhe Dunavat i Parë që shtrihen në të njëjtin kurriz kodrinor mbi të cilin ngrihet kalaja; lagjet Hazmurat (Tab. II, 2), Meçite, Teqe, që shtrihen në afërsi të qendrës dhe tregut të qytetit, si dhe pjesë të lagjeve Varosh dhe Palorto. Interes dhe vlerë paraqesin gjithashtu dhe disa ansamble të lagjeve prapa kalasë, Manalat e Cfakë (Tab. II, 3), të cilat kurorëzojnë kreshtat kodrinore e shkëmbore të kësaj ane. Tregu gjithashtu përbën një ansambël me vlerë të madhe për qytetin. Ai shtrihet në kryqëzimin e rrugëve kryesore të qendrës së qytetit të sotëm (Tab. III, 1). Dyqanet janë dykatëshe, të ndërtuara me mur guri të gdhendur në katet e para, të cilat ruhen në gjendje shumë të mirë. Rrugët në të dy anët përshkohen nga trotuare të shtruara me pllaka guri dhe të shkallëzuara për t'ju përgjigjur pjerrësisë së theksuar të rrugëve. Deri në 10- vjeçarin e parë të shekullit tonë rrugëve ruheshin pjergulla, të cilat krijonin hije të dendur gjatë stinës së verës. Nga sa thamë më sipër del se tregu i ri, siç e quan Çelebiu në shek. XVII, me zhdukjen e tregut të vjetër pranë kalasë, filloi të quhet tregu i qytetit, emër që e mban edhe sot. Nga ana tjetër, numri i kateve, sasia e dyqaneve dhe teknika e ndërtimit na lejojnë të supozojmë se edhe si ndërtim ky treg i takon shek. XVII.

E gjithë kjo dëshmon se qyteti ruan vlera të mëdha. Këto vlera rriten akoma më shumë për faktin se skema radiale që ndoqi qyteti dhe shtrirja e zhvillimi i tij në të kaluarën ruhen në gjendje pothuaj të paprekur. Ajo që bie në sy në qytetin e Gjirokastrës është uniteti i gjuhës arkitektonike me të cilën është trajtuar jo vetëm qyteti por edhe lagjet, ansamblet, monumentet dhe çdo ndërtim i tij. Ritmi i lëvizjes së volumeve, i shpërndarjes së vlerave urbanistike, i interkalimit të pjesëve bosh dhe plot dhe i dritës e hijes e bëjnë Gjirokastrën një ndër qytetet më karakteristike dhe piktoreske të vendit tonë.

Edhe banesat e shumta që trashëgojmë në qytetin e Gjirokastrës përbëjnë një pasuri të madhe kulturore të këtij qyteti. Ato përfaqësojnë një vlerë të veçantë dhe janë një burim me rëndësi për ndriçimin e prejardhjes, krijimit dhe evolucionit të banesës së këtij qyteti gjatë shekujve.

Banesat që ruhen sot në qytetin e Gjirokastrës i takojnë shek. XVIII – XIX, kryesisht shek. XIX. Për fat të keq, banesat e hershme nuk ruajnë datën e ndërtimit, ndërsa rindërtimet apo adaptimet e tyre gjatë shek. XIX si dhe banesat që ndërtohen gjatë këtij shekulli fillojnë të datohen. Në mungesë të datimeve më të plota, jemi mbështetur në të dhëna të tërthorta: në kompozimin dhe trajtimin e tyre, në degradimin e lëndës së drurit, në kalimin nga përdorimi i gozhdave të kovaçit në ato të fabrikës dhe në datimet e adaptimeve të banesave më të hershme. Bashkërenditja e fakteve të mësipërme në të gjitha rastet e konstatuara na kanë lejuar diferencimin e tyre sipas lashtësisë.

Banesat më të hershme si ndërtim i takojnë shek. XVIII. Ato janë zhvillimi i mëtejshëm, pas zgjerimit të qytetit jashtë mureve rrethuese të tij, i banesës së lashtë të parapushtimit turk që përshkruan Çelebiu në shek. XVII. Me sa duket, gjatë shek. XVIII, me zhvillimin e madh ekonomik, politik dhe kulturor, kjo banesë arriti kulmin e zhvillimit të saj. Këto banesa janë në përgjithësi me dy – tre kate (Tab. IV), dhe jo rrallë me katër kate (Tab. III, 2). Numri i kateve dhe ambientet e banimit, shpesh me dy radhë dritare, ua shtojnë akoma më shumë lartësinë. Janë ndërtuar me mure të gjera guri, të gdhendur në pjesët më të rëndësishme dhe më në pah. Katet e para mbulohen me konstruksione të harkuara, ndërsa çatitë me rrasa guri. Trajtimi i kateve të para, ku vendosen ambientet ekonomike, me mure të gjera, me mbulesa të harkuara, me frengji dhe me dritare të vogla e të vendosura lart nga toka dhe pajisja, në shumicën e rasteve me stera, i japin banesës gjirokastrite një karakter të theksuar mbrojtës duke e kthyer atë në një kështjellë të vogël (Tab. IV, 5). Nga ana tjetër, trajtimi i kateve të sipërme, ku vendosen ambientet e banimin dhe ndihmëse, me dritare të mëdha, me çardake, qoshke e shanishane, me strehë të dala në mënyrë të theksuar (Tab. IV) dhe me muret ambienteve kryesore të jashme shpesh me piktura e dekoracione floreale, pamje panoramike apo skena gjuetie (fig. 6) e bëjnë këtë banesë, në kushtet konkrete të këtij qyteti dhe të materialeve lokale të ndërtimit, një ndër banesat më tipike dhe më origjinale të qytetit mesjetar shqiptar.

Më vonë, duke filluar nga fundi i shek. XVIII sidomos gjatë shek. XIX, me shtimin e kontakteve dhe marrëdhënieve me vendet fqinje, banesat e hershme fillojnë të adaptohen dhe të transformohen. Në këtë kohë mbyllen çardakët, qoshket dhe shanishanet; strehët e theksuara shkurtohen dhe suvatohen; musandarat dhe mafilet humbasin funksionin e

DO NOT COPY



*Fig. 5. Rruga kryesore e lagjes Varosh*

tyre dhe kthehen në elementë dekorativë e kështu me radhë. Gjatë kësaj periudhe mund të themi se kristalizohet dhe lind një tip i ri, i cili në thelb ruan kompozimin dhe strukturën e banesës së hershme.

Karakteri mbrojtës i banesës gjirokastrite siç duket ka influencuar rrënjësisht në trajtimin planimetriko–funksional, në kompozimin e volumeve në hapësirë (Tab. IV) në zgjidhjen dhe trajtimin arkitektonik si dhe në teknikën e ndërtimit, duke krijuar kështu një banesë me tipare të veçanta në kuadrin e banesës mesjetare të qyteteve shqiptare të para pushtimit otoman. Karakteristikë e kësaj banese në këtë drejtim është edhe vendosja e saj në pjesën më të ngritur të parcelës dhe mundësisht, lirshëm nga të katër anët (Tab. IV, 3). Parcelat shkallëzohen me tarraca për vendosjen e banesës, krijimin e oborrit, kopshtit dhe vreshtës. Oborri rrethohet me mure të larta të cilat kishin funksion mbrojtjeje. Ky tipar mbrojtës i banesës shihet edhe në vendosjen e saj, karshi rrugëve, dhe në shfrytëzimin e terrenit të aksidentuar.

Banesa gjirokastrite ashtu si banesat e qyteteve të tjera mesjetare të parapushtimit otoman përbën tipin më origjinal dhe më karakteristik të banesës qytetare shqiptare. Këto banesa nuk i takojmë në qytetet e tjera mesjetare që lindën dhe u zhvilluan gjatë pushtimit turk. Pra, jemi të mendimit se kjo banesë nuk është produkt i periudhës së pushtimit otoman, por më i hershëm. Ajo lindi dhe u zhvillua krahas lindjes dhe zhvillimit të këtyre qyteteve, pra gjatë shek. XII – XIV. Në këtë prag pushtimi ajo kishte arritur zhvillimin më të madh.

* * *

Nga sa thamë arrijmë në përfundimin se në qytetin e Gjirokastrës ruhet nga e kaluara një trashëgimi kulturore me vlerë të madhe. Kjo pasuri zë vend me rëndësi të veçantë në fondin e krijimtarisë popullore. Ajo përbën një dëshmi të gjallë historike të dorës së parë për ndriçimin dhe thellimin e mëtejshëm të problematikës së gjerë të zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor të së kaluarës dhe në rradhë të parë të lindjes, zhvillimit dhe karakterit të qytetit mesjetar shqiptar.

Qyteti i vjetër i Gjirokastrës përbën pjesën kryesore të qytetit të sotshëm. Ai zë një sipërfaqe rreth 160 ha. Zhvillimi i tij gjatë këtij shekulli filloi vetëm mbas çlirimit, sidomos gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Gjatë kësaj kohe, ai filloi njëkohësisht të shtrihet poshtë, në verilindje, përbri rrugës nacionale.

Zonifikimi i qendrës historike të qytetit, mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i trashëgimisë që ruhet brenda kufijve të saj dhe ndërtimi e zhvillimi i mëtejshëm i qytetit nuk janë probleme të thjeshta. Qyteti i vjetër flet qartë me gjuhën e shekujve të kaluar; ndërtimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i tij, gjithashtu, duhet të flasë qartë e fuqishëm me gjuhën e rendit të ri. Pikërisht, bashkërendimi dhe harmonizimi i së resë me të vjetrën përbën problemin kryesor dhe më të ndërlikuar që duhet zgjidhur dhe përballuar.

Shpejtësia e rritjes demografike, progresi i vazhdueshëm ekonomiko–social, zhvillimi i industrisë dhe kërkesa gjithnjë në rritje për përmirësimin e konditave të jetesës, sjellin me vete edhe një varg problemesh urgjente që kanë të bëjnë me mbrojtjen e vlerave kulturore që ruan qyteti. Kërkesa e drejtë e qytetarëve për të patur komoditetet e kohës përbën një nër problemet kryesore për mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e qendrës historike. Kjo kërkon para se të gjithash të kuptohet dhe të vlerësohet drejt bashkërenditja dhe harmonizimi i mbrojtjes dhe i konservimit të qendrës historike me kërkesat dhe nevojat për zhvillimin e mëtejshëm të tij. Eksperienca e derisotshme

DO NOT COPY

ka vërtetuar se ndërtimi i shpejtuar i godinave të reja administrative, shoqërore e kulturore, i blloqeve të banimit shumëkatëshe dhe i ndërtesave private, si dhe adaptimi dhe transformimi i banesave të vjetra apo zgjerimi e rektifikimi i disa rrugëve karakteristike, pa marrë parasysh se kemi të bëjmë me një qendër historike, kanë sjellë si pasojë një degradim të ambientit dhe të ansambleve e monumenteve. Nuk është çështja të ruajmë monumente të veçanta me vlerë të madhe apo unikale, por t'i ruajmë ato së bashku me ambientin që i rrethon. Po qe se do t'i zhveshin nga ky ambient atëherë këtyre monumenteve u kemi shkaktuar një dëm të pariparueshëm; ato do të mbeten vetëm dëshmi të izoluara dhe të zbehta të kohës së tyre. Sado serioze të jenë në të ardhmen përpjekjet për një rikonstruksion mbi bazën e mbeturinave, sado e madhe të jetë forca e imagjinatës, nuk do të arrihet kurrë të krijohet një kuadër i plotë e aq besnik i asaj që është.

Prandaj, mbrojtja e shumanshme me tërë seriozitetin që kërkohet nga një dëshmi historike është detyrë e domosdoshme për të shpëtuar këto pasuri arkitektonike e artistike që trashëgojmë sot në qytetin e Gjirokastrës.

Për vënien në mbrojtje të kësaj trashëgimie, të mbështetur edhe në kriteret e zonifikimit të qytetit – muze të Beratit, qytetin e Gjirokastrës e kemi ndarë sipas vlerës e rëndësisë në tri zona (fig. 7). Dy të parat, zona muze dhe zona e mbrojtur përbëjnë qendrën historike, ndërsa e treta përbën zonën e lirë. Gjithashtu, ndërtimet që përbëjnë qendrën historike i kemi klasifikuar sipas vlerës, në monumente të kategorisë së parë dhe në monumente të kategorisë së dytë.

Zona muze përfaqëson atë pjesë të qytetit që ruan në kompleks më së miri vlera me rëndësi të madhe historike, urbanistike dhe arkitektonike. Zona e mbrojtur ruan gjithashtu vlera relativisht të rëndësishme, të cilat, së bashku me ato të zonës muze plotësojnë brenda kufijve të qendrës historike kuadrin e qytetit muze. Zona e lirë përfaqëson pjesën më të madhe të qytetit të vjetër të Gjirokastrës. Në këtë zonë ruhet vetëm një numër shumë i kufizuar monumentesh me vlerë të veçantë.

Monumentet e kategorisë së parë janë përfaqësues me vlerë të madhe për arkitekturën gjirokastrite në veçanti dhe për atë qytetare shqiptare në përgjithësi. Monumentet e kategorisë së dytë ruhen vetëm brenda kufijve të qendrës historike. Këto, duke u marrë të shkëputura nuk paraqesin ndonjë vlerë të veçantë, por në kompleksin e qendrës historike luajnë një rol vendimtar.

Kriteret kryesore për ndarjen e qendrës historike në zonë muze dhe në zonë të mbrojtur janë diferencimi sipas vlerave i ansambleve dhe monumenteve; dhe shkalla dhe metoda e ndërhyrjes për konservimin e tyre. Ndërsa klasifikimi i ndërtimeve që përbëjnë qendrën historike në dy kategori monumentesh është bërë në bazë të dallimit sipas vlerës, duke shkallëzuar për to dhe masat përkatëse për adaptim dhe shfrytëzim.

Në përvijimin e kufijve të qendrës historike janë patur parasysh: terreni dhe ambienti karakteristik mbi të cilin lindi qyteza mesjetare dhe më vonë u zgjerua dhe u zhvillua qyteti jashtë mureve rrethuese; ansamblet, lagjet dhe pjesë



*Fig. 6. Trajtimi dekorativ i pamjes së jashtme të banesës gjirokastrite*

DO NOT COPY




*Fig. 7. Zonifikimi i Qytetit-Muze të Gjirokastrës*

karakteristike të lagjeve si dhe monumente të veçantë, më tipike dhe më me vlerë, të gjinive të ndryshme.

Pjesa e qytetit që i plotëson më së miri kërkesat ndaj qendrës historike, është qendra e qytetit dhe pjesa që shtrihet në verilindje. Qendra historike, pa llogaritur gjelbërimet dhe brezin mbrojtës, përbën rreth 25% të qytetit të vjetër, ndërsa zona muze dhe e mbrojtur që e përbëjnë, zënë respektivisht 11% dhe 14%. Brenda kësaj qendre përfshihen: kalaja, gjurmët e ujësjellësit (akuaduktit), tregu i sotëm, lagjja Pazari i Vjetër, Pllakë, Hazmurat, Meçite dhe Teqe; pjesë të lagjeve Varosh dhe Palorto si dhe disa ansamble që kurorëzojnë kreshtat kodrinore e shkëmbore të lagjeve Manalat e Cfakë.

S'ka dyshim se ruatja e qendrës historike, si qëllim në vetvete, pa marrë parasysh se qyteti jeton dhe zhvillohet, do të ishte e pamundur. Në këto rrethana, një rol vendimtar për konservimin e qendrës historike luan dhe do të luajë shfrytëzimi, për nevojat e jetesës, i kësaj pjese të qytetit dhe i ndërtimeve që e përbëjnë. Praktika ka treguar se nga çdo pikëpamje shfrytëzimi i monumenteve për funksionet për të cilat u krijuan është rruga më e përshtatshme për mbrojtjen e tyre. Prandaj dhe plotësimi i kërkesave të qytetit dhe të banorëve që jetojnë në këto pjesë, me ecjen përpara të jetës dhe komoditetit, pa cënuar vlerat që ato përfaqësojnë, përbën një faktor me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e qendrës historike. Nga adaptimi i diferencuar dhe shfrytëzimi nuk përjashtohet asnjë monument apo ndërtim që është vënë në mbrojtje. Kur monumentet e kategorisë së parë, që përbëjnë një numër shumë të kufizuar, nuk mund të shfrytëzohen ashtu siç janë, ndërhyrjet për adaptimin e tyre duhet të jenë të heqëshme (reversibël) ndërsa monumenteve të kategorisë së dytë, mund t'u bëhet çdo adaptim i brendshëm por pa cënuar pamjen e jashtme, në radhë të parë të atyre që ruhen në zonën muze.

Ndërtimet e reja, siç e ka treguar eksperienca e derisotme, kanë dëmtuar unitetin dhe vlerën e qendrës historike. Kur, për arsye të paevitueshme, do të detyrohemi të bëjmë ndërtime të reja, dhe këto vetëm në zonën e mbrojtur, kompozimi i volumeve të tyre në hapësirë dhe trajtimi arkitektonik i pamjes së jashtme është e domosdoshme t'i nënshtrohet ambientit dhe monumenteve me të cilat do të bashkëjetojë.

Sigurisht, të tëra këto në zgjidhjen praktike të tyre paraqesin shumë probleme, që kërkojnë studime të veçanta dhe të thelluara. Megjithatë, mendojmë se ky studim mund të shërbejë si mbështetje për zgjidhjen e disa problemeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e qendrës historike dhe të ndërtimeve që e përbëjnë, si dhe me zhvillimin e mëtejshëm të këtij qyteti.

*Shënim: *Monumentet,* nr. 2, 1972, fq. 85 - 102

DO NOT COPY



*1. Pamja verilindore e qendrës së qytetit dhe e kalasë*



*2. Pamja jugperëndimore e kalasë, në plan të parë kulla në formë bastioni*



*3. Galeri në pjesën juglindore*



*4. Hyrje në pjesën verilindore të kalasë*

DO NOT COPY



*1. Lagjja Pazari i Vjetër*



*2. Pamje nga lagjja Hazmurat*



*3. Pamje e pjesshme e lagjes Cfakë*

DO NOT COPY



*1. Qendra e qytetit (Pazari) në plan të parë dhe pjesa e lagjes Teqe dhe Palorto në plan të dytë*



*2. Banesa në lagjen Teqe*

DO NOT COPY











DO NOT COPY

1. *Kompleks banesash në lagjen Dunavat*
2. *Banesë në lagjen Palorto*
3. *Banesë në lagjen Dunavat*
4. *Banesë në lagjen Dunavat*
5. *Banesë në lagjen Palorto*

Gani STRAZIMIRI

DO NOT COPY

# GJIROKASTËR ET SES VALEURS CULTURELLES

La ville de Gjirokastër conserve, en bon état, un riche patrimoine de monuments de la culture matérielle, crée à travers les siècles par le génie populaire. Ils constituent une source authentique qui jette la lumière sur notre histoire et en particulier sur l'oeuvre créatrice du peuple en matière d'architecture. Ces monuments de genre divers, comportent des éléments très précieux, mais le fait qu'ils sont groupés en ensembles et traités dans le même langage architectural en accroit grandement l'intérêt. Appréciant les importantes valeurs que cette ville renferme, le Conseil des Ministres l'a proclamée, en 1961, ville-musée.

En tant que ville, Gjirokastër doit sa naissance à la nécessité d'un centre d'échanges qui desserve la vallée agricole du Drino et les hautes régions pastorales de Kurvelesh et de Zagorija. La ville est mentionnée pour la première fois sous nom d'Argyrocastro en 1336, par le chroniqueur byzantin, J.Cantocuzène, qui la qualifie d'abord de cité puis de citadelle. Sa population a dû s'accroitre vers le XIVe s. ou vers le début du XVe, lorsqu'elle devint le centre des possessions des Zenevisi. Par la suite, à partir de 1417, date où la ville tomba aux mains des Turcs, sa population, de mêrne que celle des autres cités d'Albanie, dut vraisemblablement diminuer. Jusqu'au début du XVle siècle, la ville ne comptait alors, que 143 maisons. C'est au cours du XVIIe siècle, lorsque commence la désagrégation de l'économie naturelle des villages et la rapide croissance des villes, que Gjirokastër se développe à un rythme accéléré. Si l'on tient compte du fait que la ville comptait à cette époque quelque 380 maisons et que, selon Evlia Tchélébi, le voyageur turc connu, qui la visita en 1672, l'enceinte ne pouvait en contenir plus de 200, il apparait que l'expansion de la ville a dû se produire au cours du XVle siècle, période qui correspond au début d'une stabilisation relative du pouvoir turc dans notre pays. Le premier quartier qui surgit en dehors des murs d'enceinte de la cité fut apparemment le quartier Pllakë. Plusieurs données témoignent en faveur de cette hypothèse; il se situe en effet dans le prolongement du dos de colline sur lequel se dresse la cité, très près des murs d'enceinte de la citadelle; il s'étend le long de la rue principale qui menait de ce côté à la place où avait lieu le marché des villages environnants; et enfin Tchélébi qualifie les habitations de ce quartier de mauvaises maisons, c'est à dire de plus anciennes par rapport à celles des autres maisons de la ville. Immédiatement après, et ce avant le début du XVIIe siècle, les quartiers de Teqe, Meçite, Hazmurat, Varosh, Palorto, Dunavat et Manalat virent le jour et se mirent a croître tour à tour. Au XVIIIe s. à l'endroit où se situe aujourd'hui le centre de la ville, fut créé un nouveau marché appelé pazar i Memi beut. II est facile d'en déduire que l'ancienne ville médiévale avait, a l'époque, commencé à perdre en partie sa fonction séculaire et que le nouveau marché avait réduit à tel point l'importance de l'ancien, que celui-ci disparut complètement par la suite, sur son emplacement se constitua un quartier d'habitation. Selon ses données, le nouveau centre se déplaça dans de la citadelle médiévale à Varosh e Poshtëm; et, en conséquence, dès lors, ce ne fut plus la citadelle, mais le nouveau centre et le nouveau marchée qui servirent d'épicentre au développement de la ville.

Enfin, si l'on tient compte de l'absence de vestiges anciens sur le territoire de la ville et du fait qu'il n'est pas

fait mention de celle-ci dans les sources écrites antérieures au XVI siècle, on peut en conclure que Gjirokastër est éclose pendant le moyen âge, et que, comme la plupart des villes médiévales albanaises, elle a dû vraisemblablement être fondée aux XIIe et XIII siècles.

Gjirokastër s'étend sur le flanc du Mali i Gjerë, sur un assemblement de dos de colline, d'éminences rocheuses et de versants, coupés d'impétueux torrents saisonniers, qui vont se jeter dans le fleuve Drino. Au sud-ouest et au nord-ouest, la ville est respectivement bornée par les hauteurs du Mali i Gjerë et la plaine du Drino; au sud-est et au nord-ouest par les torrents saisonniers de la Bufane et du Çavo

La culture matérielle du passé y a laissé comme témoignages: la citadelle, l'embryon de réseau routier qui reliait les zones environnant la cité et le marché adjacent à la citadelle, le système des rues de la ville après son expansion hors des murs d'enceinte, les différents quartiers, le marché, ainsi que des monuments et des constructions de genre divers.

La citadelle est située sur un plateau rocheux qui surplombe le dos de colline, qui, partant du Mali i Gjerë, traverse la ville dans le sens sud-ouest-nord-est. Son périmètre de forme oblongue, a une longueur maximale de 500 m et une largeur maximale de 75 m. Ses murs d'enceinte, d'une épaisseur atteignant 3 mètres, sont conservés pour ainsi dire intacts sur toute leur hauteur. On accède à la citadelle par trois portes. L'une donne sur le nord-est, les deux autres sur les faces latérales, presque vis-à-vis l'une de l'autre. Le noyau de la citadelle est constitué par la forteresse qui date de la période antérieure à l'occupation ottomane et occupe le nord-est et le centre du territoire enceint. L'extension de la citadelle s'est opérée en 1813-1814 vers le sud-ouest, à l'époque d'Ali Pacha de Tepélène, après que celui-ci se fut emparé de la ville. Il est fort probable que l'aqueduc qui approvisionnait la citadelle en eau, et dont il ne subsiste aujourd'hui que quelques pâles vestiges, ait été construit ces années-la.

Dans la première moitié du XVIe siècle, la ville déborda des murs d'enceinte. Elle se développa durant le troisième quart du XVIIe siècle, pour atteindre son apogée au cours du XVIIIe s. Après avoir débordé de ses murs, la ville s'étendit selon un schéma concentrique. En témoigne le réseau routier, dont les artères convergent en rayons vers le centre de la ville. La cité ancienne, le marché adjacent et les communications avec la région environnante dictèrent précisément ce schéma concentrique d'extension et de développement de la ville.

Tous les quartiers de la ville qui sont nés et se sont développés durant les siècles passés sont conservés en excellent état. D'un intérêt particulier sont ceux de Pllakë, Pazar i Vjetër et Dunavat i parë, qui couvrent le même dos de colline sur lequel s'élève la citadelle; les quartiers d'Hazmurat, Meçite et Teqe, qui s'étendent à la proximité du centre et du marché de la ville, certaines parties des quartiers Varosh et Polorto, quelques ensembles de constructions des quartiers situés derrière la citadelle, ainsi que le marché qui occupe les carrefours des principales routes du centre de la ville actuelle.

Les plus anciennes habitations de la ville datent du XVIIIe siècle. Elles représentent un développement ultérieur de l'ancienne habitation type de la période qui précéda l'occupation turque, habitation qui, apparemment, avec le grand essor économique, politique et culturel de l'époque, atteignit au cours du XVIIIe s. l'apogée de son développement. Les maisons ont un, deux, et, assez souvent trois étages au-dessus du rez-de chaussée. La conception du rez-de-chaussée, qui comprend les locaux à usage ménager, avec leurs murs épais, leurs meurtrières et leurs petites fenêtres placées haut au -dessus du sol, confère à l'habitation de Gjirokastër un caractère défensif et en fait un petit château-fort. D'autre part, la conception des étages supérieurs, où sont situées les pièces d'habitation et les annexes, avec leurs grandes fenêtres, et leurs galeries souvent décorées de peintures fait de cette demeure l'une des plus typiques et des plus originales de la ville médiévale albanaise.

Pour la mise sous protection de cet héritage culturel, nous avons divisé Gjirokastër en trois zones, la zone-musée, la zone protégée et la zone libre. Les parties de la ville qui remplissent le mieux, à notre sens, les conditions pour devenir zone-musée et zone protégée sont certains quartiers situés au centre et au nord-est. Elles couvrent au total quelque 28% et respectivement 16 et 12% des 160 ha que compte la superficie de l'ancienne ville. Nous pensons que les limites du centre historique devraient englober; la citadelle, les vestiges de l'aqueduc, le marché

DO NOT COPY

actuel, les quartiers Pazar i Vjetër, Pllakë, Hazmurat, Meçite et Teqe, quelques parties des quartiers Varosh et Palorto, ainsi que certains ensembles de constructions qui couronnent les collines au sud-est de la citadelle.

Nul doute que la conservation de ce centre historique en tant que but en soi ne peut être conçue qu'en fonction de la vie et du développement de la ville. Dans ces conditions, un rôle déterminant dans la conservation de ce centre historique devra notamment revenir à l'exploitation de cette partie de la ville et des monuments qu'elle contient, en fonction des exigences de la vie quotidienne.

Les constructions nouvelles, comme l'a montré l'expérience acquise à ce jour, ont nui à l'unité et à la valeur de ce centre historique. Quand, pour des motifs impérieux, nous nous verrons contraints d'entreprendre des constructions nouvelles, il sera indispensable que la composition de leurs volumes et la conception architecturale de leur aspect extérieur soient subordonnés aux monuments aux côtés desquels elles s'élèveront. Nous espérons que cette étude pourra servir de fondement pour la solution de certains problèmes relatifs à la protection de ce centre historique et des bâtiments qui le composent, ainsi que pour l'expansion ultérieure de la ville.

DO NOT COPY

**monumentet**
**53/2015**

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

# DY KISHA BIZANTINE NË RRETHIN E GJIROKASTRËS*

Në këtë shkrim do të trajtojmë dy kisha të tipit kryq i brendashkruar me kupolë me mbështetje të lira në rrethin e Gjirokastrës[1], Shën Mërinë e Peshkopisë së Sipërme dhe Shën Mërinë e Labovës së Kryqit. Studimi i përbashkët i këtyre dy monumenteve të rëndësishme për arkitekturën bizantine të vendit tonë paraqet interes, sepse ato përbëjnë hallkat e fillimit dhe mbarimit të zhvillimit, që kishat e këtij tipi kanë pësuar në kohë. Këto monumente kanë qenë studiuar edhe më parë nga Evangjelidhis dhe Versakis, por studimet e tyre të kryera mjaft kohë më parë janë të përgjithshme, çka e bën të domosdoshme studimin e tyre të imët, për t'ju dhënë, për vetë vlerat që paraqesin, vendin që meritojnë ndër monumentet e arkitekturës bizantine të vendit tonë.

* * *

Kisha e Shën Mërisë së Peshkopisë së Sipërme ndodhet 15º në jug të fshatit, e izoluar mbi një breg të kodrave, që nga fusha shkojnë drejt malit të Buretos. Kjo kishë ka qenë selia e dikurshme e peshkopatës së Drinopojës. Pres saj ka marrë emrin dhe vetë fshati ndërsa emri i peshkopatës vjen nga qyteti antik dhe mesjetar i Adrianopojës, që ka qenë shtrirë ndërmjet Teqes së Melanit dhe Sofratikës[2].

Kisha është e tipit kryq i brendashkruar me kupolë mbi tambur me katër mbështetje të brendshme. Mbështetjet janë pilastra me forma të çrregullta nga shtresat dhe mbi to, nëpërmjet një sistemi harqesh mbajtëse, ngrihen tamburi me kupolën. Forma e kryqit, e krijuar në brendësi prej qemerëve, del në çati, duke pasur të qartë krahët veriore dhe jugore, ndërsa dy të tjerët janë nën të njëjtën çati me ambientet anësore. Në vendtakimin e krahëve të kryqit, mbi një bazament kuadratik, ngrihet tamburi cilindrik me kupolën.

Kisha përbëhet nga naosi dhe ambienti i altarit (fig. 1). Hyrja e vetme për në naos është në anën perëndimore, ku ndodhet dhe një portik i vogël (fig. 2). Portiku mbështetet mbi murin e kishës dhe në dy kolona mbi bazamente guri në anën perëndimore. Mbi kolonat dhe murin e kishës ngrihen tre harqe me gurë, mbi të cilët ngrihet një kësulë sferike mbuluar me çati piramidale. Shpatullat e portës janë prej gurësh të punuar, ndërsa arkitrau është prej guri njëcopësh. Nga porta, me një këmbë shkallë zbritet në dyshemenë e naosit. Naosi përbëhet nga vëllimi nën kupolën, krahët veriore dhe jugore të kryqit dhe ambientet këndore veriperëndimore dhe jugperëndimore.

Ky monument paraqitet sot i transformuar, me dritare krejt të murosura dhe me shtesa të mëvonshme si brenda ashtu dhe në anën e jashtme. Në anën jugore kishës i është shtuar një ambient tjetër (edhe ky i transformuar më vonë), drejtkëndësh në plan, i gjatë dhe i ngushtë dhe me pjesën qendrore më të lartë, ndërsa pjesët e tjera nën të njëjtën çati me kishën. Shtesat e brendshme janë sidomos pranë pilastrave, mbi të cilat ngrihen harqe të reja përforcuese për harqet mbajtëse, për harqet mbajtëse veriore dhe perëndimore të kupolës. Shtesa të tilla ka edhe në ambientin këndor perëndimor. Po kështu, një mur i ri përforcues është në anën perëndimore të këtij ambienti.

[1] Rilevim i autorit, S. Dashit, V. Shtyllës, R. Aliajt, fotografitë të H. Çollakut, vizatimet të S. Dashit.

[2] A. Baçe, "Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër)", *Monumentet 4*, 1972, f. 112 – 114, 119.




*Fig. 1*

DO NOT COPY

Për të qenë të saktë, është e nevojshme të themi se pilastrat janë të tillë, nëse do të vrojtonim planimetrinë me fazat e ndërtimit, sepse në të vërtetë – në ndërtimin vëllimor e struktural ato janë perde muri me kalime të mbuluara me hark. Më i vogël dhe i ulët kalimi nga bema për në protezis dhe diakonikon, më i gjerë e më i lartë kalimi nga krahu perëndimor në ambientet këndore përkatëse. Në këtë mënyrë, të katër ambientet këndore janë relativisht të shkëputura si në aspektin funksional edhe në atë hapësinor, nga hapësira qendrore, nën kupolë dhe krahët e kryqit. Këto të fundit janë mbuluar zakonisht me qemerë cilindrikë, në vendtakimin e të cilave, nëpërmjet trekëndëshave sferikë ngrihet tamburi me kupolën mbi të. Po me qemerë cilindrikë janë mbuluar edhe të katër ambientet këndore, të cilat janë në nivel më të ulët se qemerët e krahëve të kryqit. Këto qemere dalin dy nga dy në krahët veriorë dhe jugorë të kryqit.

Si e pamë, ambienti i altarit përbëhet nga bema, protezisi dhe diakonikoni. Bema, për shkak të komunikimeve të vogla



*Fig. 2*

me këto të fundit, përbën deri në një farë mase një ambient të vetëm. Ajo sot ndahet nga naosi prej një ikonostasi të pikturuar me afreske nga ana e naosit. Ky mur është i shtruar më vonë[3] shërben në të njëjtën kohë edhe si përforcim për harkun mbajtës të kupolës, sepse shkon deri tek ai. Përpara këtij muri ndodhet ikonostasi i ri prej druri. Si shpatulla të portës, nëpërmjet të cilës bema komunikon me naosin, janë dy shtylla, mundet të ikonostasit të vjetër. Në absidën gjysmë rrethore, duke filluar nga dyshemeja kemi tre shkallë, në mes të cilave është një fron i gurtë (Tab. I, 1; Tab. II). Kemi të bëjmë me fronin e peshkopit dhe vendet e ndenjes së shërbenjësve të tjerë.

Në mes të bemës është tryeza e altarit e përbërë nga një pllakë e gdhendur në sipërfaqe që mbështetet mbi bllok muri. Në dysheme është një fragment pllake me dy fole, mundet për mbështetje të kolonave të ndonjë tryeze apo baldakini.

Nga bema, nëpërmjet dy hapësirave të ngushta dhe të ulëta që përmendëm më lart, kalohet respektivisht në protezis dhe diakonikon me planimetri drejtkëndëshe të mbuluar me

[3] Sipas mbishkrimit, pikturimi është bërë në vitin 1511 shih: Th. Popa, "Mbishkrimet e kishave të Shqipërisë si burime historike", *BUSHT SH SH*, 1958, 1, f. 224; F. Versaqis mendon se ky mur, të cilin ai gabimisht e vë në tërë zonën e ambientit të altarit, është pjesë e vjetër e kishës. Shih: *Arkeologiki Efimeridha*, Athinë 1916, f. 114 – 117.

DO NOT COPY

qemer. Ato kanë në anën lindore një absidë gjysmë rrethore me dritare të vogël dyshe, sot të murosur. Nga ato, vetëm ajo e protezisit ruan akoma kolonën. Absidat nuk shkojnë deri në tokë, ato mbarojnë në formë sofaje, duke patur të murosur pllaka të tjera të gdhendura në sipërfaqe nga ikonostasi i dikurshëm i kishës. Ndërsa diakonikoni është i hapur ndaj naosit në tërë gjerësinë e tij, protezis ka një mbyllje me një portë në mes, që duket se është vënë për përforcim.

Me sa kuptohet. nga mënyra me të cilën janë vënë përforcimet në anën e poshtme dhe në brendësi, kisha do të ketë pësuar dëmtime në muret dhe strukturat mbi to, si pasojë e ndonjë shkarje të terrenit. Një mur mbrojtës është në tërë faqen veriore të kishës, deri tek dritarja e krahut të kryqit në pjesën e tij më të lartë. Pilastra dhe harqe mbi to ka në krahun verior të kryqit, ku dalin ambientet këndore verilindore dhe veriperëndimore, duke përforcuar mbështetjen e qemerit të krahut të kryqit, si edhe një mur masiv pranë murit perëndimor të ambientit këndor. Po kështu, përforcime me hark mbi pilastra janë bërë nën harqet mbrojtëse veriore dhe perëndimore të kupolës (Tab. I, 4). Kuptohet që tërë këto përforcime janë vendosur pa marrë parasysh vlerat dhe kanë zënë në një farë mase brendësinë. Duhet thënë se këto masa nuk kanë prekur strukturat e monumentit dhe në një kohë të dytë mund të zëvendësohen, duke i rikthyer monumentit tërësisht pamjen e tij të dikurshme në brendësi.

Në muret e jashtme, veriori dhe jugori janë të fshehur, i pari nën murin mbajtës ndërsa i dyti nga ambienti shtesë (Tab. III). Të vetmet pjesë që kanë mbetur në dukje janë frontonet e krahëve të kryqit. Ai nga jugu është i ndërtuar vetëm me gurë, me një dritare dyshe të mbuluar me harqe, mbi një kolonë të shkurtër me kapitel guri. Frontoni përfundon me një kornizë me një rresht tullash, të vendosura në formë dhëmbë sharre. Frontoni nga veriu ka gjithashtu një dritare dyshe, ndërsa korniza e vjetër nuk ruhet.

Fasada perëndimore (Tab. IV) ruan gjurmë të ndërtimeve të ndryshme, kështu që është e vështirë të përcaktohen pjesët e vjetra dhe radha e mbivënieve. Në të dy anët e portikut, në qendër të këtij muri dallohen dy fuga vertikale të mbuluara në mënyrë të çrregullt me llaç, që përfundojnë në mbulesën e qemerit të krahut të kryqit.

Harku në dukje i qemerit është i ndërtuar me gurë çmërsi që alternohen me dy tulla. Muret anash fugave janë ndërtuar kryesisht me gurë, duke patur jo kudo edhe tulla ndërmjet tyre. Këto fuga janë të dallueshme dhe në pjesën e brendshme, ku muri vende – vende formon një dhëmb (Tab. I, 2). Duke vrojtuar mbështetjen në mure, shohim se ato janë të lidhura me të dhe pjesë përbërëse të tij. Një gjë e tillë, si dhe fugat e mësipërme na shtyjnë të mendojmë se gjithë mbushja me qemerin e krahut perëndimor të kryqit duhet të jetë rindërtuar kur është ndërtuar portiku përpara portës. Në rast të tillë, edhe muri i vjetër ka qenë mur mbushës dhe, duke parë mënyrën me të cilën janë ndërtuar qemeri dhe muret që mbajnë atë me gurë dhe tulla, mendojmë që kjo mbushje ka qenë sadopak më brenda sipërfaqes së murit perëndimor të kishës. Mbetet për të provuar këtë në një të ardhme nëpërmjet sondazhit në pjesën e poshtme të murit dhe themelit.

Duke vërejtur muraturën, sidomos pjesën në jug të harkut qendror, dallojmë qartë teknikën e ndërtimit të murit të vjetër, që është me gurë, duke patur rrallë copa tullash apo tjegullash, të cilat në mjaft vende janë të vendosura edhe vertikalisht. Rreth 1 m nga thembra e harkut, menjëherë nën rasat e gurit të çatisë, ndodhen dy gurë njëri mbi tjetrin, që formojnë një fugë vertikale, tej së cilës muri ndërron pamjen (Tab I, 3). Kjo gjë tregon se këto gurë janë të qoshes së shpatullës jugore të krahut të kryqit, të mbuluar nga mbushja e vonë e ambientit këndor jugperëndimor, e cila është lidhur me pjesën e vjetër nëpërmjet futjes së gurëve në të. Një gjë e tillë nuk vërehet në anën veriore, ku muri është meremetuar. Korniza mbi frontonin e krahut të kryqit nuk ruhet, me përjashtim të rrafshimit me gurë e tulla, mbi të cilin vendoseshin tullat e kornizës. Më e qartë është kjo në anën jugore, ku rrasat janë vendosur direkt mbi të, ndërsa në anën veriore ka mbushje me muraturë me gurë të vendosur pjerrtas. Çatia me rrasa guri vazhdon me të njëjtën pjerrësi deri në muret veriore dhe jugore.

Pjesët e tjera të mureve janë me gjurmë meremetimesh të ndryshme, me fuga vertikale, që mund të jenë edhe dritare, sqarimi i formës të së cilave mund të bëhet vetëm pas sondazheve. Një portë e murosur është në pjesën që i takon ambientit këndor veriperëndimor. Gjithashtu, një kundërforcë është në qoshen veriore, ndërsa pjesë muresh të një ambienti të vonë në anën jugore.

Ana lindore e kishës është më pak e transformuar se të tjerat dhe më e zbukuruar se ato (Tab. IV, Tab. V, 1). Pjesën qendrore dhe më të madhen e saj e zë absida kryesore, që së

DO NOT COPY

bashku me krahun lindor të kryqit, del ndaj faqes lindore duke u theksuar në këtë mënyrë më tepër. Në qendër të absidës është një dritare treshe. Ajo mbulohet me tri harqe tullash që mbështeten në muret dhe dy kolona drejtëkëndëshe furi me kapitel guri trung piramide. Mbi harqet me tulla të vendosura në mënyrë radiale ka një rresht tullash në formë dhëmbësh sharre brenda një rreshti tullash përgjatë harkut. Sot, të tri dritaret janë të murosura në rrafshin e kolonave duke pasur për ndriçim dy hapësira mjaft të vogla. Në të dy anët e dritares treshe janë dy nike me nga një dritare të ngushtë në mes (Tab. I, 5). Nga shqyrtimi i tyre dhe në anën e brendshme, rezulton të jenë dritare të murosura në pjesën e sipërme, ndërsa nike në pjesën e poshtme. Ato mbulohen me hark prej gurësh, mbi të cilin kemi një hark tullash radiale e një rresht dhëmbësh sharre, që duket si vazhdim i atij të dritares treshe. Në mes të gjithë këtyre harqeve ka harqe të tjera prej tullash të rrethuara dhe ata me dhëmbë sharre tullash. Mbi dy qendroret ka një tjetër, në fushën që formohet ndërmjet tij dhe atyre mbi niket ka një kryq të formuar prej tullash.

Dy absidat anësore janë thuajse gjysmë rrethore, sepse i ngjiten trupit të krahut të kryqit. Edhe ato mbulohen me rrasa guri, por nuk kanë ndonjë gjurmë kornize. Dritaret e dikurshme sot janë të transformuara. Ajo e absidës nga jugu ka një dritare të mbuluar me hark tullash dhe të murosur me një hapësirë të vogël në mes. Ajo e absidës nga veriu ka dy dritare të ngushta dhe ruan të murosur (shihet vetëm nga ana e brendshme) kolonën e dikurshme. Mbi secilën nga absidat duken fugat e pjerrëta të murit të vjetër të ambienteve këndore, mbi të cilat janë ngritur më vonë mure mbushëse për të vazhduar çatia e krahut të kryqit deri në anët jugore e veriore të kishës. Muratura e faqes lindore është kryesisht prej gurësh por nuk mungojnë edhe copërat e tullave.

Tamburi është i ulët dhe përfundon me një kornizë të dyfishtë tullash të drejta dhe në formë dhëmbësh sharre, që ruhet relativisht mirë (Tab. V, 2). Katër dritare dyshe janë sipas katër pikave të horizontit. Ato mbulohen me harqe prej tullash radiale që mbështeten në qendër në një kolonë me kapitel guri (fig. 3). Rreth harqeve kalojnë dy radhë tjegullash, të cilat vazhdojnë në tërë sipërfaqen e tamburit, nga dritarja në dritare. Tamburi është i ndërtuar me gurë të mëdhenj çmërsi. Një rresht tullash të holluara nëpërmjet gdhendjes kalon edhe në pjesën e sipërme, mbi të cilin ka dy radhë gurësh çmërsi, ndër të cilët ka dhe copa tjegullash



*Fig. 3*

dhe tullash. Ndërtimi thuajse vetëm me gurë i tamburit shton edhe më tepër pamjen e tij të rëndë dhe primitive.

Ambienti i ri që i është shtuar kishës, është në plan drejtkëndësh me brinjë të gjata sa ajo e kishës, brinjët jugore dhe veriore. Ky ambient i shtuar lidhet me kishën nëpërmjet një dere që duket se është hapur më vonë. Ambienti përbëhet prej tri vëllimesh, dy anësorët më të ulët dhe mbuluar me qemer cilindrik me formuese lindje – perëndim, ndërsa qendrori më i lartë i mbuluar me qemerë cilindrikë me formuese veri – jug. Pjesa qendrore del dhe mbi çati, njëlloj si krahët e kryqit dhe mbulohet me çati dyujëse, duke patur një fronton në anën jugore.

Sot ky ambient lidhet vetëm me kishën. Por më parë, ai ka patur tri hyrje, nga një të vogël në anët lindore dhe perëndimore dhe një, më e madhja në anën jugore. Kjo e fundit, sot e murosur, zë tërë daljen e vëllimit qendror në këtë anë. Ndërsa për atë nga lindja jemi të qartë, sepse muri lindor është i tëri një dorë me muret e tjera të ambientit shtesë, hyrja nga perëndimi ka shumë gjasë të jetë e re, sepse muri në këtë anë duhet t'i përkasë ndonjë meremetimi. Kjo pjesë e murit është ndërtuar me gurë si dhe muri i ri në pjesën e ambientit këndor jugperëndimor, në kontaktin më të cilin ruhet një fragment i vjetër kluasonazh.

DO NOT COPY

Teknika e ndërtimit të mureve të shtesës është me kluasonazh, me nga një rresh tullash horizontale dhe dy ose tri tulla vertikale (Tab. V, 3). Në pjesën e poshtme të murit janë vendosur gurë të mëdhenj të skuadruar me shumë gjasë të periudhës antike (Tab. V, 4). Sipas vendasve, të tillë gurë ndodheshin deri vonë me shumicë rrëzë kodrës së kishës. Faqja lindore ka në mes hyrjen e murosur, të mbuluar me hark tullash, të vendosura sipas rrezeve, të rrethuar me tulla përgjatë harkut. Pjesa e poshtme e murit, deri afër lartësisë së kryqit të harkut është me kluasonazh. Mbi hark janë dy rozeta tulle, anash të cilave kemi një radhë tullash të vendosura sipas brinjëve dhe diagonaleve të katrorit. Mbi to ka një ose dy radhë tullash dhe pastaj vazhdon një fushë e tërë tullash, të vendosura sipas vijave që ndërpriten 45° ndaj horizontit (Tab. V, 5). Në këtë mënyrë formohet një rrjet katrorësh që kanë tulla sipas diagonaleve horizontale[4]. Duke vrojtuar anët e kësaj fushe nga jugu dhe veriu, do të dallojmë se ky mur i vjetër shkon deri në anë të mureve të ambientit, duke patur mbushje më të vonë tamam në këto pjesë, çka do të thotë se pjesa e sipërme ka qenë më e ngushtë. Kjo duket po të shohim faqen jugore, ku pjesa e sipërme në fjalë është jo me kluasonazh, por muraturë të çrregullt me gurë. Duke u nisur nga pjesët e vjetra dhe të reja, rezulton që pjesët anësore të ambientit shtesë të kenë qenë mbuluar me çati dyujëse, me flegrën nga jugu më të madhe, sepse kulmi i çatisë nuk është në qendër por i zhvendosur nga veriu. Fuga e pjerrët e murit të vjetër dhe atij të ri duket qartë.

Muret e mbulesës së pjesës qendrore mbi çati janë me kluasonazh pak a shumë të çrregullt (Tab. V, 6), me tulla në vend të gurëve dhe tri e deri katër tulla vertikale. Hyrja jugore ka qenë e mbuluar me hark tullash, vazhdimi i qemerit të brendshëm.

Duke patur të qartë si formën e dikurshme të kishës, ashtu edhe atë të ambientit shtesë, mendojmë se kjo shtesë është bërë kur kisha ruante akoma format e vjetra, sepse është realizuar me një farë mase në mënyrë të rregullt dhe duke respektuar ndërtimin bazë. Me sa mund të kuptohet nga forma e tij e parë, ky ambient duhet të ketë luajtur për kishën rolin e një narteksi të hapur, ndërsa në gjendjen e sotme rolin e një ambienti ndihmës. Ky ambient është mbyllur më vonë, duke patur meremetime të mureve si dhe ndryshimin e formës së çatisë, e cila unifikohet me çatinë e re të kishës.

Nga studimi i monumentit rezulton se kemi të bëjmë me një kishë të tipit kryq i brendashkruar me kupolë mbi tambur të tipit provincial, të cilit i përmbahet tërësisht në planimetrinë dhe ndërtimin vëllimor e strukturor. Në aspektin e jashtëm, në dekorin minimal, format dhe proporcionet e tamburit të frontoneve vërehet qartë se kemi të bëjmë me një ndërtim të hershëm. Vetëm fasada lindore dekorohet gjerësisht me tulla, ndërsa në të tjerat tulla përdoret shumë pak. Mungon gjithashtu kluasonazhi, i cili që nga fundi i shek. XI e më vonë bëhet teknikë e rëndomtë në provincat. Po për këtë flasin tamburi i ulët dhe kornizat e drejta. Në planimetri e në ndërtimin e brendshëm shohim përdorimin e pilastrave, të cilët siç pamë janë thuajse mure. Në këtë mënyrë në brendësi ruhen akoma, nëpërmjet shmangies së ambienteve këndor nga pjesa qendrore me kupolë, elemente të ndërtimit bazilikal.

Hapësira e brendshme është tipike bizantine me tipare primitive që theksohen nëpërmjet numrit të pakët të dritareve dhe madhësisë së tyre, kupolës së ulët dhe në përgjithësi mbizotërimit të akseve horizontale ndaj vertikalit. Sigurisht që monumenti do të fitonte së tepërmi me largimin e shtesave sidomos në brendësi, zbulimit të pikturës murale të vjetër që ka shumë mundësi të ruhet sado e fragmentuar. Së fundmi, me interes paraqitet dhe ikonostasi, nga i cili, siç përmendëm, ruhen disa pllaka dhe dy kolona të murosura.

Udhëtari anglez Holend, që e vizitoi monumentin në vitin 1812, lexoi në muret e tij një mbishkrim sipas të cilit, për sa arriti të kuptonte ai, rezultonte se kisha është ndërtuar nga perandori bizantin Manuel Komneni[5], që sundoi në vitet 1143 - 1180. Ky mbishkrim sot nuk ruhet, mund të jetë i mbuluar nga ngjyrosja e re e mureve. Në të tilla rrethana, ne mendojmë se është e domosdoshme të verifikojmë atë, duke shqyrtuar çka ofron monumenti, gjë që do të vlejë për pranimin apo jo të këtij datimi tradicional. Duke u nisur nga planimetria që akoma nuk ka të plota tiparet e tipit kryq i brendashkruar me kupolë, që e shohim në formën e

[4] Një dekor të përafërt me tulla sipas diagonaleve vertikale, kemi në kishën e Shën Theodhorës në Artë; shih: A. Orlandos, "Agjia Theodhora tis Artis", në *Arheion Vyzantinon Mnimeion Elladhos B*', 1936, 1, fig. 5; 13. Po aty gjejmë dhe rozetën.

[5] Holland H., *Travels in Ionian Isles. Albania, Thesaly and Macedonia during the years 1812 - 1913*, London 1815, f. 481.

ZONOTOPY

pilastrave, që janë më tepër vazhdim muresh se sa pilastra të lira; nga proporcionet që vërehen në lartësitë e vogla ndaj përmasave në plan sidomos tek tamburi si dhe nga mungesa e kluasonazhit, mendojmë se monumenti duhet të jetë ndërtuar në periudhën që shkon nga fundi i shek. XI në mesin e shek. XII, çka e bën të besueshme të dhënën e Holendit. Për këtë mendojmë se do të japin një ndihmë dhe studimet e mëtejshme lidhur me hyrjen e tipit në këto zona dhe fillimin e përdorimit të kluasonazhit.

Për sa i përket ambientit shtesë, ai i takon periudhës së para pushtimit turk dhe, duke u nisur nga teknika e ndërtimit të kluasonazhit me shumë tulla vertikale dhe dekori në murin lindor, mendojmë se ai është ndërtuar gjatë shek. XIII – XIV.

* * *

Kisha e Shën Mërisë së Labovës së Kryqit, në mes të fshatit, e rrethuar nga një oborr me volumin e saj në ngjyrë të kuqe, në sfondin e një selvie shekullore, dominon fshatin, sidomos kur e shohim për së largu.

Në pamjen e jashtme monumenti ka format e kishave të tipit kryq i brendashkruar të variantit provincial, ndërsa në brendësi nuk kemi të bëjmë me këtë tip, sepse hapësira qendrore me kupolë mbi katër pilastra, ndahet nga krahët e kryqit me tre arkada dy katërshe prej dy kolonash. Në këtë mënyrë, studimi i monumentit paraqet interes të veçantë për këtë zhvillim të mëtejshëm të tipit dhe për lidhjen e tij me monumente të tjera të përafërta të Kostandinopolit dhe të provincave.

Sot, kisha paraqitet e transformuar nga meremetimet dhe shtesat e ndryshme që i janë bërë, sidomos në anët jugore dhe perëndimore (fig. 4), të cilat duke mos marrë parasysh vlerat e saj, kanë bërë që të humbasë mjaft nga pamja e dikurshme.

Në anën perëndimore, ku është dhe hyrja e vetme e kishës, ngrihet një portik me një arkadë (fig. 5) prej 8




*Fig. 4*

DO NOT COPY



*Fig. 5*

harqesh, që mbështeten në dy pilastra anësore dhe 7 kolona të vendosura mbi një mur të ulët, që ndërpritet vetëm për të lejuar kalimin për në kishë. Nëpërmjet një dere të ulët, të mbuluar me hark hyhet në narteksin e vonë mbuluar me qemere. Njëri, me formuese lindje perëndim, është në pjesën qendrore që lidh portën e narteksit me të kishës. Tjetri me formuese jug veri mbulon gati tërë narteksin. Qemeri i parë ndërpret tërthorazi këtë qemer gjatësor dhe është në nivel më të lartë. Një gjë e tillë, me sa kuptohet, është bërë që porta e kishës të mos mbulohet nga qemeri gjatësor. Narteksi i vonë në përgjithësi është i errët dhe ndriçohet vetëm nga dy dritare të ngushta. Siç do të shohim, ndërtimi i tij është bërë më tepër për arsye konstruktive se sa për arsye funksionale.

Nga narteksi, me tre këmbë shkallë (Tab. VI), hyhet në kishë, që përbëhet nga ambienti i altarit, dy pjesët mbrapa arkadave në veri dhe në jug të hapësirës qendrore dhe nga pjesa e përparme, që në një kohë të vonë është bërë me dy kate, e cila deri në një farë mase luan sot rolin e një narteksi ndaj hapësirës nën kupolë. Hapësira qendrore nën kupolë ka në qoshet e saj katër pilastra të formave të ndryshme, mbi të cilat ngrihen harqet mbajtëse të kupolës. Arkadat që përmendëm shkojnë lart, deri në harkun mbajtës të kupolës dhe qemerin e krahut të kryqit.

Arkada jugore (fig. 6) përbëhet në pjesën e poshtme me tri harqe thuajse të barabarta që mbarojnë në të njëjtin nivel dhe të mbështeten tek jastëku mbi kapitel nëpërmjet një këmbëze harku. Të dy kapitelet janë të veshura me stuko të ngjyrosura, duke krijuar forma të rregullta të kapitelit korintik me gjete akanti të mprehta. Nga vrojtimi rezultoi se ndonjë prej tyre është dëmtuar dhe plotësuar, duke e imituar me stuko, në një kohë të vonë, kur janë bërë dhe një sërë kornizash dhe dekore të tjera që veshin në nivele

DO NOT COPY

të ndryshme interierin e hapësirës qendrore nën kupolë. Mbi kapitelet ka nga një jastëk guri që janë në formë trungu piramide të përmbysur, duke pasur pjesën e sipërme të gdhendur në formë paralelepipedike. Kolonat e kësaj arkade janë një copë, mundet të marra nga ndërtime më të vjetra, dhe mbështeten mbi bazamente të larta të ndryshme.

Kati i dytë i arkadës jugore përbëhet prej tri harqesh që janë në të njëjtën lartësi. Ato janë mbi kolona të ulëta, të cilat nga ana e tyre mbështeten mbi murin me të cilin përfundojnë harqet e poshtme. Kapitelet e kësaj arkade janë në formë trungu piramide, që zgjerohet vetëm pak në pjesën e sipërme, kështu që jastëku mbi ta, për mbështetjen e harkut del së tepërmi ndaj kapitelit. Edhe këtu ka tirante druri që janë në fillimin e tri harqeve direkte mbi kapitelet. Një mur me trashësinë e harqeve ngrihet mbi to deri në sipërfaqen e brendshme të harkut mbrojtës të kupolës, i cili është më i gjerë se ky mur.

Arkada veriore ka disa ndryshime nga ajo jugore. Harku në lindje të arkadës së poshtme është më i ulët, duke filluar drejtpërsëdrejti mbi jastëkun e kapitelit. A është kjo forma e dikurshme apo kemi të bëjmë me një meremetim, nuk mundëm ta dallojmë. Tirantet e kësaj arkade, si dhe ato të së sipërmes janë të prera. Kati i dytë i arkadës veriore ka të njëjtë me atë të arkadës jugore formën e kolonave dhe kapiteleve, por ka të ndryshme harqet. Dy të anës fillojnë drejtpërsëdrejti mbi kapitelet, ndërsa i mesit pak më lart, duke mbaruar kështu në nivel më të lartë. Gjithashtu, shënojmë se harku nga lindja është i murosur sa gjerësia e murit të arkadës. Harku tjetër anësor shkon më brenda harkut mbrojtës, çka tregon se arkada nuk bën pjesë në të njëjtën strukturë me harkun mbrojtës të kupolës dhe se qemeri i krahut të kryqit është i ndarë nga ai.

Arkada perëndimore sot është mjaft e transformuar, në pjesën e poshtme pranë kolonave janë ndërtuar dy pilastra, të cilët murosin gati tërësisht edhe harqet anësore. Mbi këto pilastra dhe murin perëndimor ngrihen dy harqe (Tab. VII, 1), mbi të cilat muri mbaron horizontalisht në pjesën e sipërme. Mbi këto dy harqe ngrihen dy pilastra që mbajnë një hark, i cili është vendosur për të përforcuar qemerin e krahut perëndimor të kryqit, i cili duhet ta kishte pësuar nga dëmtimi i kupolës, sepse dhe është shkëputur prej tij.

Mbrapa arkadës perëndimore, në një lartësi 2,30 m nga toka, në tërë gjerësinë e kishës është një tribunë me konstruksion druri, e cila ka parmakë vetëm në pjesën e arkadës, ku dhe është hapur ndaj naosit. Në të hipet me një



*Fig. 6*

shkallë druri të ngushtë dhe të pjerrët. Lëvizja në tribunë është deri në një farë mase e vështirësuar prej harqeve që përshkruam më sipër dhe qëndrimi në të, në aspektin arkitektural, është pasiv ndaj hapësirës qendrore nën kupolë dhe naosit në përgjithësi. Nga ambienti i tribunës me një portë të hapur tamam nën dritaren e frontonit të karhut perëndimor të kryqit, kalohet në nën çatinë e narteksit. Kjo nënçati ka një dysheme të shtruar me rrasa guri[6].

Hapësirat mbrapa dy arkadave të forta janë gati të njëllojta. Ato përbëhen nga vëllimi nën krahun e kryqit. Në gjendjen e sotme ato janë relativisht të errëta dhe marrin dritë

[6] Siç na thanë fshatarët, në këtë pjesë të kishës dikur ka qenë një klasë e shkollës dhe se çatia ka pasur formë tjetër, duke qenë në nivel më të lartë. Edhe sot duken në murin verior gjurmë të një dirtareje.

DO NOT COPY

nga dritare gjysmë të zëna në pjesën nën qemer (frontoni i krahut të kryqit) dhe nëpërmjet arkadës. Ambienti verior prapa arkadës lidhet në anën lindore me protezisin. Kalimi nga njëri tek tjetri bëhet nëpërmjet një hapësire të mbuluar me hark në nivel të ulët. Mbi harkun e parë ka një boshllëk të lartë të mbuluar dhe ai me hark. Në anën perëndimore kalimi i ngushtë është i mbuluar me harqe në dy nivele. Në nivel të ulët në pjesën nga perëndimi, në nivel të lartë në anën tjetër, duke formuar në këtë mënyrë një shkallëzim. Ambienti mbrapa arkadës jugore ndryshon vetëm në mbulimin e kalimit, në pjesën perëndimore. Në nivel të ulët mbulohet kalimi, ndërsa nga ana e vëllimit mbrapa arkadës, kemi në pjesën e sipërme një boshllëk të ngushtë e të fortë të mbuluar me hark.

Ambienti i altarit ndahet nga naosi nga një ikonostas druri të gdhendur në nivel të mirë artistik. Kjo pjesë e kishës mbulohet me qemer cilindrik, me formuese lindje perëndim në pjesën qendrore që i takon krahut të kryqit dhe me dy qemerë me formuese veri – jug në nivell më të ulët, në pjesët anash tij.

Mbishkrimi që ka ikonostasi mban datën 26 gusht 1805, kohë e përfundimit të gdhendjes së tij. Nga dera qendrore e ikonostasit hyhet në bemën e lartë dhe të gjerë. Bema ndiçohet nga një drityre e dyfishtë. Ajo lidhet me protezisin dhe diakonikonin me klasike të ulëta të ngushta që zënë tërë trashësinë e pilastrit, që mbulohen me qemerë në dy nivele. Në nivel më të ulët në anët e bemës, në nivel më të lartë në anët e protetisit dhe diakonikonit. Një veprim të tillë nuk e shpjegojmë dot.

Si protezisi dhe diakonikoni kanë nga një absidë të ngushtë dhe të lartë, që fillon jo menjëherë mbi dysheme. Në faqen veriore të protezisit ka një kamare në tërë trashësinë e murit, që nuk kuptohet nëse është hapur më vonë, e cila është e mbyllur në anën e jashtme nga shtesat që i janë bërë kishës. Gjithashtu, një derë, me sa duket e hapur më vonë, sot mbrapa një strukture të drunjtë me një ikonë, lidhte kishën me qimiterin e shtuar në anën veriore[7].

Edhe dy porta të tjera janë hapur më vonë, një në anën veriore dhe që lidhet me ambientin e jashtëm, ndërsa tjetra në anën jugore, për të lidhur kishën me ambientin shtesë nga jugu. Ky ambient është i zgjatur në plan dhe mbulohet me qemerë cilindrikë. Si dhe tek narteksi, kjo shtesë i ka të dy muret të reja dhe atë nga veriu të mbështetur murit jugor të kishës. Kjo shtesë mund të jetë bërë për arsye konstruktive. Ajo përbëhet prej tri pjesësh. Dy anësoret janë të mbuluara me qemer cilindrik, me formuese lindje perëndim, ndërsa pjesa tjetër qendrore është në nivel më të lartë dhe më formuese veri – jug dhe shërben për lidhjen e kishës me ambientin e jashtëm, për çka ishte hapur jo vetëm porta e re në murin jugor të kishës, por dhe një portë në muret shtesë. Kjo portë e fundit në fillim është ngushtuar e më vonë është murosur përfundimisht. Në murin lindor të kësaj shtese janë dy nike të harkuara ndërsa një kamare është në anën veriore të këtyre nikeve. Këto elementë na shtyjnë të mendojmë se kjo pjesë e ambientit do të ketë shërbyer si paraklis. Në anën perëndimore të tij ndodhet një mur, i cili përforcon qemerin për të mbajtur mbi vete kambanoren e vonë.

Studimi i monumentit është i pamundur pa njohjen e pamjes së jashtme të tij. Sot ai i ofrohet shikimit të studiuesit me pamje krejt të ndryshme nga e dikurshmja, që e bën mjaft të vështirë leximin e tij, si për shkak të shtesave ashtu edhe për shkak të meremetimeve të shumta dhe të pakujdesshme, të cilave u është nënshtruar kisha. Gjithashtu, edhe mbushjet e terrenit që arrijnë deri në nivelin e dritareve në anën lindore kanë zvogëluar dukjen e kishës në këtë anë. Në pamjen e dikurshme është vetëm kupola. Nga muri jugor janë të vjetra vetëm pjesët në dukje të bazamentit të tamburit, nga muri perëndimor duket vetëm frontoni i krahut të kryqit dhe bazamenti i tamburit, nga ana veriore frontoni dhe pjesë të vetë tamburit, ndërsa në anën lindore ruhen vetëm fragmente të muraturës së dikurshme.

Tamburi cilindrik (Tab. VIII, 1) është i dekoruar i tëri me tulla. Ai përbëhet në sipërfaqen e jashtme prej dy brezash dekorativë, të dallueshëm nga njëri tjetri. Në anën e brendshme, për sa dallohet në vrimat e skelave, muri rezulton të jetë i ndërtuar me tulla dhe gurë çmërsi. Brezi i poshtëm, që është dhe më i lartë, ka si elementë kryesorë katër dritare që alternohen me katër nike. Dritaret janë vendosur sipas pikave të horizontit. Ato janë dypjesëshe me nga një kolonë një copë guri në mes. Kolona në prerjen tërthore është e stërzgjatur me anët e ngushta të rrumbullakosura pas një dhëmbëzimi (Tab. VIII, 2). Dallim bëjnë baza dhe kreu i kolonës që janë drejtkëndëshe. Kalimi nga trupi i kolonës për në pjesën e sipërme bëhet nëpërmjet një profili. Bazamenti i kolonës është në formë trung piramide me parmasa pak më

[7] Versaqis mendon gabimisht se kjo derë ishte e vjetër dhe ndodhej në mes të murit verior. Shih: *Arheologjiki Efimeridha*, 1916, f. 108.

DO NOT COPY

të mëdha se kolona, ndërsa kapiteli po trung piramide e me brinjë të gjatë sa trashësia e mureve të tamburit.

Shpatullat e dritareve janë prej dy radhësh të shkallëzuara prej tullash, nga të cilat e jashtmja më e gjerë se e brendshmja. Këto dy radhë tullash mbulojnë në formë harku secilën nga pjesët e dritares, duke mbështetur mbi kapitelin me ndërmjetësinë e një këmbëze harku po prej tullash. Duke qenë se kapiteli është i ngushtë, harqet që mbështeten në të vijnë duke u ngushtuar, madje dy të mesit, pa arritur deri në mbështetje reduktohen, në një tullë të vendosur këlliç për së gjati. Shpatullat dhe harqet e shkallëzuara janë të rrethuara në anën e jashtme nga një shirit tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre brenda tullash të vendosura për së gjati.

Edhe niket ndërmjet dritareve janë me dy radhë harqesh të shkallëzuara që vazhdojnë dhe në shpatullat e tyre. Nikja është cilindrike me bazë gjysmë rrethore dhe mbulohet me konkë sferike në pjesën e sipërme. E gjithë nikja rrethohet me shirit tullash si dhe dritaret.

Pak mbi dritaret dhe niket ndodhet një shirit horizontal tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre, ndërmjet një rreshti tullash mbi të dhe dy rreshta nën të. Një shirit tjetër i tillë ndodhet nën nivelin e dritareve dhe nikeve. Ky i fundit duket pjesërisht, sepse mbulohet nga çatia e sotme e bazamentit të tamburit.

Sipërfaqja e lirë ndërmjet dy shiritave me tulla të vendosura në formë dhëmbësh sharre, që përmendëm më lart dhe që kufizojnë brezin e poshtëm është dekoruar e tëra me tulla. Dekori përbëhet prej brezash tullash të ndara nga rreshta tullash. Secili brez ka për dekor tulla të plota veshëse të vendosura 45° ndaj horizontit me gjysma tullash në pjesët ndërmjet këndeve, tulla trekëndëshe të vogla dhe të mëdha të alternuara, tulla këlliç me fuga llaçi të trasha dhe tulla ku janë gërvishtur diagonalet. Vrima të skelave janë në të dy rreshtat e tullave këlliç, në secilin nga intervalet ndërmjet nikeve dhe dritaret.

Brezi i dytë i tamburit është ndërmjet shiritit të sipërm me tulla dhe kornizës nën çati. Ky brez përbëhet prej rreshti tullash me veshëse të plota me brinjë 45° ndaj horizontit e tulla trekëndëshe me qoshe, prej rreshti tullash të vendosura këlliç që alternohen, me tulla trekëndëshe, me tulla të vendosura në formë kurriz peshku, tullash kuadratike dhe në një vend shirit tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre. Nga këto vetëm rreshti me tulla këlliç formon një rresht të plotë, të tjerët janë vazhdim i njëri tjetrit, gjë që shpjegohet me punën e muratorëve të ndryshëm ose me kërkesa estetike. Edhe këtu, si dhe në brezin e poshtëm, ndërmjet radhëve të ndryshme të dekorit ka rreshta tullash që shërbejnë për lidhjen e veshjes me bërthamën e murit.

Tamburi përfundon me një kornizë të dyfishtë prej tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre e tullash të drejta mbi to. Mbi të vjen çatia prej rrasash guri. Gjurmë në dukje të mbulesës së çatisë së dikurshme me tjegulla nuk ka. E vetmja dëshmi që na shtyn të mendojmë për këtë zgjidhje është prania e disa tjegullave solene, pak të kurbëta, që ruhen të përdorura në ndonjë vend ndërmjet rrasave të mbulesës.

Pjesët në dukje të bazamentit të tamburit janë të dekoruara edhe ato me tulla. Dekori, si dhe tek tamburi është me breza tullash të vendosura këlliç, me faqen në dukje, me tulla trekëndëshe të vendosura në mënyrë alternative, me tulla me faqe të plotë të vendosur 45° e tulla trekëndëshe ndërmjet tyre. Ndërmjet brezave të mësipërme ka për lidhje dy radhë të drejta tullash. Vetëm në faqen perëndimore të dy pjesët e faqes së bazamentit janë të njëjta. Bazamenti i tamburit përfundon me një kornizë me një rresht dhëmbësh sharre, mbi të cilën vjen çatia me rrasa guri. Jo në të tëra anët korniza është horizontale. Si në anën lindore ashtu edhe atë jugore ajo vjen duke u ulur në mes. Deri në një farë mase kjo mund të shpjegohet me shmangien e vertikalitetit që ka tamburi i kupolës, me prerje maksimale pikërisht në drejtim të juglindjes.

Frontoni i krahut perëndimor të kryqit ruhet në pamjen e dikurshme deri në pragun e dritares, ku arrin çatia e narteksit dhe portikut (Tab. VIII, 3; Tab. IX). Pjesën qendrore të frontonit e zë dritarja dyshe. Ajo ka një kolonë në mes me kapitel guri mbi të, dy radhë tulla të shkallëzuara si tek dritaret e kupolës formojnë si shpatullat ashtu edhe mbulesën me hark. I vetmi ndryshim qëndron në krijimin e një fushe ndërmjet dy harqeve, sepse harku i poshtëm fillon menjëherë mbi kapitel. Gjithashtu, edhe forma e kapitelit ndryshon nga ajo e kapiteleve të tamburit. Këtu kapiteli ka faqet në dukje të kurbuara dhe si dekor nga një kryq në mes. Faqja e frontonit është e dekoruar me tulla të vendosura në radhë, si dhe tek tamburi e bazamenti i tij. Kemi radhë tullash trekëndëshe, tulla të plotë të vëna 45° ndaj horizontit me tulla trekëndëshe në qoshet, tulla të plota me diagonalet të vizuara. Këto katër radhë arrijnë përafërsisht deri në

DO NOT COPY

nivelin e kapitelit të dritares dyshe. Ndërmjet tyre ka një rresht tullash të drejta për lidhje me murin. Pak mbi to fillon korniza e frontonit, e përbërë prej dy radhësh tullash të vendosura në formë dhëmbësh sharre e tullash të drejta mbi të. Nga to, rreshti i dytë dhëmbë sharre ruhet në mënyrë të fragmentuar. Korniza mbaron me majë të mprehtë në mes, ndërsa bazat e saj për një largësi të vogël janë horizontale. Nën kornizë ka një radhë tullash veshëse të plotë, të vëna 45° ndaj kornizës me tulla trekëndëshe në qoshet. Fusha që mbetet në mes këtij rreshti, dritareve dyshe dhe rreshtave horizontale që përshkruam më lart, është mbushur edhe ajo me tulla të plota dhe trekëndëshe. Të vetmet pjesë boshe janë vrimat e skelave, nga të dy anët e dritares. Me të njëjtën mënyrë janë dekoruar edhe faqet jugore e veriore të këtij krahu të kryqit.

Krahu verior i kryqit ruhet i dëmtuar me të çara të mbushura pa kujdes me llaç dhe me pjesë të meremetuara keq (Tab. VII, 2; Tab, X). Dritarja në mes të frontonit është murosur në pjesën më të madhe dhe transformuar duke i hequr pjesë të radhës së brendshme të shkallëzuar, për të krijuar dy dritare të vogla. Gjithashtu, ruhet vetëm një rresht dhëmbë sharre nga të kornizës dhe është dëmtuar së tepërmi shpatulla lindore e frontonit, e cila është meremetuar keqaz. Edhe faqet anësore të krahut të kryqit janë të dëmtuara. Kështu, faqja ruan shumë pak gjurmë të dekorit të dikurshëm, ndërsa ajo nga perëndimi ruhet më mirë me dekor që është vazhdim i atij në frontin dhe me gjurmë të pjesshme të tullave, në formë dhëmbësh sharre.

Nën dritaren e frontonit kemi dy radhë me tulla, i sipërmi me tulla trekëndëshe, i poshtmi me tulla të plota që alternohen me tulla këlliç. Më poshtë këtyre kemi vetëm muraturë me teknikën kluasonazh me një ose dy tulla horizontale. Ndërmjet gurëve ka tulla të vendosura vertikalisht, të cilat kanë anash copa tullash të vendosura pjerrtas. Kjo pjesë e poshtme e murit, që ruhet e dëmtuar, nuk është e të njëjtit nivel ekzekutimi si dhe pjesët e sipërme edhe tamburi i kupolës.

Në këtë mur verior, në pjesën në perëndim të krahut të kryqit që në interier i takon ambientit të mbuluar me qemerë në qoshen veriperëndimore të naosit që sot funksionon si narteks, kemi një dritare të mbuluar me hark tullash të vendosura në mënyrë radiale (Tab. VIII, 4). Çatia e kësaj pjese përbëhet prej dy flegrash, njëra pranë krahut të kryqit me derdhje uji nga veriu, ndërsa tjetra me derdhje uji nga perëndimi. Të dyja këto flegra ndahen me kallkan nga njëra tjera që formohet ndërmjet tyre. Mbi dritaren kemi një zonë me tulla të plota të vendosura 45° ndaj horizontit, e cila shkon deri në kornizën e pjerrët.

Pjesët e tjera të poshtme janë të mbuluara nga ndërtimet e vona si qimiteri, portiku, portën në këtë anë dhe një kontrafortë të ulët në qoshen verilindore të meremetuar pa kujdes. Ato që dallohen janë me kluasonazhin që përshkruam më lart[8].

Akoma më e transformuar është ana lindore (Tab. IX). Ajo në pjesën e poshtme është e mbuluar nga dherat, që janë në nivel më të lartë se dyshemeja e kishës. Sidoqoftë, me lehtësi vrojtohen pjesët e reja nga të vjetrat. Kështu janë ribërë absidat si ajo qendrore e madhe (Tab. VIII, 3), ashtu edhe dy të tjerat anësore të vogla. Ato janë rindërtuar vetëm me gur muri. Nga ndërtimi i vjetër ruhet vetëm muri lindor, që i takon ambientit të altarit, ndaj të cilit dalin absidat, i ndërtuar me breza të dekoruar në pjesën e sipërme dhe kluasonazh si i mësipërmi në pjesën e poshtme. Ruhen gjithashtu edhe fillimet e absidave, çka tregon se të rejat ndjekin në planimetri të vjetrat.

Absida e madhe ka një dritare dyshe me kolonë guri në mes dhe mbuluar me harqe të dyfishta tullash. Mbi të është një pllakë guri, ku është gdhendur një kryq dhe data 1776, sigurisht viti i rindërtimit, si dhe emri Papa Zoto. Muratura e absidës mbaron me një kornizë prej tri radhë gurësh më të vegjël, të vendosur në formë dhëmbësh sharre.

Të reja janë gjithashtu edhe qoshet e kësaj faqeje muri, si dhe pjesë mbi absidë që i takon krahut lindor të kryqit, duke u paraqitur kjo faqe thuajse e re.

Po kështu paraqitet ana jugore në të cilën kemi paraklisin e ri dhe kambanoren. Krahu jugor i kryqit është i ri, i ndërtuar kryesisht me gurë fuke, duke pasur me tulla vetëm dy radhë, një me tulla këlliç në nivelin e dritares dhe një tjetër me tulla me faqe të plotë (Tab. VII, 4; Tab. X). Teknika e ndërtimit me gurë të rregullt e fuga llaçi të holla na duket vetëm deri në një farë mase e njëjtë me atë të absidës. Muratura e paraklisit është më e rregullt, çka na shtyn të mendojmë për kohën më të vonë të këtij rindërtimi. Muret e tij në pjesën e poshtme përfundojnë me skarpat për të kontraforcuar qemerët e paraklisit, i cili ka

[8] Vërejmë se ky kluasonazh është i vendosur pa rregullshmërinë rigoroze, me të cilën e jep Versaqis.

DO NOT COPY

të ngjarë të jetë ndërtuar për të mbajtur muret e kishës që duket se do të jenë pjerrur e çarë. Hyrja e paraklisit, që sot është e murosur ka patur formën e një portiku të mbuluar me qemer, harku në dukje i të cilit është me gurë e tulla të alternuara dhe rrethuar nga një rresht dhëmbësh sharre (Tab. VII, 6). Dritare të vogla si frëngji janë në murin jugor për të ndriçuar sadopak interierin.

Që ky paraklis është ndërtuar më vonë se narteksi në anën perëndimore bindemi po të shohim pjesën e sipërme të mureve të tyre që janë në kontakt, gjë që mund të shihet në ambientin nën çatinë e narteksit. Duke parë formën e murit të paraklisit në zonën e kontaktit me narteksin, rezultoi se narteksi është ndërtuar më përpara dhe se paraklisi i është mbështetur atij.

Mbi qemerin e paraklisit mbështetet kambanorja që është ndërtuar në një kohë më të vonë se paraklisi dhe me muraturë mjaft të rregull (Tab. VII, 5). Kambanorja e ngushtë dhe e fortë ka dy kate me strukturë të njëjtë prej harqesh, i pari më i gjerë dhe harqe më të vogla. Në këtë kat del dhe dritarja e ambientit perëndimor të naosit, e cila është zgjeruar. Kati i dytë i ka harqet të punuar më mirë dhe të rrethuar me një rresht pllakash. Kambanorja mbulohet me një çati piramide që fillon pas një kornize prej gurësh të nxjerrë ndaj faqeve të kambanores.

Në muret e narteksit dhe të paraklisit është lidhur më vonë portiku me kolona dhe harqe që pamë më sipër, i cili mbulohet me çati druri, vazhdim i çatisë të pjesëve të tjera të kishës.

Vështrimi i shtresave në anën e jashtme na ndihmon për orientimin e kërkimeve në interier, ku para së gjithash duhet të sqarojmë formën e dikurshme të katër pilastrave nën kupolë e pastaj shtesat e tjera. E vetmja mundësi që patëm ishte dallimi i shtesave nga strukturat, që ne menduam se ishin të vjetra, ose nëpërmjet fugave të suvasë, kur ishin të suvatuara, ose nëpërmjet teknikës së ndërtimit (ana e prapme e shtesave përpara protezisit dhe diakonikonit). Kështu, forma e pilastrave prapa ikonostasit rezulton të jetë në formë L – je dhe se shtesat që ndajnë protezisin dhe diakonikonin nga naosi që mbarojnë sipër me hark, janë vendosur për të forcuar qemerin e ambienteve të mësipërme në pjesën që mbajnë shpatullat e krahëve të kryqit. Për të njëjtin funksion konstruktiv janë bërë edhe shtesat në anën tjetër të këtyre krahëve të kryqit, duke rezultuar pilastri i vjetër në formë T – je me krahë më të gjatë se atë nga ambienti qendror[9].

Shtesat e pilastrave nga ana e ambientit qendror dallohen si nga fugat pak a shumë të qarta, ashtu edhe nga mospërputhja e tyre me faqet e pilastrit dhe fillimet e harqeve mbajtëse. Tabloja e krijuar në këtë mënyrë ka nevojë për t'u sqaruar nëpërmjet sondazheve sepse mbetet për t'u përcaktuar mënyra me të cilën harqet mbajtëse mbështeten në pilastrat. Pra, kemi ndonjë pjesë në formë gjysmë kolone apo pilastri ndërmjet krahëve të pilastrit bazë, apo kemi gurë të nxjerrë konsol për mbështetjen e harqeve.

Shtesë për arsye konstruktive janë dhe pilastrat në arkadën perëndimore nën kupolë bashkë me sistemin e harqeve të cilat i përshkruam më lart.

Për shkak të shmangies së vogël nga katrori të ambientit qendror nën kupolë, harqet mbajtëse formojnë një drejtkëndësh me brinjën veri - jug pak më të madhe. Për këtë arsye, tamburi në këto dy anë mbështetet mbi konsola të harkuara të nxjerra ndaj harqeve mbajtëse.

Mbas këtij trajtimi është e lehtë të rikonstruktojmë planimetrinë e kishës si dhe fazat e ndryshme të ndërtimeve, të cilave u është nënshtruar ajo. Del menjëherë në dukje qartësia e organizimit planimetrik me ambientin qendror me kupolë si bërthama qendrore e kishës dhe vazhdimësia e ambienteve mbrapa arkadave në protezis e diakonikon. Me interes është edhe lidhja e pjesës perëndimore të naosit, i cili rezulton si i veçuar prej tij. Kjo gjë nënvizohet edhe nga mbulesat me qemerë, ndër të cilat dy anësoret në nivel më të ulët dhe i japin një aks gjatësor këtij ambienti, i cili rezulton të jetë si një ekzonarteks. Kjo është edhe arsyeja që mbas shtesave (pilastra dhe harqe), ky ambient u kthye në një narteks me tribuna.

Gjatë viteve '70 të shekullit të XVIII, për shkak të dëmtimeve në strukturat mbajtëse të kishës janë rindërtuar absidat, janë bërë shtesat në interier dhe narteksi në anën perëndimore. Sot është e vështirë të përcaktohen dëmtimet që ka pësuar kisha dhe shkaqet e tyre, gjurmë të të cilave ruhen edhe sot. Të tilla janë prerja në drejtim jug – lindje e tamburit, deformimet në bazamentin e tij, të çarat në anën veriore. Mund të na ndihmojnë për këtë edhe pjesët e reja dhe shtesat, siç janë absidat e krahut jugor të kryqit, qoshet

[9] F. Versaqis, Po aty nuk dallon pjesët shtesë të pilastrave nga pjesët e vjetra.

DO NOT COPY

verilindore e juglindore të kishës, përforcimet në interier dhe shtesat pranë mureve.

Dëmtimet në absida dhe pjerrja e tamburit na shtyjnë të mendojmë për një cedim vertikal të pilastrit juglindor ose pjerrje të tij dhe ulje të harqeve nën ngarkesat e tamburit të kupolës. Gjithashtu, plasjet në anën veriore, ribërja e krahut jugor të kryqit tregojnë se ka pasur dhe dëmtime të strukturave në harqe e qemerë, për shkak të kalbjes së brezave dhe tiranteve dhe uljes së kohezionit të muraturës, si pasojë e veprimit të agjentëve të ndryshëm dhe kohës. Nuk duket se ka munguar në këtë drejtim edhe ndonjë lëkundje tërmeti.

Në analizën që i bëmë më lart elementëve të ndryshme arkitekturore dhe shtesave që ka pësuar monumenti në kohë, nxorëm dhe të dhëna për radhën e këtyre shtesave, që përbëjnë dhe fazat e rindërtimit të kishës. Kështu, rindërtimi i parë është ai i vitit 1776, kohë në të cilën janë ribërë absidat e krahut jugor të kryqit dhe është shtuar narteksi. Më vonë, është shtuar paraklisi në anën jugore, i cili i është mbështetur narteksit. Në një kohë më të vonë janë ndërtuar qimiteri dhe portiku perëndimor, lidhja në kohë e të cilëve nuk mund të përcaktohet, por që sigurisht duhet t'i takojnë shek. XIX.

Kështu, mundëm të përcaktojmë format fillestare të kishës dhe rindërtimet që për arsye të ndryshme i janë bërë asaj. Kjo bën të mundshme edhe gjykimin për vlerat e monumentit, madje dhe datimin e tij. Siç edhe pamë, kemi të bëjmë me një kishë të tipit kryq i brendashkruar vetëm në aspektin e jashtëm të tij, ndërsa në interier, për shkak të vendosjes së arkadave në anët perëndimore, veriore dhe jugore, ambienti qendror izolohet nga krahët e kryqit, duke krijuar një organizim planimetriko – volumor pak a shumë origjinal. Kështu, shtrohet pyetja nëse kemi të bëjmë me një bazilikë trenefshe me kupolë, duke i rezervuar pjesës perëndimore të naosit rolin e narteksit. Mendojmë se një gjë e tillë nuk do të ishte e drejtë. Për vetëm madhësinë e tyre dhe gjerësinë e pakët ndaj ambientit qendror ato nuk mund të lozin rolin e një nefi anësor. Gjithashtu, duhet të pranojmë se nga tipi i monumenti në studim shmanget edhe në formën e ambienteve këndore të anës perëndimore, të cilat lidhen më tepër me krahun perëndimor të kryqit se sa me krahët e tjerë, me të cilët ndahet nga një hapësirë e ngushtë dhe e ulët.

Ne do të shpjegonim këtë formë të veçantë me dy mundësi: së pari, me ndikime të drejtpërdrejta të tipeve të vjetra të shek. VIII – IX të Selanikut (Shën Sofia) dhe Kostandinopojës (Gjyl Xhami), tek të cilët kemi krijimin e hapësirës qendrore me kupolë mbi katër pilastra, që nërpëmjet arkadave mbi kolona lidhet me galeritë që e rrethojnë nga të tri anët. Dallimi në planimetri qendron në atë që protezisi dhe diakonikoni janë në një aks me ambientet në veri dhe jug të hapësirës qendrore. Dallimi në voltmetri qëndron në atë që këtu ambientet anësore si krahë të kryqit ngrihen deri në nivelin e fillimit të tamburit. Së dyti, si ndikime të përpjekjeve të njëjta që gjatë fundit të shek. XIII bëhen në Kostandinopojë (Shën Andrea në Krisë, Shën Joan Pagëzori, Fetie Xhami) për të krijuar kisha me hapësirë qendrore me kupolë, më të çlirëta në planimetri, por gjithnjë me galeri që e rrethojnë nga të tri anët[10]. Dallimi në ndërtimin volumetrik të ambienteve anash hapësirave nën kupolë, që shfaqet edhe në anën e jashtme, është me sa duket pasojë e zgjidhjes brenda formës tradicionale të kishës të tipit kryq i brendashkruar me kupolë mbi tambur. Duhet të shënojmë se kjo zgjidhje është më se e arritur. Nëse do shqyrtojmë vlerat arkitekturale të këtij monumenti, do të bindemi se kemi të bëjmë me një ndërtesë të arritur me tërë karakteristikat e arkitekturës bizantine. Madhështia e tij vërehet që në kontaktin e parë me të, që nga rrugët që gjarpërojnë kodrave për t'ju afruar fshatit, ku mbi gjithçka vërehet në mes selvive kupola e tij madhështore. Kjo përshtypje mbetet dhe kur e sodisim atë nga brenda oborrit të kishës, e cila vizualisht fragmentohet në pak elementë: portiku elegant si dantellë mbi sfondin e errët të hijes, patia gri në të kaltër prej rrasash guri me një fakturë mjaft interesante në sfondin e së cilës, panoramës së fshatit dhe qiellit të kaltër, vlerësohen së tepërmi krahu perëndimor i kryqit dhe kupola mbi tambur, e cila me përmasat e saj zotëron tërë ndërtesën. Impresioni është i tillë që as shtesat as dëmtimet dhe as të çarat e mureve, të cilët janë meremetuar keq, nuk mund ta zvogëlojnë ndjenjën e madhështisë, e cila tej gjurmëve të kohës ndihet më tepër. Kjo përshtypje bëhet akoma më e madhe mbas studimit, kur format e dikurshme dhe madhësia e vërtetë e monumentit ndihen prapa mureve të reja e në vend të pjesëve të zëvendësuara. Gjithçka pas një loje të çative të krahëve të kryqit, si në një piramidë kulminon me tamburin me kupolë, i cili me përmasat, proporcionet e dritareve dhe nikeve, dekorin keramoplastik sundon të tërën (fig. 7). Brezi i sipërm në dekor dhe korniza e rrafshët i japin pamje të rëndë tamburit, të cilin,

[10] Me këto dy grupe të tipit me galeri rrethuese e lidh edhe Sotiriu. Shih: G. Sotiriu, *Kristianiqi qe Vizantini arkeologjia*, Athina 1942, f. 381.

POWERED BY

deri në një farë mase e pakësojnë ngjyra e tullave; forma në të cilat janë vendosur dhe dritaret me nike, që alternohen të nënvizuara nga shiritat me dhëmbë sharre.

Në pjesët sot në dukje mund të vërehet vlera e madhe dekorative e tullave në vizatime nga më të ndryshmet që kontribuonte në piktoresken. Po kështu, edhe pjesët e poshtme të kishës me kluasonazhin e tyre karakteristik, ku prania e tullë është jo e vogël, nuk mbeten pas, si nga ana koloristike ashtu edhe nga endja e muraturës. Pa këtë lloj kluasonazhi dekori kompleks prej tullash i pjesës së sipërme do ta shkëputste këtë prej "bazamentit", gjë që nxjerr në dukje aftësinë e ndërtuesve.

Gjithë ky impresion sikur venitet, kur futemi brenda në narteksin e errët e të ngushtë të shtuar gjatë shek XVIII. Pasi futemi në kishë, nën dyshemenë e tribunave e prapa arkadës perëndimore, sot të transformuar, ky impresionon mbetet, por mjafton të kalojmë këtë arkadë, do të shtangemi duke kaluar shikimin nga ikonostasi lart mbi kokën tonë, ku në një lartësi rreth 17 m përfundon kupola. Ndjenja e të madhërishmes mbizotëron dhe pse brendia sot është e gjymtuar, i mungojnë afresket e dikurshme, janë shtuar dekore në stuko dhe është lyer me ngjyrë të ftohtë. Gjithçka flet për vlerat e padyshimta të monumentit. Dikur këto do të kenë qenë akoma më të dukshme, kur prapa arkadave jo gjithçka ishte e errët sa sot dhe muret ishin të rregullta. Hapësira e brendshme është tipike për arkikturën bizantine. Dy elementë kontribuojnë më tepër se në kishat e tipit kryq i brendashkruar. Madhësia, e cila shton vertikalitetin dhe shkallën e monumentit; arkadat të cilat shtojnë ndjenjën e pafundësisë së hapësirë së brendshme, e cila bëhet në këtë rast edhe me dinamikë. Kështu, për vizitorin nga qendra shikimi humbet në të tërë drejtimin prapa arkadave, të cilat zvogëlojnë praninë e pakët të dritareve (një për çdo krah). Janë pikërisht arkadat ato të zvogëlojnë, jo në kurriz të monumentalitetit, staticitetin e hapësirës qendrore në kupolë – aksin vertikal.

Duke gjykuar tërësisht vlerat arkitekturale të monumentit, si atë të brendësisë ashtu dhe ato të poshtmet, duke mos përjashtuar këtu dekorin keramoplastik, i cili është një element mjaft i rëndësishëm në formulimin e arkitekturës së jashtme, mendojmë se monumenti është një realizim i arritur dhe ruan vlera të dorës së parë.

Datimi i monumentit është i kushtëzuar nga mungesa e të dhënave epigrafike dhe burimore. Në këtë rast, arkitektura mbetet si e vetmja mbështetje. Nëse do të niseshim nga ndërtimi planimetrik, gjejmë paralele siç përmendëm dhe më



*Fig. 7*

DO NOT COPY

lart, me kishat e Kostandinopojës, të cilat ndërtohen në fund të shek. XIII. Në drejtim të dekorit me tulla të plota (damier) gjejmë paralele me kishat e Kosturit (shek. XI), Shën Sofia e Ohrit (shek. XI), kishat e Artës (shek. XIII), Sotiriu mendon se kisha duhet të jetë ndërtim i shek. XII – XIII[11]. Duke u nisur nga forma planimetrike dhe vëllimore (zgjidhja brenda tipit kryq i brendashkruar), dekori keramoplastik, format e zhvilluara dhe kupola e lartë, mendojmë se kisha duhet të jetë ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. XIII. Në të mirë të kësaj teze janë dhe dy faktorë. Së pari, se gjatë kësaj kohe ndërtohet në Despotatin e Epirit, në lidhje të njohura arkitekturale me kryeqytetin, disa kisha të rëndësishme dhe me zgjidhje të veçantë (Artë, Mesopotam) dhe së dyti në gjysmën e dytë të shek. XI në Peshkopinë e sipërme, pak më në jug të Labovës së Kryqit, kisha e Shën Mërisë akoma nuk ka formën e mirëfilltë kryq i brendashkruar. Shtojmë se me interes për studimet e ardhshme do të ishte edhe hetimi i shkaqeve të ndërtimit të kësaj kishe në vend.

* * *

Siç doli dhe nga studimi i këtyre dy monumenteve, rindërtimet dhe shtesat që u janë bërë nuk kanë marrë asnjëherë parasysh vlerat e tyre, por janë bërë ose për të mënjanuar dëmtimet ose për shtim ambientesh. Për një vlerësim më të mirë të tyre shkencor dhe estetik është e domosdoshme të ndërmerren punimet restauruese, që duhet të pranojmë se janë jo të lehta. Për këtë, në radhë të parë duhet të kryhen një sërë sondazhesh, të cilat krahas pranisë apo jo të pikturës murale, do të sqarojnë përfundimisht shkaqet e dëmtimeve dhe do të na lejojnë të gjykojmë më mirë për madhësitë e përforcimit të monumentit dhe heqjeve të shtesave konstruktive në brendësi dhe në anën e jashtme. Megjithëkëtë mendojmë se është vendi të shprehim mendimin tonë lidhur me ndërhyrjet restauruese në këto dy monumente.

Për sa mund të gjykohet sot, kisha e Shën Mërisë së Peshkopisë paraqet një sërë avantazhesh për ndërhyrjet restauruese, nga që për mendimin tonë ambienti shtesë dhe portiku në hyrje duhet ruajtur për vlerat e tyre historike e estetike, ndërsa duhen hequr shtesat në çati dhe rikonstruktuar ajo në format e para. Për të çliruar dhe brendësinë nga përforcimet, do të duhet të përcaktohen më saktë shkaqet e dëmtimeve dhe mundësia reale e përforcimit të strukturave të vjetra si dhe rivendosja e tirandave të reja të domosdoshme për përballimin e shtytjeve.

Gjithashtu, nëpërmjet ndërtimit të një muri mbajtës të terrenit në anën veriore besojmë se do të jetë e mundur të hiqet kontraforta në anën veriore.

E njëjta gjë nuk mund të thuhet për kishën e Labovës së Kryqit, e cila ka një numër më të madh shtesash në anën e jashtme, nga të cilat, për mendimin tonë, me vlerë është vetëm portiku në anën perëndimore. Por, me përjashtim të qimiterit në anën veriore, të gjitha këto shtesa kanë karakter të qartë konstruktiv, kështu që gjykimi në heqjen e tyre mund të bëhet vetëm pas sondazheve të shumta për të studiuar gjendjen e strukturave (harqe, qemerë, mure), të cilat për numrin e madh të përforcimeve në brendësi dhe në anën e jashtme duhet të jenë të dëmtuara në mënyrë të ndjeshme. Një ndërhyrje restauruese duhej pikërisht të riaftësonte në pikëpamje konstruktive këto elementë, duke rikrijuar kohezionin e tyre dhe nëpërmjet vendosjes së tirandave, skemën konstruktive të dikurshme. Duke qenë se shtytjet vijnë nga kupola në pilastrat dhe prej tyre në muret anësore kryesisht në pjesët në drejtim të pilastrave, nëse masat e mësipërme do të jenë të pamjaftueshme, heqja e përforcimeve në brendësi duhet të zëvendësohet me përforcime të reja prej beton armeje që rrjedhimisht do të zënë më pak vend. Këto përforcime besojmë se janë më pak të ndjeshme se sa kontrafortat në anët e jashme.

Për sa i përket pjesëve të rindërtuara si absidat dhe krahu jugor i kryqit, mendojmë se në fazën e parë të punimeve mund të mbeten, dhe rikthimi i tyre në formën e vjetër të vendoset më vonë.

* * *

Të dy monumentet që trajtuam deri tashti tregojnë qartë që dhe në këtë zonë kishat bizantine të tipit kryq i brendashkruar me kupolë ndoqën rrugën tradicionale të kalimit nga format jo të qarta të kryqit dhe thuajse bazilikale, në ato të zhvilluara mbi bazën e formës së mirëfilltë planimetrike të tipit. Madje në rastin e Labovës së Kryqit kemi të bëjmë me një monument më të zhvilluar se tipit dhe që tenton të përdorë galeritë rrethuese, por gjithnjë brenda formës tradicionale të tipit. Për këto arsye studimi i tyre i përbashkët paraqet interes të veçantë, aq më tepër kur nuk kemi të bëjmë me monumente të zakonshme.

[11] Sotiriu G., *Po aty.*

*Shënim: *Monumentet,* nr. 9, 1975, fq. 77 - 106

DO NOT COPY


1


2


3


4


5

DO NOT COPY



Prerje gjatësore

0 3 m



Prerje tërthore

0 3 m

DO NOT COPY



Pamje nga jugu

0 3 m



Pamje nga veriu

0 3 m

DO NOT COPY



Pamje nga lindja

0 3 m



Pamje nga perëndimi

0 3 m

DO NOT COPY


1


4


2


5


3


6

DO NOT COPY




Prerje gjatësore




Prerje tërthore

DO NOT COPY


1


2


3


4


5


6

DO NOT COPY


1


2


3


4

DO NOT COPY




Pamje nga lindja



Pamje nga perëndimi

DO NOT COPY




Pāmjė nga veriu




Pamje nga jugu

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

# DEUX EGLISES BYZANTINES DU DISTRICT DE GJIROKASTRA

Cet article traite de deux églises, de forme de croix inscrite à coupole sans appui, situées dans le district de Gjirokastra. Il s'agit précisément de l'église de Sainte-Marie de Peshkopi e Sipërme et de l'église Sainte-Marie de Labovë e Kryqit.

L'église de Sainte-Marie de Peshkopi e Sipërme se trouve à 15 minutes de marche au sud du village de même nom. C'est la seule construction qui domine une des collines s'étendant de la plaine vers le mont Bureto. Elle était naguère le siège de l'évêché de Drinopoje. Elle a donné son nom au village, tandis que le nom de l'évêché dérive de celui de la ville ancienne et moyenâgeuse d'Andrinople, qui s'étendait autrefois entre le couvent des bektachis de Melan et le village de Sofratike.

Dans son aspect actuel, elle comporte des fenêtres presque complètement murées et des adjonctions récentes aussi bien à l'intérieur qu'à l'extérieur. Dans sa partie méridionale a été ajoutée une pièce, qui, plus tard, a également subi des transformations. Cette église appartient au type croix inscrite à coupole reposant sur un tambour ayant quatre appuis intérieurs. Les appuis sont représentés par des pilastres de forme irrégulière en raison des adjonctions et supportent à travers un systeme d'arcs de soutien le tambour et la coupole. La forme de la croix créée à l'intérieur par les cintres rejoint le toit, en laissant voir clairement les bras septentrional et méridional, tandis que les deux autres se trouvent sous le même toit avec les deux autres pièces. Au point de rencontre des bras de la croix se dresse un tambour cylindrique à coupole sur un soubassement quadratique. La toiture de l'église est constituée entièrement de plaques de pierres. La pièce ajoutée dans la partie sud est à angle droit sur le plan long et étroit, avec sa partie centrale plus haute, tandis que les autres parties sont disposées sous le même toit que l'église.

Cette église comporte le naos et l'autel. La seule entrée au naos est aménagée sur le côté occidental, ou se trouve aussi un petit portique. A l'intérieur de l'église ont été effectuées maintes adjonctions surtout en ce qui concerne les pilastres: les arcs de soutien nord et ouest de la coupole ont été renforcés par de nouveaux arcs. De telles adjonctions concernent aussi la pièce de l'angle occidentale. Un nouveau mur de soutènement a été également aménagé sur le côté ouest de cette même pièce.

Il convient de souligner que les pilastres, selon la planimétrie correspondant aux différentes phases de construction, ne représentent en effet au point de vue du volume ou structural que des cloisons avec des passages couverts d'arcs. Ainsi les quatre pièces angulaires sont relativement séparées, aussi bien sous l'aspect fonctionnel que sous l'aspect de l'espace, du volume central disposé au dessous de la coupole et des bras de la croix. Ceux-ci sont couverts comme d'habitude par des cintres cylindriques, dont le point de rencontre à travers des triangles sphériques est surmonté par le tambour à coupole. Les quatre pièces angulaires également sont couvertes par des cintres cylindriques, disposés à un niveau moins élevé que les cintres des bras de la croix. Ces cintres rejoignent deux à deux les bras septentrional et méridional de la croix.

La nef est séparée du naos par un mur peint de fresques en l'an 1511 du côté du naos, qui a évidemment joué le rôle

d'une iconostase. Ce mur de construction plus récente à du être vraisemblablement, ajouté pour renforcer l'arc de soutien de la coupole du fait qu'il le rejoint. Par devant ce mur, se trouve la nouvelle iconostase en bois. La porte, mettant en communication la nef avec le naos, est soutenue par deux colonnes appartenant peut être a l'ancienne iconostase.

En plein centre de la nef se trouve la table de l'autel représentée par une plaque de pierre taillée s'appuyant sur un bloc de mur. De telles plaques se trouvent également en d'autres parties de cette église. Sur le plancher il y a un fragment de plaque à deux orifices servant probablement d'appui aux colonnes de quelque table ou baldaquin.

En ce qui concerne les murs extérieurs, les murs septentrional et méridional sont masqués le premier par le mur de soutien qui le surmonte et le deuxième par la pièce ajoutée plus tard. Les seules parties apparentes sont les frontons des bras de la croix. Construits seulement en pierres, ils sont munis d'une fenêtre à deux vantaux et couverts par des arcs reposant sur une petite colonne à chapiteau de pierre. Les frontons se terminent par une corniche comportant une rangée de briques disposées à dents de scie. Le mur occidental conserve maintes traces de nombreuses constructions qu'il est très difficile de déchiffrer. Ainsi, en portant des joints l'on comprend que le portique et son mur portant, aménagé dans la partie intérieure du bras de la croix, représente une reconstruction. Dans la partie supérieure du côté sud on distingue le joint du bras de la croix actuellement couvert par un toit comme les autres pièces. De même, le côté est présente clairement les anciennes formes et l'on relève les adjonctions effectuées au-dessus des pièces angulaires. II s'agit là de la partie la plus décorée de l'église. On relève sur le côté sud les traces d'une pièce ajoutée, qui a probablement servi de narthex. Ses portes sont murées, son mur ouest et sa couverture autrefois sous forme de croix à bras de dimensions inégales ont été transformés. Actuellement ce toit est unifié au toit même de l'église. Les murs de la pièce ajoutée sont en cloisonnage avec deux-trois briques disposées verticalement, tandis que sa face orientale est agrémentée de décorations ressemblant à celles de l'église de Saint-Théodore à Narte. Ces données facilitent également la datation de cette pièce et montrent que nous sommes en présence d'un ouvrage ancien. La façade orientale seulement est décorée de briques, celles-ci étant employées rarement dans les autres façades. On relève également l'absence du cloisonnage, qui vers la fin du Xle siècle et plus tard était devenue une technique de construction habituelle dans les provinces. Le tambour est peu élevé et les corniches sont droites. La planimétrie et les constructions intérieures se caractérisent par l'usage des pilastres, qui représentent presque des murs séparant outre mesure la nef du prothésis et du diaconicon, d'une part, et le bras occidental des pièces angulaires de l'autre. C'est pourquoi à l'intérieur de cette église sont encore conservés des éléments du plan basilical, et cela grâce au fait que les pièces angulaires évitent la partie centrale à coupole.

Le voyageur anglais Holland, qui a visité ce monument en l'an 1812, a déchiffré sur ces murs une inscription selon laquelle il apparait que l'église en question a été construite par l'empereur byzantin Emmanuel Comnène (1143-1180). Cette inscription n'existe plus de nos jours, il se peut qu'elle ait été recouverte par la peinture des murs. Dans ces conditions, il est indispensable de bien vérifier les divers éléments de ce monument offrant des arguments en faveur ou contre cette datation traditionnelle. En partant de la planimétrie qui ne présente pas entièrement les traits d'une église de type croix inscrite à coupole, comme le montre la forme des pilastres qui sont plutôt un prolongement de murs que de vrais pilastres sans appui, des proportions plus petites en hauteur par rapport aux dimensions sur le plan, surtout en ce qui concerne le tambour, ainsi que de l'absence du cloisonnage, il semble que ce monument a été construit pendant la période allant de la fin du XIe siècle jusqu'à la moitié du XIIe, ce qui rend plus vraisemblable les données fournies par Holland. En vue d'une datation plus exacte il importe, a notre sens, d'étudier plus à fond la période d'introduction de ce type d'église dans la dite zone et le commencement de l'utilisation du cloisonnage. En ce qui concerne la pièce ajoutée, elle appartient à la période antérieure à l'occupation turque; partant de la technique de construction à cloisonnage avec plusieurs briques verticales et du décor du mur oriental, ils nous semble qu'elle a été construite pendant les XIIIe -XIVe siècles.

* * *

L'église de Sainte-Marie de Labove e Kryqit se situe en plein centre du village de même nom et y occupe une position dominante, surtout quand on l'observe de loin. Elle

DO NOT COPY

est entourée par une cour et présente un volume de coloration rouge sur l'arrière-plan d'un cyprès séculaire.

De dehors, ce monument a la forme d'une église du type croix inscrite de la variante provinciale, tandis qu'à l'intérieur elle s'éloigne de ce type du fait que l'espace central à coupole reposant sur quatre pilastres et séparée des bras de la croix par trois arcades à deux étages comportant deux colonnes. C'est pourquoi l'étude de ce monument présente un intérêt particulier en ce qui concerne l'évolution de ce type et ses rapports avec les autres monuments proches de Constantinople et des provinces.

Actuellement cette église présente des modifications à la suite des réparations et des adjonctions effectuées, surtout sur ses côtés sud et ouest, sans tenir compte des valeurs qu'elle renfermait et en dégradant lamentablement son aspect antérieur.

Sur le côté ouest, où est aménagée la seule entrée de l'église, se dresse un portique avec une arcade à 8 arcs reposant sur deux pilastres latéraux et 7 colonnes disposées au-dessus d'un mur peu élevé, qui est entrecoupé seulement pour laisser libre l'accès à l'église. C'est par une porte basse couverte d'un arc que l'on entre dans le narthex de construction plus récente, qui est surmonté de cintres.

C'est à travers le narthex à trois degrés d'escalier que l'on entre dans l'église, qui comporte l'espace central au-dessous de la coupole, la pièce de l'autel, les deux pièces derrière les arcades au nord et au sud de l'espace central et la pièce antérieure, qui plus tard a été reconstruite à deux étages, remplissant ainsi jusqu'à un certain point la fonction du narthex par rapport à l'espace se trouvant sous la coupole. L'espace central disposé sous la coupole est muni à ses angles par quatre pilastres de formes différentes, au-dessus desquels reposent les arcs de soutien de la coupole. Les arcades mentionnées plus haut rejoignent en hauteur l'arc de soutien de la coupole et le cintre du bras de la croix.

La planimétrie reproduit les sections et les façades dans leur forme antérieure, ainsi que les reconstructions enregistrées par cette église dans le temps. Cette répartition en différentes phases se fonde sur les résultats des sondages et des observations effectuées dans les murs soit à l'extérieur qu'à l'intérieur. II a été ainsi possible de reproduire clairement l'aspect antérieur de cet église à croix inscrite de dehors, tandis que son intérieur présente un espace central séparé par des arcades ce qui signifie un éloignement du type. Il convient d'ajouter que la plus grande partie des reconstructions effectuées sont d'ordre technique et qu'une petite part d'entre elles seulement concerne des pièces auxiliaires, comme le paraclysis sur le côté sud et le cimetière sur le côté nord de l'église.

Pendant les années 70 du XVIIIe siècle, les structures de soutien de cette église ayant été endommagées, on a reconstruit les absides et effectué des adjonctions dans son intérieur et mis en place le narthex sur le côté occidental. II est difficile actuellement de déterminer les endommagements enregistrés par cette église et les causes qui les ont provoqués, malgré les traces conservées encore de nos jours. Mentionnons entre autre l'inclinaison du tambour en direction sud-est, les déformations de son soubassement, les fissures sur le côté septentrional. Une importante contribution peuvent nous offrir dans cette direction les parties de construction plus récente et les adjonctions, comme les absides du bras méridional de la croix, les angles nord-est et sud-est de l'église, les renforcements effectués dans sa partie intérieure et les adjonctions faites aux murs.

L'analyse des différents éléments architecturaux et des adjonctions enregistrées par ce monument dans le temps, nous a permis d'établir l'ordre chronologique d'exécution de ces adjonctions, soit les différentes phases de reconstruction. La première reconstruction se rapporte à l'an 1776, période au cours de laquelle ont été mises en place les absides du bras méridional de la croix et a été ajouté le narthex. Plus tard a été construit le paraclysis sur le côté méridional en s'appuyant au narthex. Plus tard encore on a construit le cimetière et le portique occidental. II s'agit en somme de constructions se rattachant, selon toute probabilité, au XIXe siècle.

C'est ainsi qu'il nous a été possible de déterminer les formes initiales de cette église et les reconstructions effectuées pour des motifs différents. C'est à partir de ces données que nous pouvons également juger de la valeur de ce monument, voir même procéder à sa datation. Comme nous venons de le dire, il s'agit là d'une église du type croix inscrite seulement quant à son aspect extérieur, tandis que l'intérieur de ce monument, en raison des arcades disposées dans les parties occidentales, septentrionales et méridionales, comporte une pièce centrale séparée des bras

DO NOT COPY

de la croix, créant de la sorte une organisation planimetrico-volumétrique plus ou moins originale. Aussi reste-t-il à savoir si nous avons affaire à une bàsilique à trois nefs avec chapelle, en reservant à la partie occidentale du naos la fonction du narthex. A notre sens, un tel jugement n'est pas juste. En raison même de leur dimension, et de leur largeur petite par rapport à la pièce centrale, ils n'ont pas pu évidemment exercer les fonctions d'une nef latérale. Il convient de relever également que ce monument diffère de son type par la forme même des «pièces angulaires» du côté occidental, se reliant plutôt au bras occidental de la croix qu'aux autres bras dont ils sont sépares par un espace étroit et peu élevé.

Cette forme particulière s'explique, à notre avis, de deux manières: premièrement, par suite de l'influence directe des anciens types des VIIIe - IXe siècle de Salonique (St. Sophie) et de Constantinople (Gül Cami), ou la pièce centrale à coupole reposant sur quatre pilastres se relie, a travers des arcades s'appuyant sur des colonnes, aux galeries qui contournent ses églises de trois côtés. La différence sur le plan de la planimétrie consiste dans le fait que le prothesis et le diaconicon sont disposés sur le même axe tout comme les pièces situées au nord et au sud de la piece centrale. La différence sur le plan du volume consiste dans le fait que les piecès latérales, en tant que bras de la croix, s'élèvent jusqu'au niveau initial du tambour. Deuxièmement, par suite de l'influence des efforts analogues entrepris a Constantinople vers la fin du XVIIIe siècle (St. André à Krise, Saint-Jean Baptiste, Fetiye Cami) en vue de créer dans l'église une pièce centrale à coupole, ayant une planimétrie plus limpide mais toujours munie d'une galerie la contournant des trois côtés. La différence quant au changement du volume des pièces latérales disposées au-dessous de la coupole, qui se manifeste à l'extérieur aussi, représente, à ce qu'il semble, une solution dans le cadre même du type traditionnel d'église à croix inscrite à coupole surmontant le tambour. Il convient de souligner qu'il s'agit là d'une solution vraiment réussie.

Quant aux valeurs architecturales de ce monument, il suffit d'affirmer que nous sommes en présence d'une construction reproduisant à la perfection toutes les caractéristiques de l'architecture byzantine. Dans leur ensemble ces valeurs, à l'intérieur comme a l'extérieur, y compris le décor ceramoplastique, en tant qu'élément très important de l'architecture extérieure, représentent une réalisation réussie sur tous les plans. Aussi l'église de Saint Marie de Labove e Kryqit renferme-t-elle des elements d'une très grande valeur.

La datation de ce monument est conditionnée par l'absence de données épigraphiques et d'autres sources écrites. En conséquence nous ne disposons que les éléments architecturaux pour ce faire. Sur le plan de la planimétrie, on trouve des parallèles, comme indiqué plus haut dans les églises de Constantinople édifiées vers la fin du XIIIe siècle. Quant à la décoration en briques à damier, les parallèles nous sont offerts par les églises de Kostur (XIe siècle], de Sainte Marie de Ohri (XIe siècle) et celles d'Arte (XIIIe siècle). Selon Sotiriu, notre monument date le XIIe - XIIIe siècle. Si l'on se fonde sur la forme planimétrique, sur la solution dans le cadre même du type d'église à croix inscrite et sur la décoration ceramoplastique, ainsi que sur les formes plus évoluées et la coupole plus élevée, il nous semble que ce monument a du être construit dans la deuxième moitié du XIIIe siècle. Et cela pour les raisons suivantes: premièrement, parce qu'au cours de cette période dans le Despotat d'Epire, qui se trouvait en rapports architecturaux avec la métropole, ont été mises en place d'importantes églises se caractérisant par une solution particulière (Arte, Mesopotame) et, deuxièmement, parce que pendant la moitié du XIIe siècle a Peshkopi e Sipërme, un peu plus au sud de Labovë e Kryqit, l'église de Sainte Marie n'avait pas encore la forme originale de croix inscrite. Les prochaines études dans cette direction doivent également s'employer à découvrir les motifs qui ont porté à la construction de ce monument en cet endroit.

DO NOT COPY

Thanas KAMBERI

DO NOT COPY

# DISA TË DHËNA MBI TEKNIKËN E NDËRTIMIT TË BANESËS GJIROKASTRITE

Banesat gjirokastrite i përkasin shekullit XVIII dhe më shumë shekullit XIX. Teknika e ndërtimit të tyre ka specifikat e saj të kushtëzuar nga materialet e ndërtimit që janë përdorur, nga karakteri i veçantë i banesës gjirokastrite dhe nga mjeshtrit popullorë, që punuan për ndërtimin e tyre. Teknika e ndërtimit është një tregues me rëndësi i nivelit të ndërtuesve. Evolucioni i saj jep të dhëna të rëndësishme për datimin relativ të ndërtimeve, si edhe për shkollat e ndryshme të mjeshtërve shqiptarë.

Zakonisht, në Gjirokastër, muratura e banesave dhe mureve ndërtohet me gurë e shumë rrallë me çatma, kurse druri përdoret në çati, tavan, dysheme, dyer e dritare, si dhe në brezat e muraturës.

Trashësia e themeleve arrin deri ne 130 cm; ajo është në vartësi të ngarkesës e lartësisë së banesës. Për ndërtimin e themeleve përdoreshin gurët më të mëdhenj ose pjesë shkëmbinjsh, të dalë nga kavat e gurit në afërsi të objektit që ndërtohej. Përgjithësisht themelet e qytetit janë të thata, të palidhura me llaç, gjë që siguronte kullimin e ujërave nëntokësore dhe mënjanonte ngjitjen kapilare të ujit në katet e mësipërme. Kjo mënyrë ndërtimi krijonte mundësinë që ambientet e sipërme të ishin pa lagështirë. Muratura përpjetë, duke u rritur ne lartësi nga kati në kat, vjen duke u ngushtuar, ose, siç thonë muratorët, shkelet në 8 - 12 cm. Numri i kateve ndikon si në themelet ashtu edhe në trashësinë e muraturës, që lëviz nga 80 – 130 cm. Për ndërtimin e mureve përdoret guri i bardhë dhe guri i zi, prej të cilëve i bardhi gjen përdorim më të gjerë, për arsye se dhe shumica e banesave të Gjirokastrës gjenden mbi këto shtresa.

Në lagjet Pllakë dhe Pazari i Vjetër, ku ka vetëm gur të zi, muratura ndërtohet ose me këtë gur ose përzihet me gurin e bardhë. Duke qenë se guri i zi është me i dobët se i bardhi, mjeshtri, në vendet kyçe të godinës, si qemerë, qoshe etj., përdor vetëm gurin e bardhë.

Si material lidhës në këto mure përdorej llaçi i argjilit, shumë herë i dalë nga kavat e gurit, si dhe llaçi i gëlqeres. Llaçi gjen përdorim vetëm në rreshtat e faqes së jashtme dhe të brendshme të banesës dhe nuk përdoret në mesin e trashësisë së muraturës.

Përdorimi i llaçit vetëm në faqen e jashtme dhe në të brendshmen, për mendimin tonë, shpjegohet nga këto faktorë:

a) Guri i një kualiteti të mirë shtresor lejon ndërtimin e një murature solide pa llaç.

b) Duke qenë Gjirokastra e asaj kohe një qytet pa ujë të bollshëm, sigurimi i tij duke e prurë nga lumi, kërkonte shumë shpenzime.

c) Leverdia ekonomike nga kufizimi përdorimit të llaçit.

d) Shkaku i fundit, për mendimin tonë më i rëndësishmi, është se muratura me gur të thatë heq mundësinë e depërtimit të lagështirës kapilare nga jashtë brenda. Dhe në të vërtetë, nëse do të krahasojnë muret e lidhura me llaç me ato të ndërtuara me gurë të thatë, do të vërejmë se nga jugu ose perëndimi në të parët kemi lagështi, e cila në të shumtën e rasteve ka shkaktuar rrëzimin e suvatimit.

Arsyen e fundit jemi të prirur ta quajmë më kryesoren në përdorimin e gjerë të muraturës me gur të thatë, pa llaç, edhe sepse në Gjirokastër, ku ka banesa shumë të mëdha e të zbukuruara me dekorime të kushtueshme, nuk do të ishte logjik kursimi në gëlqere dhe ujë. Faktikisht në Gjirokastër ka




*Fig. 1.*

banesa, si ajo e Zekatëve, ku muret e avllisë, që zënë pothuajse gjysmën e volumit të mureve të godinës, janë ndërtuar me llaç gëlqereje, ndërsa ato të·vetë banesës janë gjysmë të thata.

Muraturën përpjetë, në vartësi nga trashësia e saj, mund ta klasifikojmë: në muraturë të trashë guri dhe në muraturë të hollë guri. Muret e trasha të thata prej guri pa breza druri, kronologjikisht janë muret më të vjetra të ndërtuara në këtë qytet. Këta i gjejmë përgjithësisht të zbatuara në godinat njëkatëshe. Këta lloj muresh kërkojnë gurë të mëdhenj në mënyrë që ai i faqes së jashtme të shkelë gurin e faqes së brendshme. Në godinat e ndërtuara në shek. XVIII, XIX gjejmë mure gjysmë të thata, lidhja e të cilave realizohet me anë të lidhjes së gurëve në trashësi dhe në lartësi të tij.

Lidhja në trashësi e murit, që është njëkohësisht më e rëndësishme, është lidhja brenda –jashtë. Kjo lidhje është e përkryer tek muret me trashësi deri 60 cm. Ndërtimi i këtyre mureve kërkon, si dhe në muret e thata, gurë me madhësi të konsiderueshme.

Kur trashësia e murit rritet, për të mos humbur shkeljen e gurëve të dy faqeve, është e domosdoshme dhe rritja e madhësisë së gurit (Tab. 1). Kur gurët e kësaj madhësie nuk përballonin kërkesat, lindte nevoja e ekonomizimit të tyre. Mjeshtrit, për ekonomizimin e gurëve të mëdhenj, lejonin që kjo lidhje të bëhej të paktën në çdo katër gurë. Ajo bëhej në formë asimetrike dhe garantonte qëndrueshmërinë e murit. Kur muret arrinin 60 – 75 cm., lidhja në më të shumtën e rasteve realizohej nëpërmjet tre gurëve, ku dy gurët e faqeve shkelnin mbi atë të mesit. Kjo lidhje nuk ka dhënë përfundimet e dëshiruara, gjë që vihet re në mjaft godina të Gjirokastrës, në të cilat faqja e jashtme është e deformuar dhe në shumë raste është shkëputur nga faqja e brendshme. Kjo e ka burimin nga që lidhja duhej të bëhej me tre gurë të së njëjtës trashësi, të cilët nuk i kanë patur mjeshtrit e ndërtimit.

Lidhja e murit në lartësi (Tab. 1), e cila është gjithashtu e rëndësishme, qëndron në mos rënien e fugave mbi njëra–tjetrën. Megjithatë, lejohej që mbi njëra–tjetrën të binin të shumtën tri fuga. Kjo lidhje vihet re dhe del më qartë në të gjitha ato godina ku guri ka trashësi të njëjtë.

Në disa raste, kur muret e kalojnë trashësinë 60 cm, ato ndërtohen me gurë të mëdhenj, të vendosur në të dy faqet anësore dhe me gurë të vegjël në mes të tyre, duke u lidhur me breza druri. Vendosja e brezave të drurit (Tab. 1) siguron një lidhje të tërthortë shumë të mirë, ulje gjatësore uniforme dhe nuk lejon të çarë në mur, pavarësisht nga çdo ulje e vogël e rastit e themelit ose prishje e ndonjë pjese të vogël të murit. Meqenëse në Gjirokastër reshjet e shiut vijnë kryesisht nga ana e jugut dhe e perëndimit, mjeshtrit, që të mos kalbeshin brezat e drurit, kanë gjetur zgjidhjen e drejtë, duke i veshur nga ana e jashtme me mur deri në 12 cm. Brezat fillojnë 120 – 130 cm nga toka dhe gjithmonë në pjesën e jashtme janë të veshur me muraturë. Veshja e brezave vazhdonte deri në lartësinë 3.5 – 4 m nën strehët e çatisë, meqenëse mbi lartësi mbroheshin prej saj. Largësia e vendosjes së brezave është 80 – 110 cm. Nga ana e lindjes dhe e veriut brezat janë krejtësisht të paveshur. Përmasat e brezave janë të ndryshme; ata kanë trashësi 3 cm më tepër dhe në gjerësi 6 – 12 cm. Më të përdorshëm janë ata me trashësi 6 – 7 cm, të cilët, të gjithë pa përjashtim janë prej lëndë lisi. Brezat janë dyshe, një nga jashtë dhe një nga brenda, por i gjejmë dhe treshe, duke vënë një në mes (Tab. 1). Si ato dyshet edhe ato treshet janë të lidhura midis tyre me traversa po prej lisi, me të njëjtat përmasa dhe që vendosen në një largësi 60 – 70 cm.

Kur kemi breza dyshe, ata vendosen në faqen e jashtme të murit, (sigurisht që flasim për ato të mbrojtura nga shiu). Kur kemi breza treshe, ata vendosen simetrikisht, në mënyrë që rreshti i poshtëm i gurëve të shkelet nga dy breza dhe të krijohet një lidhje më e mirë. Në rast se brezi i mesit vendosej në mes të murit, nuk do të siguronte asnjë lidhje, se ai mbetej në boshllëk. Brezi i mesit nuk vendoset mbi rreshtin e brendshëm të gurit, se pesha më e madhe e çatisë bie mbi këtë faqe, kështu që kjo faqe ka qëndrueshmëri më të madhe, prandaj edhe muret në Gjirokastër hapen më shumë nga jashtë. Mbërthimi i brezave bëhet gjithmonë me gozhdë kovaçi.

DO NOT COPY

Qoshet e bashkimit të mureve (Tab. 1) bëhen me shumë kujdes, në mënyrë që të gjithë brezat të mbivendosen, d.m.th. të kemi kryqëzime. Lidhjet e vet brezave (Tab. 1) (zgjatja) bëhen me fallco (kalem) dhe në mbivendosje; mënyra e parë është më e mirë se nuk prish radhitjen e gurëve.

Mbulimi i hapësirave të dyerve e të dritareve bëhet me qemer guri, ndërsa vetëm në katin e sipërm me arkitrarë druri. Arkitrau i drurit, gjithmonë prej lisi, përdoret dhe brenda qemerëve të dritareve dhe të dyerve, në katet e poshtme. Guri që përdoret në këto qemerë, ishte shumë i madh dhe disa herë kemi qemerë me dy të tilla. Për mbulimin e hapësirave të mëdha, si të kamerieve dhe të sterave të ujit etj., përdorej harku cilindrik. Teknika e ndërtimit dhe lidhjet e këtyre harqeve janë si ata të muraturës. Në këto harqe përdorej gjithmonë llaç gëlqereje dhe nuk takojmë në asnjë rast qemerë me llaç argjile ose pa lidhës. Mbi harkun, i cili ka një trashësi rreth 35 cm, hidhet një sasi mbeturinash ndërtimi ose çakëll për nivelim dhe mbi të llaç gëlqereje dhe rrasa guri (kapak). Kameriet, meqë ndodhen jashtë mbulesës së çatisë, kanë një shtresë hidroizoluese me harasan. Në qemerët vendosen tiranta prej lisi, të cilat kryqëzohen në brezat e mureve.

Muratura e hollë prej guri (Tab. 1) është gjithashtu mjaft e përhapur në këtë qytet. Ajo përdoret në muret ndarëse në katet e sipërme dhe në ballin e godinave. Muret e holla ndërtohen me skelet druri të mbushur me gurë të gdhendur me dimensione 12 x 20 – 40 cm. dhe të lidhur me llaç argjili. Trashësia e këtij muri nuk i kalon të 12 cm.

Në godinat ku gjen përdorim ky lloj muri, nuk takojmë asnjëherë mur çatma. Kjo na lë të kuptojmë se çatmaja është shumë e vonë në këtë qytet; ajo duhet të ketë hyrë aty rreth fundit të shek. XIX. Këtë bindje na e përforcon dhe karakteri mbrojtës i banesës gjirokastrite.

Zakonisht të gjitha muret perimetrale përfundojnë me një kornizë guri të thjeshtë (Tab. I, 4), të përbërë prej dy rreshta gurësh të latuar njëri mbi tjetrin, jo më pak se 50 cm, të vendosur në formë shkallësh. Kjo kornizë përgjithësisht është përdorur deri nga fillimi i shek. XIX. Nga fillimi i këtij shekulli deri në fund të tij fillon të përdoret gjerësisht korniza e gurit, e ashtuquajtur nga mjeshtrit korniza me kokosha, e cila formohet nga një gur me lartësi 20 cm, të profiluar në formë çerek rrethi.

Përveç këtyre, rreth fundit të shek. XIX filluan të përdoreshin tipe të tjera kornizash të profiluara.

Më e vjetra është ajo me dy radhë kapakë, me rreshtin e mesit si dhëmbë sharre (tab. 1), e cila përdorej më shumë në mesin e godinave, në pjesën e sipërme të kamerieve si dhe në fund të qostekëve më të gjatë, në ballin e godinës.

Suvatimi më i përhapur dhe më i vjetër është ai me baltë argjili, që është njëkohësisht dhe më i thjeshti. Balta e argjilit, përzihej mirë me kashtë dhe lihej dy – tri ditë për të fituar lagështi uniforme, pastaj hidhej në mur dhe rrafshohej. Ky lloj suvatimi përdorej kudo me përjashtim të dhomave të miqve. Suvatimi me baltë argjili dhe gëlqere është nga më të mirët. Ai përdorej sidomos në mure pa llaç ose kur muri ka si lidhës llaç argjili. Mbi murin e gurit hidhej një shtresë llaç argjili me trashësi deri 2 cm, me përmbajtje kashte të prerë. Pas rrafshimit ajo lihej për t'u tharë, derisa të merrte të plasura nga tkurrja e argjilit. Mbi shtresën e parë hidhej shtresa e dytë, që nuk i kalonte 5 mm. Shtresa e dytë përgatitej duke marrë lesh dhie dhe duke rrahur me një shufër, deri në hapjen e tij të plotë. Pastaj përzihej me gëlqere shumë të pastër, derisa të krijohej një lëndë viskoze. Në stinën e verës, për të ulur tkurrjen e gëlqeres hidhej dhe pak rërë e larë. Llaçi i përgatitur shtrohej mbi shtresën e parë me mistri dhe pastaj me anën e një malloje vazhdohej fërkimi për tri – katër ditë. Pas kësaj pune përftohej një sipërfaqe e rrafshët si patinaturë. Mbi të kalonte sherbeti i gëlqeres dhe pastaj dy duar emulsion me përmbajtje 1% tutkall, për të mbajtur sherbetin e gëlqeres.

Kjo mënyrë suvatimi është më e mirë, sepse nga fërkimi i madh i saj krijohej një sipërfaqe e lëmuar, e cila, meqë gëlqerja e shuar është hidroizoluese, nuk lejonte hyrjen e ujit në thellësi. Këto lloj suvatimesh janë më të bukura dhe më ekonomike se suvatimet me gëlqere.

Suvatimi me harasan përdorej në sterat e ujit (muslluqet) dhe në shtresat ku kërkohej hidroizolim. Trashësia e suvasë është deri në 3 cm. Shtresa e parë përbëhet nga pluhur tulle dhe gëlqere; mbi këtë hidhet një shtresë tjetër, e cila është shumë më e fortë, që mund të jetë një përzierje me të bardhë veze dhe vaj.

Çatitë e banesave të Gjirokastrës janë të ndërtuara me lëndë të rrumbullakuar (latuar) bredhi, ndërsa strehët me lëndë lisi dhe mbulohen me rrasa guri. Përdorimi i tjegullave të vendit në qytet është i vonë. Mbeturinat e tjegullave, më të mëdha se tjegullat e sotme, të gjetura gjatë pastrimeve në kala, tregojnë se ato janë përdorur te godinat e ndërtuara në

ZONOTOBY



Lidhje e murit me dy gurë



Lidhje e murit
me tre gurë



Pamje e murit





Brezat gjatësorë



Kryqëzimi i brezave



Zgjatja e brezave



Mur guri me trashësi
12 cm me skelet druri



Kornizë guri tipi I



Kornizë guri tipi II



Kornizë guri (kokosha)



Ndarje me mure guri 12 cm

DO NOT COPY

kala në vitet e Ali Pashës. Strehët e çatisë dalin jashtë faqes së murit deri në 1.5 m, e mbështeten mbi qestekë të shkurtër prej lisi 6 – 7 cm dhe të gjatë po prej lisi 7 x 11 cm. Qestekët e shkurtër zakonisht mbështeten në mur mbi brezin e parë të drurit. Nga perëndimi ose nga jugu strehët janë të shkurtra, pa qestekë, si kornizat që përmendëm më lart. Strehët 60 cm, me tavan dërrase, janë të vona në qytet; ato mund të kenë hyrë atëherë kur është vënë në përdorim çatmaja. Pjerrësia e çative në Gjirokastër shkon nga 25° – 30°, më të zakonshmet janë 27°. Të gjitha çatitë me strehë të shkurtra, kanë si lartësi të baballëkut ¼ e hapësirës së brendshme, ndërsa në çatitë me strehë të gjatë merret ¼ e hapësirës së brendshme, ndërsa në çatitë me strehë merret ¼ e hapësirës brenda plus trashësinë e dy mureve, duke hequr zinxhirin e poshtëm, të sipërm si dhe trashësinë e mahive. Kufiri i pjerrësisë që përcaktohet nga 25° – 30°, është në përpjesëtim të zhdrejtë me madhësinë e rrasës së gurit dhe trashësinë e lëndës së drurit. Lënda e përdorur për trarët e poshtëm (tavan) dhe mahitë, është e trashë 12 x 15 cm, ndërsa për pajandimet është me përmasa të vogla. Konstruksioni më i thjeshtë i çative, që nuk ndryshon nga të sotmet, është ai me hapësirë drite deri në 4 m. Zgjidhje interesante kanë çatitë me hapësirë drite mbi 4 m (Fig. 1), në të cilën mjeshtri, pa ndonjë llogaritje statike, ka arritur që edhe me lëndë të holla të ndërtojë konstruksione të tilla që, me gjithë peshën e madhe të rrasës së gurit, të qëndrojnë në gjendje të mirë më tepër se një shekull. Mbulesa me rrasa guri bëhej po ashtu si dhe në kohët tona: duke filluar me vendosjen e rrasës më të madhe afër strehëve, sepse atje është më e madhe sasia e ujit, dhe duke u ngjitur për në kulm me rrasa më të vogla. Kulmi ka rrasa të mëdha dhe të mënjanuara nga ana e jugut ose e perëndimit.

Kjo varet prej drejtimit të kulmit, por në asnjë rast ky nuk ka pjerrësi nga veriu ose lindja, sepse andej nuk ka reshje të shumta. Ky shkak shpjegon dhe kalbjen më të madhe të lëndës nga jugu ose perëndimi. Çatitë me rrasa guri kanë dhe anën negative, se kërkojnë shumë lëndë, dhe anë pozitive, sepse rrasat janë më ekonomike, mbasi gjenden në vend, janë më termoizoluese se tjegullat dhe nuk i transmetojnë lëndës as lagështirën më të vogël.

Punimet e ndërtimit të banesave kryheshin nga grupe, që udhëhiqeshin nga një kryemjeshtër. Grupi arrinte deri në 20 vetë dhe përbëhej nga kryemjeshtri, mjeshtrit, punëtorë e kafsharë. Këta merrnin përsipër në marrëveshje me pronarin, të gjithë punën e imët dhe materialet, përveç lëndës së drurit dhe gëlqeres, të cilën porositësi e siguronte shumë kohë përpara fillimit të punimeve.

Të dhënat e teknikës së ndërtimit që trajtuam do të plotësohen në të ardhmen me materialet e reja, që do dalin gjatë punimeve restauruese, të cilat, njëkohësisht, do të hedhin dritë mbi një sërë problemesh të tjera të pazgjidhura ose të papërcaktuara përfundimisht.

*Shënim:* *Monumentet,* nr. 2, 1971, fq. 157 - 164

DO NOT COPY

Thanas KAMBERI

DO NOT COPY

# DONNÉES SUR LA TECHNIQUE DE CONTRUCTION APPLIQUÉE DANS L'HABITATION TYPE DE GJIROKASTËR

La maçonnerie des habitations des XVIIIe et XIXe siècles à Gjirokastēr est faite de pierres, le bois étant utilisé pour la toiture, les plafonds, les planchers, les portes et les fenêtres, ainsi que pour les ceintures de renforcement des murs.

Les fondations sont construites en pierres disposées à sec, procédé qui permet le drainage des eaux souterraines et élimine la montée capillaire. L'épaisseur des murs diminue, d'un étage à l'autre, de 8 à 12 centimètres; pour la liaison de la maçonnerie on se servait de mortier d'argile ou de mortier à chaux, celui-ci n'étant employé que pour les parois et non pour l'intérieur des murs. Les raisons qui ont fait adopter un tel procédé de construction sont les suivantes :

a) Les pierres stratifiées permettent de bâtir des murs solides sans mortier.

b) Gjirokastër n'ayant pas été jusqu'à récemment encore, approvisionnée abondamment en eau, il était coûteux d'en faire transporter de la rivière.

c) Il avait l'avantage d'économiser le mortier.

d) Ce procédé rend impossible l'infiltration de l'humidité capillaire du dehors à l'intérieur.

Nous sommes enclins à considérer cette dernière raison, comme ayant été essentielle.

Nous diviserons la maçonnerie de pierres en murs épais et en murs minces. Les premiers, construits selon le procédé à sec, sans ceintures en bois, sont chronologiquement les plus anciens. Dans les habitations bâties au cours des XVIIIe-XIXe siècles, on trouve des murs à demi secs, liés en épaisseur et en hauteur. La liaison en épaisseur se fait en évitant que les joints soient superposés. La maçonnerie est consolidée par des ceintures de bois, qui assurent une bonne liaison transversale de la construction et un nivellement longitudinal uniforme. Sur les parois sud et ouest qui sont les plus battues par la pluie, les ceintures sont revêtus de maçonnerie à l'extérieur pour les empêcher de pourrir.

Les encadrements des portes et des fenêtres sont surmontés de linteaux en pierre et, au deuxième étage, seulement d'architraves en bois. Les grandes ouvertures sont surmontées d'arcs en plein cintre. Les murs minces en pierres servent de cloison, et au troisième étage de façade. Ils sont constitués d'une ossature en bois comblée de pierres appareillées.

D'ordinaire, tous les murs périmétraux sont terminés par des corniches de divers types, en pierre.

Le revêtement le plus usité et le plus ancien est celui en terre argileuse. Comme pratique répandue citons aussi l'enduit d'une première couche de terre argileuse, suivi d'un second à la chaux, procédé qui a donné d'excellents revêtements. Le revêtement au mortier de sable et de chaux a été utilisé là où il fallait empêcher l'infiltration de l'eau, autrement dit pour les citernes.

Les toits des habitations de Gjirokastër sont construits en charpentes de bois et recouverts de plaques de pierre ordinaire, (dalles minces). Les avant-toits, en général, ne sont pas revêtus, ils avancent de 1,5 mètre environ et s'appuient sur des contrefiches en bois.

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

# UJËSJELLËSI I VJETËR I KALASË SË GJIROKASTRËS

Ujësjellësi që ka pas furnizuar kalanë e Gjirokastrës me ujë gjatë mesjetës së vonë është një nga ndërtimet më interesante dhe monumentale të këtij qyteti në këtë periudhë. Në fazën e tanishme të studimit e gjurmimit të ujësjellësve të vjetër tek ne mund të shprehemi se për nga gjatësia, kompleksiteti i zgjidhjeve inxhinierike-hidraulike gjatë aksit të tij, ndërtimet mbrojtëse të tij, etj. ndoshta ky ujësjellës është më i madhi e më interesanti i ujësjellësve të ndërtuar në vendin tonë gjatë periudhës së mesjetës.

Lidhur me kohën e ndërtimit të këtij ujësjellësi nuk kemi burime të sakta dokumentare. Kur më 1672 Evlia Çelebiu[1] ka vizituar Gjirokastrën dhe në shënimet e tij e përmend ndërtime hidraulike mjaft më të thjeshta se ujësjellësi monumental, për të cilin nuk përmend asnjë fjalë. Ky është një fakt që të bën të mendosh se në këtë kohë ujësjellësi nuk ka ekzistuar.

Pasi ujësjellësi i Gjirokastrës furnizonte me ujë kalanë, atëherë, për datimin e këtij ndërtimi hidraulik, argumente bindëse japin dhe vetë fazat e ndërtimit të kalasë. Pjesën më të vjetër të Kalasë e përbën faza e periudhës së para pushtimit turk, që zë pjesën verilindore dhe atë qendrore, e cila duhet të jetë ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XIII[2]. Në ditët e sotme kalaja ruan një shtrirje më të madhe. Zgjerimi i kalasë ka ndodhur në drejtimin jug - perëndimor të saj, ku kemi të bëjmë me një fazë ndërtimi që lidhet me aktivitetin ndërtimor të Ali Pashë Tepelenës, siç dëshmojnë Hani[3] etj.

Pikërisht në ekstremin jug - perëndimor të kësaj faze ujësjellësi lidhej me kalanë (fig. 1). Ky është një argument i fortë që na shtyn të mendojmë se edhe ndërtimi i ujësjellësit duhet t'i takojë kohës së Ali Pashë Tepelenës[4]. Në këtë kohë, vitet 1811 - 12 e më tej deri në 1820, kalaja e Gjirokastrës ishte një nga pikat ku Ali Pasha kish vendosur një garnizon të fuqishëm ushtarak me 75 topa të kalibrave e të peshave të ndryshme[5]. Ndërtimi një ujësjellësi të tillë të gjatë më shumë vepra arti, disa nga të cilat mjaft të vështirë për t'u ndërtuar kërkonte njerëz të kualifikuar, pra teknikë, mjeshtër e inxhinierë që në administratën e Aliut zinin një nga vendet kryesore e që kryen një volum të madh ndërtimesh të gjinive të ndryshme, si kala, ura, banesa etj.

Si argument tjetër mund të sillnin faktin se akoma dhe sot një nga urat më të mëdha të ujësjellësit; e ndërtuar në dalje të lagjes Manalat mbi lumin e Manalatit, nga fragmentet e vetme të ujësjellësit të ruajtura më mirë, populli e quan me emrin Ura e Ali Pashë Tepelenës (Tab. I).

[1] Evlija Çelebiu, *Shqipnija para dy shekujsh*, Tiranë, 1930, 29. Këtu Çelebiu shprehet: Në kala ka 200 shtëpi.... Brenda në fortesë ndodhet xhamia e Bajazit Hamit... Afër minares së kësaj xhamie ka një sarenxhë të madhe ku mblidhen ujërat e shiut që kullojnë nga rrasat e pullazeve të fortesës në të cilën pinë ujë gjithë banorët e kalasë. Veç kësaj, çdo zotni ka në shtëpi të vet një sarenxhe të veçantë. Pra fakti që banorët e kalasë problemin e furnizimit me ujë e kishin zgjidhur me organizimin e ujërave të shiut nëpër sarenxha (stera-depozita) tregon se ky ujësjellës në atë kohë nuk ka ekzistuar.

[2] A. Baçe, "Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër)", *Monumente* 4, 1972, 122.

[3] I.G. Hahn, *Albanesische Studien*, Jena 1854, 53.

[4] E. Riza, Disertacion, *Qyteti muze i Gjirokastrës*, 1978, 25.

[5] R. Drishti, *Armët dhe armëtarët shqiptarë,* Tiranë 1976, 84.



*Fig. 1. Hyrja e ujësjellësit në skajin jugperëndimor të kalasë së Gjirokastrës*



*Fig. 2. Rrënojat e ujësjellësit të kalasë së Gjirokastrës*

Pra, pas këtyre argumenteve si datim të ujësjellësit pranojmë kohën e ndërtimit të fazës së Ali Pashës në kala, pra vitet 1811 - 1812. Në këtë kohë në Gjirokastër ka pas ekzistuar dhe një ujësjellës tjetër që furnizonte qytetin me ujë (pjesën jashtë kalasë)[6].

Pukëvili në dekadën e parë të shek. XIX-të kur përmend marrjen e qytetit të Gjirokastrës nga Ali Pasha shkruan se "sapo ushtritë e Vezirit këputen ujësjellësin dhe rrëzuan mullinjtë, banorët kërkuan të dorëzohen"[7].

Pra, duke pranuar si kohë ndërtimi të ujësjellësit atë të Ali Pashës, atëherë nga ky shënim i Pukëvilit mund të mendojmë se Aliu ka prishur ujësjellësin tjetër të ndërtuar para kohës së tij.

Në gjendjen e sotme ky ujësjellës ruhet mjaft i dëmtuar. Ruhen vetëm disa urë-kanale të tij, një pus kontrolli, një kullë mbrojtje, gjurmë të këmbëve të akueduktit të madh pranë kalasë dhe ndonjë rrënojë tjetër (fig. 2). Megjithatë studimi i tij bazuar në këto gjurmë e në burimet mund të kryhet.

Ujësjellësi i kalasë së Gjirokastrës që nga vendi ku buronte tek Mëma e Ujit, siç e quajnë vendasit, në Grykën e Sopotit në jug-perëndim të fshatit Lazarat e deri në hyrjen e tij në skajin jug-perëndimor të Kalasë arrinte gjatësinë afër 12 km. Aksi i tij është trasuar duke ndjekur shpatet e kodrave, pak a shumë me parimin e izoipseve, duke u krijuar sigurisht edhe qarkullimet me rënie (duker) nëpër përrenjtë apo grykat (ultësirat) ndërmjet kodrave apo "shullireve"[8] siç i quajnë këto vendasit, (Tab. II).

Po të emërtojmë vendet karakteristike nga kalon ujësjellësi, kodrat, sheshet, etj. ashtu siç i quajnë vendasit atëherë prej burimit e deri në kala rruga që përshkonte ky ujësjellës i gjatë ishte: Mëma e Ujit (burimi) - Shulliri i Kroit - Sheshi i Fotos - Përroi i Mesunit - Mokrra e Kokonos - Gropa e Kokonos - Shtegu i Rradhoit të Qershisë - Shulliri i Gropës së Qershisë - Kurrizi i Zhape - Shulliri i Ristës, - Fundi i Gropave të Sejdiut - Sheshi i Pllashnjës - Shulliri i Urës - Gropa e Lugut - Kodra e Mesunit - Kreu i gërmadhave të Mustafa Aliut - Këmbët e Shesheve - Shulliri i Qivurit - mali i Lulos - Shulliri i Gjokanës - kodra e Hijes së Arapëve - ura e Ali Pashës mbi lumin e Manalatit - lagje Dunavat.

Gjatë trasimit që jemi përpjekur të bëjmë në hartë mund të themi se pothuaj me saktësi kemi vendosur aksin nga kalaja deri tek ura e shesheve, ndërsa intervali prej këtej e deri në burim, për mungesë gjurmësh, është trasuar me afërsi.

Nga pikëpamja teknike ky objekt është mjaft i arritur. Sipas rastit, gjatë aksit të tij janë ndërtuar shumë vepra arti si urë-kanale në përrenjtë, mure mbajtës në shpatet shkëmbore të thikta, pus kontrolli e bile deri dhe kullë për mbrojtjen e saj nga dëmtuesit. Nga burimi deri në kala për funksionimin normal të ujësjellësit janë ndërtuar shtatë ura guri me hark me madhësi të ndryshme sipas grykës së përroit apo lumit që ndërpret aksin e ujësjellësit. Duke filluar nga burimi, në

[6] Th. Kamberi, *Shkenca dhe Jeta*, Nr. 4, 1975, 55.

[7] F.C.H.L. Pouqueville, *Voyage de la Grèce*, T.I., 1920 f. 338.

[8] Shulliri - me këtë emër vendasit quajnë pllajën malore karshi diellit.

DO NOT COPY



*Fig. 3. Ura e Karcales gjatë aksit të ujësjellësit*



*Fig. 4. Kanali i tubacionit të ujësjellësit*

grykën e përroit të Pllashunjës që ndan Shullirin e Urës me Sheshin e Pllashnjes tubacioni i ujësjellësit kalonte mbi urën e Vogël të Pllashnjes, sot e shkatërruar. Më tej, në grykën që ndan Kodrën e Mesunit me Gropën e Lugut tubacioni kalonte mbi një urë tjetër e quajtur ura e Mesunit, edhe kjo e prishur.

Në grykën ndërmjet dy lartësive, këmbët e Shesheve dhe Shulliri i Qivurit ndodhet një përrua i vogël, verës pa ujë, këtu ujësjellësi kalonte mbi një urë të vogël - urë e shesheve me vetëm një hark me hapësirë rreth 5 m. Sot ura është e prishur dhe në kreun e saj me gjerësi 2 m nuk ruhet asnjë gjurmë tubacioni. Ura është ndërtuar me gurë pllakë gëlqerore lidhur me llaç gëlqere.

Ura e katërt duke nisur nga burimi është ura e Karcales (Shën-Nikollës) mbi lumin e Gjonakatës gryka e të cilit kalon ndërmjet malit të Lules dhe Shullirit të Gjokanës.

Ura e Karcales është interesante si kompozim dhe e ndërtuar me finesë. Në gjendjen e sotme ajo ruhet mjaft e dëmtuar, megjithatë rikonstruksioni ideor i tij është plotësisht i mundshëm (Tab. III, 1). Si zgjidhje ai është ndërtuar i tërë mbi brigjet shkëmbore dhe konstruksioni i tij nuk ka kontakt fare me shtratin e lumit të Gjenakatës mbi të cilin është ngritur, lum krejt i tharë gjatë periudhës së verës. Ura ka qenë e ndërtuar mbi dy harqe, më i madhi prej të cilëve kalon mbi shtratin e lumit. Ky ka pasur formën e harkut rrethor me diametër 7.5 m, e lartësi mbi shtrat 6,5 m. Konstruksioni i qemerit të harkut ka trashësinë 55 cm.

Këmba e mesit e urës që ndan dy harqet me gjatësi 1,7 m nga të dy bjefet është trajtuar me majë të mprehtë (fig. 3). Harku i vogël me hapësirë drite 2,4 m e trashësi qemeri po 55 cm është ndërtuar i tëri mbi shkëmbin në anën e djathtë. Në kreun e urës me gjerësi 110 cm nuk ruhet asnjë gjurmë tubacioni i ujësjellësit. Teknika e ndërtimit është me gurë pllakë lidhur me llaç gëlqere.

Ura e pestë që vijon për më nga afër qytetit dhe që është nga ndërtimet më interesante të këtij ujësjellësi është ura e Ali Pashës, e ndërtuar mbi lumin e Manalatit, në grykën që ndan lartësinë e quajtur "Hija e Arapëve" me shpatin shkëmbor që vijon për nga banesat periferike të lagjes Dunavat buzë lumit të Manalatit, mjaft e thiktë ndaj shtratit të tij, (Tab. I).

Ura e Ali Pashës, kështu e quajnë sot vendasit, është një ndërtim monumental që të imponohet veçanërisht me theksimin e tij vertikal. Duke soditur këtë ndërtim të guximshëm inxhinierik të lind vetiu një respekt i veçantë për kurajën dhe aftësinë e mjeshtërve tanë të ndërtimit, që kanë realizuar një objekt të tillë solid e të vështirë. Kjo urë kanal me gjatësi afër 40 m në qendër të kompozimit ka harkun e madh rrethor që mbështetet mbi faqet e pjerrëta shkëmbore të grykës së lumit e nuk takon në shtratin e lumit i cili në këtë vend është mjaft i ngushtë. Harku është me hapësirë drite 13,7 m dhe lartësi nga kyçi në shtratin e lumit 19 m. Harku është ndërtuar me dopio qemer me trashësi të përgjithshme 130 m. Në ballin e qemerit të poshtëm nga të dy bjefet janë vendosur nga tetë ganxhe metalike për mbërthimin e gurëve ballorë ndërmjet tyre. Për lehtësimin e konstruksionit e për të evituar muret masive bregore që mbështeten mbi skarpate shkëmbore, anash harkut të madh, në lartësi, janë hapur dy harqe lehtësues me formë gjysmë rrethore. Kanali ka pas kaluar mbi kreun e urës, që ka gjerësinë 2,3 m. Sot mbi urë nuk

DO NOT COPY

ruhet asnjë gjurmë e tubacionit të ujësjellësit, por në krahun e djathtë të urës, në faqen shkëmbore të malit është dalluar një thellim për vendosjen e tubacioneve (fig. 4). Ura është ndërtuar me gurë gëlqere pllakë lidhur me llaç e gëlqere.

Pasi kalon urë-kanalin e Ali Pashës, tubacioni vijonte në shpatin shkëmbor në bregun e majtë të lumit dhe pasi bën disa qindra metra gjatë këtij bregu futet në lagjen Dunavat.

Nuk kemi ndonjë të dhënë për rrugën që përshkon ujësjellësi në pjesën jug-perëndimore të lagjes Dunavat deri sa hasim aksin e tij në urën e vogël me një hark, në qendër të lagjes Dunavat, mbi të cilën kalonte tubacioni i ujësjellësit.

Ura e Dunavatit është ndërtuar me një hark rrethor me trashësi të qemerit 45 cm. Hapësirë drite e harkut është 3.6 m, e lartësia nga kyçi në tokë është 2.3 m. (Tab. III, 2). Përroi i Dunavatit gjatë verës nuk ka ujë. Tubacioni ka pas kaluar mbi kreun e urës, që ka gjerësinë 1.75 m. Menjëherë sapo del nga ura, tubacioni kalonte në faqen e thiktë shkëmbore të grykës së përroit. Në afërsi të urës pak metra pas daljes prej saj, në shkëmb për vendosjen e tubacionit është ndërtuar një mur mbajtës rreth 7 m i gjatë, mbi të cilin kalonte tubacioni i ujësjellësit. Më tej, gjurmët e ujësjellësit i hasim përpara portës së jashtme të ish-banesës së Qerebashit (fig. 5). Këtu tubacioni ruhet ende nën dyshemenë e oborrit të shtëpisë. Në këtë banesë që është shumë afër skajit jugperëndimor të kalasë, ku dhe përfundonte ujësjellësi, ruhen elemente me interes që bënin pjesë në atë larmi zgjidhjesh teknike që e përbënin këtë objekt hidraulik.



*Fig. 5. Gjurmë të tubacionit të ujësjellësit në hyrjen e banesës së Qeribashit*

Brenda murit rrethues të kësaj banese ndodhen dy godina të lidhura në formë L-je, njëra në formë kulle me tre kate (e sipërmja) dhe tjetra më afër kalasë me dy kate (Tab. IV). Ndërtimi trekëndësh ka shërbyer si kullë e fortifikuar për mbrojtjen e ujësjellësit. Në murin e lartë nga ana veriore, që sheh nga qyteti, janë vetëm dy dritare në katin e sipërm, ndërsa në katin përdhes e në të parin ruhen akoma frëngjitë, që duket se ishin hapur për mbrojtjen e ujësjellësit, aq më tepër pasi në këtë banese ish ndërtuar dhe një pus kontrolli për kontrollin e tubacionit. Pusi ruhet ende (por i mbyllur) në katin përdhes të volumit me dy kate që lidhet me kullën e mësipërme. Nga ana e oborrit kjo godinë është me një kat, ndërsa nga faqja që sheh nga kalaja, për shkak të terrenit të aksidentuar është me dy kate e pikërisht nga kjo faqe muri shihet edhe sot një kamare e vogël që komunikon me pusin e kontrollit e ku në thellësi të saj ruhet edhe një tubacion qeramike. Ky pus kontrolli mund të ketë qenë i fundit i këtij lloji para hyrjes së ujit në kala, duke shërbyer dhe për dekantimin e grimcave të ndryshme në mënyrë që uji në kala të shkonte sa më i pastër.

Vepra me afër kalasë dhe më interesantja e gjithë ujësjellësit të vjetër të Ali Pashë Tepelenës në Gjirokastër është urë – kanali (akuadukti) i lartë me dy palë harqe, sot i rrënuar krejtësisht, i ndërtuar për arsye të rënies së terrenit në intervalin e banesave e Qeribashit (pusi i kontrollit). - skaji jug perëndimor i kalasë. Pra, ky akuadukt lidhte këto dy pika me kuotë afërsisht të njëjtë.

Ky akuadukt monumental ka një kompozim arkitektonik mjaft të goditur për objekte të kësaj gjinie e me një zgjidhje konstruktive shumë elegante siç na e paraqet Lir[9] në një gravurë të gjysmës së parë të shekullit XIX (fig. 6). Në ditët e sotme nga ky ndërtim i rrallë ruhen vetëm disa fragmente muresh të pjesëve të poshtme të kolonave. Vërejmë gjurmë të gjashtë kolonave. Më mirë nga këto ruhet pjesa e poshtme e kolonës në buzë të rrugës që lidh qendrën Komitetik me lagjen Dunavat (fig. 2). Ajo është me seksion katërkëndësh me përmasa të poshtme 5,5 x 2,5 m (gjerësi). Këmbët qenë me seksion variabël p.sh. deri në lartësinë 4 m që ruhet kjo këmbë gjatësia 5,5 m shkon e ngushtohen 20 cm nga të dy skajet (fig. 7). Kolona apo këmba është ndërtuar me breza druri çdo 1,3 m, seksioni i binarëve 8 x 10 cm.

[9] E. Lear, *Journals of a Landscape Painter in Albania,* London, 1851.

DO NOT COPY



*Fig. 6. Ujësjellësi i kalasë sipas një gravure të Edward Lear, 1851*



*Fig. 3. Fragment nga urat e mëdha të ujësjellësit të kalasë*

Muratura me gurë pllakë gëlqerore me trashësi 6 – 12 cm lidhur me llaç gëlqere. Qoshet janë punuar me gurë shtufi të skuadruar. Më lart kësaj, nga ana e pusit të kontrollit ruhet një këmbë tjetër me gjerësi 2,25 m.

Hapësira ndërmjet këtyre këmbëve është 5,7 m. Akoma më lart ndodhet një këmbë tjetër me hapësire më të madhe, 6,15 m. Në pjesën e rrugës nga kodra e kalasë duhet të kenë qenë dy këmbë me hapësirë 5,7 m ndërmjet tyre. Në bregun e kodrës se kalasë ruhen gjurmët mjaft të dëmtuara të tre këmbëve.

Pra sot, gjurmë të ruajtura janë vetëm për gjashtë këmbë të akuaduktit. Si përmasë e hapësirës së këmbëve dominon shifra 5.7 m. Nga llogaritja e përafërt del se gjatësia totale e akuaduktit me dy palë harqe prej buzës se kalasë e deri tek pusi i kontrollit i Qeribashit është rreth 120 m.

Qarkullimi i ujit në ujësjellësin e vjetër të Gjirokastrës kryhej me tuba qeramike. Për arsye të disnivelit që ekzistonte ndërmjet burimit të marrjes së ujit dhe skajit jug perëndimor të kalasë, ku është vepra e marrjes, rreth 1000 m, ky tubacion punonte me presion pra me mbushje të plotë. Nga gjurmët e gjetura tek ura e shesheve, 1/3 e rrugës pranë burimit, rezulton se diametri i brendshëm i tubacionit ka qenë mesatarisht 140 mm, ndërsa në tubacionet e gjetura në lagjen Dunavat, pra pranë fundit të ujësjellësit, rezulton se tubacioni ka pasur diametër 110 mm (Tab. V).

Ky fakt tregon se ujësjellësi është llogaritur me saktësi duke pasur parasysh edhe humbjet hidraulike, pra humbjet në gjatësi për efekt të fërkimit si dhe humbjet e vendit, në kthesat e ngushtimet pasi në atë kohë tubat ndërtoheshin me seksion variabël me pjesën më të ngushtë në dalje. Këto zgjidhje hidraulike të goditura tregojnë dhe një herë se ky ujësjellës është ndërtuar nga teknikë të aftë dhe forcon mendimin se objekti është ndërtuar nga Ali Pasha në administratën e të cilit kanë punuar teknike e inxhinierë të profileve të ndryshme. Faqet e brendshme të tubave janë me viaska apo thellime paralele ndërmjet tyre. Lidhja e tubave kryhej me futje njëra tek tjetra. Lidhjet e tubave visheshin me llaç të përbëre vetëm prej gëlqereje të pastër e të stazhionuar. Gjatësia e tubave arrinte 330 – 360 mm. Trashësia e pareteve të tubave prej qeramike për të përballuar presionin e ujit shkonte nga 15 deri në 19 mm.

Për të mbrojtur rrjetin e ujësjellësit nga dëmtimet e mundshme tubacionet e qeramikës vendosen thellë në tokë 50 – 60 cm. Ato bëheshin prej argjile dhe gjatë përgatitjes së tyre piqeshin mirë në mënyrë që të përballonin presionin e ujit brenda tyre. Uji në kala futet jo pikërisht në kullën jug perëndimore, ai me tubacion vijon disa dhjetëra metra në faqen shkëmbore, poshtë murit verilindor. Pas një farë rruge, bën kthesë e futet në kala, ku depozitohet në tri stera të mëdha prej nga merret me muslluk.

DO NOT COPY

Lidhur me mjeshtrit që kanë punuar për ndërtimin e këtij ujësjellësi nuk kemi të dhëna. Në bazë të burimeve të ndryshme rezulton se në atë kohë në krahinën e Lunxhërisë e pikërisht në fshatrat Nokovë, Dhoksat e Këllez ka pasur mjeshtër të njohur në ndërtimin e ujësjellësve[10], të cilët me veprat e tyre hidraulike u bënë të njohur në të gjithë Perandorinë. Pra kuptohet se po këta mjeshtër duhet të kenë marrë pjesë në ndërtimin e ujësjellësit të kalasë së Gjirokastrës, aq më tepër që ky ndërtim i profilit të tyre kryhej pranë vendlindjes së tyre. Puset e sterat e shumta dhe ujësjellësit e ndërtuar në Gjirokastër dhe fushën e Dropullit dëshmojnë për një aktivitet të gjerë të mjeshtërve lunxhiotë.

Ujësjellësi i Ali Pashë Tepelenës që furnizonte me ujë kalanë e Gjirokastrës ka një gjatësi të konsiderueshme, që e vendos atë ndër ujësjellësit më të gjatë. Nga literatura që kemi mundur të konsultojmë për ujësjellësit e ndërtuar në Ballkan gjatë mesjetës, në Tivar ruhet një ujësjellës i ndërtuar në shekullin XVII me gjatësi 1.5 km. Akuadukti (urë – kanali) i tij që sjell ujin në kala është i gjate 74 m[11]. Për realizimin teknik e larminë e zgjidhjes funksionale ai gjithashtu është një nga objektet më të goditura të gjinisë së tij dhe që e vlerëson mjaft aftësinë dhe pjekurinë e mjeshtërve tanë të ndërtimeve hidraulike.

[*] **Shënim:** *Monumentet,* nr. 20, 1980, fq. 69 - 82

DO NOT COPY

[10] C. Robert, *Les Slaves de Turquie*, Paris, 1852, II, f. 171.

[11] N. Katdiç, M. Gojkoviç, *Graça za prouçvanije kamenih mostova i akvedukata u Hrvatskoj,* Beograd-Zagreb. 1972, f. 229.




DO NOT COPY

Ura-kanal e Ali Pashë Tepelenës




Traseja e ujësjellësit nga burimi në k ala



Ura e Karcales e ujësjellësit të kalasë



Ura e Dunavatit

DO NOT COPY




DO NOT COPY

*Banesa e Qeribashit me pusin dekantues të ujësjellësit*




*Tubacion i ujësjellësit i gjetur në lagjen Dunavat*

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

# L'ANCIEN AQUEDUC DE LA CITADELLE DE GJIROKASTËR

L'aqueduc qui a fourni d'eau la citadelle de Gjirokastër, pendant le haut Moyen-Age, est l'une des constructions les plus monumentales de cette ville, à cette époque-là. Au stade actuel des recherches et études sur les anciens aqueducs de notre pays, on peut dire que par la longueur, la complexité des solutions d'engineering et hydrauliques sur son axe, les constructions à caractère défensif etc., cet aqueduc est probablement le plus grand et le plus intéressant des aqueducs construits dans notre pays au cours de la période du Moyen-Age. Concernant l'époque de la construction de cet aqueduc, on ne dispose pas de sources documentaires précises. En nous basant sur les phases de construction de la citadelle, sur les sources orales attestées et sur d'autres arguments extraits de l'époque. Nous admettrons que cet aqueduc est construit à l'époque d'Ali Pacha Tepelena et précisément aux années 1811-1812.

A l'état actuel, cet aqueduc se trouve très endommagé. II n'en reste que quelques viaducs le long de son axe, un puits de contrôle et une tour défensive, des traces de colonnes du grand aqueduc près de la citadelle et quelque autre ruine, constituant des objets rendent possible son étude.

L'aqueduc de la citadelle de Gjirokastër, depuis sa source "Mema e Ujit" comme la dénomment les habitants au col de Sopot, au sud-ouest du village de Lazarat, jusqu'a son entrée, t'extrémité sud-ouest de la citadelle, atteint une longueur d'environ 12 km.

Nous avons essayé de tracer sur la carte à peu près exactement l'axe depuis la citadelle jusqu'à "Ura e Shesheve", tandis que l'intervalle, de là, jusqu'à la source, à défaut de traces, a été tracé approximativement.

Du point de vue technique, cet objet est assez réussi. Afin d'assurer un fonctionnement normal a l'aqueduc, entre la source et la citadelle, on avait construit sept viaducs en pierre à arcades, de différentes dimensions, selon la gorge du torrent ou de la rivière qui coupe l'axe de l'aqueduc. Depuis la source à la gorge du torrent de Pllashnjë qui sépare "Shulliri i Urës", du "Sheshi i Pllashnjës", la conduite d'eau de l'aqueduc passait sur le petit pont de Pllashnjë, aujourd'hui ruiné. Plus loin, à la gorge qui sépare "Kodra e Mesunit" de "Gropa e Lugut" la conduit d'eau passait sur un autre pont, celui de Mesun, également ruiné.

A la gorge entre deux hauteurs "Këmbët e Shesheve" et "Shulliri i Qivurit" se trouve un petit torrent, sec en été; où l'aqueduc passait sur un petit pont (Ura e Shesheve) a un seul arc, avec une espace de 5 mètres environ. Actuellement le pont est démoli.

Le viaduc de Karcaler (Saint-Nikolla), sur la rivière de Gjirokastër dont le cours passe à travers la montagne de "Lule" et de "Shulliri i Gjokanës", est le quatrième à partir de la source. Il est intéressant du point de vue de la composition et de fine construction.

Bien que à 'état actuel il se présente très endommagé, sa reconstruction imaginaire est tout à fait possible. Le viaduc avait été construit sur deux arcs, dont le plus grand passait au-dessus du lit de la rivière. II avait la forme d'un arc en plein cintre d'un diamètre de 7,5 m et d'une hauteur de 6,5 m au dessus du lit. La partie supérieure du pont, d'une largeur de 110 cm ne conserve aucune trace de la conduite d'eau.

Le cinquième pont, le plus proche de la ville, qui constitue l'une des constructions les plus intéressantes de

cet aqueduc, est celui d'Ali Pacha, construit sur la rivière de Manalat à la gorge qui sépare la hauteur "Hieja e Arapëve" du versant rocheux qui suit vers les habitations périphériques du quartier de Dunavat au bord de la rivière de Manalat, très raide envers son lit. Le pont d'Ali Pacha, comme l'appellent les autochtones de nos jours, est une construction monumental qui s'impose particulièrement par sa verticalité accentuée.

Au centre de la composition de ce viaduc d'une longueur d'à peu près de 40 m, se situe le grand arc en plein cintre qui repose sur les pentes rocheuses de la gorge de la rivière sans toucher à son lit, très étroit en cet endroit. L'arc mesure, du haut au lit de la rivière une hauteur de 19 m et a un espace de lumière de 13,7 m. Autrefois le canal passait sur la partie supérieure du pont, d'une logeur de 2,3 m. A l'heure actuelle le pont ne conserve aucune trace de la conduit d'eau de l'aqueduc, mais au côté droit du pont, sur le versant rocheux de la montagne il a été taillé un creux pour l'installation de la conduite d'eau.

Après avoir traversé le viaduc d 'Ali Pacha, la conduite d'eau suivait sur une centaine de mètres la pente rocheuse de la montagne, le long de la rive gauche de la rivière, puis s'introduisait dans le quartier de Dunavat.

Nous ne disposons pas de données sur le chemin que suivait l'aqueduc dans la partie sud - ouest du quartier de Dunavat, jusqu'au petit viaduc à un arc au centre de ce quartier, au dessus duquel passait la conduite d'eau de l'aqueduc.

Le viaduc de Dunavat comporte un arc en plein cintre ayant un espace de lumière de 36 m. Son arche est large de 45 m. Ayant quitté le pont, la conduite d'eau suivait l'abrupt versant rocheux de la gorge du torrent. A la proximité du pont, quelques mètres au déjà, sur le rocheux un mur d'appui d'environ 7 m de long avait été construit pour l'installation de la conduite d'eau. Plus loin, on rencontre les traces de l'aqueduc devant la porte extérieure de l'ex-habitation des Qeribash. La conduite d'eau se conserve encore sous les dalles de la cour de la maison. Dans cette habitation, qui se trouve tout près de l'extrémité sud-ouest de la citadelle, où terminait l'aqueduc se conservent des éléments d'intérêt.

A l'intérieur du mur d'enceinte qui entoure l'habitation se trouvent deux bâtiments liés en forme de "L", l'une en forme de manoir (celle d'au-dessus) de trois étages et l'autre, dans le voisinage de la citadelle de deux étages. Cette construction triangulaire a servi de tour fortifiée pour la défense de l'aqueduc. Le haut mur nord, qui donne sur la ville, comporte seulement deux fenêtres à l'étage supérieure, tandis que le rez-de-chaussée et le premier étage gardent encore les meurtrières qui semblent avoir été ouvertes pour défendre l'aqueduc, d'autant plus que dans cette habitation on avait construit aussi un puits de contrôle, afin de contrôler la conduite d'eau. Le puits se conserve encore, mais bloqué, dans le rez-de-chaussée du volume de deux étages, lié au manoir ci-dessus.

Le haut viaduc à deux rangées d'arcades, aujourd'hui complètement ruiné, qui se trouve le plus près de la citadelle, constitue la partie la plus intéressante de tout l'ancien aqueduc d'Ali Pacha Tepelena à Gjirokastër. Ce viaduc a été construit la cause de l'affaissement du terrain entre le group d'habitations s'élevant sur le rocher des Qeribash (puits de contrôle) et l'extrémité sud-ouest de la citadelle. Donc le pont reliait ces deux points qui sont presqu'à la même hauteur.

Cet aqueduc monumental est d'une composition architectonique assez réussi pour des objets de ce genre et d'une solution constructive très élégante, comme cela nous est présenté par Leake sur une gravure de la première moitié du XIX siècle. A l'heure actuelle, de cette construction exemplaire il ne reste que quelques fragments de murs des parties inférieures des colonnes. On aperçoit les traces de six colonnes. L'espace entre les colonnes est de 5-7 m.

L'eau potable, dans l'ancien aqueduc de Gjirokastër, circulait au moyen de tubes de grès. La source de l'eau et l'extrémité sud-ouest du château, n'ayant pas le même niveau une différence d'environ 1000 m, cette conduite d'eau travaillait à pression pleine. Des traces restées à "Ura e Shesheve" (un pont) au tiers du chemin près de la source, il résulte que le diamètre intérieur des tubes a été en moyenne de 140 mm, tandis que les conduites d'eau trouvées dans le quartier de Dunavat, donc près d'extrémité de l'aqueduc il résulte que le diamètre des tubes a été en moyenne de 110 mm.

De ce fait il s'ensuit que l'aqueduc avait été calculé avec précision prenant en considération même les pertes en longueur, a cause du frottage, ainsi que les pertes dues au terrain, aux tournants et aux endroits étroits, parce que, à

DO NOT COPY

cette époque-la, les tubes étaient produits à section variable, la partie la plus étroite étant à la sortie. Ces solutions hydrauliques réussies démontrent une fois de plus, que cet aqueduc a été construit par Ali Pacha, dans l'administration duquel ont travaillé des techniciens et des ingénieurs de différentes spécialités. Les tubes étaient liés en entrant l'un de l'autre, étant revêtus en cette partie d'une couche de mortier fait de chaux pure conditionnée. Ils atteignaient une longueur de 330-360 m. L'épaisseur des parois des tubes de grès, afin de pouvoir faire face à la pression de l'eau, était de 15 à 19 mm.

Afin de préserver le réseau de l'aqueduc des endommagements possibles, les tubes de céramique, étaient placés à une profondeur de 50-60 cm. L'eau ne s'introduisait pas dans la citadelle par le tour sud-ouest, mais il suivait sur quelques dizaines de mètres, la partie rocheuse au dessous du mur longitudinal de derrière. Plus loin, après un détour, elle entrait dans la citadelle, où on la conservait dans de grandes citernes et qu'on puisait au moyen de robinets.

Nous ne savons rien sur les maitres qui ont construit l'aqueduc. D'après différentes sources, il résulte qu'en cette époque-la, dans la région de Lunxheri, à savoir, les villages de Nakove, Dhoksat, Këllez, il y a eu des maitres connus dans la construction d'aqueducs, qui par leurs œuvres hydrauliques se sont fait connaître dans tout l'empire. Il est évident que ces maitres ont du participer à la construction de l'aqueduc de la citadelle de Gjirokastër, d'autant plus que cette construction, appartenant à leur spécialité, avait lieu dans le voisinage de leur région natale. Les puits et citernes multiples, ainsi que les aqueducs construits à Gjirokastër et dans la plaine de Dropull font preuve d'une large activité des maitres de Lunxhëri.

L'aqueduc d'Ali Pacha Tepelena, qui fournissait d'eau la citadelle de Gjirokastër, a une longueur considérable qui le place parmi les plus longs aqueducs. D'après la littérature, que nous avons pu consulter, concernant les aqueducs construits aux Balkans, au cours du Moyen-Age, à Tivar du Monténégro se conserve un aqueduc long de 1,5 km, construit au Moyen-Age au XVIII$^{ème}$ siècle. Son viaduc qui conduit l'eau à la citadelle est d'une longueur de 74 m. Du point de vue de la réalisation technique et de la variété des solutions fonctionnelles, il est aussi l'un des objets les plus réussis de son genre, qui fait revaloir assez la capacité et la maturité de nos maitres de constructions hydrauliques.

DO NOT COPY

Prof. dr. Emin RIZA

DO NOT COPY

# ARKITEKTURA DHE RESTAURIMI I BANESËS SË ZEKATËVE – GJIROKASTËR[1*]

Banesa gjirokastrite[2] tashmë konsiderohet si një tip i veçantë brenda tipologjisë së banesës popullore qytetare shqiptare[3]. Ndërmjet banesave të shumta gjirokastrite të tipit: kullë qytetare, që ruhet ende sot, ajo e Zekatëve (fig. 1) shquan jo vetëm për vlerat madhore arkitektonike, në kuptimin më të plotë të fjalës, por dhe për faktin se ajo ruan përgjithësisht mirë kompozimin origjinal dhe elementët e veçanta arkitektonike, duke qenë kështu një pikëmbështetje mjaft me rëndësi për tipologjinë dhe evolucionin e banesës gjitokastrite dhe më tej të mbarë banesës qytetare shqiptare. Këto konsiderata marrin një vlerë më konkrete dhe për faktin se kjo banesë mund të quhet përafërsisht e datuar, megjithëse fatkeqësisht mbishkrimi mbi kyçin e harkut të portës së jashme, nga juglindja, është dëmtuar pikërisht aty ku ishte daltuar data e ndërtimit (fig. 2). Për datimin e saj flet në radhë të parë kujtesa popullore, e cila e lidh ngritjen e saj me Ali Pashë Tepelenën, ashtu si dhe "sarajet" e Nelo Kabilit[4]. Dhe trajtimi arkitektonik i banesës flet në favor të këtyre të dhënave. Kështu që banesa e Zekatëve duhet të jetë ndërtuar rreth viteve 1811 – 1812.

Qëllimi i këtij artikulli është të japë arkitekturën e kësaj banese, që pa dyshim mund të mbahet si një nga arritjet më të shënuara të banesës gjirokastrite gjatë periudhës së saj klasike (1800 – 1830), si dhe punimet e restaurimit të kryera në të prej vitit 1968 – 1975.

Banesa e Zekatëve ngrihet në lagjen Palorto, që i vishet pjerrësisë së poshtme të Malit të Gjerë, zë pikën më të lartë në gjithë lagjen, duke siguruar kështu një pozitë sunduese mbi pjesën jugperëndimore të qytetit.

Banesa ka qenë rrethuar me mure me përjashtim të pjesës jugperëndimore, ku në gjendjen e sotme është veshtirë të gjykosh për shtrirjen e saj, megjithëse disa trakte ruhen. Si një rast mjaft të rrallë këtu ndeshim me tri oborre, (Tab. I), me përjashtim të kopshtit në verilindje të tyre, gjatë gjithë gjatësisë, i cili gjithashtu ka shenja rrethimi. Ekzistenca e dy oborreve është një shfaqje e njohur në shumë banesa gjirokastrite, atë e ka vënë re dhe Hani[5]. Rasti në shqyrtim nuk duhet konsideruar si një variant më vete. Ai shpjegohet me nevojën për dy hyrje, duke lehtësuar ndërlidhjen dhe me krahun e majtë (e djathta e vrojtuesit) të lagjes. Ndërtimi i një oborri të dytë, pranë atij të mirëfilltë, përpara banesës, përveç funksionit mbrojtës, duket se lidhet dhe me fanatizmin

---

[1] Rilevimi i monumentit është kryer nga autori dhe F. Zarshati, ndërsa vizatimet e artikullit nga F. Zarshati, fotot nga M. Kallfa, R. Veseli dhe autori.

[2] E. Riza, "Banesa e fortifikuar gjirokastrite", *Monumentet* 1, 1971; E. Riza, "L'habitation type Gjirokastrite" (XVIII - XIX). *Ethnographie albanaise*, Tiranë 1976.

[3] E. Riza, "Tipologjia e banesës qytetare shqiptare gjatë shek. XVIII deri rreth mesit të shek. XIX". *Studime historike* 3/1976.

[4] Dihet se Ali Pashë Tepelena e pushtoi qytetin më 1812 dhe menjëherë forcoi dhe zgjeroi kalanë e qytetit. Në lidhje me këtë Hani shkruan: "Aliu e shpejtoi kaq shumë ndërtimin e Kalasë së Gjirokastrës saqë kjo u mbarua brenda një viti e gjysmë, me gjithë pallatin e madh dhe shumë godina të tjera" (I.G. Hahn. *Albanesische Studien*, Jena 1852). Mendojmë se njëra prej godinave që përmend Hani është edhe ajo e Zekatëve. Me interes është të japim pjesërisht përmbajtjen e mbishkrimi të përmendur "...nuk ka levend veç Aliut dhe nuk ka shpatë më të fortë se Zylfikari". Zgjedhja pikërisht e këtij pasazhi, me një lëvdatë për shenjtin Ali, nuk është e rastit por lë të nënkuptohet Ali Pasha, duke përforcuar mendimin për datën e ndërtimit të banesës në vitet 1811- 1812.

[5] Hani shkruan: Të gjitha shtëpitë e mëdha muhamedane kanë dy oborre. (G. Hahn. *Vep. Cit.* 41.).



*Fig. 1*

në shtresat e pasura. Kështu, duke qenë se banesat e mëdha kishin gjithmonë një aneks që thirrej "odajashta" ku qëndronin miq të dorës së dytë, shërbyes e madje trima, dilte nevoja e veçimit të tij nga oborri kryesor përbri banesës.

Porta kryesore, nga jugu, tregonte se mbulohej me hark në pjesën e jashtme, në gurët formues të të cilit janë gdhendur motive dhe simbole të njohura të kohës. Porta tjetër e jashtme nga veriu, si dhe dy të brendshmet, që ndërlidhnin oborrin kryesor me ata anësorë, mbulohen gjithashtu me hark në ballin e tyre. Hapësira e dritës së tyre tregon qartë se mbylleshin me dy flegra dhe siguroheshin me katarah[6]. Porta që lidh oborrin e majtë me kopshtin është më e vogël dhe një flegërshe. Në oborrin e djathtë gjejmë dy ndërtime, i poshtmi i rrënuar deri në katin përdhe, ndërsa i sipërmi në gjendje të mirë. Ndërtimi i sipërm ka qenë "odajashta" e banesës, ndërsa i poshtmi, me kat, sipas dëshmish gojore ka shërbyer në katin përdhe: stallë, ndërsa sipër: depo bari. Këto janë ndërtimet e vetme ndihmëse.

Banesa është ndërtuar në terren të pjerrët, duke kushtëzuar kompozimin e njohur volumor me gjysmë kat. Kështu, të dy katet e fundit pësojnë një zgjerim planimetrik prapa, duke rritur sipërfaqen e ndërtimit në krahasim me katin përdhe, i cili në pjesën e prapme është në kontakt me tokën. Përveç kësaj pabarazie në sipërfaqen e banuar, ndërmjet kateve, terreni ka ushtruar një ndikim të dukshëm dhe mbi numrin e kateve të dy blloqeve kryesore të banesës. Kështu, blloku i majtë, duke shfrytëzuar rënien e terrenit, është më i lartë një kat më shumë se blloku i djathtë. Kjo pabarazi ndërmjet të dy blloqeve përfundon me fillimin e katit të banuar. Për t'u shënuar është dhe dalja përpara e bllokut të majtë, e cila kushtëzohet me nevojën për rritjen e sipërfaqes së ambientit të odës së miqve. Të tri dukuritë e mësipërme janë të njohura në mbarë banesën gjirokastrite, por pabarazia e numrit të kateve ndeshet relativisht më rrallë.

[6] "Katarah", një binar, i cili lëviz horizontalisht, i guiduar në dy kanale në mur. Shërben për të siguruar portën e jashtrne, derën e banesës dhe madje rrallë dhe ato të brendshmet.

DO NOT COPY

Në skemën planimetrike (Tab. II, III) banesa është e thjeshtë: një bërthamë ndërlidhëse në qendër dhe dy blloqe anash saj, ndërsa në të dy katet e sipërme shtohen prapa nga një ambient për secilin kat. Ambientet sanitare dalin anash blloqeve në formë kulle. Kështu, planimetria pëson mjaft thyerje, megjithëse ajo funksionalisht është e mbarë dhe e pastër. Për nga funksioni, ambientet mund t'i ndajmë në dy grupe: kryesore dhe ndihmëse. Në ato kryesoret përfshihen odat e banimit, pesë të tilla në të dy katet e sipërme. Ambientet ndihmëse: katoi, stera, qilari i zahiresë dhe ambientet e gatimit janë të vendosura, të parat në katin përdhe dhe gjysmëkatin, ndërsa të dytat në zgjerimin e planimetrisë në dy katet e sipërme. Pra, kemi një grupim të dallueshëm ndërmjet ambienteve me funksione të ndryshme, duke u siguruar ambienteve të banimit vendin më të mirë. Në lartësi kemi një diferencim të dallueshëm ndërmjet kateve, kështu kati përdhe dhe gjysmëkati janë të pabanuara, ndërsa dy katet e sipërme të banuara.

Por dhe vetë katet e banuara ndryshojnë ndërmjet tyre, kati i parë, është i lartë 2,80 m, në dallim nga kati i dytë me lartësi 3,40 m. Ky ndryshim i lartësisë, si dhe dritaret më të vogla dhe më të pakta të katit të parë, në krahasim me të dytin, shpjegohen me përdorimin e tyre përkatësisht në dimër dhe në verë, karakteristike kjo e mbarë varianteve të zhvilluar të banesës gjirokastrite. Në bërthamën qendrore ndërlidhëse, shkallët zhvillohen lirshëm duke ndjekur plotësisht apo pjesërisht të katër faqet e mureve të kësaj hapësire. Nëndivani, divani i gjysmëkatit dhe ai i poshtmi[7], janë volume të mbyllura me ndriçim të paktë, ndërsa çardaku dhe para tij ndërtimi karakteristik që thirret "kamerie"[8] janë të hapura dhe plot dritë.

Njësia themelore në kompozimin e banesës është "oda", ajo formulohet njëlloj nga ana kompozicionale, por trajtimi



*Fig. 2*

i saj në planin e elementëve të veçanta arkitektonike është e ndryshme në përputhje me funksionimin e çdo ambienti.

**Pati i vogël.** Quhet ambienti (Tab. III, IV) më i vogël i banimit të katit të parë. Ai ka një formë të theksuar drejtkëndëshe dhe ndahet në tri pjesë. Në pjesën fundore ndodhet volumi karakteristik musandër - dhipato[9]. Pjesa ballore dallohet sepse aty janë ndërtuar të gjitha dritaret, katër të ulta, në nivelin e dollapeve të murit, posaçërisht për të bërë të mundur soditjen nga to, duke qenë ulur mbi minder, ndërsa dy të sipërmet, në faqen e pamjes kryesore, të cilat janë fikse. Dritaret e poshtme mbrohen nga jashtë me hekura, ndërsa nga brenda me kapakë druri si dollapet e murit. Në pjesën qendrore të hapësirës së odës është ndërtuar oxhaku në murin e jashtëm. Volumi dhipato – musandër krijon në planin e poshtëm një parahyrje të vogël, prej së cilës kalohet në odë, ndërsa nëpërmjet një rrige në ambientin sanitar. Përbri rruginës, me ballë nga dhoma është ndërtuar musandra dhe kamare të vendosura vertikalisht. Dhipatoja e hapur kufizohet me hapësirën e odës me parmakllëk të lehtë. Si rast të rrallë gjejmë banjën me hipokaust, që ngrohet nëpërmjet oxhakut, më të madh se ai i ambienteve të tjera. Banja është në ndërlidhje të drejtpërdrejtë me odën. Kamare dhe dollape druri, si dhe sergjeni karakteristik, plotësojnë brendësinë e këtij

[7] Vendasit emërtojnë nëndivan hapësirën fill mbas hyrjes së vetme në banesë. Zakonisht banesa gjirokastrite është trekatëshe, kurse banesa e Zekatëve ka dhe një kat të improvizuar, i cili bën të kemi një hapësirë shtesë, atë që emërtuam: divan i gjysmëkatit. Hapësira mbi të emërtohet "divan i poshtëm", ndërsa çardaku emërtohet "divan i sipërm".

[8] Mbi emërtimin "kamerie" në Gjirokastër quhen tri forma të përafërta arkitektonike: një ndërtim i mbyllur përngjitur banesës, ose veças saj dhe një ndërtim i hapur përngjitur banesës. Të tria këto i bashkon përdorimi i qemerit për mbulesën e tyre, apo dhe ndarjen ndërmjet kateve, si dhe qenia e një tarrace që përfundon kamerien në lartësi. Siç duket termi kamerie vjen nga greqishtja e vjetër "kamara", që do të thotë qemer. Shih dhe E. Riza, "Banesa e fortifikuar gjirokastrite", *Monumentet*, 1/1971.

[9] "Dhipato", vendasit emërtojnë galerinë e hapur apo të mbyllur sipër musandrës. I njëjti element në Shqipërinë e mesme emërtohet "mafil" ndërsa në Shkodër "trapazan".

BOTIMI SOUY



*Fig. 3*



*Fig. 4*



*Fig. 5*

DO NOT COPY

ambienti, intimitetin dhe ngrohtësinë e të cilit e thekson lartësia e vogël dhe mungesa e tavanit (fig. 3), funksionin e të cilit e luajnë dërrasat e dyshemesë me paturë të ambientit mbi të. Trajtim thuajse të njëjtë ka dhe pati i madh. Ndryshimi qëndron në vendosjen e banjës, pa ngrohje, e cila nuk lidhet drejtpërdrejt me ambientin, por nëpërmjet rruginës pas musandrës.

Të dy ambientet e banimit mbi patin e vogël, kanë një zhvillim planimetrik dhe karakteristika disi të veçanta, për shkak të sipërfaqes së vogël ku vendosen, megjithëse ajo është rritur, duke përfshirë dhe atë ku tipologjikisht pritej të ndërtoheshin ambientet sanitare. Kështu, ambienti ballor që ka pësuar me kohë disa transformime, për mungesë sipërfaqeje, nuk ka kompleksin musandër – dhipato. Ky nuk i mungon ambientit përbri, një pjesë e të cilit i përket parahyrjes së ambientit ballor. Ndarja e të dy ambienteve është realizuar me një perde prej druri trajtuar me motivet e përdorura gjerësisht në dyer, musandra dhe dollape. Ambienti fundor e ka oxhakun në ballin kundrejt musandrës. Ai ka dy tavane, në dallim nga ambienti përbri duke theksuar kështu me qartë pjesën ballore nga ajo qendrore e ambientit.

**“Oda e mirë”** ose “oda e madhe” apo “oda e verës” është ambienti (Tab. III, V) më paraqitës i banesës, ku përkujdesja për një trajtim sa më të përpunuar në formulimin dekorativ, e shkëput atë qartazi nga ambientet e tjera. Ky ambient zë një sipërfaqe prej 48m$^2$. Në të, ndarja e pjesës ballore nga pjesë qendrore është shumë e qartë, nëpërmjet tavaneve të veçanta të tyre. Pjesa ballore zë një sipërfaqe prej 15 m$^2$, ajo qendrore 24,30 m$^2$ ndërsa kompleksi fundor 8,7 m$^2$. Pjesa ballore emërtohet “qoshk”; ajo shquan për ndriçimin e bollshëm që arrihet me dritaret e shumta, mjaft të ulëta, për të siguruar soditjen ndenjurazi. Të gjitha dritaret janë dyfish në lartësi. Gjerësia më e madhe e këtij ambienti, në krahasim me të tjerët ka lejuar që anash musandrës të



*Fig. 6*

vendosen dy kolona me kamare dhe pranë tyre dy hyrjet, njëra për në ambientet sanitare (banjë, WC), tjetra, nëpërmjet parahyrjes, për në çardak. Përmasat dhe formulimi i flegrave të dollapëve është i njëjtë me ato të kapakëve të dritareve. Karakteristikë e këtij ambienti janë dekoracionet murale (fig. 4) që veshin të gjitha faqet e mureve mbi nivelin e sergjeneve. Gjithashtu duken gjurmë dekoracioni dhe mbi sipërfaqen e mureve, brenda volumit të dhipatos duke provuar se ajo ka qenë e hapur. Gjithashtu me dekoracione mbulohen rozetat e tavaneve, bordurat që rrethojnë fushën e tij, sergjenet, kornizat e dollapëve dhe të gjithë elementët prej druri në ballin nën dhipato. Oxhaku dekorativ (fig. 5) (ai nuk përdoret asnjëherë) me tambur të komplikuar, gjithashtu të dekoruar, plotëson dhe i shton odës së madhe pompozitetin. Karakteri i barokut të vonë, që shquan këtë ornamentikë, i jep këtij ambienti tipare të veçanta.

**Ambientet ndërlidhëse.** Këto zënë pjesën qendrore të kompozimit. Sipërfaqja e tyre relativisht e vogël si dhe rrymat e kalimit për në ambientet e blloqeve anësore dhe ato fundore, i bëjnë ata të kenë vetëm funksione ndërlidhëse. Shkallët e rënda prej guri, (Tab. III) të zgjidhura me qemerë, gjithashtu kanë bërë që sipërfaqet të zvogëlohen. Nëndivani, thuajse i errët, e ka, ashtu si dhe dy divanet mbi të, hapësirën të copëtuar për shkak të sistemit kolonë – hark – qemer, që mban rampën e fundit të shkallëve. Veçuar kësaj hapësire,



*Fig. 7*

duke zbritur, kalohet në vendmarrjen e ujit nga sterna. Dy qemerët e rampës së dytë dhe të tretë, janë pjesë e volumit të nëndivanit. Divani i gjysmë katit dhe ai i patit janë të thjeshta. Një lloj musandre e hapur që thirret "tahtaposh" është ndërtuar mbi një pjesë të rampës së dytë të shkallëve. Rampa e fundit të çon në çardak, hapësira e saj mbetet e kufizuar dhe brenda volumit të çardakut, nëpërmjet dy rreshta kolonash druri që lidhen me harqe në pjesën e sipërme (fig. 6), duke formuar kështu një çift arkadash. Përpara kësaj hapësire shtrihet sipërfaqja e kameries, me "nerohitin"[10], në të majtë, mbrojtur nga një parapet guri. Vetë çardaku, me sipërfaqe të pastër, ka tavan dhe shenjat e një qoshku, mbi një pjesë të hapësirës ndërmjet arkadave.

[10] "Nerohiti" apo "sqolli", siç thirret i njëjti element në veri të vendit, është një lloj lugu prej guri, me dalje jashtë muraturës, ku lirisht mund të derdhen ujëra.

DO NOT COPY



*Fig. 8*



*Fig. 9*

Kamerieja (fig. 7), e cila është e variantit të hapur, përngjitur banesës, ashtu si gjithmonë është një plan me çardakun. Ajo, si të gjithë kamerietë e hapura duke se është një rudiment i kamerieve të mbyllura me qëllime mbrojtëse. Sidoqoftë funksioni i tarracës si vend qëndrimi, gjatë stinëve të ngrohta është i padyshimtë dhe nerohiti dëshmon për këtë. Qenia e çardakut e bën disi të tepërt këtë sipërfaqe të hapur, megjithatë fakti se ai është copëtuar nga rrymat e kalimit e justifikon këtë ndërtim, i cili në rastin e dhënë luan dhe funksione të dallueshme në kompozimin arkitektonik të pamjes kryesore. E mbrojtur mirë nga dy blloqet anësore dhe parapeti, ajo është një sipërfaqe shumë e dobishme, nga e cila ke çfarë të soditësh.

**Qilari i zahiresë.** Është një ambient i zakonshëm në banesat e mëdha gjirokastrite. Në shembullin tonë ai zë volumin e gjysmë katit, mbi sterën, duke siguruar kështu mjaft freski dhe për faktin se ndriçohet nga dy dritare shumë të vogla. Një podium i ulët prej guri qarkon këtë ambient, me përjashtim të pjesës fundore. Ai shërben për vendosjen e qypave apo kadeve me rezervat ushqimore. Shkallë të brendshme ndërlidhin këtë ambient me një volum të errët, me planin e sterës, i cili duket se është sajuar për të mos rritur tejmase volumin e saj.

**Stera.** Zë volumin më të ulët të banesës, ajo është në një pjesë të mirë nën dhé, siç duket për të balancuar një pjesë të presionit të ujit. Ky rezervuar mbledh një volum të madh uji, nëpërmjet një sistemi ulluqesh që grumbullon ujërat e shiut nga pjesa e strehëve mbi kamerie (fig. 8). Stera mbulohet me qemer. Një dritare e vogël shërben si vend kalimi për pastrimin e saj vjetor. Ajo ka dy vende marrje uji, nga brenda dhe nga jashtë, në oborrin anësor, një tub në drejtim të nivelit maksimal të mbushjes, derdh ujërat e tepërta, duke lajmëruar mbushjen e sternës që detyron shkëputjen e tubit furnizues në kamerie.

**Katoi.** Banesa ka një të tillë, mjaft të lartë, siç duket për të arritur në nivelin e gjysmëkatit, në mënyrë që të dy katet e banuara të jenë në të njëjtën lartësi. Ai mbulohet me qemer. Një dritare e vogël, ndërtuar shumë lart, mezi lejon të hyjë pak dritë. Dera e vetme sigurohet me katarah, kjo të sugjeron ekzistencën e një komunikimi të brendshëm me ambientin mbi të dhe vërtet në njërin skaj fundor në qemer është lënë një hapësirë 75 x 55 m, e cila bie në rruginën e patit të vogël që të çon në WC.

**Ambientet e gatimit.** Në gjendjen e sotme ato janë krejt të shkatërruara, prej tyre ruhen vetëm gjurmët e muraturës së ambientit të poshtëm (fig. 9), shtruar me pllakë guri si dhe "gjirma"[11] e zjarrit. Nga thembra që ruhet, duket qartë se një qemer me formuese verilindje -jugperëndim e mbulonte atë. Në murin verilindor ruhen dy frengji si dhe vendderdhja e ujërave të zeza, që presupozon ekzistencën

[11] "Gjirm", emërtohet nga vendasit vatra e zjarrit.

DO NOT COPY

e një ambienti sanitar që u shërbente të dy ambienteve të bllokut të djathtë. Nga ambienti i sipërm nuk ruhet asgjë. Shkëputja e plotë e ambienteve të gatimit nga pjesa tjetër e banesës është një zgjidhje funksionale e përhapur në banesa të mëdha gjirokastrite, në dallim nga variantet e thjeshta ku njëri prej ambienteve të banimit shërbente dhe për gatim. Ekzistenca e dy ambienteve të tilla lidhet me faktin se gjatë dimrit banimi shpërngulej në katin e parë, ndërsa gjatë verës në katin e dytë.

Diferencimi funksional i ambienteve të ndryshme dhe madje dhe i atyre të banimit ndërmjet tyre, që shprehet në trajtimin jo të barabartë të brendësisë, gjen shprehjen dhe në një larmi formash dhe trajtimesh të elementëve të veçanta arkitektonike.

Në përputhje me funksionin dhe ambientin ku bëjnë pjesë elementët e veçanta arkitektonike, brenda trajtimit në përgjithësi të njëjtë, kanë dallime, që më tepër i përkasin formës dhe shkollës se përpunimit estetik.

**Portat dhe dyert**. Nga flegrat e portave të oborrit nuk ruhej asnjë para punimeve të restaurimit. Porta e vetme e banesës njëflegërshe, mbulohet me hark pak të thelluar në vazhdim të poturave me të njëjtën trashësi me të, ndërsa më tej me arkitra. Ajo sigurohet me katarah. Të gjitha dyert e tjera të banesës janë njëflegërshe (Tab. IV, fig. 10) të punuara me dru arre apo gështenje. Ato të katit përdhe, të gjysmëkatit dhe atij të parë në ballë mbulohen gjithashtu me hark të thelluar, në dallim nga ato të katit të dytë që mbulohen në gjithë hapësirën me arkitra. Por dhe këto dyer në kreun e tyre kanë të sajuar me dërrasë një lloj harku. Vetë flegrat e dyerve formohen nga dërrasa të puthitura me poture, që lidhen në tre apo katër binarë, me gozhdë kovaçi me kokë në formë pafte rrethore. Vetëm flegrat e derës së odës së miqve trajtohen ndryshe, me copëra katrore dhe katërkëndëshe kënddrejtë të kllaposura me pjesët e tjera dhe gjithashtu të përforcuara me katër binarë. Të gjitha dyert kanë pragje dhe nga jashtë vishen me façatura. Karakteristikë është sigurimi i të gjitha dyerve me katarah, rast ky relativisht i rrallë.

Dyert anash musandrave janë më të lehta, ato janë të thjeshta në të gjitha ambientet e banimit, me përjashtim të odës së miqve ku trajtohen me të njëjtën teknikë si të derës së tij.

DO NOT COPY



*Fig. 10*



*Fig. 11*



*Fig. 12*

DO NOT COPY

**Dritaret.** Për nga madhësia ato ndryshojnë simbas ambienteve, (fig. 11) duke qenë relativisht të vogla e të pakta në katin përdhe e duke u rritur e shtuar drejt atij të sipërm. Për nga forma, gjejmë dritare në formë frëngjie (2 të tilla që ndriçojnë nëndivanin, këtu mund të përfshijmë dhe dy dritaret e banjës, nga jashtë në formë rrethore), dritare të mbuluara nga jashtë me hark (të gjitha dritaret e katit përdhe, gjysmëkatit dhe atij të parë) dhe të mbuluara me arkitra, dritaret prej allçie dhe ato të katit të dytë. Mbulesa e dritareve të katit të dytë me arkitra, përputhet me të njëjtën zgjidhje konstruktive të dyerve, në dallim nga ato të kateve të mëposhtme, ku të dy këto elementë mbulohen nga jashtë me hark. Nga mënyra e sigurimit dhe mbylljes mund të grupohen: në dritare me rrjetë hekuri nga jashtë dhe kaçakë druri në të njëjtën kasë (stera, gjysmë kati dhe ambientet ndërlidhëse), rrjetë hekuri nga jashtë dhe kapakë druri në faqen e brendshme të muraturës (ambientet e katit të parë). Në këtë grup përfshihen dhe ato me kafaz druri nga jashtë dhe kapakë nga brenda (ambientet e katit të dytë, përveç dritareve të ballit) si dhe ato me kafaz druri dhe kapakë nga jashtë (balli i odës së miqve). Në grupin e dytë përfshihen tri dritaret e ambientit ballor mbi patin e vogël. Ato i përkasin një faze të dytë dhe duke filluar nga jashtë kanë hekura persiane, telajo me xhama dhe qepena druri, të tre të fundit të guiduara për të lëvizur vertikalisht. Ndërsa në grupin e tretë përfshihen dritaret fikse prej allçie në ambientet e katit të dytë dhe ballin e dy ambienteve të katit të parë.

**Tavanet dhe dyshemetë.** Tavanët, shtatë të tilla, kanë qenë ndërtuar vetëm në katin e dytë, në të gjitha ambientet duke përfshirë dhe çardakun. Për sa i përket skemës





*Fig. 13*



*Fig. 14*



*Fig. 15*

DO NOT COPY

kompozicionale, ato paraqesin të njëjtën zgjidhje me variante të ndryshme të rozetës, në përputhje me funksionin e çdo ambienti apo pjese të tij. Një bordurë e gjerë tetëkëndëshe (fig. 12) kufizon fushën më të thelluar, në qendër të së cilës vendoset rozeta, gjithashtu tetëkëndëshe, apo në formë katrori (ambienti fundor i krahut të djathtë). Motivi i vetëm i rozetave (fig. 13), është një rreth, në qendër të të cilit qëndron një i dytë mjaft më i vogël, hapësira ndërmjet tyre ndërpritet në mënyrë radiale me copëra katërkëndësh – kënddrejtë (tetë, dhjetë apo dymbëdhjetë të tilla simbas madhësisë së rrethit) që përfundojnë në rrethin qendror në formë pyke. Ky motiv herë është i vetëm, dhe herë rrethohet me tetë sektorë me të njëjtin motiv (fig. 14) apo me tetë rrathë më të vegjël e pastaj me tetë sektorë rrethi (fig. 15) me të njëjtën rreze. Tavanet e odës së miqve në dallim nga të tjerat, janë të pikturuara me të njëjtat motive floreale, si dhe muret e këtij ambienti, duke qenë kështu në harmoni të plotë me to, në dobi të unitetit stilistik. Disa bordura të holla që injorojnë tetëkëndëshat karakteristike, janë të daltuara lehtë, duke mos lënë ndonjë përshtypje, për shkak të mbisundimit të pikturës që i jep tonin karakteristik tavanit. Tavane me motiv të tillë takohen rrallë gjithashtu në Berat dhe Shkodër nga fundi i shek. XVIII deri nga fillimi i shek. XIX.

Në dallim nga kati i dytë, ambientet e katit të parë nuk kanë tavane. Këtë funksion e kryejnë dërrasat e dyshemesë së katit të dytë, të lidhura me pature mbi trarët e dyshemesë. Dyshemetë mbërthehen me gozhdë kovaçi. Ambientet mbi qemerë, shkeljet e shkallëve dhe nëndivani janë shtruat me pllaka guri të zi.



*Fig. 16*

**Kamaret dhe dollapet** në mur. Mungesa e mobiljeve, ka influencuar drejtpërdrejtë në përpjekjen e mjeshtrit popullor për të krijuar sa më shumë orendi fikse, pjesë përbërëse të konstruksionit të banesës, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në formulimin arkitektonik të brendësisë. Ato janë hapësira të hapura apo të mbyllura. Në të parat bëjnë pjesë kamaret, në muret kryesore dhe në krah të musandrës vendosur vertikalisht njëra mbas tjetrës. Kamaret në muraturë mbulohen gjithmonë me qemer, ato i gjejmë jo vetëm në brendësi të odave por edhe në ambientet ndërlidhëse, madje dhe në muret rrethuese të banesës. Dollapet me dy flegra dhe në disa raste me një kamare, në pjesën e sipërme, janë të përpunuara thjeshtë, apo me elementë katrorë dhe katërkëndësh kënddrejtë (fig. 16) të bashkuar me teknikën e kllaposje.

**Oxhakët.** Të gjitha ambientet e banimit si dhe ato të gatimit (simbas gjurmëve që ruhen nga rrënjët dhe të dhënat gojore) kanë pasur oxhakë. Këta mund të grupohen në dy lloje, oxhakë funksionalë dhe dekorativë. Në grupin e dytë bën pjesë oxhaku i odës së miqve (fig. 5) dhe i ambientit ballor të bllokut të djathtë, ndërsa të tjerët janë funksionalë. Të dy llojet kanë anash tyre dy kamaret karakteristike dhe vatrën e zjarrit, të ngritur nga niveli i dyshemesë. Shembull përfaqësues i oxhakëve funksionalë (fig. 17) është ai i patit të vogël, i cili i shërben dhe hipokaustit të banjës. Tamburi i oxhakut, ashtu si dhe të tjerët e këtij grupi, formohet nga bashkimi i një gjysme cilindri me një gjysmë koni, të ndarë me një dalje në formë bordure. Ndërsa oxhaku dekorativ i odës së miqve, i cili nuk ka tymar mbi çati dhe nuk përdoret, ka një tambur me volume më të komplikuar, me bazë një gjysmë prizmi. Trajtimi dekorativ, arrihet me teknikën stukreliev si në pjesën e sipërme të tamburit ashtu dhe në një bordurë të valëzuar, që qarkon pjesën e sipërme të tij. E gjithë sipërfaqja e oxhakut është e pikturuar. Karakteristikë e këtij oxhaku ka qenë dhe zbukurimi i pjesës që vjen fill mbas zvogëlimit të tamburit poligonal, me modelim frutash të llojeve të ndryshme (në gjendjen e sotme të shkatërruara).

DO NOT COPY

### MATERIALET DHE TEKNIKA E NDËRTIMIT

Ashtu si mbarë banesat gjirokastrite dhe për banesën e Zekatëve materialet kryesore ndërtimore janë guri dhe druri. Me gurë është ndërtuar muratura, konstruksionet mbajtëse me qemerë, shtresat e shumë ambienteve dhe mbulimi i çatisë. Druri, gjithashtu, zë një vend të rëndësishëm, duke u përdorur gjerësisht në brendësi. Ai është i llojeve të ndryshme në përputhje me funksionimin e çdo elementi, kështu në banesë gjejmë dru bredhi, lisi, gështenje, arre dhe plepi.

Muratura siç përmendëm, është ndërtuar me muri guri, lidhur me breza lisi çdo 80 – 100 m me dimensione 5x5 dhe tërthor lidhen me binarë. Në qoshe brezat përforcohen me një binar. Nga jashtë, deri në fillim të katit të fundit, brezat janë maskuar, kurse vetëm në katin e fundit të blloqeve anësore ato dalin në faqen e jashtme, duke qenë të siguruara nga reshjet për shkak të strehëve. Brezat e drurit shpesh bien dhe në hapësirën e dritareve. Muratura e katit përdhe është punuar me llaç gëlqereje, ndërsa duke u ngritur lart, ai pakësohet ndjeshëm në faqen e brendshme duke u përdorur vetëm në faqen e jashtme. Kjo nuk dëmton qëndrueshmërinë e mureve, për shkak se guri është shtresor. Trashësia e murit vjen e ngushtohet për çdo kat nga brenda.

Muratura me skelet druri është përdorur vetëm në dy ballët e ambienteve të katit të fundit. Oda e miqve e ruan këtë teknikë në gjendjen origjinale. Skeleti i drurit mbulohet me gurë në hapësirat kuadratike, ndërsa balli i odës tjetër është ndërtuar me teknikën e njohur të çatmasë.

Një përdorim të gjerë kanë gjetur në banesë kolonat e sidomos qemerët dhe harqet prej guri. Këto të fundit (fig. 18) në nivelin e thembrës së tyre, pajisen me tirante druri 8x9 m çdo 60 – 80 cm, të cilët mbërthehen me gozhdë kovaçi (ashtu si të gjitha elementët e drurit), në brezat lidhës të muraturës. Arkitrarët mbulohen në faqen e brendshme me binarë. Kur hapësira është e madhe, vendosen dhe dy rreshta të tillë, ndërsa frëngjitë dhe dritaret në këtë formë, mbulohen pjesërisht me gurë dhe pjesërisht me binarë.

Çatia është transformuar rëndë duke mos mbetur asgjë origjinale, përveç strehëve. Këto i gjejmë katër llojesh: strehë guri, strehë druri, në formë konsoli, strehë druri me testekë[12] të gjatë. Suvatimet janë dy llojesh, me llaç balte



*Fig. 17*



*Fig. 18*

në dy shtresa (nëndivan) dhe llaç gëlqereje me dy shtresa (oda e miqve), dora e parë me përzieje kashte, ndërsa dora e dytë me përzierje leshi.

Në morfologjinë e banesës gjirokastritem banesa e Zekatëve u përket varianteve të zhvilluara. Ajo është e variantit me dy krahë dhe bën pjesë nën nënvariantin e thjeshtë. E

[12] "Testekë", emërtohen pajantat që mbajnë strehët. Përdorimi i testekëve të gjatë kushtëzohet prej faktit se muratura përbri tyre është me skelet druri dhe si e tillë nuk mund të mbajë shtytjen që i japin testekët.

DO NOT COPY

ruajtur thuajse në gjendjen origjinale, përpos dëmtimeve më tepër të karakterit teknik, ajo është një pikë referimi me shumë vlerë për karakterin dhe formulimet arkitektoniko – konstruktive të banesës gjirokastrite. Banesa e Zekatëve ka një kompozim planimetrik të thjeshtë, dy njësitë tipike të krahëve, që përbëjnë bërthamën kompozicionale të mbarë banesës gjirokastrite, ndërlidhen në mes tyre me sipërfaqen qendrore, që për vetë përmasat dhe elementet komunikuese në lartësi që bartin, mbesin sipërfaqe të mirëfillta ndërlidhëse. Kompozimi i ambienteve është i diferencuar simbas funksioneve, madje dhe në lartësi banesa ka një ndarje të dallueshme: kati përdhe dhe gjysmëkati i pabanuar, kati i parë i shfrytëzueshëm për dimër dhe ai i fundit kryesisht për verë. Diferenca në lartësi e kateve të banuara dhe ndryshimi i sipërfaqeve të ndriçimit shpreh qartë synimin për ta bërë të ngrohtë katin e parë. Kompozimi i vetë ambienteve të banimit është i njëllojtë, por ato ndryshojnë nga përmasat dhe për më tepër nga trajtimi i brendshëm, i cili, megjithëse në përgjithësi ka të njëjtën frymë, diferencohet për sa i përket përkujdesjes në trajtimi dekorativ. Nga trajtimi pothuaj unikal i brendësisë të ambienteve të banuara shkëputet qartazi oda e miqve, e cila ka një frymë krejt tjetër, ku dekori i mbingarkuar e bën atë të qëndrojë si një vlerë në vetvete, mjaft e shkëputur nga ambientet e tjera të banesës. Thjeshtësia dhe qartësia kompozicionale shquhen qartë në këtë banesë. Në volumin qendror, një rol me rëndësi në formulimin e brendësisë, luajnë sistemet e qemerëve dhe të harqeve (fig. 19) që me konstruksionin e tyre i japin një karakter të theksuar monumental kësaj hapësire, në dallim nga ajo e brendësisë së ambienteve, ku elementët e drurit kanë bërë që ngrohtësia dhe intimiteti t'i karakterizojnë ato. Por dhe ndërmjet kateve, të poshtëm dhe atij të sipërm, kemi një dallim për sa i përket trajtimit.

Në të poshtmit, konstruksioni i ndërtimit lexohet qartë, ai rrallë maskohet, fshihet dhe vlera estetike e tyre qëndron jo në përpunimin e elementëve të veçantë, por në raportin e volumeve në thyerjet e tyre nga elementët konstruktiv, siç flasin shumë qartë: nëndivani i gjysmëkatit dhe ai i katit. Në katin e sipërm kemi përkujdesje për veshjen e faqeve formuese të volumeve, mjaft të përmendim këtu tavanet. Në katet e poshtëm të bëjnë për vete proporcionet dhe teknika e veprës, ndërsa në të sipërmit dekori të tërheq më shumë vëmendjen, megjithëse ai është i lidhur organikisht me arkitekturën.



*Fig. 19*

Kompozimi në pamjen e parë duket se është simetrik, por një shqyrtim i vëmendshëm i tij, tregon qartë se simetria nuk ka qenë një synim për t'u arritur me çdo kusht, ajo është kuptuar në mënyrë shumë të lirë, pa u bërë aspak pengesë për thyerjen e dallueshme të saj jo vetëm në plan por dhe në volum. Ky zhvillim i kompozimit shihet qartë në thyerjet e shumta, megjithëse në forma të pastra të kontureve dhe në zhvillimin e pabarabartë të numrit të kateve të të dy blloqeve themelore të ndërtimit. Shkak për këto janë jo vetëm arsye të tilla si synimi i kuptueshëm për të shkëputur volumet e ambienteve sanitare nga ato të ambienteve të banimit dhe i zmadhimit të volumeve të ambienteve të bllokut të majtë, për

DO NOT COPY

shkak të odës së miqve, por dhe ndikimi i dukshëm që ka ushtruar trualli i aksidentuar. Kjo shihet shumë qartë në të dy katet e fundit, ku pabarazia e truallit ka mundësuar zgjerimin e planimetrisë prapa.

Kompozimi ka një zhvillim të dallueshëm në lartësi duke qenë çdo kat me një numër relativisht të paktë ambientesh. Ky kompozim volumor theksohet dhe më tepër nga jashtë me thyerjet e volumeve, duke marrë krejt ndërtimi një hedhje të dallueshme, që përbën shkakun kryesore të karakterit monumental të veprës. Një karakteristikë me rëndësi në kompozimin e brendësisë është pasuria e orendive të palëvizshme, pjesë përbërëse e trajtimit arkitektonik të ambienteve. Musandrat, dhipatot, dollapët dhe kamaret i gjejmë mjaft të përdorura, ato ndërtohen në volumet më pak të shfrytëzueshme, apo trashësitë relativisht të mëdha të mureve.

Trajtimi i jashtëm arkitektonik i banesës i përgjigjet mirë dhe diferencimit funksional të kateve, madhe dhe trajtimi i pamjes kryesore me një përkujdesje shumë më të madhe se ai i pamjeve të tjera, duhet shpjeguar me vendin kryesor që zë në kompozimin e odës balli i saj. pamja kryesore (Tab. II) formohet nga tri komponentë, dy blloqet anësore dhe ai qendrori pasi volumet e ambienteve sanitare, mjaft të larguara, nuk punojnë me ato. Blloqet anësore me trajtim të njëjtë, por në plane të ndryshme, lidhen shumë mirë me dy qemerë që mbështeten mbi një kolonë të lartë. Në sfondin e kësaj hapësire, shquan lehtë masa e muraturës me të njëjtin trajtim si ato të blloqeve anësore. Kjo shkëputje, vazhdon edhe me e theksuar në katin e fundit, ku kamerieja është e pa mbuluar. Ky grupim i tre pjesëve kryesore të kompozimit, në pamjen kryesore, nuk e copëton këtë të fundit, trajtimi i tyre arkitektonik jep shumë për gjallërimin e pamjes kryesore dhe për theksimin e vertikalitetit pa dëmtuar unitetin. Por dhe në lartësi kemi një ndarje të dallueshme nga një kornizë karakteristike guri, në nivelin e dyshemesë së katit të fundit, pikërisht atje ku mbaron muri masiv prej guri. Pjesa e poshtme, e pasuvatuar, e ashpër dhe monumentale, që vjen e thyhet në mënyrë ritmike nga dritare të harkuara, që shtohen e zmadhohen duke iu afruar kornizës, është në kontrast me të sipërmen, me dritaret e shumta në ballët anësore dhe çardakun e pjesës qendrore. Bardhësia vezulluese e gëlqeres shton dhe më tepër këtë ndryshim të theksuar trajtimi. Nga kati përdhe i ashpër dhe monumental tek i fundit, kalohet me ritëm të ekuilibruar deri tek korniza karakteristike, për të pasur pastaj një shpërthim të vrullshëm në dobi të transparencës dhe lirizmit. Për këtë kontribuojnë dhe strehët e gjera, të mbajtura plot elegancë nga testekët e gjatë. Pamjet anësore janë trajtuar me të njëjtën gjuhë arkitektonike si katet e poshtme, dritaret e qoshkeve të ambienteve të banimit, që dalin anash, nuk ua tjetërsojnë dot ftohtësinë dhe lakonizmin këtyre pamjeve, që në volum nxjerrin edhe më shumë në pah trajtimin e veçantë të pamjes kryesore. Banesa e Zekatëve, me proporcionet e gjetura, karakterin e theksuar monumental dhe lidhjen e goditur me truallin, është një kulm, i cili vjen i natyrshëm pas asaj përvoje të pasur, që kishte fituar mjeshtri popullor me ndërlikimet e këtij tipi.

Në karakterizimin e kësaj banese nuk mund të lihet pa u theksuar dhe një tipar i qenësishëm i saj, karakteri mbrojtës, i cili madje shpjegon dhe mjaft probleme. Synimi për të bërë banesën dhe një strehë të sigurtë nga çdo mësymje, ka qenë në të njëjtin plan, në mos më kryesori, krahas kërkesave të tjera lidhur me komoditetin. Këtë e shohim që te muret rrethuese dhe oborret e njëpasnjëshme, por më qartë në vetë kompozimin e banesës dhe karakterin e saj. Kompozimi i theksuar vertikal është një shenjë e qartë e synimit për t'i vendosur ambientet e banimit në kondita më të sigurta, duke mos kompromentuar nevojat e tyre për ndriçim. Banesa me gjithë çardakun dhe kamerienë e katit të sipërm, është mbyllur mbasi ato janë shumë lart, nuk luajnë rol të rëndësishëm funksional dhe së fundi janë të mbrojtura shumë mirë nga dy blloqet anësore. Shumë kuptimplotë është trajtimi i dritareve të ambienteve ndërlidhëse (fig. 20), të cilat barabar kërkojnë ndriçim, por për arsye thjesht mbrojtëse, nëndivani ndriçohej vetëm nga një dritare e vogël, e lartë në drejtim të vendit të marrjes së ujit, e mbrojtur me hekura dhe dy hapësira në formë frëngjie. Divani i gjysmëkatit, më i ngritur nga toka, pra më i sigurt, ka dritare më të mëdha, që mbrohen me hekura në seksion më të vogël. Trajtimi i muraturës së pjesës së prapme të banesës thuajse të shurdhët, gjithashtu tregon përkujdesjen për mbrojtje, por elementi më tipik që tregon sheshit karakterin fortesë të banesës janë frëngjitë për qitje me armë zjarri. Ato janë të formës së njohur pykë në plan dhe rrahin të mbikëqyrin dy hyrjet për në oborrin qendror si dhe portën e banesës (fig. 21), gjithashtu të tilla ndeshim në murin fundor të banesës për të kontrolluar pjesën e prapme të saj, praktikisht më të dobëtën. Banesa e Zekatëve është një shembull tipik i banesës gjirokastrite jo vetëm në mbarështrimin kompozicional por dhe për sa i

DO NOT COPY



*Fig. 20*



*Fig. 21*

DO NOT COPY

përket natyrës së saj mbrojtëse, duke mbajtur shumë mirë emërtimin: "Kullë qytetare".

Restaurimi[13]. Banesa e Zekatëve në pragun e fillimit të punimeve restauruese paraqitej me dëmtime të shumta në strukturën e mureve mbajtëse dhe sidomos në konstruksionin e çatisë. Mjaft elementë të veçanta arkitektonike kishin humbur pjesërisht apo plotësisht, ndërsa një pjesë ishin në prag të degradimit të plotë fizik. Kjo gjendje bëri të domosdoshëm restaurimin e këtij monumenti, i cili do të kishte si qëllim konsolidimin e veprës nga ana statike dhe ritrajtimin e elementëve të ndryshme arkitektonike në përputhje me gradën e dëmtimit. Dokumentacioni i grumbulluar gjatë studimit të monumentit, analiza e imët e gjendjes së tij teknike, pozita e kësaj banese në raport me simotrat e saj nga ana e trajtimit arkitektonik në përgjithësi, krijuan kushtet që projekti i restaurimit të arrinte në zgjidhje të drejta, në përputhje me kriteret e shëndosha të vlerësimit që e shohin monumentin arkitektonik në unitetin vepër arti – dokument historik.

Nga studimi i monumentit u konstatua se banesa në strukturën e saj planimetrike nuk ka pësuar ndonjë ndryshim me rëndësi, me përjashtim të disa ndarjeve të lehta në patin e madh. I vetmi ndryshim, apo më saktë dëmtim, që ka prekur kompozimin e banesës, është shkatërrimi thuajse i plotë për shkaqe të panjohura i dy ambienteve të gatimit. Pastrimet në këtë pjesë nxorën në dritë dyshemenë e ambientit të katit të parashtruar me pllaka guri, vatrën dhe një trakt të murit juglindor. Gjatë pastrimit dolën qartë

[13] Projekti i restaurimit u hartua nga autori i artikullit, ndërsa punimet e kryen nga Atelieja e Gjirokastrës gjatë viteve 1967 – 1975. Më parë se kjo banesë të vihej në mbrojtje janë rindërtuar muri fundor i saj dhe blloku i majtë i ambienteve sanitare.

gjurmët që tregonin se ambienti i poshtëm i gatimit mbulohej me qemer guri, me formuese juglindje – veriperëndim. Përpos këtij dëmtimi, banesës i është bërë një rikonstruksion në ballin e odës së krahut të djathtë në katin e sipërm, i cili ka qenë më parë i njëllojtë me atë të odës së miqve. Sipas të dhënave gojore ky ndryshim i përket fillimit të shek. XX.

Për hartimin e projektit të restaurimit u patën parasysh këto kritere:

1. Ruajtja në maksimum e elementëve origjinalë edhe pse pjesërisht të degraduar.
2. Rindërtimi i elementëve të veçantë konstruktivë që ishin në prag të rrënimit, në pamundësi për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre, duke përdorur sipas rastit teknikën origjinale apo teknikat e kohës.
3. Rindërtimin e elementëve të humbura simbas modeleve apo gjurmëve ekzistuese dhe rrallë në raste të veçanta sipas të dhënave gojore të sigurta dhe analogjisë me monumente të së njëjtës kohë.
4. Ruajtja e kontributeve të periudhave të mëvonshme kur ato nuk janë improvizime pa kriter dhe rrjedhimisht nuk cënojne rëndë unitetin e trajtimit të veprës.
5. Mosrindërtimi i ambienteve të rrënuar, prej të cilave ruhen shumë pak gjurmë.

Këto kritere u zbatuan sipas rastit në shkallë të ndryshme, veças ose bashkërisht në ambiente apo elementë të veçanta të banesës. Të dy portave të jashtme, si dhe atyre që ndërlidhin oborrin qendror me ata anësorët u mungojnë krejtësisht flegrat e dyerve, ndërsa porta kryesore nga jugu ishte thuajse e rrafshuar dhe në pjesët e muraturës, të cilat ku më shumë e ku më pak gjithashtu ishin të dëmtuara. Punimet e pastrimit pranë portës kryesore nga jugu, nxorën në dritë mjaft fragmente të gurëve të harkut mbulues si dhe disa gurë me seksion rrethor, të cilët bënë të qartë se porta e jashtme ishte e tipit me kalona guri. Duke plotësuar elementët mungues (fig. 22) dhe duke përfshirë ato origjinale u bë rindërtimi i pjesëve të muraturës, proces që u krye me volum më të vogël dhe në portat e tjera. Flegrat e dyerve u ndërtuan të reja në analogji me portat e të njëjtit lloj në banesa të ndërtuara rreth çerekut të parë të shek. XIX. Në muret rrethuese u bënë punime të vogla plotësimi dhe konsolidimi. Oborri qendror u shtrua me pllaka guri në analogji me zgjidhjet e zakonshme në këto sipërfaqe. Ndërsa odajashta u pastrua, kurse muret u konsoliduan në gjendjen e rrënojave.



*Fig. 22*

Struktura e mureve të banesës paraqiste rrezik shembjeje në disa pjesë. Në rradhë të parë shqetësime paraqiste një pjesë e mirë e murit fundor të banesës, të cilin shembja e ambienteve të gatimit e kishte vënë në kushte të vështira statike. Shmangia nga vertikaliteti në kufij të palejueshëm, si dhe gufimi në disa pjesë, si rezultat i shkëputjes së dy faqeve, bën të domosdoshëm prishjen dhe rindërtimin e kësaj murature. Nga ana statike rrezik shembjeje paraqiste dhe kolona që shërben si mbështetëse për kamerienë si dhe të dy qemerët, mbi të cilat ngrihet platforma e saj. Veprimi shkatërrues i ujërave madje kishte dëmtuar rëndë dhe strukturën e një pjese të gurëve. Në pamundësi për konsolidimin e këtij konstruksioni, gjithashtu u vendos për rindërtimin e tij (fig. 23).

Konstruksioni i çatisë paraqitej në gjendje të keqe teknike. Por duhet theksuar se përveç strehëve të pamjes kryesore dhe atyre anësore, të cilat ruanin me dëmtime jo të mëdha gjendjen origjinale, vetë struktura e çatisë ishte transformuar rrënjësisht në rrjedhje të kohës. punimet e restaurimit në çati u kryen duke përdorur skemat statike të kohës, ndërsa në strehët u kryen punime plotësuese, duke respektuar skemën dhe teknikën origjinale.

Vëllimi më i madh i punës restauruese u krye në brendësi të banesës, e cila paraqiste mjaft dëmtime, veçanërisht në strukturat prej druri. Në ambientet ndërlidhëse u kryen një sërë punimesh. Nëndivani paraqitej i ruajtur mirë, ai u çlirua nga disa parete të lehta ndarëse me skelet druri, u risuvatua si dhe u bë plotësimi i një pjese të parmakëve të rampës së dytë të shkallëve. Në divanin e gjysmëkatit u shtrua dyshemeja dhe u bënë punime plotësimi në tahtaposhin mbi kafazin e shkallëve.

DO NOT COPY



*Fig. 23*

Në divanin e poshtëm u rindërtua dyshemeja dhe parmakët e shkallëve. Në çardak u kryen një sërë punimesh. U rindërtua dyshemeja dhe u ribënë suvatimet. Sipas gjurmëve ekzistuese dhe të dhënave gojore u arrit të rindërtohej qoshku mbi kafazin e shkallëve. Punime plotësimi u kryen në parmakët e drurit, si dhe në veshjen me fletë plepi të arkadës së valëzuar mbi shtyllat e drurit. Duke ruajtur skemën e tavanëve origjinalë por mjaft të thjeshtuar u rindërtuan dy tavanet e çardakut. Qilari i zahiresë u çlirua nga oxhaku i mëvonshëm si dhe një ndarje e lehtë. Në patin e vogël u bënë punime të vogla pastrimi ndërsa në patin e madh u rindërtua, sipas modelit ekzistues të degraduar, musandra si dhe pjesërisht dhipatoja. Ashtu si në patin e vogël u rindërtuan dritaret e sipërme fikse, sipas gjurmëve ekzistuese. Në odën ballore të krahut nga jugu, u bënë punime plotësimi në tavan, si dhe u rindërtuan tamburi i oxhakut sipas skemës së zakonshme të kohës, në ambientet e banimit. Balli i këtij ambienti, i transformuar më vonë u ruajt si dëshmi jo pa vlerë në zhvillimin e teknikës së mureve të holla dhe dritareve. Në ambientin përbri u kryen punime plotësimi në të dy tavanet, si dhe u bënë punime plotësimi në dritaret. Punime të rëndësishme restaurimi u kryen në odën e miqve, e cila ishte mjaft e dëmtuar. Në të dy tavanet e kryen punime plotësimi dhe konsolidimi. U rindërtuan sipas shembujve ekzistues, apo plotësuan elemente të tilla si kapakët e dollapëve dhe dritareve, kafazet e drurit, dritaret prej allçie, etj. U rindërtua dhipatoja sipas modelit të të njëjtit element në një banesë të zhvilluar gjirokastrite ndërtuar më 1823[14]. Punime pastrimi u kryen në pikturën murale si dhe oxhakun dekorativ të këtij ambienti.

Rrënojat e ambientit të gatimit u konsoliduan, ndërsa një trakt me lartësi rreth 2 m u rindërtua. Rindërtimi i këtyre ambienteve hynte në fushën e hipotezës dhe si i tillë u përjashtua.

Punimet disavjeçare restauruese të konsolidimit në këtë banesë e siguruan atë plotësisht nga ana e qëndrueshmërisë, ndërsa punimet plotësuese dhanë mjaft për krijimin e kuadrit të plotë të kësaj vepre, që e kthyer në muze etnografik ka gjetur destinacionin më të përshtatshëm, në përputhje me vlerat e saj madhore.

*Shënim:** *Monumentet,* nr. 13, 1977, fq. 107 - 132

[14] Banesa në lagjen Palorto Rr. Themo Vasi Nr. 2, është fjala për dhipaton e odës së miqve të kësaj banese.

DO NOT COPY




DO NOT COPY




DO NOT COPY



0 3 m



0 10 m

DO NOT COPY



DO NOT COPY



DO NOT COPY




DO NOT COPY

Prof. dr. Emin RIZA

DO NOT COPY

# ARCHITECTURE ET RESTAURATION DE LA MAISON DES ZEKAT A GJIROKASTËR

La maison gjirokastrit constitue désormais un type à soi dans la typologie de l'habitation urbaine albanaise. Parmi les nombreuses habitations de Gjirokastër, de type kulla urbaine, conservées de nos jours encore, celle des Zekat se fait remarquer non seulement par sa grande valeur du point de vue architectonique mais aussi par le fait que la composition originale de cet ouvrage et nombre de ses éléments architectoniques se trouvent dans un état satisfaisant et constituent de la sorte un point de départ assez important pour l'étude de la typologie et de l'évolution de la maison gjirokastrit en particulier et de l'habitation urbaine albanaise en général. Ces considérations acquièrent une valeur plus concrète du fait aussi que l'on connait approximativement la date de sa construction. En témoignent tout d'abord les sources orales, qui rattachent sa construction à l'activité déployée par Ali Pacha Telelena dans ce domaine. Le traitement architectonique, par ailleurs, s'exprime en faveur de ces indications. Il en ressort donc que la maison des Zekat doit avoir été construite vers les années 1811-1812.

L'auteur de cet article s'est fixé la tâche de fournir une description de l'architecture de cette habitation, qui, sans le moindre doute, représente un des plus grands succès obtenus par la maison gjirokastrit pendant la période de son épanouissement classique (1800-1830), ainsi que des travaux de restauration qui y ont été effectués pendant les années 1968-1975.

La maison des Zekat se dresse dans le quartier Palorto, qui flanque le flanc inférieur de Mali i Gjerë : elle surplombe tout le quartier, dominant de la sorte la partie SO de la ville. Autrefois elle était entourée des murs, à l'exception de sa partie SO, dont il est difficile d'en définir l'extension malgré la présence de quelques tronçons. En tant que caractéristique relativement rare, ici nous sommes en présence de trois cours intérieures s'étendant sur toute la longueur, en plus d'un jardin situé au NE de ces cours et comportant les signes évidents d'une enceinte. L'existence des deux cours est une caractéristique habituelle à plusieurs maisons gjirokastrit, ce qui d'ailleurs a été relevé par G. Hahn aussi. La construction d'une deuxième cours à proximité de celle originale et par devant la maison, en dehors de sa fonction défensive, s'explique aussi, vraisemblablement, par le fanatisme des couches aisées de la ville.

La cour à droite comporte deux constructions, dont celle inférieure en ruine jusqu'au rez-de-chaussée et celle supérieure dans un état de conservation satisfaisant. La construction d 'en haut représentait l' "odajashta" de la maison, tandis que la construction inférieure, à étage, conformément aux témoignages oraux, avait un rez-de-chaussée employée comme étable et une pièce au-dessus destinée à la conservation du foin. Ces deux bâtiments sont les seules annexes de la maison.

Construite sur un terrain en pente, la composition volumétrique est celle caractéristique aux maisons à demi-étage. En conséquence les deux étages inférieurs s'élargissent du point de vue planimétrique par derrière, ce qui accroit la surface de construction par rapport á l'étage à rez-de-chaussée, dont la partie postérieure se trouve en contact avec le terrain. En dehors de cette inégalité de surface d'habitation entre les étages, le terrain, lui aussi, a évidemment influé sur le nombre des étages des deux principaux blocs de la maison. Ainsi le bloc situé sur le coté gauche, tirant profit

du pendage du terrain, a un étage en plus du bloc situé sur le côté droit. Cette irrégularité entre les deux blocs disparait au commencement de l'étage habité. Il convient de relever aussi la saillie faite par le bloc gauche, ce qui est conditionné par la nécessité de croître la surface de la chambre des amis. Ce sont là trois phénomènes caractéristiques à toutes les maisons gjirokastrit, mais l'irrégularité relevée dans le nombre des étages est un élément relativement plus rare.

Le schéma planimétrique est simple: un noeud reliant les différents éléments au centre et deux blocs latéraux, en plus d'une pièce ajoutée à chacun des étages supérieurs. Les installations sanitaires avancent en saillie hors des blocs, en forme de kulla. Malgré ces saillies, la planimétrie est bien nette et assez réussie du point de vue fonctionnel. Les pièces de cette maison peuvent être réparties, toujours du point de vue fonctionnel, en deux groupes : principaux et accessoires. Le premier comporte les chambres d'habitation, au nombre de cinq dans les étages supérieurs. En ce qui concerne les annexes : le local des animaux, la citerne, la cave des aliments et les pièces de la préparation des mets, les premiers se trouvent au rez-de-chaussée et au demi-étage et les autres dans la partie élargie de la planimétrie des étages supérieurs. Donc nous sommes en présence d'un regroupement où l'on relève facilement les pièces exerçant des fonctions différentes, en réservant la meilleure place aux chambres dites d'habitation. En hauteur également on relève une différence évidente entre les étages, ainsi l'étage à rez-de-chaussée et le demi-étage ne sont pas destinés à l'habitation, alors que le sont les étages supérieurs. Mais les étages destinés à l'habitation, eux-aussi, se différencient l'un de l'autre : le premier est haut de 2,80 mètres et le deuxième de 3,40 mètres. Cette différence de hauteur, ainsi que les fenêtres plus petites et en un nombre inférieur au premier étage par rapport au deuxième, s'expliquent par le fait que le premier étage est employé en hiver et le deuxième en été. C'est là une caractéristique de toutes les variantes plus évoluées de la maison gjirokastrit. Dans le noyau central, qui met en communication les différents éléments planimétriques, les escaliers évoluent librement et souvent entièrement ou partiellement les quatre parois des murs de cet espace. Le «sousdivan", le «divan" du demi-étage et celui inférieur représentent des volumes fermés mal illuminés, tandis que le "tchardak" et la construction caractéristique appelée "Kamerie" sont ouverts et bien illuminés.

L'unité base de ce type d'habitation est l'"oda" (=chambre), ayant une composition identique partout et des éléments architectoniques varie selon la fonction de chaque pièce.

La maison des Zekat représente, dans la morphologie de l'habitation gjirokastrit, une de ses variantes plus évoluées. Nous sommes en présence de la variante à deux ailes, rentrant dans la sous-variante simple. Dans un état de conservation presque intact, a l'exception de quelques dégâts plutôt d'ordre technique, cette maison constitue un point de référence très important quant au caractère et à l'aspect architectonique et de construction de l'habitation gjirokastrit. Parmi les pièces destinées à l'habitation, la chambre des amis se détache des autres pièces par le traitement presque unique et dans un esprit différent, par le décor surchargé lui conférant une valeur à soi bien distincte. La composition est simple et nette. En ce qui concerne le volume central, le système des voutes et des arcs joue un rôle important dans la formulation de l'intérieur et lui confère un caractère monumental par rapport a l'intérieur des pièces, où les éléments de bois créent une atmosphère de chaleur et d'intimité. Mais entre les étages aussi, entre l'étage inférieur et celui supérieur, on relève la même différence de traitement. Dans les étages inférieurs le type de construction est bien clair, il est rarement dissimulé; leur valeur esthétique ne consiste pas dans le traitement des différents éléments, mais dans le rapport des volumes et les irrégularités constituées par les éléments de construction que sont le "sousdivan", le "divan" du demi-étage et celui de l'étage. A l'étage supérieur, un soin particulier a été consacré au revêtement des parois des volumes: exemple les plafonds. Les étages inférieurs se distinguent par leurs proportions et la technique de l'ouvrage et les étages supérieurs par le décor attrayant mais toujours relié organiquement à l'architecture.

A première vue la composition apparait symétrique, mais une étude plus attentive montre clairement que cette symétrie loin de constituer un objectif indispensable à atteindre, a été traitée avec beaucoup de fantaisie au point qu'elle est brisée en plus d'un point soit pour ce qui concerne le plan que le volume. Le développement de la composition apparait clairement dans les nombreuses irrégularités, ayant toutefois des contours aux formes nettes, et dans le nombre inégal des étages dans chacun des principaux blocs du bâtiment. Ces phénomènes s'expliquent non seulement par la nécessité compréhensible de

DO NOT COPY

détacher le volume des cabinets de toilette de ceux des autres pièces de l'habitation et d'agrandir le volume des pièces du bloc gauche, afin de réserver la place requise à la chambre des amis, mais aussi par l'influence évidente exercée par le terrain accidenté. Cela apparait clairement dans les deux derniers étages, où l'inégalité du terrain permet l'élargissement de la planimétrie par derrière.

La composition se développe clairement en hauteur, d'autant plus que chaque étage comporte un nombre relativement petit de pièces. Cette composition volumétrique étant plus marquante de l'extérieur, en raison de l'inégalité des volumes, l'édifice apparait dans son ensemble plus svelte et confère a l'ouvrage le caractère monumental qu'on lui connait. Une autre caractéristique importante de la composition à l'intérieur est constituée par l'abondance les ameublements fixes, en tant que partie intégrale du traitement architectonique des différentes pièces. Des placards, des "dhipato", les armoires à mur et des niches occupent les volumes non utilisables ou l'épaisseur relativement grande des murs.

Le traitement extérieur architectoniques de cette maison correspond au mieux à la fonction différente de chaque étage: en plus le traitement de la façade principale, avec un soin plus grand que celui accordé aux autres façades, s'explique par la place de relief qu'occupe sa partie frontale dans la composition de la pièce. La façade principale comporte trois composantes: les deux blocs latéraux et celui central, le volume des cabinets de toilette ne communiquant pas avec ceux-ci. Les blocs latéraux se caractérisent par un traitement analogue mais sur des plans différents, ils sont bien reliés par deux voutes s'appuyant sur une colonne haute. Sur le fond de cette ouverture se détache facilement la masse de la maçonnerie, dont le traitement est analogue à celui des blocs latéraux. Ce détachement devient plus marquant au dernier étage, où la niche manque de couverture. Un tel regroupement des trois parties principales de la composition, loin de briser l'aspect de la façade principale confère à celle-ci, grâce au traitement architectonique de ses composantes, plus de vie et souligne son caractère vertical sans en affecter l'unité. Toutefois plus haut se distingue nettement une corniche caractéristique de pierre, placée au niveau du plancher du dernier étage, là où précisément se termine le mur massif de pierres. La partie inférieure, non enduite de crépi, rugueuse et monumentale, qui est brisée rythmiquement par des fenêtres en plein cintre dont le nombre et les dimensions croissent au fur et à mesure qu'elles s'approchent de la corniche, est en contraste avec la partie supérieure caractérisée par de nombreuses fenêtres sur les façades latérales el par le tchardak de la partie centrale. La blancheur miroitante de la chaux ne fait qu'accroitre cette différence marquante du traitement. Le passage de l'étage à rez-de-chaussée, d'aspect rude et monumental, au dernier étage se réalise à un rythme équilibré jusqu'à la corniche caractéristique, puis l'on est en présence d'un élan impétueux en faveur de la transparence et du lyrisme. Des auvents larges, soutenus élégamment par des chenaux longs, apportent également leur contribution en ce sens. Les façades latérales se caractérisent par un traitement architectonique analogue à celui des étages inférieurs, des fenêtres des estrades, des pièces d'habitation, et, bien qu'elles soient en saillie, ne réussissent pas à modifier la froideur et la concision de ces façades, dont le volume met encore plus en relief le traitement particulier de la vue principale. La maison des Zekat, par ses proportions réussies, par son caractère profondément monumental et par sa liaison parfait avec le terrain, constitue en soi un summum, le fruit d'une grande expérience par nos maîtres populaires dans la construction de ce type d'habitation.

II convient de souligner encore un trait essentiel à ce type d'habitation, son caractère défensif, d'autant plus qu'il nous permet d'apporter une solution à un bon nombre de problèmes. Le but de faire de cette maison un milieu à l'abri de n'importe quelle attaque venant du dehors revêt évidemment une importance primordiale par rapport aux exigences de la commodité. Cela apparait clairement dans les murs d'enceinte el les cours intérieures qui se succèdent et plus clairement encore dans la composition même de cette habitation et dans son caractère. La composition verticale prononcée est un signe évident de l'intention de disposer les pièces d'habitation dans les meilleures conditions de sécurité possible, sans compromettre toutefois leur illumination. La maison des Zekat, avec son tchardak et sa niche de l'étage supérieur, appartient au type d'habitation fermée, du fait que les éléments susmentionnés se trouvent à un niveau très élevé, n'accomplissent pas un rôle important du point de vue fonctionnel et, en dernier lieu, ils sont bien protégés par les deux blocs latéraux. Une grande importance revêt le traitement des fenêtres des pièces de communication, qui

DO NOT COPY

doivent être bien illuminées mais ne le sont pas pour des motifs de sécurité. En effet, le "sous-divan" est illuminé seulement par une petite fenêtre, relativement haute en direction de l'endroit ou l'on puise l'eau et protégée par des barres de fer et deux ouvertures en forme de meurtrières. Le "divan" du demi-étage, au-dessus du niveau du sol, donc plus sûr, est équipé de fenêtres plus grandes protégées par des barres de fer d'une section plus petite. Le traitement de la maçonnerie dans la partie postérieure de l'habitation, presque à sec, montre également, le soin accordé a la défense, mais l'élément plus typique mettant en évidence le caractère forteresse de cette habitation est représenté par les meurtrières destinées aux armes a feu. Comme d'habitude en forme de pieu, ces meurtrières surveillent les deux entrées de la cour centrale ainsi que la porte principale. Le mur terminal de l'habitation aussi est pourvu de meurtrières afin de pouvoir contrôler sa partie postérieure, qui est la moins protégée. La maison des Zekat est un exemple typique de l'habitation gjirokastrit non seulement quant au développement de sa composition, mais encore quant à sa nature défensive. Aussi la dénomination de "kullë urbaine" lui sied à la perfection.

La restauration. - Avant de commencer les travaux de restauration, la maison des Zekat présentait plusieurs, endommagements dans la structure des murs de soutien et surtout dans la construction du toit. Différent éléments architectoniques manquaient en partie ou totalement, d'autres étaient sur le point de se dégrader complètement. Donc il était indispensable d'entreprendre la restauration de ce monument, afin de le consolider du point de vue statique et de traiter à nouveau des différentes architectoniques conformément à leur degré de dégradation. La documentation recueillie pendant l'étude du monument, l'analyse minutieuse de son état technique et de sa position par rapport aux autres habitations de même type architectonique ont créé les conditions requises pour que le projet de restauration d'apporter une solution judicieuse au problème posé et cela suivant des critères d'appréciation qui considèrent le monument architectonique dans l'unité oeuvre d'art - document historique.

A la suite des études effectuées il a été constaté que cette maison n'avait subi aucune sorte de modification importante quant à la structure de sa planimétrie, à l'exception de quelques murs de séparation dans une de ses pièces. L'unique endommagement vrai et propre causé à la composition de l'habitation consiste dans la destruction presque totale, et cela pour des motifs que nous ne connaissons pas, de deux pièces destinées à la préparation de la nourriture.

Les travaux de déblayage effectués dans cette partie de l'habitation ont mis en lumière le plancher de la pièce du premier étage revêtue de dalles, le foyer et un trançon du mur SE. Ont été mises aussi au jour les traces de l'autre pièce, située a l'étage inférieur et faisant les fonctions d'une cuisine, couverte de voûtes de pierre et avec des formants SE-NO. En plus de cet endommagement a été reconstruite la partie frontale de la chambre du côté droit se trouvant à l'étage supérieur, qui, auparavant, était analogue à celle de la chambre des amis. Selon les témoignages oraux, cette modification a été effectuée au commencement du XXe siècle.

Le projet de restauration a été élaboré selon les critères suivants:

1. Sauvegarde maximale des éléments originaux, même lorsque ceux-ci sont partiellement dégradés;
2. Reconstruction de différents éléments de construction en danger d'écroulement, lorsqu'il est impossible d'assurer leur stabilité, en employant selon les cas la technique originale ou les techniques de l'époque ;
3. Reconstruction des éléments disparus selon les modèles ou les traces existants et très rarement, en des cas exceptionnels, selon des témoignages oraux bien contrôlés et en analogie à d'autres monuments de la même époque;
4. Conservation des modifications effectuées en des périodes postérieures, lorsque celles-ci ne sont pas des improvisations sans critère et n'affectent pas gravement, en conséquence, l'unité de traitement du monument;
5. Non reconstruction des pièces écroulées dont on ne conserve qu'un nombre intime de traces. Ces critères ont été appliqués selon les cas à des degrés différents, séparément ou dans leur ensemble dans les diverses pièces ou éléments particuliers de la maison.

A la suite des travaux de restauration, qui se poursuivirent pendant plusieurs années dans le but de consolider la maison des Zekat, celle-ci a accru sa stabilité. Par ailleurs, les travaux complémentaires ont contribué à recréer le cadre original de cet ouvrage, qui, en sa qualité actuelle de musée ethnographique a trouvé sa destination la plus appropriée en raison des grandes valeurs qu'il comporte.

DO NOT COPY

Fatbardha SHKUPI

DO NOT COPY

# ZBUKURIMORJA E DISA BANESAVE GJIROKASTRITE*

Për qytetin e Gjirokastrës kanë dhënë mendime mjaft udhëtarë e studiues të së kaluarës si Çelebiu, Hani e Shuflai, të cilët janë kufizuar në përshkrimin arkitekturor. Arkitekturën e qytetit muze e njohim nga monografia "Qyteti – muze i Gjirokastrës"[1] në të cilën trajtohen edhe pjesët përbërëse të brendisë. Në të del zhvillimi shkallëzor i tavaneve, rafteve, dyerve, trapazanëve e tymtarëve, kështu që jemi ndihmuar për kategorizimin e tyre artistik. Duke marrë gjithashtu të dhëna nga popullsia e vendit dhe nga pasardhësit e mjeshtërve korçarë, e kolonjarë, kryesisht prej Rehove, si dhe kujtimet e patriotit Petro Nini Luarasi, i ati i të cilit, Nini, ka qenë gurskalitës në qytetin e Gjirokastrës gjatë shek. 19, mësuam se ndërtuesit kryesore të këtij qyteti gjatë shek. 18 e 19, kanë qenë nga Vakëfet, Kolonja, Luarasi, Orgocka, Opari, Gramozi e Konica.

Këta ndërtues quheshin mjeshtrokë. Në mes tyre vepronin gurskalitësit, drugdhendësit e piktorët e mureve[2]. Veprat e shquara që ata krijuan na bindin për shkallën e zhvillimit ekonomik të qytetit, i cili që në shek. XIII njihej si kështjella "Argirokastron"[3].

Pozita gjeografike e saj e ka ndihmuar të ketë lidhje me Shkodrën në veri, Manastirin e Janinën në jug dhe kështu të këmbejë përvojën në fushën e krijimtarisë zbukuruese të brendisë në tërësi.

Pothuaj në të gjithë qytetet shqiptare gjatë shek. 18 dhe 19, brenditë u pasuruan me tavane, tymtarë, rafte e trapazanë të zbukuruar me piktura, gdhendje druri e plazmime të shkëlqyera, që u dalluan nga pikëpamja artistike prej dhomave të thjeshta të kateve të dyta[4].

Duke vrojtuar dhomat e pikturuara me shije të këtyre brendive në qytetin e Gjirokastrës të zbatuara nga fundi i shek. 18 e fillimi i shek. 19 përkatësisht tek Zekatët, Çuberajt e Gegët, kemi vënë re trajta të stilizuara dredhkash, ku krahas motivit të traditës popullore ndjehet ndikimi i arabeskut dhe i gobelinave tip rokoko e direktorat, që ndofta kanë depërtuar në rrugë tregtare nga Europa qendrore e jugore[5]. Kjo dukuri që shfaqet në prag të sundimit të Ali Pashë Tepelenës duke vazhduar në mënyrë të izoluar, do të zëvendësohet gjatë kohës së tij me një zbukurimore të zbatuar kryesisht në gdhendje druri gjatë shek. 19 në pallatin e sundimtarit Maliq Pasha (Hadërajt), tek Çabejt, Babametot e Hajrot. Megjithatë, në mes të dy grupeve të zbukurimores ndjehet një vazhdimësi organike e kompozimeve të pikturuara tipike të shek. 18, që paraqesin motivet e njohura popullore në të gjitha qytetet e Shqipërisë[6]. Këto punime si në Gjirokastër dhe qytete të tjera vetëkuptohet se janë udhëhequr nga arkitektë të aftë

[1] E. Riza, *Qyteti-muze i Gjirokastrës*, Tiranë 1981.

[2] Të dhëna nga mjeshtër ndërtimi arsimtar; e studiues gjirokastritë e kolonjarë si Lefter Dilo, Familja Babameto, Skënder Luarasi, Naum Prifti e të tjerë.

[3] *Historia e Shqipërisë*, V-I, fq. 230-232, Tiranë 1959.

[4] S. M. Nenadoviq, "Prizrenske tavanice", *Glasnik Kos -Met*, 1956, fq. 289-293.

[5] G. Marçais, *L'art musulman*, Paris 1962 - Ku flitet për punishtet e sixhadeve me arabeska të Siçiljes - që shiteshin në Europë e Ballkan), M. de Fayet, *Comment installer on intérieur en directoire et empire*, Paris 1964, 13 – 19, ku paraqiten trajtat e kompozuara të stileve përkatëse në brenditë e mobiljet.

[6] F. Shkupi, "Tipari popullor i zbukurimores së banesës shkodrane", *Monumentet* 20/1980 fq. 105-123 ku flitet për motivet e përbashkëta shqiptare.

që kanë qenë në gjendje të vënë në zbatim vepra të tilla të rëndësishme. Njëri prej tyre ishte Petro Korçari, Kryearkitekt i Ali Pashës që udhëhoqi punimet e disa pallateve të Janinës, Gjirokastrës e Korçës[7]. Faktet e mësipërme na qartësojnë për karakterin e pashallëkut të Janinës, i cili gjatë shekujve 18 – 19 i dha një farë lirie zhvillimit ekonomik të artizanëve popullorë dhe përkrahu elementin vendas. Ali Pasha dëshironte të grumbullonte rreth vetes mjeshtër shqiptarë në të gjitha fushat e veprimtarisë dhe të mënjanonte ndikimet e huaja brenda mundësive të lejueshme për kohën[8].

Zbukurimet e brendive të disa pallateve në Janinë dhe korrabartësit (ikonostaset) e Sopikut e të Lashovës i kreu mjeshtër Nikolla dibrani, artisti i Ali Pashës sipas të dhënave të krahinës së Pogonit dhe të Lashovës. Ali Pashë Tepelena qe interesuar të sillte në pashallëk mjeshtër të aftë nga Dibra e Kolonja[9]. Këta artistë zbukurues që i njihnin mirë stilet e kohës i kanë zbatuar në veprat e tyre, duke i ndërthurur me motivet trashëgimore të popullit në kompozimet e tyre vetjake që do t'i shtjellojmë me poshtë.

Në bazë të studimit për arkitekturën e qytetit – muze bindemi se në banesat që ruajnë vlera të larta arkitekturore e artistike të ndërtuara gjatë shek. 18 e në vazhdim e shek. 19 dhomat paraqiten të larta dhe të zgjatura. Mbi ballin e tyre janë renditur tri dritare kënddrejtë, në disa raste shihen dhe dy dritare anësore si tek banesa e Zekatëve (fig. 1). Pamja e dhomës së parë tip. shek. 18 tek Zekati). Në murin ballor, të shumtën e herës vendosen mbidritarëza me xham të pikturuar.

Trapazani i quajtur dhipato që ndodhet nga ana e hyrjes, në fillim të shek. 18 ka qenë i mbyllur me pano dërrase të modeluara me harqe të prefta si i kemi ndeshur në banesën e Muhedinëve, të Sokolajve në Shkodër dhe në mjedise turke që na kujtojnë gotikën islamike[10]. Më vonë nga fundi i shek. 18 e fillimit i shek. 19 u pajis me katër ose pesë harqe të larta



*Fig. 1*

me ballore të luhatur në trajtë baroke, si trapazani i dhomës së dytë tip shek. 18 tek Zekatët (fig. 2).

Musandra anash mban nga tri kamare njëra mbi tjetrën si në brendinë e Elbasanit, kurse dyert e hyrjes dhe të banjës ruajnë ballorë hark luhatur si në brendinë e Shkodrës, pa zbukurime. Mbi muret anësore të ndarë prej brezash dërrase vendosen dy ose tri rafte muri kënddrejtë të kufizuar prej bedenash. Mbi njërin nga muret plazmohet tymtari, i cili gjatë shek. 18 e fillimi i shek. 19 paraqitet me ballor prizmatik të pajisur me kurorë, anash shihen kamaret e vogla. Ndërsa muret përshkohen prej tavlash të gdhendura me bedena, nimet ngrihen 20 cm më lart shtrojës (fig. 3. Ana e tymtarit në dhomën e parë tip. shek. 18 të Zekatit).

Tavanet paraqiten kënddrejtë me fusha tetëkëndore të zgjatura të përshkuara prej rripash katrore. Të katër trekëndëshat daltohen me lule të thjeshta ose pajisen me

[7] Dh. S. Shuteriqi, *Petro Korçari - kryearkitekti i Ali Pashë Tepelenës*, Tiranë 1976.

[8] L. Mile, "Sur le caractère du pouvoir d'Ali Pasha de Tepelene", në *Edition du comité National albanais des études balcaniques*, Tirana 1969, 8-10.

[9] Bashkëbisedim me ksilografin e mirënjohur Sopiqot mësuesin Arqile Papadhimitri për mjeshtrin e Ali Pashës, Nikolla nga Magarova.

[10] E, Riza, *Vep. cit*, fq. 29 – 109, R, Günay - *Sofranbolu evleri ve olušumu*, Ankara 1981, 141, 201, 202, ku shihen trapazanë me patavra gotike islamike.

DO NOT COPY



*Fig. 2*

tufëza gjethesh si rreze. Në disa raste ato paraqesin figurën ballore të përftuar prej dyfish vijëzash të ndërprera[11].

Të gjitha pjesët e gdhendura mbulohen me lulëza e dredhka të pikturuara, të cilat përfshijnë në disa raste dhe tymtarët e punuar në stuk relief. Në zbukurimoren gjirokastrite të fundit të shek. 18 e fillimit të shek. 19 dallojmë elemente tipike të cilët i gjejmë të zbatuar në brenditë e Beratit që në fillim të shek. 18. Kjo dukuri na bind për drejtësinë e të dhënës gojore të mbledhur në qytetin e Beratit se mjeshtrit e aftë vendas u larguan nga qyteti i tyre për të punuar gjetke pas grindjes që patën me disa feudalë të rrethit të Kurt Pashait. Sipas kësaj të dhëne dhe konstatimeve tona në rrethin e Kolonjës e të Dibrës nga pasardhësit e mjeshtërve, grupe të organizuara ndërtuesish shqiptare kryesisht Oparakë, Kolonjarë, pjesërisht dhe Beratas vepronin në Greqinë e

[11] F, Shkupi, "Artet e aplikuara në banesën Shkodrane", *Mjeshtrit dhe arkitektura populloré*, Tiranë 1976, 133 - 138, ku flitet për motive të shek. 18 të afërta me ato të Gjirokastrës e Beratit.



*Fig. 3*

Veriut e Shqipërinë e Jugut si Janinë, Gramoz, Follorinë, Selanik, Dramë, Brusë, Stamboll, Maqedoni, Bullgari, e brigjet e detit të Zi[12]. Sipas pohimit të populllsisë, mjeshtrit shqiptarë pranoheshin përpara grekëve e bullgarëve për të zbukuruar brenditë e banesave sepse ishin më të aftësuar se ata në këtë kohë. Nga Turqia filluan të depërtonin shiritat e gjerë me lajle tip hatai si lëpjeta të lakuara që në Shqipëri i quajtën "krah zogu" dhe bisqet e valëzuara tip rumi të përafërta me grotesken që këtu u emërtuan "bisht dallëndyshe".

[12] E. Riza - H. Nallbani, "Një ndërtim i tipit kullë në Berat". *Monumentet* 10. Tiranë 1975, fq. 126, ku flitet për ngjashmërinë e brendisë beratase me atë të Gjirokastrës: F. Shkupi, - "Zbukurimorja e disa monumenteve të kultit në rrethin e Kolonjës", *Kultura Populloré 2*, Tiranë 1985, fq. 86 - 97.

DO NOT COPY



*Fig. 4*

Për këtë arsye, vënia në pah e krahasueseve kombëtare, sidomos nga Berati është kërkesë e domosdoshme për shtjellimin e zbukurimores gjirokastrite.

Duke analizuar brendinë e banesës së Zekatit të shek. 18 - 19 shohim se tavani i madh i dhomës së miqve ruan një fushë të blertë të përshkuar prej rripash katrorë me lule të bardha në mes (fig. 4). Të katër trekëndëshat paraqesin lule, ndërsa brezat anësorë të tavanit vizatohen me dredhëse bisqesh të kuq e të kaltër. Në mes tyre sajohen zemërza, trëndafila mbi fusha të blerta të krahas - këmbyera me dy mollë ngjyrë okër të kufizuara prej bisqesh të kuq, që na kujtojnë panotë e kompozuara me kafshë e mollë të kishës së Shën Pjetrit e Pavlit e shekujve 18 - 19 në Vithkuq. Këto lajle, bisqe e mollë janë trajtuar me ngjyra të çelura e të arta mbi fusha të kafenjta ose të kuqe që i përshtaten stilit rumi, të shoqëruar me gjethe të gjera hatai sipas artit islamik[13]. Tipari shqiptar dallohet në mënyrën e veçantë të kompozimit të trëndafilave, dardhave, e mollëve në vend të jaseminave, pjeprave, e shalqinjve që mbushin repertorin e zbukurimores turke me lajle të ngathëta.

[13] V. Hahn, "Les courants des styles dans les metiers d'art des artisans chrétiens en XVI et durant les prémiérs décéniés du XVII siécle dans les rêgions des balcans", *Balcanica 1*, Beograd 1970, fq. 240 - 245 .



*Fig. 5*

Mbi tavanin e vogël të teqesë se Xhelvetive, të shek. 18 në Berat vërejmë tipare të ngjashme sidomos në brezin e dytë, ku paraqiten grupe prej dy mollësh ngjyrë okër të qarkuara prej bisqesh të vezët, që krahas këmbehen me lule të kuqe e gjethe të blerta (fig. 5).

Motive të përafërta pajisin tetëkëndorin e rozetës së vendosur në qendrën e thelluar, e cila është daltuar si rreth mëzak i qarkuar prej tetë rrathësh anësor e ku vizatohen tetë dyfish vijëza të ndërprera si yll. Mbi të janë pikturuar lule të kaltra mbi fusha të kuqe e lule të kuqe mbi të kaltër

DO NOT COPY



*Fig. 6*



*Fig. 7*



*Fig. 8*

të kufizuara prej buzinash ngjyrë okër. Shiritat anësore të rozetës sajojnë bisqe lakuese të blertë mbi fushë të kuqe (fig. 6 Rozetë tip shek. 18 në banesën e Zekatit).

Yllin e vizatuar me dyfish vijëza të ndërprera e kemi ndeshur fillimisht në shtrojet e kishave të shek. 17 në Berat, në disa banesa të lagjes Partizani po të këtij qyteti, si në banesën e Tutulanëve të shek. 18 (fig. 7), dhe në banesat shkodrane të shek. 18. Siç dihet, ky motiv u krijua në Egjipt nga Koptët për të pasqyruar diellin që në shek. 13 dhe u përhap në të gjithë perandorinë osmane pas pushtimit të Aleksandrisë[14]. Mjeshtrit shqiptarë pikturuan me zambakë të bardhë mbi fushë të blertë në banesën gjirokastrite sipas kompozimeve vetjake[15].

Në të kundërt, tek rozetat e tavanit të madh të teqesë së xhelvetive motivi diellor kompozohet prej gjethesh të zgjatura si rreze me spira që njihet në trevën e Ballkanit si karakteristike e artit shqiptar. Sipas rastit, mbi muret anësore pranë tymtarit zbukurimorja mvishet me pano ku shihen peizazhe me ngjyra të kuqërremta, të blerta, të vezëta, të vizuara në të zezë ose të kaltër. Krahas tyre vizatohen broke, tufa trëndeline e gjethe shpatullgjera, të përafërta me disa paraqitje brendish turke[16].

Pano të kësaj natyre gjenden në banesën e Gegëve dhe tek dhoma e mirë e Zekatit, ku shihen tufëza lulesh të shoqëruara me gjethe përkulëse të kufizuara prej bisqesh vezake. Ato paraqiten të zgjatura, kënddrejtë me harqe të valëzuara tipike për artin barok (Fig. 8. Pano zbukurimi të shek. 18 në banesën e Zekatit).

Trajta të ngjashme shohim tek panotë e teqes Xhelvetive. Aty në vend të tufëzove të luleve të ngjeshura paraqiten peizazhe me banesa (Fig. 9. Pano e teqesë së Beratit e punuar gjatë shek. 18).

Teqeja e Xhelvetive u pikturua gati 25 vjet përpara Zekatit, në kohën e sundimit të Kurt Pashait sipas mbishkrimeve që e datojnë në vitin 1782[17]. Sigurisht të dy

[14] Q. Cig, "A uniques ceilling style Newly discovered in the Harem of the Top Kapi Palace", *Atti del secondo congresso Internazionale di arte Turca, Venezia*, settembre 1963, Napoli 1965, 57-60. G. Bazin, *Histoire de l'art,* Paris 1951, f. 19.

[15] F. Shkupi "Dekoracioni i arkitekturës popullore në qytetin e Shkodrës", *Monumentet* 12, Tiranë 1976, fq. 196 – 200.

[16] E. Esin, "An Eighteenth Century (Jali) viewed in the line of development forms in turkish architecture", *Atti*, fq . 105-110 për stilet rumi e hatai në panotë e mureve.

[17] Mbishkrime të teqes së Xhelvetive të Beratit në turqishte të vjetër, të

DO NOT COPY



*Fig. 9*

brenditë ruajnë kompozime të ndryshme por fryma e zbatimit është e përbashkët. Duke krahasuar zbukurimet e banesës së Zekatit me ato të teqesë së Xhelvetive ne shtrojmë hipotezën se grupi i punës pas ndërtimit të teqesë u largua në drejtim të Gjirokastrës, ku punoi në fillim të shek. 19 gjatë sundimit të Ali Pashait, me mënyrën e vjetër të pikturimit.

Të dhëna të sakta mbi këta piktorë ende nuk kemi gjetur. Sipas të dhënave gojore, mjeshtrit, Kurt Pashai i solli nga larg. Sipas të dhënave të rrethit të Kolonjës, piktorët zbukurues të brendive në atë kohë vinin nga Pilkati, Fjonjati, Ellova e Radimishti, fshatra shqiptarë të Gramozit[18]. Në qytetin e Gjirokastrës flitet se piktorët e banesave nuk ishin vendas. Kështu që hëpërhë priremi të pranojmë se këta piktorë që me veprat e tyre pasuruan Beratin e Gjirokastrën, duhet të kenë qenë kolonjarë, në grupin e të cilëve punonin dhe mjeshtër beratas.

Po të kishin qenë të huaj nuk do të vazhdonin punën e tyre në Shqipërinë e Jugut për tridhjetë vite të tjera duke lënë pasardhës. Vetëkuptohet që secili grup mbronte elementët e vet tipike që nuk përsëriteshin nga grupet e tjera si folëm për rastin e mollëve. Simbolet e përbashkëta trashëgimore i paraqitnin të gjithë në veprat e tyre si në rastin e tymtarëve, të cilët pothuaj kudo në Shqipëri ruajnë motive të diellit, hënës e në disa raste helikën e gjarprin.

Tek tymtarët e banesës gjirokastrite brenda trajtës së njohur kombëtare u zbatuan elementet tipike të veçantë që mbeten si pasuri vetjake e zbukurimores së këtij qyteti. Në brendinë e Zekatit tymtari mban një daulle prizmatike me shtatë faqe ku shihen pano të pikturuara me bisqe të hajthët zambakësh e trëndafilash të kuqe me gjethe të blerta e të dherta. Tip shek. 18. Baza e ballorit është e luhatur në trajtën e një harku barok. Shatorja gjysmë konike, në pjesën e sipërme mvishet me pemë e perime të plazmuara e të pikturuara si natyra të gjalla. Mbi to vendoset mbulesa gjysmë cilindrike prej xhami mbi të cilën janë plazmuar pesë zymbyla. Sipër tyre ngrihet një trajtë kambane me tufa gjethesh fletëgjera në majë dhe pesë hapje vezake me ndarëse gjethesh pingule. Shatorja rrethohet prej kurorës se gjetheve shpatull gjera të valëzuara dhe një trine me pala e xhufka. Brenda tyre janë plazmuar e pikturuar motive të njëjta si tek tavanet me drethka, e gjethe të përthyera që mbyllin nga tri kokrra mollë në të dy anët e kurorës. Tymtari është pajisur me dy kamare anësore harkore (shih fig. 3).

Tek tymtarët e Beratit të ndërtuar prej grupit të mjeshtërve beratas, oparakë e kolonjarë gjatë shek. 18, daullet paraqiten prizmatike. Në një banesë të lagjes "Partizani" (Nr. 276) tymtari i bardhë i cili duhet të ketë qenë i pikturuar (fig 10) paraqet veti të ngjashme si ballori prizmatik e shatorja gjysmë konike me simotrën e vet të Zekatit.

përkthyera nga Vexhi Buharaja, ku caktohen datat e ndërtimit si çereku i tretë i shekullit 18.

[18] N. Moutcopullos, *The popular architecture of Verria*, Athinai 1967, fq. 56, 104-107, ku flitet për mjeshtër shqiptarë të pikturës prej Gramozi. F. Shkupi, *Vep. cit.*, "Zbukurimorja kolonjare".

DO NOT COPY



*Fig. 10*



*Fig. 11*

Meqenëse në krahinën e Kosovës, krah Vardarit dhe Elbasanit gjatë shekujve 18 – 19 mjeshtrit dibranë punonin tymtarë me daulle gjysmë cilindrike, ne shfaqëm mendimin, sipas të dhënave të familjeve Kuqani, Çoba e Kaçulini të Shkodrës, se tymtarët me daulle gjysmë prizmatik kaluan nga Shqipëria e Jugut në Shkodër e Lezhë me anë të familjes suljote të Arsen Idromenos. Nipi i tyre Zef Arseni ka modeluar me kallëpe balloret e zbukuruar me bisqe të drejta, që na kujtojnë tufëzat hollake të pikturuara të tymtarëve gjirokastrite, ndërsa shatoret i plazmonin mjeshtrit dibranë[19].

Raftet e murit të kësaj kohe paraqiten fare të thjeshtë, si i gjetëm në disa banesa të lagjeve Pazar i vjetër te Karallinjtë, Manalat e Dunavat. Një nga më tipikët e këtij lloji e shohim në banesën e Zanajve. Ai mban dy flegra të ndara nga një rrip i daltuar, të cilat anash vizatohen me katrorë ndërsa në mes me drejtkëndësh. Të dy flegrat janë mbërthyer me nga gjashtë kunja kovaçi. Në pjesën e sipërme ndodhet kamarja e azhurnuar me gardhime të rombuara të luhatura dhe rrathë që përshkohen brenda rombeve të lidhura prej fijesh të drunjta (fig. 11). Me vonë këto rafte mvishen me piktura lulëzore ose bisqe hardhie si në banesën e Gegëve nga fillimi i shek. 19. Gardhime gjeometrike të kësaj periudhe gjinden në të gjitha raftet e Shqipërisë, në Shkodër me zymbylë e shermashekë, në Krujë dhe Elbasan me rombe të valëzuar dhe lule katërpetlash. Të tillë gjejmë edhe në Berat. Ndryshimi qëndron tek flegrat e rafteve të Shkodrës dhe Elbasanit, të cilat paraqesin kompozime vazosh e spirash të riteve taurobolike (therori i demave) ndërsa në Krujë, Berat e Gjirokastër flegrat janë të thjeshta ose të zbukuruara lehtas

[19] F. Shkupi, "Dekoracioni", *vep. cit,* 197, 199, 201, 211, *Tymtarët me daulle cilindrike e prizmatike*.

DO NOT COPY



*Fig. 12*



*Fig. 13*

me thonjëza e bisqe (fig. 12 – Raft muri i shek. 18 në banesën e Qanove në Berat). Këto fakte na bindin për kombësinë e mjeshtërve ndërtues anonimë të shek. 18 dhe fillimit të shek. 19, që punuan në Berat e Gjirokastër. Ata qenë vendas dhe të mirënjohur në perandorinë osmane, siç pohon vetë populli.

Duke përgjithësuar zbukurimoren e fundit të shek. 18 dhe fillimit të shek 19 në Gjirokastër, elementet tipike të zbatimit të saj janë kryesisht: tavanet e pikturuar me bisqe e gjethësime të gjera, flatra zogu e mollë, rozetat e daltuara si yll me dyfish vijëza të ndërprera, tymtarët me ballorë prizmatikë, kurora të stolisura me dredhka e natyra te qeta pemëzore, trapazanët me ballkon dhe raftet me flegra të thjeshta, gardhime gjeometrike e natyra të qeta pemëzore, panotë e pikturuara mes brezash ndarës mbi muret, raftet e përbëre nga dy flegra të thjeshta me kamare të gardhuara ndër rombe dhe mbidritarëzat me xham të pikturuar në trajtë vezake.

Brendi të tilla gjinden kudo ne Ballkan e Turqi të pikturuara ose të daltuara.

Gjatë shek. 19, dyert e raftet do të pajisen me motive gjeometrike rreth shtjellëse që u trashëguan me anë të gurskalitjes. Duke vështruar derën e një dhome tek banesa e Shemsho Hajros, ajo është gdhendur me pjesëza të kapërthyera në trajtë svastike rombe të trefishuar e lule shermasheku dhe në të katër këndet, lule me tre gjethe (fig. 13). Në qytetin e Beratit gjinden ndërtime të ngjashme dyersh gjatë të njëjtit shekull. Dera e banesës 32 të lagjes 8 Nëntori në Berat paraqitet me dy svastika rombe (fig. 14).

Dyert e zbukuruara me motivin e svastikës janë përhapur në të gjithë Shqipërinë[20]. Musandra me motive të njëjta që si duket qenë punuar fillimisht prej rumëve do t'i gjejmë tek brenditë e qytetit Sofranbollu në bregun e detit të Zi[21].

[20] K.A. Makri, *I Laiqi Tehni tu Pellu*, Atenai 196, 115-118 (dyert svastikoide). L. Mile, "Aspekte të mënyrës së jetesës në fshatin shqiptar (fundi i shek. XVIII-vitet 20 të shek. XIX)", *Studime Historike* Nr. 3, Tiranë 1977, fq. 123-126.

[21] R. Günay, *Vep. cit*, 141, 175, 244. Autorja na flet për mjeshtër

DO NOT COPY



*Fig. 14*

Në se brendia gjirokastrite ruan autoktoninë e vet apo është krijuar si rrjedhojë e bashkimit të elementeve ilirë, bizantinë, ballkanas e islamikë ne nuk mund ta përcaktojmë. Hedhim vetëm hipotezën se trajtat e tymtarëve, të dritareve e musandrave ngjajnë me atë që shohim në kullat paraturke të rrethit të Vlorës e Mistras në Greqi[22]. Gardhimet e harqet e trapazanëve mund t'i krahasojmë me pjergullën e çardakut të shtëpisë elbasanase.

Me anë të historianit Lefter Dilo u njohëm me pasardhësit e një grupi mjeshtërish, që në fillim të shek. 19 erdhën në Gjirokastër nga Hormova e Tepelenës. Ata na treguan me hollësi mbi veprimtarinë e këtyre mjeshtërve të cilën ne e ndoqëm nga afër duke zbatuar metodën e krahasimit siç vepruam në Shkodër dhe Elbasan. Kryetari i këtij grupi qe Nikë Bashari, i cili daltoi mjedise bashkë me të birin Gjikën si tek pallati i sundimtarit Maliq Pasha, tek Shemsho Hajro, tek Çabejt, Çoçolotët, Selfatët. Në grupin e tyre u përfshinë më vonë Niko Lumi, Mihal Kosta, Fotaq Bakalli, Dhimitër e Zoto Bashari, Ngjeli Poga, Niko e Koço Kalemi, Naqo Prifti, Paço Kromidha, Stefan Koçollari, Selim Gjirokastriti, Spiro Pano, Stavri Duholi, Vangjel Bashari gjatë shek. XIX e në fillim të shek. XX, si ndërtues gurskalitës e drugdhendës.

Me ardhjen e Nikë Basharit, zbukurimorja gjirokastrite u zhvillua në drejtim të drugdhendjes. Mjeshtri ruajti bashkërenditjen e mëposhtme të brendisë po në vend të pikturës ai krijoi zbukurime të daltuara dhe të plazmuara. Brenditë e pallatit të sundimtarit u punuan në kohë të ndryshme prej Nikës e djemve të tij Gjikë e Dhimitër.

Duke vështruar dhomën e zbukuruar nga dora e Nikës vërejmë se ajo përbëhet prej dy tavanesh tek të cilët janë gdhendur breza me gjethe të hajthta të krahaskëmbyera (alternim) me lulëza në vargje anakesh (guirlands). Ato kufizohen prej bedenash zymbylka rreth fushave të përshkruara me rombe të gjethëzuara (fig. 15). Mjeshtri ka krijuar dhe tavane të tjerë të përkryer, si p.sh. në kullën e Shemsho Hajros, ku dhe musandrat e raftet ruajnë motive të veçanta. Në brezin e parë ishin vargëzime gjethesh të pasura prej margaritarësh. Brezi i dytë është i thjeshtë, ndërsa i treti paraqet zambakë të vargëzuar me shirita kordon. Brezi i katërt vijon i thjeshtë. Pas tij vijnë tufëzat e luleve, rreshti i gjetheve S vazhduese dhe dredhëset (fig. 16). Harqet e musandrës, panotë e mureve dhe kufizat e dritareve përshkohen gjithashtu nga një larmi motivesh të kompozuara në trajta kënddrejtë të pranëvëna që lehtësojnë përmasat e mëdha të dhomës dhe hijeshojnë dritaret. Kemi parasysh njërin prej harqeve me kufiza baroke. Në qendër shihen gjethe të dredhurave, anash përshkohen bisqe S vazhduese të përhapura gjerësisht në Ballkan. (fig. 17. Harku i musandrës në pallatin e sundimtarit). Të njëjtat trajta i ndeshim në banesën e Çabejve ku punoi mjeshtri Gjikë Bashari, i cili vazhdoi traditën e prindërve gjatë shek. XIX. Ai i dha fuqi shtjellëse dredhkave të plota, pranë të cilave rreshtoi breza me gjysmë hënë dhe motive rrathësh.

ballkanas rumelë që skalitën gurin, të cilët u larguan pas këmbimit të popullsisë greke me turqit e Greqisë.

[22] A.K. Orlandas, *Ta astika tu Mistra*, A.V.M.E. Tomos 1937, Athinai (ku jepen skica e fotografi brendish mesjetare të njëjta me banesat tona të shekujve 18 - 19).

DO NOT COPY



*Fig. 15*



*Fig. 16*



*Fig. 17*



*Fig. 18*

DO NOT COPY

Fushën e tavanit e trajtoi me listela të drejta dhe në këndet kompozoi tufëza me pikëza ose zemërza (fig. 18).

Në tavanin e dytë gjendet një rozetë yllore tetë cepash e krijuar prej dy katroreve të mbivënë, në mes të cilëve sajohen rrathët bashkëqendrorë me bisqe të luhatur e zambakë. Në secilin nga tetë cepat shihen përfytyrime lulesh e zogjsh. Brezat e rozetës janë pikturuar me dredhka e lule ndërsa në qendër përmblidhen njëzetepesë rreze të gjethëzuara si diell (fig. 19). Daltimet lyhen me ngjyra vaji në disa raste. Rozeta të ngjashme takojmë në brenditë e Beratit por në vend të figurave tek cepat vizatohen lule (fig. 20. Rozetë yllore e shek. 18 në muzeun e artit popullor në Berat).

Nga fundi i shek. 19 rozetat pësojnë disa ndryshime. Në njërën prej tyre, rrethi i përbërë nga tetëmbëdhjete rreze të gjethëzuara kufizohet prej dyfish gjethesh në rreth dhe në tetëkëndor. (fig. 21. Rozetë e daltuar nga fundi i shek. 19 në banesën e Lulajve në Varosh). Mbi kufirin e tij vendosen tetë gjysmë hëna me motive gjethesh; helika shtjellësve e zogj të përballshëm anash pemës së jetës që paraqitet si bisk kokrrizor. Kjo rozetë është punuar prej mjeshtrit Dhimitër Bashari.



*Fig. 19*



*Fig. 20*



*Fig. 21*

Raftet e mureve gjatë këtij shekulli nisin të pasurohen me kamare të zbukuruara me dredhka, helika rreth hapjeve vezake ose harkuese[23]. Ndonjëherë shihen zogj të përballshëm anash hapjes. Flegrat e rafteve ose janë ndërtuar me katrorë ose me copëzime në trajtën e svastikës ose me pjesë të zgjatura këndrejtë. Poshtë flegrave sajohen kamare të valëzuara me lulëzime ose dredhka dy krerëshe (bipene) që krijojnë hapje baroke. Në të dy anët e rafteve vendosen gjysmë shtyllëza me krejsa dhe gjethe të vargëzuara (fig. 22. Raft muri i shek. 19 në banesën e Shemsho Hajros).

Në ndonjë rast, në vend të kamares së poshtme vendoset paneli i lulëzuar si në banesën Çabejve. Në qytetin e Beratit raftet e shek. 19 përqasen me ato të Gjirokastrës si në ndërtimin e flegrave ashtu tek kamaret e sipërme të gdhendura me bisqe të valëzuar. Ndryshojnë kamaret e poshtme anash të cilave gdhenden vazo lulembajtëse (fig. 23. Raft muri i shek. 19 në banesën 16 të lagjes Kala në Berat).

Sipas Emin Rizës, në fillim të shek. 19 në Gjirokastër u krijuan trapazanët në trajtë ballkoni të cekët ose si lozha të larta, me ballore të valëzuar, të daltuar me teknikën tej e mbanë (tejshpimi) të ndërlidhura me gardhim të ulët (balustrade). Të tillë i gjejmë në banesën e Skëndulajve, sot muzeu etnografik (fig. 24). Më vonë pas zhdukjes së trapazanit në vendin e tij mbeten tri harqet e musendrës[24].

[23] F. Shkupi, *Vep. cit,* fq. 116 – 123, ku flitet për helikat e rozetat diellore.
[24] E. Riza, *Vep. cit,* fq. 106 - 109, 150.

DO NOT COPY



*Fig. 22*

Ne do të përqendrohemi tek lloji i fundit për të shqyrtuar praninë e tij, njëkohësisht ndër të gjashtë nga qytetet kryesore shqiptare: Gjirokastër, Berat, Elbasan, Krujë, Dibër, Prizren. Gjatë gjithë studimit ne e vumë Beratin përkrah Gjirokastrës si qytetin më të afërt jugor të kësaj qendre me tipare të njëjta arkitekturore, duke u lënë rrugën e hapur qyteteve të tjerë që meritojnë trajtim të veçantë sipas pozitës gjeografike. Theksojmë se ndaj Gjirokastrës objektet e zbukuruara të Beratit janë pararendëse.

Në njërën nga brenditë e Çabejve, musandra është ndërtuar me flegra të thjeshta të ndara së gjati prej katër copa dërrase, pranë të cilave renditen nga tri kamare "një mbi një" të pajisura me harqe majuca, të zbukuruara me zogj tufëza rrëshqitëse. Përpara raftit, shtrihet sheshorja. Sipërfaqja e përkulur nga buza e sheshores deri tek shtroja zbukurohet me panelat e gdhendur te krahaskëmbyer me patavra të thjeshta. Sipër musandrës modelohet harku i luhatur si zemër Në banesat e tjera e gjejmë të shoqëruar prej dy harqesh rrethore anësorë. Në rastin tonë janë ndërtuar dy dritare katrore (fig. 25).



*Fig. 23*



*Fig. 24*

DO NOT COPY



*Fig. 25*



*Fig. 26*



*Fig. 27*

DO NOT COPY

Po vëmë në dukje musandrën e banesës Nr. 162 të lagjes 13 Shtatori (Mangalem) në Berat, ku përsëriten të njëjtat trajta arkitekturore me disa përjashtime. Flegrat e musandrës ndahen prej rombesh, sheshorja është pajisur me patavra të gjata pa zbukurime.

Në mes të harqeve shihen dritare rrethore (fig. 26). Shfaqje të tilla na qartësojnë se kjo lloj musandre me tri harqe e sheshore u zbatua në banesat e vilajeteve të Janinës, Manastirit e Shkupit. Nuk u përdor në vilajetin e Shkodrës, se zonat e mësipërme u përfshinë nga mjeshtrit e ardhur prej Reke, Zabzuni, Kosturi e Kolonja, që kishin lidhje të afërta, kurse Shkodrën e ndërtoi Golloborda dhe disa familje prej Zabzuni, që nuk ishin përzierë me Rekën. Mendojmë se një shtrirje e tillë e musandrës me harqe



*Fig. 28*

lidhet me lëvizjet e vazhdueshme të mjeshtërve dibrane, oparakë, kolonjarë e gjirokastritë të cilët këmbenin përvojën në mes tyre. Gjithashtu ndikoi tradita e ndodhjes së kamares së madhe lutëse për kujtimin e të parëve të familjes që u përdor më vonë si raft[25].

Tymtarët e rremë të shek. 19 në Gjirokastër plazmohen me ballore gjysmë cilindrike. Kufiza e harkut përfton trajta të luhatura rrethore ose valëzore në buzën e poshtme kurse harku i sipërm ruan një vijë të qetë. Mbi ballor ngrihet shatorja gjysmë konike e mbuluar me bisqe të përkulura deri në majë ku përfundon me tufëza gjethesh. Në të dy anët e tij ndodhen kamaret e vogla (fig. 27. Tymtari shek. 19 në banesën e Angonatëve). Dukuri të tilla vërejmë në qytetet e Beratit, të Elbasanit dhe Krujës, ku ndodhen tymtarë bashkëkohorë të shek. 19 me zbukurime të përafërta. Në këtë rast, buza e poshtme e ballorit paraqitet rrethore e drejtë (fig. 28. Tymtar i shek. 19 në banesën 32 të lagjes 8 Nëntori në Berat).

Tymtarët e lulëzuar hijeshuan për dy shekuj mjedisin e dhomës së miqve duke thyer me bardhësinë e tyre pajisjet e blerta e të kuqërremta të brendisë. Ata u përhapen nga Ballkani në Turqi si dukuri autoktone me zanafillë që në kohë tepër të lashta[26]. Si përfundim arritëm të njohim tiparet dalluese të zbukurimores me elementet përkatëse.

Gjatë shek. 19, brendia e dhomës gjirokastrite ruajti gjendjen e mëparshme arkitekturore duke e pasuruar atë me daltime dredhkash fletë-gjëra të luhatura ngathët, rozetat në trajtë ylli tetë cepash që paraqesin shqiponja, zogj të përballshëm, motive kokrrizore dhe rreze tufëzash. Tymtarët shfaqen me ballore gjysmë cilindrike e kurorë gjysmë konike të thjeshtë ose të zbukuruar me modelime dredhkash në stuko, të pa pikturuara. Panotë zhduken. Raftet përbëhen prej flegrash të daltuara në trajtë svastike dhe kamaret gdhenden me bisqe e kafshë fantastike. Musandrat pajisen me sheshore harkore, dhe tri harqe zemërza ose gjysmë hëna në vend të trapazanëve me ballkon. Këto krahasohen me simotrat e tyre të Kolonjës, Beratit, Elbasanit e Kosovës. Raftet e murit përputhen me shëmbëllesat e tyre më të lashta ose ndërkohore të Beratit. Tymtarët e bardhë, me daulle gjysmë cilindrike hasen në Shkodër, Dibër, Elbasan, Berat e Gjirokastër gjatë shek. 18 e fillimit të shek. 19. Ata me trajtë gjysmë prizmatike i gjejmë dhe në Shkodër nga mezi i shek. 19. Këta tymtarë të dytrajtshëm u përhapen në Maqedoni, Selanik, Brusë, e Stamboll sipas Haberlandit. Prejardhjen e tyre e gjetëm tek vatra shqiptare që nga gropa e zjarrit deri tek kulmari tympërhapës. Ata përfaqësuan në të gjitha kohërat mikpritjen të lidhur me besën e mbrojtjen kombëtare kudo në Shqipëri.

*Shënim: *Monumentet,* nr. 12, 1986, fq. 99 - 116

[25] H. Graillot, Zothecula, *Dictionnaire des antiquités grécque et romaines*, Paris, 1929, 1073 – 1074.

[26] F. Nopčsa, *Albanien, Bauten, Trachten und Geräte Nordalbaniens*, Berlin, Leipzig 1925, fq. 76 - 93.

DO NOT COPY

Fatbardha SHKUPI

DO NOT COPY

# L'ORNEMENTATION DE QUELQUES HABITATIONS DE GJIROKASTRA

Beaucoup de voyageurs et chercheurs du passe tel: Çelebi, Hani, Shuflai ont avancé des opinions sur la ville de Gjirokastra, mais ils se sont limités à la description de l'architecture.

Nous connaissons déjà l'architecture de la ville-musée par la monographie "La ville-musée de Gjirokastra" qui traite même l'intérieur de l'habitation. L'auteur nous fait connaitre l'évolution échelonnée des plafonds, des placards, des portes, des cheminées, ce qui nous aide à préciser leur catégorie artistique. Les principaux constructeurs de cette ville au cours des XVIII$^{e}$ - XIX$^{e}$ siècle vinrent de Kolonja, Luaras, Orgocka, Opar, Gramoz et Konice. C'étaient des sculpteurs de pierre, de bois et des peintres.

La position géographique de la ville permit des relations avec la ville de Shkodra au nord, le monastère de Joanina au sud, donc, favorisa l'échange de l'expérience de la création dans le domaine de l'ornementation de tout l'intérieur. Presque dans toutes les villes albanaises des XVIII - XIXe siècle, les intérieurs des habitations s'enrichirent de plafonds, de cheminées, de placards ornés de peintures ou en bois sculpté qui se différencièrent des autres chambres simples des deuxièmes étages.

En examinant les chambres peintes de ces intérieurs d'habitations de la fin du XVIII$^{e}$ siècle et du début du XIX$^{e}$ siècle, on remarque des formes de rinceau stylisées où de pair au motif de la tradition populaire, on sent l'influence de l'arabesque et des gobelins du type rococo et du style Directoire qui peut-être s'introduisirent par les échanges commerciaux avec l'Europe Centrale et Méridionale.

Cette manifestation qui apparait à la veille de la domination d'Ali Pacha de Tepelena, se poursuivant de manière isolée, sera substituée à l'époque de sa domination, par une ornementation réalisée essentiellement en bois, au cours du XIX$^{e}$ siècle. Malgré cela, entre les deux groupes d'ornementation, on remarque une suite organique des compositions peintes, typiques au XVIII$^{e}$ siècle, qui représentent des motifs populaires connus dans toutes les villes de l'Albanie. Il est évident que ces travaux sont guidés par des architectes à talent qui ont pu réaliser, de telles oeuvres importantes. Ali Pacha de Tepelena s'intéressa d'amener dans son pachalik des maitres affirmés de Dibra et de Kolonja.

Dans les habitations des XVIII$^{e}$-XIX$^{e}$ siècle qui conservent des valeurs architecturales et artistiques, les chambres se présentent hautes et allongées. Dans leur partie frontale s'allongent trois fenêtres à angles droits et dans quelques cas il y a aussi deux fenêtres latérales. Souvent dans le mur frontal sont percés de petites fenêtres en verre peint.

Le "trapazan" nommé aussi "dhipato", qui se situe du coté de l'entrée, au début du XVIII$^{e}$ siècle était fermé en panneaux de bois modelés en arcs ogives. Plus tard, vers la fin du XVIII$^{e}$ siècle et le début du XIX$^{e}$ siècle il s'enrichit de quatre au cinq arcs ondulés de style baroque.

Des deux côtés de "musandra", se trouvent trois niches superposées, comme dans les habitations d' Elbasan, tandis que les portes d'entrée et du W.C. conservent des arcs ondulés sans ornements, comme dans la ville de Shkodra. Sur l'un des murs latéraux se trouve la cheminée qui au cours du XVIII$^{e}$ siècle et au début du XIX$^{e}$ siècle se présente

sous forme prismatique pourvue d'une couronne et entourée des deux côtés de petites niches.

Une superficie octogonale allongée divisée en carrées est inscrite aux plafonds qui se présentent en angles droits. Les quatre triangles des côtés sont ornés de simples fleurs sculptées ou dotés de bouquets de feuilles en forme de rayon. Toutes les parties sculptées sont ornées de petites fleurs et de rinceaux peints dans quelques cas même les cheminées en stuc relief. Dans l'ornementation de la ville de Gjirokastra de la fin du XVIII[e] siècle et du début du XIXe siècle nous rencontrons des éléments typiques qui s'appliquent même a l'intérieur de l'habitation de Berat dès le début du XVIII[e] siècle, cela parce que les maitres affirmés s'éloignèrent de leur ville pour aller travailler ailleurs, après leur querelle avec les féodaux de Kurt Pacha.

Dans l'habitation des Zekat le plafond de la grande chambre des amis conserve un fond vert divisé en carreaux avec des f1eurs blanches au milieu. Les quatre triangles représentent des fleurs, tandis que les bandes latérales du plafond sont dessinées de rinceaux rouges et bleus. Au milieu sur un fond vert il y a des rais de coeur, des roses qui alternent avec deux pommes en couleur ocre limitées de rameaux vermeils. Le trait albanais se distingue particulièrement par la composition des roses et des pommes au lieu des jacinthes, des meulons et pastèques dont est remplie le répertoire de la décoration turque en arabesques dilatées. Sur le petit plafond du "tekke des Xhelvetie", du XVIII[e] siècle à Berat, on distingue les mêmes traits surtout à la deuxième bande où l'on remarque des groupes de deux pommes en couleur ocre entourées de rameaux jaunes qui alternent avec des fleurs vermeilles et des feuilles vertes.

Presque les mêmes motifs ornent la rosace octogonale située au centre.

Le motif de l'étoile kopte apparait premièrement dans les églises du XVIIe siècle à Berat, dans quelques habitations du quartier "Partizani" de cette ville et dans les habitations de Shkodra du XVIII[e] siècle. La décoration de l'habitation de Gjirokastra avec des lys blancs sur un fond vert était une manière personnelle de composition des maitres albanais.

Au contraire, le motif du soleil sur la rosace du grand plafond du « tekke des Xhelvétie » est réalisé par des feuilles allongées en guise de rayons spirales, que dans les contrées des Balkans, on les connait comme caractéristique de l'art albanais.

La mosquée des Xhelvetie fut peinte presque 25 années avant l'habitation des Zekat, à l'époque de la domination de Kurt Pache (d'après les inscriptions en 1782). Certainement les deux intérieurs représentent deux compositions différentes mais le mode d'application semble commun. En comparant les décorations de l'habitation des Zekat avec celles de la mosquée des Xhelvetie, on avance l'hypothèse que le groupe des constructeurs, après avoir construit la mosquée s'installa a Gjirokastra où au début du XIX[e] siècle travailla en respectant l'ancienne mode décorative. D'après les données de la région de Kolonja, les peintres de la décoration des intérieurs, a cette époque-la venaient de Pilkat, de Fjonjat, d'Ellova et Radimisht, des villages albanais de Gramoz.

Au traitement des cheminées de l'habitation de Gjirokastra, à l'intérieur de la forme connue on appliqua des éléments typiques particuliers qui demeurèrent des éléments propres à la décoration de cette ville. Dans l'habitation des Zekat, la cheminée supporte le tambour à sept faces où l'on distingue des panneaux peints de rameaux élancés de lys et d'églantines rouges avec des feuilles vertes et bruns de terre de Sienne. Le fond du tambour se présente ondulé en style baroque. Le baldaquin est entouré d'une couronne de feuilles plates et ondulées et d'une décoration en guise de rideau plissé et galonné. On y a modelé et peint des motifs pareils a ceux des plafonds avec des rinceaux de feuilles déclinées qui font la corniche de trois pommes des deux côtés de la couronne. La cheminée est pourvue de deux niches latérales courbées.

Les tambours des cheminées de Berat, construits par le groupe des maitres de Berat, Opar, Kolonje, au cours du XVIII[e] siècle, se présentent en forme prismatique.

Puisque dans la région de Kosova de Vardar, et d'Elbasan, au cours des XVIII[e] -XIX[e] siècle les maitres de Dibra réalisaient des cheminées avec des tambours cylindriques, nous pensons que les cheminées au tambour semi-prismatiques passèrent de l'Albanie méridionale à Shkodra et Lezhë, par la famille suliote d'Arsen Idromeno.

Les placards de cette époque se présentent assez simples. Dans quelques cas ils se composent de deux battants séparés d'un ruban ciselé et ils sont entourés de carreaux au milieux desquels se trouvent des quadrangulaires. Dans la partie supérieure se trouve la niche ajourée de motif rhomboïdal et de cercles entre liés par des listeaux de bois. Plus tard ces placards sont revêtus de peintures floréals ou de feuilles de

DO NOT COPY

vigne. Une rencontre des décorations géométriques de cette période dans tous les placards de l'Albanie, à Shkodra avec des lilas, fleurs de lis, à Kruja et à Elbasan avec des losanges ondulés et des quatre-feuilles. On en trouve même dans la ville de Berat. Une différence apparait dans les battants des placards de Shkodra et d'Elbasan, qui représentent des compositions de vases et de spires des rites tauroboles, tandis qu'à Kruja, Berat et Gjirokostra, les battants sont simples ou ornés légèrement de formes digitales et de rameaux.

Donc, au cours de la fin du XVIIIe siècle et du début du XIXe siècle les éléments typiques de la décoration de Gjirokastra, sont généralement les plafonds peints de rameaux et de feuilles plates en style hâtai, de pommes, les rosaces ciselées en guise d'Etoile kopte les cheminées au tambour prismatique, couronnés ornées de rameaux et de nature morte de fruits, les trapazans a balcons et les placards a battants simples a balustrade et niches décorées de motifs géométriques en guise de rampe, a nature morte de fruits, les panneaux muraux peints entre les cloisonnages et les placards composés de deux simples battants avec des niches en guise de rampe en losange et de petites fenêtres peintes en forme ovale, au-dessus.

Au début du XIXe siècle un groupe de maitre originaires d'Hormova de Tepelena, s'installa à Gjirokastra. Le chef de ce groupe, Nike Bashari, son fils Gjikë et les autres collaborateurs, sculptèrent beaucoup d'intérieurs. Grace à leur travail, l'ornementation de Gjirokastra évolua et s'orienta vers les sculptures en bois. Le maitre ne toucha rien à l'ordre de l'ornementation de l'intérieur, mais il substitua à la peinture la décoration sculptée.

En contemplant la chambre décorée par Nikë nous distinguons deux plafonds ornés de bandes sculptés en fouilles élancées alternées avec des guirlandes.

Vers la fin du XIXe siècle, les rosaces subissent quelques transformations. On n'utilise plus l'octogonal , mais on conserve le cercle limité d'une bande de double feuilles Sur le périmètre sont disposés huit demi-lunes avec des motifs de double feuilles, d'hélice, d'oiseaux affrontés des deux cotés de l'arbre de vie qui se présente granulée.

Au cours de ce siècle, les placards s'enrichirent des niches ornées de rinceaux, d'hélices. Quelques fois on distingue des oiseaux affrontés des deux cotés de l'ouverture. Les battons des placards sont réalisés par des carreaux, des placages en guise de svastika ou des parties rectangulaires. A la partie inférieure des battons se trouvent les niches baroques ornées de fleurs et de rinceaux bipennes. Des deux cotés des placards se profilent deux demi-colonnes avec des chapiteaux couverts d'une rangée de feuilles. Dans quelques cas au lieu de la niche on pratique le panneau-en fleur. Dans la ville de Berat, les placards du XIX$^{e}$ siècle ressemblent à ceux de Gjirokastra, tant par la construction des battons que par celle des niches inférieures aux cotés desquelles sont sculptées des portes-fleurs, qui diffèrent.

Au début du XIXe siècle a Gjirokastra, furent crées les trapazans en arcs assez bas de hautes loges avec des frontons ondulés reliés de balustrades. On en retrouve dans l'habitation des Skëndulaj. Plus tard, avec la disparition du trapazan, substituèrent seulement les trois arcs de «musandra».

Nous allons nous arrêter à ce dernier exemple pour mieux étudier sa présence simultanée dans six villes principales albanaises: Gjirokastër, Berat, Elbasan, Krujë, Dibër, Prizren.

Dans l'habitation des Çabej, «musandra» est composé de deux simples battants divisés en longueur par quatre panneaux de bois près desquels se superposent trois niches en arcs en ogive, ornées d'oiseaux et de rameaux.

En dessus de musandra est modelé l'arc ondulé en forme de coeur. Dans les autres habitations nous le trouvons accompagnée de deux arcs circulaires latéraux. Dans notre cas, on y a construit deux fenêtres carrées.

Nous rappelons ici le «musandra» d'une habitation du quartier «13 shtatori» (Mangalem Berat) ou se répètent les mêmes traits architecturaux avec quelques exceptions. Les battants du «musandra» se divisent en losanges, le plancher est pourvu de longues lattes sans circulaires.

De tels exemples nous montrent que cette sorte de «musandër» pourvu de trois arcs se pratiqua dans les habitations de Joanina, Manastir et Skopje. On ne l'utilisa pas dans la ville de Shkodra, parce que dans les zones déjà mentionnées travaillèrent des maitres venus de Reke , Zabzun, Kastoria et Kolonjë, tandis que dans celle de Shkodra des maitres de Golloborda et quelques familles de Zabzuni, qui n'étaient pas liés a Reka. Il parait qu'un tel emploi de «musandra» à trois arcs est lié aux continuels va-et-vient des maitres de Dibra, d 'Opar, de Kolonja et de Gjirokastra, qui échangeaient leur expérience.

DO NOT COPY

Les fausses cheminées du XIX^e siècle à Gjirokastra, sont réalisées avec des frontons demi-cylindriques. Au-dessus du fronton s'élève le tambour semi-conique couvert de rameaux courbés qui se terminent par des bouquets de feuilles. Des deux côtés se trouvent les petites niches. On remarqua de tels exemples dans les villes de Berat, Elbasan, Krujë. Dans ce cas, la partie inférieure du fronton est circulaire.

Au cours du XIX^e siècle l'intérieur de la chambre de Gjirokastër conserva la meme présentation architectonique en l'enrichissant de sculptures de rinceaux en feuilles plates de rosaces octogonales en forme d'étoile qui représentent des aigles, des oiseaux affrontés des motifs granulés et des rats de bouquets. Les «musandra» ressemblent à ses consoeurs de Kolonja, Berat, Elbasan et Kosove. Les placards ressemblent à ceux de Berat. Les blanches cheminées, a tambour cylindrique se rencontrent à Shkodra, à Dibër, à Elbasan, à Berat et à Gjirokastra au cours du XVIII^e siècle et au début du XIX^e siècle. Ceux en forme semi-prismatique se trouvent à Berat en cours du XVIII^e siècle, à Gjirokastra au début du XIX^e siècle  et à Shkodra, au milieu du XIX^e siècle.

DO NOT COPY

Prof. dr. Pirro THOMO

DO NOT COPY

# MANASTIRET E KRAHINAVE TË GJIROKASTRËS

Shekulli i XVI shënon një dukuri të re në ndërtimin e ndërtesave të kultit të krishterë. Përveç kishave, nga kjo periudhë janë ruajtur dhe mjaft manastire.

Një përhapje të madhe pati ndërtimi i manastireve dhe në krahinat e Gjirokastrës.

Manastiret janë ngritur larg fshatrave dhe sidomos në periudhën e parë të pushtimit osman, mënjanë rrugëve të komunikacionit. Ato ndërtohen në vende zotëruese, në pika sa më të mbrojtura, aq dhe piktoreske. Karakteri mbrojtës është një tipar i manastireve, i cili, në periudhën e parë ka qenë më i theksuar. Ato rrethoheshin me mure të larta dhe pajiseshin me frëngji, e ndonjëherë me kulla mbrojtëse.

Ndërtimet që përbëjnë manastiret ndahen në ndërtimet e kultit, kisha, trapezaria ose salla e ngrënjes, ambientet për shërbimet administrative dhe ato të banimit të klerit, ambiente për fjetje të besimtarëve ose konakët, ambientet për shërbyesit e manastirit, si dhe ambientet ndihmëse, ahure për bagëti, qilarë për zahiretë etj. Këto ndërtime formonin një tërësi arkitektonike, qendrën e të cilit e zinte kisha kryesore ose katolikoni. Ndërtesat mund të mos jenë të njëkohshme. Ato shtohen herë pas here me shtimin e fuqisë së manastirit, duke mbartur me vete karakteristikat e kohës së ndërtimit. Duke mos qenë të kushtëzuara nga kërkesa të kultit, ndërtesat kanë një trajtim arkitektonik më të lirshëm. Kompozimi i tyre është i ngjashëm me atë të haneve dhe të banesave, kategori ndërtimesh me të cilat kanë afërsi funksionale.

Sot manastiret kanë mbetur të shkretuara, kanë kohë që nuk funksionojnë. Si pasojë, konakët janë shkatërruar dhe shumë objekte, arkiva e biblioteka janë zhdukur._Por, mbishkrimet e shumta që janë mbledhur ose ruhet ende dëshmojnë se në këto manastire zhvillohej një jetë e gjallë monastike, me një veprimtari të dendur fetare, arsimore, shoqërore dhe ekonomike.

Me ndërtimin e manastireve, tipologjia e ndërtesave të kultit njohu një rritje të theksuar cilësore, me futjen e tipeve më të përparuar të tyre: kishave njënefëshe me qemere dhe atyre me kupolë, kishat me çati në formë kryqi dhe sidomos, kishat në formë kryqi me kupolë, me ose pa apsida anësore[1].

Periudha relativisht e hershme e ndërtimit të tyre si dhe tipologjia e përparuar e kishave flasin për një traditë të vjetër për ndërtime te tilla. Kjo i jep një farë baze gojëdhënave dhe supozimeve që kërkojne zanafillën e këtyre manastireve në periudhën bizantine. Këto supozime gjejnë mbështetje dhe në legjislacionin e administratës osmane, e cila, për ndërtimin e ndërtesave të kultit të krishterë jepte leje kryesisht për rindërtimin e tyre[2].

## KRAHINA E DROPULLIT

Shtrihet gjatë luginës së lumit Drinos, në rrëzë të Malit të Gjerë dhe të Stugarës. Fshatrat e Dropullit kanë një pozitë shumë piktoreske, të vendosura njëra pas tjetrës rrëzë Malit të Gjerë dhe buzë fushës së Dropullit. Ato shquhen

---

[1] Thomo P., *Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut*, Tiranë 1998

[2] Τσιτιμάκη M., *Παραδοσιακή Ναοδομία στη Λέσβο* (18ος-19ος αι), f. 101, dhe vijim. http://thesis.ekt.gr/thesisBookReader/id/17339#page/134/mode/2up; Rëmbeci, A., "Kuadri ligjor dhe lejet ndërtimore të autoriteteve osmane për objektet e kultit të krishterë gjatë shekujve XVIII-XIX", kumtesë e mbajtur në Konferencën: *50 vjet Studim edhe Restaurim i Trashësimisë Kulturore në Shqipëri*, Tiranë, 22-23 tetor 2015








*Kisha e manastirit të Profet Ilias, Jorgucat,*
*Fig. 1. Planimetria*
*Fig. 2. Pamja veriore*
*Fig. 3. Mbishkrimi i narteksit*

gjithashtu për strukturën urbanistike të dendur dhe banesat solide dykatëshe prej guri.

Gërmimet arkeologjike dëshmojnë për një banim të hershëm të kësaj krahine. Pranë fshatit Sofratikë janë zbuluar rrënojat e një teatri, tempulli dhe nekropoli, të cilat mendohet se i përkasin qytetit antik të Hadrianopolit. Në këtë krahinë duhet kërkuar dhe selia e Peshkopatës së Drianopojës. Sipas një hipoteze, qendra e peshkopatës ka qenë në fshatin Melan, i cili identifikohet me Justianopolisin, qytet i shek. V-VI, i përmendur nga Prokopi i Cezaresë. Por nuk është pa vlerë dhe hipoteza tjetër që e vendos qendrën peshkopale të Drianopojës në fshatin Peshkopi, jo vetëm duke u nisur nga emri, por dhe nga ekzistenca e kishës se Shën Marisë, e cila përmban në apsidë *sinthronin*, të formuar me tri radhë shkallësh me fronin peshkopal në mes.

Duke filluar nga shek. XVI u ngritën një numër i madh manastiresh në shpatin lindor të Malit të Gjerë, nga të cilat hapet një pamje e gjerë e luginës së Drinosit.

**Manastiri i Profet Ilisë mbi fshatin Jorgucat**

Ngrihet rreth një orë e gjysmë mbi fshatin Jorgucat, në një pllajë të vogël e të zhveshur të Malit të Gjerë. Sot ka mbetur e plotë vetëm kisha kushtuar Profet Ilisë, ndërsa ndërtesat e tjera të manastirit pothuajse janë rrënuar krejtësisht, kështu që nuk na japin mundësi të gjykojmë për madhësinë e tij. Por, mbishkrimet dhe dokumentet e vjetra të grumbulluara më parë flasin për rëndësinë e këtij manastiri dhe për lidhjet e gjera që ka pasur jo vetëm me fshatra të tjera të krahinës, por dhe me fshatra e qendra më të largëta. Kështu, mbishkrimi në bazën e një kryqi me datë 1682 na njeh me dhuruesin, Dhimitri Komninis Elbasanasin[3]. Në faqet e një diptiku janë shënuar emrat e vendeve, që siç duket kanë pasur lidhje me manastirin, si: Goranxia, Eleusa, Voskopoja, Jorgucati, Hormova, Kështjella e Beratit, Skorea, Tranoshista, Hllomova, Dhrovjani e Përmeti[4].

Kisha e manastirit ka përmasa të vogla. Ajo i përket tipit të kishave njënefëshe të mbuluara me qemer cilindrik të pandërprerë dhe me apsida anësore (fig. 1). Nga ana perëndimore

[3] Πουλίτσα Π. Η., «Επιγράφαι και ενθυμήσεις εκ της Βορείου Ηπείρου», *Επετηρίς Εταιρείας Βυζαντινών Σπουδών*, Αθήναι 1928, f. 61
[4] *Po aty*, f. 82-83

DO NOT COPY

lidhet me narteksin, gjithashtu të mbuluar me qemer cilindrik, i cili paraprihet nga një ambient i mbyllur, i mbuluar me çati druri. Në pamjen e jashtme mbizotëron volumi prizmatik i gurtë i kishës, i mbuluar nga çatia treujëse, nga i cili shkëputen volumet e apsidave. Pamjet e jashtme janë të zhveshura nga përpunimi dekorativ (fig. 2). Të vetmet elemente që tentojnë të thyejnë ftohtësinë e sipërfaqeve të rrafshta të muraturës së gurtë janë niket e verbëta të apsidës lindore dhe një harkadë, që i bashkëngjitet murit verior, mbi të cilën është vendosur një ulluk që mbledh ujërat e shiut nga çatia dhe i dërgon në stere.

Tipologjia e thjeshtë e kishës dhe mungesa e theksuar e elementeve dekorative flasin për një datim të hershëm përsa i përket ndërtimit të saj. Mbishkrimi mbi portën e brendshme të naosit na jep si datë të pikturimit të tij vitin 1586 dhe na njeh me piktorin, murgun Niqifor, që e realizoi atë[5]. Një mbishkrim tjetër, që bën fjalë për pikturimin e narteksit, mban datën 1617 dhe emrin e piktor Mihalit nga Linotopi[6] (fig. 3), i njohur nga veprimtaria e tij edhe në kishat e tjera të kësaj krahine dhe të krahinave përreth (fig. 4).

**Manastiri i Shën Marisë së Drianos**

Ngrihet mbi një nga lartësitë e vargmalit të Dropollit që ndan luginën e Dropullit me ultësirën e Vurgut. Vendi përreth sipas traditës ka qenë tepër i pyllëzuar me lisa (δάση των δρυών), gjë që ka bërë të supozohet që prej tyre të ketë marrë emrin Δρύνος, Δρύανος. Ka qenë një nga manastiret më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm, i cili frekuentohej dendur nga banorët e krahinave përreth. Por emri dhe fama e tij i kishin kaluar me kohë kufijtë e vendit. Mbishkrimet e botuara apo të ruajtura ende janë një kronikë e gjallë e historisë së manastirit dhe lidhjeve të tij me botën. Kështu mësojmë se më 1650-n, dy klerikë kanë ardhur nga Moldavia dhe lanë borxhin manastirit prej katërmijë asprash[7] (Në vitin 1650 erdhën nga Moldavia, unë Papa Dositheu, igumeni i Shën Gjergjit dhe Papa Dionisi dhe lamë borxhin 4 mijë aspra…). Mbreti i Moskës Mihail Theodhorocki i ka bërë dhuratë manastirit potirin[8] (Cari i shumëdevotshëm i gjithë Moskovisë Mihail



*Fig. 5. Manastiri i Shën Marisë së Drianos, hyrja e manastirit*

Theodoroçki i dhurova diskopotirin Manastirit të nderuar Fjetjes së Hyjëlindëses në vendin e quajtur Driano, për shpëtimin e shpirtit tim). Dhurata i kanë bërë manastirit dhe shumë të tjerë nga qendra të tjera të largëta, si Ungrovllahia[9] si dhe më të afërta, si nga Korfuzi[10] Kalqeladhon[11] etj.

Për madhësinë e manastirit dëshmojnë ndërtimet madhështore të mbetura, qoftë dhe në gjendje jo të plotë, si dhe një numur i madh rrënojash. Ndër to dallojnë për nga përpunimi arkitektonik ndërtesa që mbyll oborrin në anën jugore, një ndërtim trekatësh me krahë të dala, të cilat shëmbëllejnë me kullat e fortifikimeve, ndërsa në pjesën qendrore është vendosur porta kryesore e hyrjes për në manastir (fig. 5). Një ndërtesë tjetër në anën lindore ngrihet në pikën më të lartë të oborrit në formë kulle (fig. 6). Sipas një mbishkrimi të gdhendur mbi një pllakë guri, magjirioja (kuzhina) e manastirit është ndërtuar më 1777[12].

Katolikoni ka filluar së ndërtuari në vitin 1569[13], kur murgu Kalist ngriti kolonat e tij (fig. 7). Përbëhet nga naosi

[5] Popa Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, mb. 530
[6] *Po aty,* mb. 540
[7] *Po aty*, mb. 560
[8] *Po aty*, mb. 785
[9] Πουλίτσα, *vep. cit.,* f. 59
[10] Popa, *vep. cit.,* mb. 645
[11] *Po aty,* mb. 576
[12] *Po aty,* mb. 602
[13] *Po aty,* mb. 526

DO NOT COPY









DO NOT COPY

*Manastiri i Shën Marisë së Drianos*
*Fig. 6. Kulla e manastirit Fig. 7. Planimetria dhe prerja gjatësore e kishës së manastirit*
*Fig. 8. Pamja verilindore e kishës së manastirit*





*Manastiri i Shën Marisë së Drianos*
*Fig. 9. Pikturë murale e kishës së manastirit*
*Fig. 10. Fragment ikonostasi i kishës së manastirit*

dhe narteksi në anën perëndimore, ndërsa hajati i hapur në pjesët ballore dhe anësore me hapësira të harkuara është shtuar në një fazë të dytë. Naosi me përmasa të brendshme 7,20x5.80 m i përket tipit në formë kryqi me kupolë. Muratura e ndërtuar me gurë dhe e suvatuar nga jashtë është e zhveshur nga përpunimi dekorativ (fig. 8). Përkundrazi, i gjithë interieri është i veshur me piktura murale të një cilësie të mirë artistike (fig. 9, 10).

**Manastiri i Ungjillëzimit mbi fshatin Vanishtë**

Ndodhet rreth 3/4 e orës mbi fshatin Vanishtë. Është një manastir i vogël, por me vlera arkitektonike dhe artistike.

Muri rrethues mbyll një oborr thuajse katror, i sistemuar me dy tarraca në nivele të ndryshme. Nga ndërtesat e manastirit ruhen në gjendje gjysmë të rrënuara, krahu verior përdhe, ku janë vendosur kuzhina dhe ambientet ndihmëse, kulla me steren e ujit në qoshen veriperëndimore të kishës dhe krahu jugor dykatësh (fig. 11, 12).

Me interes për zgjidhjen e saj arkitektonike e funksionale është kulla. Në pjesën e poshtme të saj ndodhet stera e ujit, që grumbullon ujërat e shiut, ndërsa dy katet e sipërme, njëkthinëshe, përdoreshin për banim. Balli i katit të sipërm (sot i modifikuar) ishte ndërtuar me konstruksion çatmaje dhe dilte në formë erkeri mbi muraturën e gurtë të pjesës së poshtme (fig. 13, 14).

Krahu jugor duhet të përmbante dhomat e pritjes në kat dhe qilaret poshtë tyre. Në anën lindore të këtij krahu ngrihet një ndërtim i veçantë, i cili mund të ketë shërbyer si igumenio (vendqëndrimi i kryemurgut). Ai përmbante në katin e sipërm një hajat të hapur, i cili del në formë ballkoni mbi portën e hyrjes së manastirit (fig. 15). Prej këtej hapej një pamje e gjerë e luginës së Drinosit, duke krijuar një ambient shumë të këndshëm qëndrimi në kohë të ngrohtë.

Në qendër të oborrit ngrihet kisha. Mbishkrimi i gdhendur mbi një tullë të murosur në faqen e jashtme të apsidës na jep datën e ndërtimit të kishës, në vitin 1582[14]. Kisha përbëhet nga naosi, narteksi dhe eksonarteksi (fig. 16).

Naosi është një nga shembujt më të arritur të tipit në formë kryqi me kupolë me apsida anësore. Këtu i është kushtuar kujdes si proporcionimit të brendshëm në plan dhe

[14] *Po aty,* mb. 527

DO NOT COPY






*Manastiri i Ungjillëzimit, Vanishtë*
*Fig. 11. Pamje e përgjithshme e manastirit sot, Fig. 12. Genplani*





*Fig. 13, 14. Manastiri i Ungjillëzimit, Vanishtë, kulla e steres së ujit, në vitin 1967 dhe sot*

DO NOT COPY









DO NOT COPY

*Manastiri i Ungjillëzimit, Vanishtë*
*Fig. 15. Çardaku i igumenios, 1967, Fig. 16. Planimetria dhe prerja gjatësore e kishës së manastirit*
*Fig. 17. Pamja veriore e kishës së manastirit, Fig. 18. Pikturë murale e kishës së manastirit*

hapësirë, gjë që pasqyrohet dhe në ndërtimin e jashtëm, ashtu edhe në përpunimin dekorativ të elementeve më kryesore.

Në qendër ngrihen katër kolona dhe mbi to kryqëzohen qemeret cilindrike, duke krijuar katrorin qendror, ku ngrihet kupola mbi një tambur të lartë. Krahët verior dhe jugor janë të ngushtë, por hapësira e tyre zmadhohet nga hapësirat e apsidave që dalin tej këtyre faqeve. Boshti lindje-perëndim më i gjatë i vetë naosit, si dhe narteksi e ambienti shtesë në anën perëndimore, i kanë dhënë ndërtesës pamjen e një katërkëndëshi të zgjatur në plan. Pikërisht në këtë bosht janë vendosur hyrjet në narteks dhe nëpërmjet narteksit në nefin qendër të naosit. Në këtë mënyrë, ky bosht përcakton lëvizjen kryesore dhe, në përputhje me këtë, është bërë ndërtimi i strukturave. Mbulesat gjatë këtij drejtimi kanë formuese lindje-perëndim, ndërsa qemeret e pjesëve të tjera, të ambienteve këndore, nefit tërthor dhe të narteksit, hapen ndaj drejtimit kryesor të lëvizjes. Përveç këtij boshti gjatësor, në formulimin e ndërtesës është i pranishëm dhe një bosht tjetër vertikal. Lartësia e mbulesave cilindrike të krahëve të kryqit arkitektonik është mjaft e madhe, për të dhënë mundësinë e boshtit vertikal nën kupolë të konkurrojë boshtin horizontal, pa prishur ekuilibrin e proporcionit në lartësi të pjesëve të ndryshme të brendësisë së ndërtesës.

Në ndryshim me proporcionimin e brendshëm, nga jashtë kisha ka një formë të zgjatur, meqenëse jo të gjitha strukturat e brendshme shfaqen në çati. Ato mbulohen nga një çati dyujëse, e cila ndërpritet nga mbulesat e nefit tërthor, duke formuar në pamjet veriore dhe jugore dy frontone trapezoidale. I vetmi element vertikal është tamburi që ngrihet në ndërprerjen e çatisë gjatësore me çatitë tërthore të krahëve veriorë dhe jugorë (fig. 17).

Muratura është punuar pastër dhe thjeshtë prej guri. Një kujdes më i madh i është kushtuar përpunimit të disa elementeve: kornizave, apsidave dhe tamburit. Apsida lindore është trefaqëshe me nike të harkuara nga sipër, ndërsa ato veriore dhe jugore janë rrethore dhe përmbajnë një varg nikesh të ngushta e të gjata, të harkuara nga sipër. Më i pasur me elemente dekorative është tamburi tetëfaqësh, ku çdo faqe është e përpunuar me nike të shkallëzuara, në formën e harqeve perspektive, të cilat jo vetëm që theksojnë ngritjen e tij në lartësi, por i japin më tepër plasticitet dhe në dukje e lehtësojnë atë. Për efekt dekorativ, ndërtuesit kanë kombinuar në muraturën e tamburit gurin dhe tullën, duke e përdorur këtë të fundit në harqet e nikeve dhe duke krijuar në intervale të caktuara breza horizontale.

Nga brenda kisha ruan piktura murale që veshin gjithë sipërfaqen e muraturës. Për pikturën e narteksit mësojmë nga mbishkrimi i pikturuar mbi portën e narteksit se është vepër e piktorit të njohur nga një veprimtari e dendur e ushtruar në kishat e rrethit të Gjirokastrës, Mihalit nga Linotopi pranë Kosturit, i cili e përfundoi në vitin 1617[15] (fig. 18).

### Manastiri i Shën Qiriakut dhe Julitës mbi fshatin Dhuvjan

Pranë fshatit Dhuvjan, në mes të një gjelbërimi të dendur ngrihet një manastir, vërtet i vogël, por me vlera të veçanta arkitektonike.

Manastriri ka një kompozim tepër të ngjeshur. Në qendër të oborrit ngrihet kisha, e cila rrethohet nga të gjitha anët nga ndërtimet e manastirit, duke lënë ndërmjet tyre rrugica të ngushta të shtruara me pllaka guri. Sipas mbishkrimit të gdhendur mbi arkitraun prej guri të portës së narteksit, kisha është ndërtuar ne vitin 1588[16]. Ajo është e tipit arkitektonik në formë kryqi me kupolë me një kompozim të përbërë (fig. 19). Krahu lindor i kryqit arkitektonik është tepër i zgjatur dhe i formuar prej dy pjesësh, ndërmjet të cilave është vendosur ikonostasi, i cili ndan naosin nga ambienti i altarit. Në këtë mënyrë, bërthama qëndrore në formë kryqi është tepër e plotë dhe e ndarë qartë me ambientin e altarit.



*Fig. 19. Manastiri i Shën Qiriakut dhe Julitës, Dhuvjan, planimetria e kishës së manastirit*

[15] *Po aty,* mb. 542
[16] *Po aty,* mb. 531

PO NOT COPY





*Fig. 20. Manastiri i Shën Qiriakut dhe Julitës, Dhuvjan, pamja veriore e kishës së manastirit*
*Fig. 21. Kambanarja e kishës së manastirit*





*Fig. 23, 24. Manastiri i Shën Qiriakut dhe Julitës, Dhuvjan, konakët e manastirit në vitin 1967 dhe sot*

Në anën perëndimore lidhet me narteksin, i cili nga ana e tij paraprihet nga eksonarteksi, i shtuar më vonë.

Në pamjen e jashtme kisha ka një shtrirje gjatësore, por megjithatë, struktura në formë kryqi shfaqet qartë, gjë që i jep kompozimit volumor të jashtëm një karakter tepër dinamik (fig. 20). Është ndërtuar me gurë shtresorë, por në një fazë të dytë është suvatuar. Ne kundërshtim me sipërfaqet e rrafshta të muraturës, faqet e tamburit të kupolës dhe të apsidës janë gjallëruar me nike të verbëta e të shkallëzuara.

Në qoshen veriperëndimore të eksonarteksit lartësohet kambanarja si një bllok i vetëm guri, i cili lehtësohet në pjesën

DO NOT COPY

e sipërme me një hapje dyshe të harkuar dhe me një hapësirë të harkuar sipër saj, ku është vendosur kambana (fig. 21).

Naosi është i veshur me pikturë murale. Mbishkrimi i pikturuar mbi portën e narteksit na jep datën 1595 të pikturimit të tij, si dhe datën 1873 të ripërtrirjes së pikturës[17] (fig. 22).

Ndër ndërtesat e manastirit konaket për bujtje të besimtarëve, të cilët fatkeqësisht tani janë gjysmë të rrënuar, kishin një formulim arkitektonik tepër të përpunuar. Ata rrethonin katolikonin në anën perëndimore dhe kishin në plan formën e shkronjës U (fig. 23, 24). Janë dykatëshe me hajate në të dy katet, të cilët ndërlidheshin me shkallë paradë prej guri me dy rampa, të ndëruara në pjesën qendrore. Kati përdhe, i cili përdorej për katoje, hapet ndaj kishës me një harkadë mbi kolona guri, ndërsa kati i sipërm, ku ishin vendosur qelitë, hapej me një varg kolonash druri.

**Manastiri i Shën Marisë së Ravenës mbi fshatin Goranxi**

Rreth një orë në këmbë nëpër monopate shkëmbore nga fshatin Goranxi, mbi një pllajë të Malit të Gjerë ngrihet një nga manastiret më të mëdhenj të Dropullit të Poshtëm, i njohur për pasurinë dhe bukurinë e tij. Sot ruhet e plotë vetëm kisha, ndërsa konakët janë në gjëndje rrënoje (fig. 25).

Hyrja për në manastir bëhet nga ana veriore, nëpërmjet një porte të harkuar, të mbrojtur nga një portik me dy kolona (fig. 26). Data 1877 e gdhendur mbi një pllakë guri e murosur



*Fig. 25. Manastiri i Shën Marisë së Ravenës, Goranxi, pamje e përgjithshme e manastirit sot*

[17] *Po aty,* mb. 532







*Manastiri i Shën Marisë së Ravenës, Goranxi*
*Fig. 26. Hyrja e manastirit*
*Fig. 27, 28. Konakët perëndimorë të manastirit*

DO NOT COPY

mbi harkun e portës mund të jetë data e ndërtimit të portës. Mbrenda mureve rrethuese që mbyllin një oborr thuajse katror, janë ndërtuar qelitë, depot dhe ambiente të tjera shërbimi, ndërtesa këto përdhese dhe me kat. Ndër to ruhet në gjëndje të dëmtuar krahu perëndimor. Ai përbëhet nga një ndërtesë dykatëshe, me hajate në të dy katet, me dhoma të mëdha sipër dhe depo e qilare poshtë. Në anën jugore i bashkangjitet një ndërtesë e mbyllur (fig. 27), ndërsa na qoshen veriperëndimore të saj ngrihet një ndërtesë tjetër dykatëshe, e cila mund të ketë shërbyer si igumenio (fig. 28). Balli i katit të sipërm të saj është i ndërtuar me konstruksion çatmeje dhe përmban motive të pasura dekorative. Manastiri ka patur dhe magjirion (kuzhinën), e cila ka qenë ndërtuar në vitin 1773[18].

Në mes të oborrit ngrihet kisha kushtuar Fjetjes së Shën Marisë. Sipas mbishkrimit të gdhendur në një pllakë guri mbi portën e narteksit, kisha është ndërtuar në vitin 1600[19] nga naosi, të cilit i bashkëngjitet në anën perëndimore narteksi dhe, më tej, eksonarteksi.

Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë dhe me apsida anësore (fig. 29, 30). Veçanti e saj, që e dallon nga kishat e tjera të së njëjtës krahinë dhe periudhë, por që njëkohësisht përbën një rast unikal në arkitekturën pasbizantine, është dekoracioni i saj i jashtëm. Apsidat, tamburi i kupolës dhe dritaret e apsidave përmbajnë kolonçina prej guri të lidhura me harqe, të cilat duke u ndërprerë ndërmjet tyre krijojnë një harkadë me harqe të mprehta (fig. 31). Në timpanet e harqeve janë vendosur relieve me motive zoomorfe dhe anthropomorfe (fig. 32). Forma dhe motive të tilla janë të pazakonshme për arkitekturën bizantine. Kjo i ka shtyrë studiuesit të supozojnë për një ndikim perëndimor.

E gjithë sipërfaqja e brendshme e kishës është e mbuluar me pikturë murale e një cilësie të lartë artistike, e cila ruhet në gjëndje relativisht të mirë (fig. 33). Piktura, e cila mbetet anonime, në qoftë se e përgjithësojmë me mbishkrimin që gjendet poshtë skenës së Platiterës në konkën lindore, duhet të jetë realizuar në vitin 1622[20] (fig. 34, 35). Ruhet gjithashtu ikonostasi prej druri të gdhendur me ikonat e






*Manastiri i Shën Marisë së Ravenës, Goranxi*
*Fig. 29. Planimetria e kishës së manastirit*
*Fig. 30. Pamja juglindore e kishës së manastirit*

mëdha në brezin e poshtëm dhe ikonat e dymbëdhjetë festave në brezin e sipërm. Ikonostasi duhet të jetë vepër e shek. 18, në qoftë se nisemi nga mbishkrimi me vitin 1775 i ikonës së Fjetjes së Shën Marisë, e pikturuar nga i biri i Athanasit Kapesovitit dhe e dhuruar nga Zambetas Haxhi

[18] Πουλίτσα, *vep. cit.,* f. 63
[19] Popa, *vep. cit*., mb. 533
[20] Γιακουμής Γ., *Η Ιερά Μονή Ραβενίων Δρόπολης*. Athina: Bastas-Plessas, 1995

DOKTORATURË





*Manastiri i Shën Marisë së Ravenës, Goranxi.*
*Fig. 31. Tamburi i kishës së manastirit*
*Fig. 32. Dekoracioni i apsidës së kishës së manastirit*

Vasiliu nga Gjirokastra[21]. Manastiri kishte gjithashtu dhe vulën e saj që mbante datën 1622[22].

**Manastiri i Kryeengjëjve - Derviçan**

Ngrihet rreth një orë mbi fshatin Derviçan. Pranë manastirit ndodhen dy pareklise, e Burimit Jetëdhënës dhe e Shën Anës ose e Panajatopullës, si dhe një zonë mbushur me rrënoja banesash të vjetra. Ato na dëshmojnë për vendbanimin e hershëm të Derviçanit, i cili duhet të jetë braktisur dhe të ketë zbritur afër fushës rreth shek. 17[23].

Në qendër të oborrit të rrethuar me mure ngrihet kisha si ndërtimi kryesor i manastirit. Ajo qarkohej nga të gjitha anët me ndërtime të karakterit dhe periudhave të ndryshme, duke lënë rreth kishës rrugica të ngushta, të shtruara me pllaka guri (fig. 36, 37). Kisha përbëhet nga naosi dhe narteksi. Naosi është i tipit në formë kryqi me apsida anësore ose i tipit athonik (fig. 38). Ndryshe nga kishat e tjera të këtij tipi, këtu kupola qendrore nuk ngrihet mbi tambur. Gjithashtu, edhe pamjet e jashtme nuk e pasqyrojnë aspak kompozimin e brendshëm hapësinor. Ato të kujtojnë më tepër kishat e tipit bazilikal me çati dyujëse (fig. 39). Në anën perëndimore i bashkëngjitet narteksi dykatësh, mbi murin perëndimor të të cilit ngrihet kambanarja. Një ndërtim i tillë krijon një kompozim të jashtëm volumetrik të shkallëzuar: nga volumi i naosit shkëputen volumet më të ulta të apsidave, ndërsa në krahun perëndimor ngrihet volumi i lartë i narteksit me kambanaren, si theksim vertikal jo vetëm i kishës, por dhe i të gjithë kompleksit të manastirit. Të gjitha ndërtesat e manastirit ishin të ndërtuara me gurë shtresorë, akoma dhe çatitë janë të mbuluara me pllaka guri. Gjithashtu edhe detajet dekorative, si kornizat që përfundojnë muraturën, harqet e verbër që gjallërojnë apsidat etj., janë të realizuara prej guri. Kjo krijon pështypjen e një mase të gurtë të përpunuar, e cila harmonizohet me terrenin përreth të zhveshur e shkëmbor.

Nga brenda naosi është i veshur me piktura murale, të cilat përmbajnë ritokime të mëvonshme (fig. 40, 41).

Kisha nuk ruan mbishkrim për datën e ndërtimit ose të pikturimit. Por, duke u nisur nga tiparet tipologjike dhe morfologjike, si mungesa e tamburit të kupolës, pamja e

[21] Πουλίτσα, *vep. cit.,* f. 63
[22] Popa, *vep. cit.,* mb. 546
[23] Riza E., Thomo P., "Karakteri dhe tiparet e vendbanimeve fshatare shqiptare në shek. XV-XVIII", *Kultura Popullore*, 2, 1983, f. 123-150

DO NOT COPY











DO NOT COPY

*Manastiri i Kryeengjëjve, Derviçan*
*Fig. 36, 37. Ndërtime të manastirit, 1967*
*Fig. 38. Planimetria dhe prerja gjatësore e kishës së manastirit*
*Fig. 39. Pamja jugore e kishës së manastirit*





*Manastiri i Kryeengjëjve, Derviçan*
*Fig. 40. Pikturë murale e kishës së manastirit*
*Fig. 41. Fragment ikonostasi i kishës së manastirit*

jashtme bazilikale etj., ajo mund të reshtohet në kishat e shek. 18, periudhë kur tipi bazilikal bëhet mbizotërues dhe kishat në formë kryqi me kupolë ndërtohen gjithnjë e më rallë.

**Manastiri i Shën Triadhës - Pepel**

Është një nga manastiret më të dëgjuar të Dropullit të Sipërm. Legjenda të shumta janë thurur për këtë manastir dhe kishën e tij. Ajo që ka arritur deri në ditët tona tregon për një ndriçim shumëngjyrësh që banorët e fshatrave përreth shihnin të dilte nga pylli, ku sot ngrihet manastiri. Ky ndriçim dilte nga ikona e Shën Triadhës, të cilën banorët e morën dhe e vendosën në kishën e fshatit. Por ikona nuk qëndronte aty dhe rikthehej në vendin e mëparshëm. Atëhere vendasit e kuptuan që ikona nuk duhej prekur dhe ndërtuan aty një kishë të vogël për nder të saj. Me kalimin e kohës kisha u zgjerua dhe përreth u ndërtua një kompleks i madh manastiror. Këtu çdo vit, në muajin Maj, organizoheshin panaire të mëdha tregtare. Sot nga ky manastir i madh ka mbetur e plotë vetëm kisha, dhe një numur i madh rrënojash të ndërtesave të dikurshme.

Hyrja për në manastir bëhej nëpërmjet një porte të hapur në katin përdhe të një ndërtese që mbyll oborrin e manastirit, të ndërtuar në vitin 1843 (fig. 42). Porta ishte e mbuluar me harqe të ndërtuara me gurë të gdhendur, që përmbanin reliefe të shumta dekorative. Ajo mbrohej nga një frëngji e nxjerrë sipër saj. Në anën jugore të kishës ruheshin rrënojat e një ndërtese me kompozim karakteristik për ndërtesat e manastireve: ajo kishte një shtrirje në gjatësi, në katin përdhe të së cilës zhvillohej hajati i hapur me një harkadë prej guri, ndërsa në katin e sipërm, hajati duhet të ketë qenë prej druri (fig. 43).

Kisha e manastirit përbëhet nga naosi, narteksi në anën perëndimore, një portik me tre hapësira të harkuara përpara hyrjes jugore të narteksit dhe nga kambanarja që lartësohet mbrapa portikut, mbi hyrjen e narteksit (fig. 44). Naosi ka një kompozim ndërmjet tipit në formë kryqi me kupolë dhe tipit bazilikal trenefësh, i mbuluar me një sistem harqesh, qemeresh dhe kalotash sferike (fig. 45). Katër kolonat, që lidhen me harqe në të dy drejtimet, krijojnë bërthamën

DO NOT COPY







DO NOT COPY

*Manastiri i Shën Triadhës, Pepel*
*Fig. 42. Porta e hyrjes së manastirit, 1967, Fig. 43. Konakët jugorë të manastirit, 1967*
*Fig. 44. Kambanarja e kishës së manastirit*

qendrore të mbuluar me kalotë sferike, e cila nuk ngrihet lart me tambur. Krahu lindor i kryqit mbulohet gjithashtu me kalotë sferike, ndërsa gjithë bërthamat e tjera, të kryqit perëndimor dhe të nefeve anësore, janë të mbuluara me qemere çerekrrethore. Por, ky sistem i larmishëm i interierit është i fshehur në pamjen e jashtme nga çatia e gjerë e mbuluar me pllaka guri. Gjithashtu, në ndryshim me interierin, pamja e jashtme është e thjeshtë dhe e varfër nga përpunimi dekorativ (fig. 46).

Kisha është e tëra e pikturuar (fig. 47). Mbishkrimi na njeh me piktorin, Adhamin nga Theotoqi, që i ka realizuar ato në vitin 1754[24].

[24] Popa, *vep. cit.*, mb. 584







DO NOT COPY

*Manastiri i Shën Triadhës, Pepel*

*Fig. 45. Planimetria dhe prerja gjatësore e kishës së manastirit*

*Fig. 46. Pamja jugore e kishës së manastirit*

*Fig. 47. Pikturë murale e kishës së manastirit*

**Manastiri i Shën Marisë - Koshovicë**

Në vargun e gjatë të manastireve të Dropullit, manastiri i Koshovicës është më skajori, pranë kufirit me Greqinë. Nga manastiri ishin të ruajtura kisha dhe një ndërtesë. Ndërtesa ishte dykatëshe, nga të cilët, kati përdhe përdorej për katoje, ndërsa i sipërmi për banim. Hyrja për në katin e sipërm bëhej me shkallë guri dyrampëshe, që mbështeteshin mbi një qemer cilindrik në pjesën qendrore dhe që përfundonin me një portik, ose strehë me dy kolona guri përpara hyrjes (fig. 48).

Nga kisha ruhet vetëm naosi, ndërsa narteksi në anën perëndimore është i rrënuar. Lidhur me datimin na vijnë në ndihmë mbishkrimet në një ikonë të Shën Marisë dhe në pikturën e kubesë me datë 1669[25] (fig. 49).

Naosi i përket tipit në formë kryqi me kupolë dhe me apsida anësore (fig. 50). Megjithëse i takon një date relativisht më të vonë në krahasim me kishat e tjera të krahinës të të njëjtit tip, tiparet arkitektonike nuk janë më të përpunuara, përkundrazi ato janë më të thjeshtësuara. Kjo dëshmon edhe një herë se tipi në formë kryqi me kupolë po e mbaronte rrugën e zhvillimit të vet, duke i lënë vend përhapjes së tipit bazilikal, që po fillon të bëhet mbizotërues. Edhe këtu, struktura e brendshme në formë kryqi nuk pasqyrohet në pamjet e jashtme, të cilat të japin përshtypjen se kemi të bëjme me një bazilikë me kupolë (fig. 51). Muratura është e ndërtuar me gurë, ku mungon thuajse çdo përpunim dekorativ.










DO NOT COPY

*Manastiri i Shën Marisë, Koshovicë*

*Fig. 48. Konaku i manastirit, 1967, Fig. 49. Fragment ikonostasi i kishës së manastirit, Fig. 50. Planimetria e kishës së manastirit, Fig. 51. Pamja jugperëndimore e kishës së manastirit*

[25] *Po aty*, mb. 569

## KRAHINA E POGONIT

Është një krahinë malore në juglindje të Gjirokastrës. Fshatrat e saj shtrihen në një luginë të kufizuar nga malet e Nëmërçkës në lindje, Buretos në perëndim dhe Makrikambos në jug. Fshatrat kryesore të saj janë Poliçani, Sopiku, Skoreja, Çatishta, Hllomoja, në të cilat ruhen kisha me vlera arkitektonike e artistike, por manastire ruhen vetëm në Poliçan dhe në Çatishtë.

### Manastiri i Shën Thanasit - Poliçan

Ngrihet mbi një kodër të ulët jashtë fshatit, në anën veriore të tij. Sot nga manastiri ka mbetur vetëm kisha, por tregimet dhe përshkrimet e vjetra flasin për madhështinë e dikurshme të tij. Tradita e konsideron manastirin si metoq të manastirit të rrënuar të Shën Marisë së Peras. Të paktën deri në vitin 1945, siç dëshmojnë disa autorë, përreth kishës ngriheshin një numër i madh ndërtesash me qeli dhe ambiente të








*Manastiri i Shën Thanasit, Poliçan*
*Fig. 52. Planimetria e kishës së manastirit, Fig. 53. Pamja jugperëndimore e kishës së manastirit*
*Fig. 54. Dekoracioni i tamburit të kishës së manastirit*

tjera. Manastiri kishte një bibliotekë të çmuar, si dhe shumë objekte e dorëshkrime të tjera fetare. Aty ruheshin dhe lipsanat e Sofianosit, igumenit të manastirit, që nga viti 1711 deri në vdekjen e tij[26].

Kisha e manastirit me përpunimin e pasur arkitektoniko-dekorativ të saj, vjen të plotësojë dhe të mbështesë tregimet dhe përshkrimet e mësipërme. Ajo është e tipit në formë kryqi me kupolë (fig. 52). Përbëhet nga naosi dhe nga narteksi në anën perëndimore, i cili duket se i përket një faze më të vonë. Në pamjet e jashtme dallon në mënyrë të veçantë kupola, e cila

[26] Μπεντούλις Δ., *Μια επισκόπηση στις εκκλησίες και τα μαναστήρια του Πωγωνίου*, Shtëpia Botuese "Neraida", 2007, f. 11-14

DO NOT COPY

përmban një përpunim të pasur dekorativ me tulla të alternuara me radhë gurësh, përpunim ky i ngjashëm me atë të kishave të manastireve të Vanishtës dhe të Dhuvjanit (fig. 53, 54).

Për datimin e kishës na vjen në ndihmë një mbishkrim në pikturën murale me përfytyrimin e Shën Marisë që mban datën 1601[27], gjë që presupozon ndërtimin e kishës përpara kësaj date.

**Manastiri i Shpërfytyrimit - Çatishtë**

Ndodhet jashtë fshatit Çatishtë, buzë vijës kufitare Shqipëri-Greqi. Ky manastir, dikur tepër i lulëzuar dhe i njohur në të gjithë krahinat e Epirit dhe të Maqedonisë si një qendër e jetës fetare, arsimore dhe kulturore, dalëngadalë u braktis dhe u shkretua. Në ditët tona ka arritur i plotë vetëm katolikoni, ndërsa ndërtesat e tjera të manastirit janë krejtësisht të shkatërruara ose në gjendje rrënoje.

Kotolikoni, i cili i është kushtuar Shpërfytyrimit të Shpëtimtarit, përbëhet nga naosi, narteksi dhe eksonarteksi (fig. 55). Naosi është njënefësh me çati në formë kryqi dhe me apsida anësore. Qemeri në drejtimin gjatësor ndërpritet në pjesën qendrore të tij nga një tjetër qemer në drejtimin tërthor, i cili është më i ngritur në lartësi. Në pamjen e jashtme qemeri tërthor krijon një vëllim që ndërpret mbulesën gjatësore, duke na dhënë formën e kryqit (fig. 56). Sipas mbishkrimit që gjendej i gdhendur mbi një pllakë guri, kisha është ndërtuar në vitin 1584[28]. Në anën perëndimore naosit i bashkëngjitet një ndërtim që plotëson funksionet e narteksit, i cili i përket tipit të kishave njënefëshe me kupolë mbi një tambur të lartë. Sipas mbishkrimit të ruajtur, narteksi është ndërtuar në vitin 1626 me kontributin e mitropolitëve Nakovos të Zihnos dhe Daniil të Nevrokopit dhe është pikturuar nga piktor Mihali nga fshati Linotopi të Kosturit[29] (fig. 57, 58). Emrat e këtyre mitropolitëve i gjejmë edhe në mbishkrimin me copa tullash në faqen e jashtme të murit jugor të kishës[30]. Dikur, në ikonostasin e kishës ruheshim dhe tri ikona, ajo e Shën Marisë (1614), e Krishtit (1615) dhe e Shpërfytyrimit






*Manastiri i Shpërfytyrimit, Çatistë*
*Fig. 55. Planimetria dhe prerja gjatësore e kishës së manastirit, Fig. 56. Pamja veriore e kishës së manastirit*

(1615), vepra të piktor Onufër Qipriotit[31]. Në kodikun e manastirit janë regjistruar, përveç ktitorëve të përmendur në mbishkrim dhe emra të tjerë, deri dhe nga krahinat e largëta të Moldovllahisë, të cilët kanë kontribuar për rritjen dhe zbukurimin e manastirit.

[27] Popa, *vep. cit.,* mb. 534
[28] Πουλίτσα, vep. cit., f. 66: Popa, *vep. cit.,* mb. 529
[29] Popa, *vep. cit.,* mb. 552
[30] *Po aty*, mb. 553
[31] *Po aty*, mb. 537, 538, 539

DO NOT COPY

## KRAHINA E LUNXHËRISË

Shtrihet gjatë shpatit perëndimor të malit me të njëjtin emër. Relievi është maloro-kodrinor me zbritje të butë drejt luginës së Drinosit. Në këtë krahinë, pranë fshatit Jermë, janë zbuluar rrënojat e qytetit antik të Antigonesë. Qytet i Kaonëve, Antigonea, u themelua nga mbreti Pirro i Epirit në shek. III para Kr., i cili i dha emrin e njërës prej grave të tij, Antigonesë. U shkatërrua në vitin 167 para Kr. nga romakët, të cilët si hakmarrje ndaj maqedonasve dogjën 70 qytete epirote, ndërmjet të cilëve dhe Antigonenë. Periudhat e mëvonëshme në këtë qendër dëshmohen nga një kishë e vogël trikonkëshe me dysheme të shtruar me mozaikë. Kanë arritur gjithashtu deri në ditët tona një numër i madh kishash dhe manastiresh, kryesisht pasbizantine, siç janë p.sh. manastiri i Profet Ilias në fshatin Stegopol, manastiri i Shën Marisë së Spilesë pranë fshatit Tranoshisht.

### Manastiri i Profet Ilias në Stegopol

Është ndërtuar mbi fshat, mbi një kodër që mbizotëron në gjithë peizazhin përreth. Nga sa mund të gjykohet nga dëshmitë e vendasve dhe nga gjurmët e mbetura, manastiri ka qenë tepër i madh. Fatkeqësisht sot ruhen vetëm disa ndërtesa në gjendje gjysmë të rrënuara ose krejtesisht të rrënuara, por ruhet i plotë katolikoni, i cili me kupolën e lartë dhe me ngjyrën e kuqërremtë të tij dallohet që nga larg.










DO NOT COPY

*Manastiri i Profet Ilias, Stegopul*
*Fig. 59. Planimetria e kishës së manastirit, Fig. 60. Pamja jugore e kishës së manastirit*
*Fig. 61. Dekoracioni i tamburit të kishës së manastirit, Fig. 62. Dekoracioni i apsidës së kishës së manastirit*

Kisha përbëhet nga naosi dhe narteksi, që i bashkëngjitet naosit në anën perëndimore. Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë dhe me apsida anësore (fig. 59). Por kjo strukturë e brendshme nuk shfaqet në pamjet e jashtme. Lartësia e madhe e apsidave dhe lidhja e butë e tyre me muret e kishës kanë bërë që e tërë ndërtesa të përceptohet si një vëllim i vetëm, i mbuluar nga çatia e gjerë dyujëse, e cila ndërpritet në pjesën qendrore nga vëllimi i kupolës (fig. 60). Nga jashtë, kisha është e suvatuar dhe e ngjyer me ngjyrë të kuqërremtë. Mbishkrime të mëdha të pikturuara në pjesën e sipërme të kupolës dhe të pamjes jugore janë elemente dekorative që përbëjnë një veçori të këtij monumenti (fig. 61, 62).

Sipas mbishkrimit, naosi u ndërtua në vitin 1624 me kontributin e jeromonahëve Makario dhe Joakim[32]. Një mbishkrim i dytë na njeh me piktorët Konstandinin, të birin e piktor Mihalit nga Linotopi dhe të nxënësit të tij Nikollën, të cilët e pikturuan më 19 qershor 1653[33].

### Manastiri i Shën Marisë së Spilesë pranë fshatit Tranoshisht

Ngrihet i veçuar nga qendrat e banuara, në një lartësi të madhe që zotëron luginën e Drinosit, pikërisht rrëzë një rrëpire të madhe shkëmbore që ngihet mbi manastir. Ka marrë këtë emër nga disa shpella të hapura në rrëpirën shkëmbore (fig. 63). Sipas dëshmive të udhëtarit anglez Holland[34], njëra nga këto shpella ishte adaptuar për paraklis, me hyrje të vetme nëpërmjet një shkalle të gdhendur në shkëmb.

Nga ndërtesat e manastirit, i cili ishte madhështor, siç dëshmohet nga fotot e vjetra, në ditët tona kanë mbetur disa rrënoja dhe katolikoni (fig. 64).

Katolikoni përbëhet nga naosi, narteksi në anën perëndimore dhe një portiku përpara hyrjes së narteksit në anën jugore (fig. 65). Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë. Mbishkrimi mbi portën e naosit bën fjalë për ndërtimin dhe pikturimin e tij në kohën e peshkopimit të Zotit Kalist dhe me kontributin e jeromonahëve Konstandin dhe Joasaf dhe të arkondëve të Saraqinishtit, më 3 gusht








*Manastiri i Shën Marisë së Spilesë, Tanoshisht*
*Fig. 63. Shpellat mbi manastir*
*Fig. 64. Pamja veriperëndimore e kishës së manastirit*
*Fig. 65. Planimetria e kishës së manastirit*

[32] *Po aty*, mb. 550
[33] *Po aty*, mb. 561
[34] Holland H., *Travels In the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia*, London, 1819.

DO NOT COPY

të vitit 1634 nga dora e piktor Mihalit, i cili duhet të jetë piktori i njohur në këto anë, Mihali nga Linotopi[35]. Një mbishkrim tjetër nbi portën e narteksit daton ndërtimin dhe pikturimin e narteksit në vitin 1659[36]. Një e dhënë tjetër për piktorët gjendet në mbulesën prej argjendi të një ikone të Shën Marisë së Spilesë, e lënë nga piktor Theodhori nga Linotopi më 1765[37]. Ashtu si manastiret e tjerë edhe ky manastir kishte një jetë të gjallë. Vizitorë të shumtë kalonin në këtë manastir, shumë prej të cilëve kanë lënë gjurmë, duke shkruar emrat ose prejardhjen e tyre në pjesë të ndryshme të kishës[38].

**KRAHINA E ZAGORISË**

Ndodhet në verilindje të Gjirokastrës. Fshatrat e saj shtrihen në shpatet e një lugine të përshkuar nga lumi i Zagorisë (degë e lumit të Vjosës), e cila kufizohet nga mali i Dhëmbelit në lindje dhe i Lunxhërisë në perëndim. Në këtë krahinë ruhet një numur i madh kishash pasbizantine dhe një manastir në fshatin Nivan.

**Manastiri i Taksiarkëve - Nivan**

Manastiri i Nivanit ka qenë një qendër e rëndësishme fetare, kulturore, arsimore, ku ka studiuar dhe poeti i shquar i Zagorisë, Çajupi, dhe vendorganizim panairesh për gjithë krahinën e Zagorisë dhe krahinave përreth. Është ngritur poshtë fshatit, në një shesh të pyllëzuar, jo larg lumit të Zagorisë (fig. 67).

Në gjendjen e sotme manastiri është krejtësisht i rrënuar (fig. 68), madje dhe kisha ishte gjysmë e rrënuar para restaurimit (fig. 70). Katolikoni përbëhet nga naosi dhe narteksi në anën perëndimore. Naosi është një bazilikë me kupolë, e mbuluar me një sistem qemeresh cilindrike (fig. 69). Interieri ishte i zbukuruar me pikturë murale, por është i zhveshur nga pajisjet e shumta dhe objektet e tjera kishtare që ka patur dhe që dëshmohen nga mbishkrimet e mbledhura, si ikona, potire, ungjij, kuti lipsanash etj. Përkundrazi, pamjet








*Manastiri i Taksiarkëvë, Nivan*
*Fig. 67. Pamja e manastirit në vitet '60 të shek. XX*
*Fig. 68. Pamja e manastirit para restaurimit në vitin 2006*
*Fig. 69. Planimetria e kishës së manastirit*

[35] Popa, *vep. cit.*, mb. 559
[36] *Po aty*, mb. 564
[37] *Po aty*, mb. 591
[38] Πουλίτσα, *vep. cit.*, f. 77-78

DO NOT COPY

e jashtme ishin të thjeshta dhe të zhveshura nga përpunimi dekorativ (fig. 71).

Sipas mbishkrimit naosi është pikturuar më 28 qershor të vitit 1779 nga piktor Jani dhe i biri, nga fshati Sikriati[39]. Sigurisht, ndërtimi është më i hershëm. Siç dëshmojnë dy mbishkrime në pajisjet e kishës, 1772 në një kuti lipsanash të Shën Varvarës[40] dhe 1775[41] në bazamentin e një kryqi, manastiri ishte në funksion të plotë.





*Manastiri i Taksiarkëve, Nivan*
*Fig. 70. Pamja e kishës së manastirit para restaurimit në vitin 2006*
*Fig. 71. Pamja jugperëndimore e kishës së manastirit mbas restaurimit të vitit 2008*

DO NOT COPY

[39] Popa, *vep. cit*., mb. 612
[40] *Po aty*, mb. 599
[41] *Po aty*, mb. 60

Prof. dr. Pirro THOMO

DO NOT COPY

# MONASTERIES IN THE PROVINCES OF GJIROKASTRA

XVI century marks a new phenomenon in the construction of Christian religious buildings. Not only churches, but many monasteries from this period, have been preserved, too.

The building of monasteries had a huge spread in the provinces of Gjirokastra.

Monasteries are built far from villages, especially in the first period of the Ottoman occupation, aside traffic routes. They are built in dominant places, in well protected, as well as in scenic points. The defensive character is a feature of monasteries, which, in the first period was more pronounced. They were surrounded by high walls, provided with turrets, sometimes with defensive towers.

The constructions which comprise monasteries are divided in religious buildings, churches, trapezaria or dinning rooms, facilities for administrative services and clergy housing, sleeping facilities for believers or hospices, facilities to serve the monastery, as well as ancillary facilities such as stables for livestock, cellars for the preserved food, etc. These buildings form an architectural ensemble, where the main church or katholikon occupied the center of it. Buildings might not be simultaneous. They were added occasionally with the increase of the monastery power, carrying with them the construction characteristics of the times.

Monasteries of today have remained deserted and since long have ceased to function. Consequently, hospices were destroyed and many objects, archives and libraries are missing. But still, numerous inscriptions that are collected or stored show that a living monastic life developed in these monasteries, with an intense religious, educational, social and economic activity.

Alongside with the monasteries construction, the typology of religious buildings witnessed an increasing significant quality, with the introduction of their most advanced types: single-nave vaulted or domed churches, cross-vaulted churches, and especially cross-in-square churches, with or without side choirs.

The relatively early period of their construction, as well as the advanced typology of churches speaks of an old tradition for such constructions. This gives a certain basis to traditions and assumptions which seek the origin of the monasteries in the Byzantine period. These assumptions find support in the Ottoman administrative legislation, which used to give permission mainly for the reconstruction of Christian religious buildings.

Monasteries were built in all regions of Gjirokastra, in: Dropull, Pogon, Lunxhëri and Zagoria. The article analyzes monasteries of Prophet Ilias over Jorgucat village, St. Mary of Drianos over Zervat village, that of the Annunciation over Vanishtë village, St. Kyriakos and Julita over Dhuvjan village, St. Mary of Ravena over Goranxi village, that of Archangels over Derviçan village, the Holy Trinity near Pepel village, St. Mary near Koshovica village in Dropulli region, the monasteries of St. Athanasius near Poliçan village, that of Transfiguration near Çatishta village in the province of Pogoni, that of Prophet Ilias near Stegopol village, St. Mary of Spile near Tranoshisht village in the province of Lunxhëria and the monastery of Archangels near Nivan village.

**monumentet**
**53/2015**

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

# GJURMË MESJETARE NË KALANË E GJIROKASTRËS

Pamjen e sotme kalaja e Gjirokastrës (Fig. 1) e ka nga koha e rindërtimit të saj prej Ali Pashë Tepelenës në vitin 1812-13. Aliu, jo vetëm që i veshi muret e kalasë së vjetër me mure të rinj më të fuqishëm, por dhe e zgjeroi atë në drejtim të anës juglindore, ku dikur ajo mbrohej nga një hendek, duke e zgjatur këtë pjesë të fortifikimit deri në buzë të shkëmbinjve që përbënin mbrojtjen natyrore të kalalasë. Sipas përshkrimit të udhëtarëve dhe studiuesve bashkëkohës si Hughes etj. (Hughes 1830 ii 222, 348; Hahn 1853, 53; Leake 1835, 78, 499) kalaja përmbante jo vetëm kthina për strehimin e 5000 ushtarëve, por edhe një pallat të madh dhe një xhami. Kishte shumë magazina nëntokësore, të llogaritura për sigurimin e municioneve dhe ushqimeve të nevojshme, një mulli, si dhe kalesa nëntokësore, që të çonin në të gjitha drejtimet e fortesës.1500 fshatarë punonin vetëm për ndërtimin e bastionit juglindor, nga i cili komandohej krejt kalaja.Në kala ishin montuar 40 topa dhe priteshin dhe 45 të tjerë. Ali Pasha e transformoi kalanë nga një fortifikim me tipare mesjetare në një fortesë moderne për kohën Kjo ndërhyrje kaq e thellë bëri që të humbasin shumë gjurmë të së kaluarës. Mure mesjetare u përfshinë brenda mureve të reja apo u prishën për të hapur vend për ambientet e shumta nëntokësore të fortifikimit të ri.

Por, kalaja e Gjirokastrës ka një histori të gjatë, që vërteton ekzistencën e saj gjatë mesjetës, madje duke u cilësuar dhe si e papushtueshme për shkak të pozicionit dhe mbrojteve artificiale, edhe pse nuk kemi një përshkrim të saj për atë periudhë.

Të vetmin përshkrim të kalasë para kohës së rindërtimit të saj nga Ali Pashë Tepelena e kemi vetëm nga udhëtari turk i shek. XVII Evliya Çelebiu (Babinger 1938, 1-41). Sipas përshkrimit të tij të vitit 1672, kështjella ishte ndërtuar në kohë të moçme, krejt prej guri të gdhendur mbi një shkëmb në formën e një kurrizi peshku. Ishte 600 hapa e gjatë dhe 100 hapa e gjerë. Në mes të kalasë kalonte një rrugë e gjerë, në të dy anët e të cilës ndodheshin 200 shtëpi, të mbuluara me rrasa guri. Brenda saj ndodhej xhamija e Bajazidit dhe pranë xhamisë një depozitë e madhe uji, ku mblidheshin ujrat e shiut që kullonin nga pullazet e ndërtesave të kalasë. Në të pinin ujë gjithë banorët, por çdo zotni kishte dhe një sterë të veçantë. Kështjella kishte dy porta kryesore të forta prej hekuri me nga tre kanate. Çelebiu na njofton gjithashtu se nga ana e namasgjasë, midis kësaj të fundit dhe kështjellës, kishte një hendek 100 hapa të gjatë dhe 20 hapa të gjerë. Tre anët e tjera, thotë ai, nuk kishin nevojë për hendek, pasi ishin pjerrje natyrore. Ky është i vetmi përshkrim i hershëm i kalasë, por që nuk përmban detaje për elementët përbërës dhe formën e fortifikimit. Nga ky përshkrim del vetëm se kalaja ka qenë ndërtuar "me mure të moçme krejt prej guri të gdhendur" dhe se ajo nuk kishte të njëjtën gjatësi me të sotmen, pasi rrëzë murit rrethues në njërën nga anët e ngushta të saj qe hapur një hendek për mbrojtje.

Kalaja mesjetare e Gjirokastrës nuk duhet të jetë më e hershme se shek. XII pasi Kedreni (Bozhori-Liço, 36) dhe Al- Idrisi, në mesin e shek. XI përmendin vetëm Drinopolin në këtë zonë, ndërsa më vonë, në kronikën e Janinës, ku përshkruhen ngjarje të gjysmës së dytë të shek. XIV përmenden njëkohësisht të dyja këto qendra si Drinopoli ashtu edhe Gjirokastra (Bozhori - Liço, 249), duke përjashtuar mundësinë e identifikimit të njërës nga qendrat me tjetrën.



*Fig. 1. Pamje e Kalasë së Gjirokastrës*

Gjirokastra përmendet për herë të parë si qytet dhe kështjellë vetëm në vitin 1338 nga Johan Kantakuzeni, domestiku i madh i Andronikut III, i cili bashkë me këtë të fundit mori pjesë në fushatat ushtarake që u zhvilluan për nënshtrimin e Akarnanisë, kur me atë rast, Gjirokastra përmendet midis qyteteve dhe kështjellave që mbajtën anën e perandorit (Bozhori - Lico, 1975, 221). Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV, qyteti ishte nën zotërimin e familjes feudale shqiptare të Zenebishëve. Në vitin 1399, despoti Esau, në krye të të gjitha forcave të tija ushtarake u orvat ta pushtonte qytetin, por arriti deri në Mesopotam ku pësoi disfatë, u zu rob dhe u mbajt i burgosur në kalanë e Gjirokastrës (Argyrokastro) me gjithë arhondët e tij, nga Gjin Zenebishi. Ai u lirua vetëm kundrejt një shume prej 10 000 fiorintash nga të afërmit e tij prej gjaku në Firence, me ndërmjetësinë e bajlit venecian të Korfuzit (Bozhori - Lico, 1975, 249-250)).

Në vitin 1417 Gjirokastra u rrethua nga turqit. Komandanti i ushtrisë turke Hamza beu, e mbajti të rrethuar kalanë gjatë gjithë verës, por nuk mundi ta merrte. Kalaja konsiderohej e fuqishme dhe e papushtueshme nëpërmjet rrethimit.Vetëm në vitin1418, i biri i Zenebishit ua dorëzon qytetin turqve. Në kronikën e Tokove thuhet se ata nuk do ta merrnin dot kurrë kalanë, po të mos ua kishte dorëzuar vetë Zenebishi, dhe këtë, thuhet, ai e bëri për të shpëtuar pasurinë e vet, mori çfarë kishte dhe bashkë më gruan u vendos në Korfuz ( Schiro,1975, 3220 - 3324, 3270 - 3274). Menjëherë pas pushtimit turk, Gjirokastra u bë kryeqytet i sanxhakut të Shqipërisë (Arvanid) dhe i vilajetit të Gjirokastrës (Argirikastri) (Inalcik 1954, 1-27).

Në vitet 1434-35, shqiptarët që ndodheshin në afërsi të Gjirokastrës, të frymëzuar dhe nga kryengritja e Araniti Komnenit e viteve1432-33, “menduan të shkëputeshin edhe

DO NOT COPY

ata nga sundimi i Sulltan Muratit – thotë historiani bizantin Halkokondili – dhe thirrën Depan, prijësin e tyre, babanë e të cilit, Bajazidi, i biri i Muratit e kishte përzënë dikur nga vendi i tij... dhe e bënë mbret të tyre; dhe mbasi formuan ushtri, marshuan mbi Argjiropolihnin (Gjirokastra), i cili në atë kohë ishte qytet i Sulltanit. Ata vendosën t'ia kthenin atë Depës." I ati i Depës duhet të ketë qenë sundimtar i ndonjë krahine në afërsi të Gjirokastrës, por që, pas përzënies së tij nga Bajazidi (babai i Muratit I), i biri, sipas kronikës, qëndronte kohën më të madhe në Korfuz dhe shpesh udhëtonte për në Itali. Kryengritësit e rrethuan qytetin duke sjellë pranë mureve edhe makina gurëhedhëse. Në qytet ndodhej garnizoni i jeniçerëve dhe një pakicë turqish që kishin gjetur strehim në këtë qytet dhe përkrahnin garnizonin por, rrethimi, për shkak të aftësisë mbrojtëse të kalasë, zgjati aq shumë sa që turqit patën kohë të sillnin trupa të freskëta dhe ta shtypnin kryengritjen (Bozhori-Lico 1975, 221 e vazhd.).

Në vitin 1443, sipas Halkokondilit, Zenebishi bëri edhe një herë përpjekje për të çliruar Gjirokastrën nga turqit, por u thye në krahinën pranë Kosturit, ku kishte qëndruar për fushim me ushtrinë e tij të përbërë prej shqiptarësh. (K.Bozhori-F. Lico, .329).

Në vitin 1444, në Gjirokastër ekzistone një koloni tregtare veneciane nga Korfuzi (Soustal TIB3, 11 – 112). Figura e luanit të Venedikut ruhej ende në fasadat e shtëpive të Gjirokastrës, në kohën kur qytetin e vizitoi Çelebiu.

Kalaja e Gjirokastrës konsiderohej e fuqishme edhe në kohën kur ajo u bë objekt i synimeve të Ali Pashë Tepelenës. Aliu urdhëroi prerjen e ujësjellësit dhe prishjen e mullinjve të qytetit, për ta detyruar kalanë e Gjirokastrës që të dorëzohej.

Një histori kaq e pasur në ngjarje, dhe që lidhen drejtpërdrejt me rolin që ka luajtur kalaja në mbrojtjen e qytetit të Gjirokastrës, duhet të pasqyrohej edhe në fazat e saj ndërtimore, të lidhura me periudhat më të rëndësishme historike që ka kaluar qyteti i Gjirokastrës dhe kalaja e saj. Por, për fat të keq, edhe për shkak të rikonstruksionit të plotë që pësoi ajo në periudhën e Ali Pashës, kanë humbur shumë gjurmë të së kaluarës. Ndoshta gërmimet arkeologjike mund të nxjerrin në dritë në të ardhmen themelet e fortifikimeve më të hershme të kalasë. Deri tani këto gjurmë janë të pamjaftueshme për të bërë një rikonstruksion hipotetik të fortifikimeve të kalasë së Gjirokastrës për periudhat historike më të hershme nga ajo e Ali Pashë Tepelenës.



*Fig. 2. Muri pranë hyrjes kryesore (Sondazhi D), pamje nga lart*



*Fig. 3. Muri pranë hyrjes kryesore (Sondazhi D), pamje anësore*

Në vitin 1983, arkeologu Damjan Komata kreu disa sondazhe arkeologjike në pika të ndryshme të kalasë, që zinin një sipërfaqe të përgjithshme prej 112m$^2$, të cilat arritën në një thellësi nga 1- 2,5m. Sondazhi që na intereson për temën që kemi në shqyrtim është ai në pikën D, që është kryer brenda fortifikimit, në një galeri që ndodhet në të majtë të hyrjes kryesore. Sondazhi arriti thellësinë 2,5m. Nga ky sondazh doli në dritë një mur me gjatësi 3,30m , lartësi 2,15m dhe gjerësi 1,82 m (Fig. 2) ( Komata 1983, 259-260.) Muri përbëhej nga gurë gjysmë të punuar të vendosur në rreshta pak a shumë horizontalë (Fig. 3), ku shihej e ndërfutur edhe ndonjë copë tjegulle midis fugave.

DO NOT COPY




*Fig. 4. Gjurmët e kullës rrethore pranë depos së municionit*

D. Komata e daton këtë mur në mesjetën e hershme, por përshkrimi i qeramikës së datueshme të kujton më tepër enët bizantine të shek. XIII-XIV. Një monedhë bizantine e shek. XIII u gjet edhe në murin përballë kalasë, në sondazhin që u bë në pikën B. Në vazhdim të këtij muri, në drejtim të jug-perëndimit, D. Komata thotë se u gjetën mbeturinat e një muri para mesjetar, si dhe qeramikë e shek. II – IV p. Kr., por ai nuk na e përshkruan këtë mur. Disa vite më vonë, në kuadrin e masave që u morën për pastrimin dhe konsolidimin e kalasë për ta përgatitur atë për zhvillimin e festivalit folklorik të Gjirokastrës, zbulova një kullë trekëndëshe, që dilte jashtë, nën muret e Ali Pashës, në të majtë të hyrjes kryesore, në afërsi të murit të zbuluar nga D. Komata në pikën D. Ky mur, që ka drejtimin veri-jug, tregon se fortifikimi fillonte të mbyllej në këtë pikë.

Por, përveç kësaj kulle, që u zbulua rastësisht nga ulja e nivelit të terrenit, nga ana e jashtme e hyrjes, për sistemimin e rrugës që të çon në të, po pranë këtij muri, në drejtim të verilindjes, në bodrumet e e kalasë së Ali Pashës, pranë vendit të quajtur depo e municionit, ruhej në një gjendje më të mirë një kullë mesjetare, kësaj rradhe gjysmë rrethore (Fig. 4,5). Nga kulla ruhet vetëm një segment i saj, i përfshirë në një strukturë muresh të vona. Muri i kullës ka qenë 0,90m i gjerë dhe ruhet në pjesën e ruajtur deri në lartësinë prej 4,50m. Ai është ndërtuar mbi një xokol 0,40m të lartë, që del prej tij 0,13 m., në formë dhëmbi. Në kullë ruhen dy rradhë frëngjish shigjete me nga dy frëngji secila. Këto të fundit kanë një lartësi 0.55 – 0, 70m, gjerësi të brendshme 0,25-0,30 m dhe përfundojnë nga jashtë me një të çarë 0,12m të gjerë. Katet kanë qenë jashtëzakonisht të ulët, vetëm 1,50m. Një dukuri të tillë e hasim vetëm në kullat e kalasë së Bashtovës. Frëngjitë e shigjetave, por më tepër trashësia prej 0,90m e murit të kullës të kujton kullat bizantine të shek. XIII-XIV në Butrint.

Muri i zbuluar nga D. Komata në pikën D, pranë hyrjes kryesore të kalasë, kalonte poshtë murit të Ali Pashës dhe lidhej me kullën trekëndëshe që del në anën e jashtme të tij. Në kushtet që nga gërmimi arkeologjik nuk mund të mbështetemi për datimin e këtij ndërtimi, kulla trekëndëshe mbetet i vetmi element arkitektonik ku mund të bazohemi për një datim në një diapazon mjaft të gjerë.

Kullat trekëndëshe në vendin tonë nuk i hasim para shek. VI dhe vazhdojnë të përdoren deri në fund të shek. XII, pas kësaj kohe ato janë shumë të rralla (Karaiskaj 2010, 28,89).

Gjurmët e paraqitura më sipër nuk na japin një ide të qartë, as fazat e shumta ndërtimore para Ali Pashës, dhe për datimin e saktë të tyre. Duhen kryer gërmime arkeologjike, duke filluar me gërmimin e plotë të kullës trekëndëshe dhe më tej, duke ndjekur gjurmën e kalimit të mureve të heshme të fortifikimit, për t'i dhënë vizitorëve mundësinë të njohin më të plotë historinë e fortifikimeve të Gjirokastrës, të cilat shërbyen edhe si fillesë për lindjen e qytetit.

DO NOT COPY




*Fig. 5. Kalaja e Gjirokastrës, planimetria*

DO NOT COPY

**Bibliografia**


1. Bozhori, K., Liço F., *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë*, Tiranë 1975.
2. J.G. von Hahn., *Albanesische Studien*, Jena 1853.
3. Hughes, R.T., *Travels in Greece and Albania, II,* London 1830.
4. Leake, W. M., *Travels in Northern Greece, Rodwel-London, I,* 1835.
5. Soustal, P., *Tabula Imperi Bizantini 3. Nikopolis und Kephalenia*, Wien 1981.
6. Babinger, F., *Ewlija Tschelebi's Reisewegen in Albanien. Rumelische Streifen*, Berlin 1938.
7. Schiro, G., *Cronaca dei Tooco di Cefalonia di anonimo. Prolegomeni, testo critico e traduzione* (CFRB,10), Roma 1975.
8. Inalćik, H., *Surret-i defter-i sancak-i Arvanid*, Ankara 1954.
9. Komata, D., "Kalaja e Gjirokastrës. Gërmime arkeologjike të vitit 1983", *Iliria* 1983/2.
10. Karaiskaj, Gj., *Die spätantiken und mittelalterlichen Wehranlagen in Albanien*, Hamburg 2010.

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

# MEDIEVAL TRACES IN THE CASTLE OF GJIROKASTRA

The castle of Gjirokastra has this appearance from the time of its reconstruction made from Ali Pasha in 1812-13. Ali, not only covered the existing walls of the old castle with more powerful new walls, but extended them toward the southeast side, where the castle was protected once by a moat, prolonging this part of the fortification to the edge of a rock that constituted the castle's natural protection. According to the description of the passengers and contemporary scholars as Hughes, etc.,the castle had not only an enclosure to accommodate 5,000 soldiers, but also a great palace and a mosque. There were many underground warehouses, calculated to ensure the necessary munitions and food, a mill and underground crossings that lead in all directions of the fortress.

Ali Pasha transformed the castle from a fortified one with medieval features in a modern fortress of the time. That profound intervention caused loss of past traces. Medieval walls were included within the new walls or were demolished to create space for multiple underground environments of the new fortification.

The castle of Gjirokastra has a long history proving its existence from the Middle Ages, considered as impregnable because of its position and artificial protections.

The medieval castle of Gjirokastra might not be earlier than XIIth century, because Kedreni and Al-Idrisi, mention only Drinopoli in this area during the middle of XI century, while later, in the chronicle of Ioannina which describes the events of the second half of the fourteenth century, both these centers Gjirokastra as well as Drinopoli are also mentioned, excluding the possibility of identifying one instead of the other center.

Throughout the events of Middle Ages, starting from 1338 until its conquest by Ali Pasha in 1812, the castle was considered a strong fortification and unpregnable through the siege.

But a story so rich in events, directly related to the role fortress played to defend the town of Gjirokastra is not reflected in its stages of construction. The traces found so far are insufficient to make a hypothetical reconstruction of the fortifications of Gjirokastra castle for earlier historical periods than that of Ali Pasha.

In 1983, Damian Komata - archaeologist headed several archaeological surveys at various points of the castle, covering a total area of 112m2, which reached the depth of 1- 2,5m. The survey on the topic that interests us is the point D, located within the fortification, in a gallery, to the left of the main entrance. The survey reached the depth of 2,5m. From this survey a wall with a length of 3,30m came to light, 2,15m height and width 1.82 m (Komata 1983, 259-260.) The wall consisted of semi-worked stones set in more or less horizontal lines, where pieces of tiles inserted between the joints were also seen.

Damian Komata dates this wall to the early Middle Ages, but the description of datable pottery recalls more the Byzantine vessels of XIII-XIV century. A Byzantine currency of XIIIth century was also found in the front wall of the castle in the survey made to point B. Some years later, in the context of measures taken to clean and consolidate the castle and to prepare it for the folk festival in Gjirokastra, I discovered a triangle tower which came out the walls of Ali Pasha, to the left of the main entrance, near the wall discovered by D. Komata at the point D. This wall, which

has a north-south direction shows that the fortification began to close in this point.

But, besides this tower which was discovered randomly, again, on this side of the fortification, in the cellars of the castle of Ali Pasha, near a place called the warehouse of ammunition, a medieval tower, this time semi-circular was preserved in a better state. From the tower we have only one segment of it, involved in a late wall structure. The thickness 0,90m of the tower wall recalls the Byzantine towers of XIII-XIV century, in Butrint.

The wall discovered by D. Komata at point D, near the main entrance to the castle, steeped down the wall of Ali Pasha and was linked with the triangle tower that appeared on the outer side of it. In such conditions, when the archaeological excavations can not give the dating of this construction, the tower triangle remains the only architectural element which can refer to a dating in a fairly wide range.

We did not come across triangle towers in our country before VIth century. They continue to be used until the end of XII century, after this time they are very rare (Karaiskaj 2010,28,89).

Traces presented above do not give us a clear idea about the numerous construction phases made before Ali Pasha, nor their exact dating. Digging needs to be done, starting with the complete excavation of the triangle tower and further trail the early crossing fortification walls, to give visitors the opportunity to know the full history of fortifications of Gjirokastra, which also served as the starting point for the rising of this medieval city.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

**monumentet**
**53/2015**

Joli MITROJORGJI

DO NOT COPY

# KODET NDËRTIMORE NË SHQIPËRI. PROCESI QYTET-FORMUES I VENDBANIMEVE TË TRADITËS. GJIROKASTRA

## 1. Hyrje

Duke e fokusuar vëmendjen në historinë e qytetërimit iliro-shqiptar, dallojmë jetëgjatësinë më se 2500 vjeçare të disa vendbanimeve qytetare në këtë territor. Që këtej lind natyrshëm pyetja: si kanë mundur këto vendbanime t'i qëndrojnë kohës, luftrave të pareshtura, krizave ekonomike, epidemive dhe agjentëve shkatërrues natyrorë për kaq shekuj? Çfarë i ka bërë kaq vitalë? Kush ua ka dhënë forcën e ripërtëritjes?

Me siguri, jo mungesa e ligjeve dhe kaosi shoqëror. Ky i fundit shpie vetëm në shkatërrim, në rrënim, në vdekje të qyteteve, në braktisje të vendbanimeve, në zhdukje të qytetërimeve e kombeve. *Por, kjo nuk ka ndodhur!* Atëherë, cilët janë faktorët që kanë mundësuar popullimin e këtyre trojeve në vazhdimësi? Cilët faktorë kanë mundësuar vazhdimësinë e jetës shoqërore e kulturore dhe në tërësi gjithë kuadrin e elementeve që përbëjnë identitetin vendor të qyteteve shqiptare?

Territori shqiptar ka qenë pjesë e shumë qytetërimeve që e kanë patur atë djep të historisë dhe kulturës së tyre. Mbretëritë ilire, perandoria maqedonase, ajo romake, bizantine, bullgare dhe ajo osmane së fundmi, kanë lënë gjurmë të kudondodhura në mjedisin ballkanik e për rrjedhojë edhe atë shqiptar. Prandaj, edhe shoqëria shqiptare është zhvilluar e transformuar në përshtatje me këto organizma shtetërore dhe me legjislacionin shtetëror të diktuar nga lart. Megjithatë, pozicioni larg qendrës së perandorive dhe dekadenca kohë mbas kohe e këtyre perandorive të mëdha (pjesë e të cilave ishin dhe trojet iliro-shqiptare), ka mundësuar qysh në kohë të hershme edhe një formë tjetër legjislacioni në këto troje, atë të së drejtës zakonore. Nuk duhet të harrojmë se ndodhemi përballë një shoqërie kur mbi të ishte e vështirë të ushtrohej një pushtet shtetëror, në kuptimin e drejtë të fjalës, kjo për dy arsye: ky pushtet vinte nga larg e nga të huaj. Format e organizimit, të cilësuara si të bashkësive fshatare e qytetare, nuk kanë qenë në kundërshti me ligjet shtetërore që vinin nga lart, por, duke pranuar një pjesë të legjislacionit të pushtetit qendror, kanë ngritur një korpus ligjesh, kodesh, normash a dokesh për t'u vetadministruar dhe për të rregulluar marrëdhëniet e brendshme dhe të përditshme të bashkësisë.

Ku qëndron baza e tyre historike, dhe cila është forca e tyre vepruese?

Nëse pranojmë së çdo shoqëri drejtohet nga një korpus ligjor i hartuar për stadin e zhvillimit kur ajo lulëzon, duhet të nisim të bëjmë dallimin midis legjislacionit nga lart, të hartuar nga pushteti qëndror dhe atyre normave e kodeve që vetë bashkësia e një territori të caktuar harton si mekanizëm rregullues të marrëdhënieve të saj të brendshme. Këto kode, në përgjithësi të pranuara dhe nga pushteti qëndror, mund të shtrijnë influencën e tyre në çdo fushë të veprimtarisë dhe marrëdhënieve të bashkësisë, në çdo nivel të organizimit shoqëror, familje, fis, lagje, fshat, krahinë a komb. Si formë e vetëdijes shoqërore, këto kode kanë qenë pjesë aktive e shpirtit të etnosit dhe janë ruajtur, respektuar e trashëguar në mënyrë gojore, dhe fanatizëm nga bashkësia.

Shumë studiues shqiptarë dhe të huaj, kanë shprehur opinionet e tyre mbi bazën shoqërore dhe kushtet historike të veprimit të legjislacionit vendor në trojet shqiptare. Këto opinione na shërbejnë për të treguar lashtësinë e kulturës së popullit tonë, njëkohësisht shprehin qartë dhe vlerësojnë filozofinë popullore për t'u vetëqeverisur me drejtësi, sipas rregullave zakonore të rrënjosura në mendje, ashtu siç shprehet edhe Edit Durham, që kjo filozofi e ligjit qëndron edhe mbi "dhjetë urdhëresat e zotit". Këto ligje jetojnë më gjatë, pavarësisht se nuk sanksionohen nga pushteti qendror.

*"Edhe struktura etike e shoqërisë homerike, e përbërë nga besa, nderi, miku, gjaku, buka dhe hakmarrja duket se i përket kategorisë etike të një shoqërie pa autoritet shtetëror, përfaqësuar më së miri nga struktura etike e Kanunit".* - Prof. Kazuhiko Yamamoto

## 2. Legjislacioni ndërtimor në pellgun e Mesdheut

Një përshkrim historik të legjislacionit ndërtimor në pellgun e Mesdheut na e jep studiuesi Besim S. Hakim në artikullin e tij "*Kodet urbanë dhe ndërtimorë Mesdhetarë: origjina, përmbajtja, ndikimi dhe mësime.*"[1] Studimi i tij mbështetet në dy dokumenta historikë, së pari në kodet bizantinë të *Julianit* të *Askalonit* nga Palestina i shkruar mes viteve 531-533 pas Krishtit, dhe në ligjet islame të disa traktateve ku më i vjetri është ai i Imam Malik që ka jetuar në vitet 712-795 pas Krishtit. Rëndësia e studimit qëndron në lidhjen dhe vërtetimin e vazhdimësisë historike dhe marrëdhëniet e ndërsjella të dy korpuseve ligjore të ndërtimtarisë në Mesdhe. Kjo na bën ne, si pjesë e dy perandorive që pasuan njëra-tjetrën, të gjejmë vendin tonë në këto korpuse ligjore.

Traktati i Julianit të Askalonit nga Palestina u shkrua gjatë viteve 531-533 pas Krishtit, dhe është dokumenti më i vjetër i zbuluar mbi rregullat ndërtimore. I shkruajtur gjatë mbretërimit të Perandorit Justiniani I (527-565 pas Krishtit) ky traktat u përfshi për herë të parë në *Librin e Eparkut (Eparchicon biblion)*[2] gjatë mbretërimit të perandorit Leon VI (886-912 pas Krishtit), dhe më tej u përfshi në *Hexalibros*[3] të Armenopoulos në Thessaloniki. Përfshirja e këtij traktati në këto korpuse ligjore edhe më vonë në kohë, tregon për influencën e veprimit të tij edhe në vendet e Ballkanit, që ishin nën sundimin e Perandorisë Bizantine.

Nga ana tjetër, në trojet tona vihet re ndërthurrja reciproke e së drejtës qytetare (Statutet e qyteteve bregdetare) me të drejtën zakonore fshatare (Kanunet), ç'ka shpreh ndikimin e ndërsjellë dhe raportet e ngushta shoqërore të krijuara në popullsinë shqiptare gjatë mesjetës. Materialet që kemi në dispozicion janë kanunet e shoqërisë fshatare shqiptare: Kanuni i Lek Dukagjinit, Kanuni i Labërisë (Papa Zhulit), Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Dibrës, e shumë të tjerë bashkëkohës me ta, si edhe statutet qytetare, ndër të cilët shumë interesantë paraqiten Statutet e Shkodrës, Statutet e Drishtit, dhe statutet zejtare të disa qyteteve të shekullit XIV pas Krishtit, të cilat janë pasuri e çmuar kulturore kombëtare.

Për sa i përket korpusit ligjor popullor, në trojet shqiptare ka vepruar e drejta zakonore, ku më i njohur mund të konsiderohen Kanuni i Lek Dukagjinit dhe Kanuni i Labërisë ose i Papa Zhulit. Kanunet përbëjnë bazat juridike dhe etiko-morale të shoqërisë shqiptare, pra në to përfshihen ligjet, rregullat, normat, zakonet, doket, të cilat dhe pse nuk kanë qenë shkruar, kanë mbijetuar me shekuj sepse janë ruajtur me fanatizëm në kujtesën e të parëve dhe janë transmetuar gojarisht deri në ditët tona.[4] Si një korpus ligjor që ka rregulluar jetën shoqërore, ekonomike, sociale e juridike të shoqërisë rurale shqiptare, lindi nevoja për të analizuar brenda tij vlerat themelore lidhur me çështjet ndërtimore në trojet tona. Professor Lufti Alia në studimet e tij rreth Kanunit dhe të drejtës zakonore shqiptare, e quan kanunin **"E Drejta Shqiptare *(Jus Albanicae)*"** e pashkruar, por e ruajtur nga populli si një vepër me vlera të mëdha juridike, etiko-morale, kulturore dhe historike[5]. Ka fakte historike që tregojnë se organizimi i bashkësive fshatare në Perandorinë Bizantine (shek.VII-VIII) pasqyrohet në një dokument juridik të kohës "Ligji Bujqësor (*nomos georgikos*)"[6], i cili vepronte në gjithë territoret ballkanike të perandorisë së Bizantit, përfshi këtu edhe trojet shqiptare. Ajo ç'ka është

[1] Hakim, Besim S., *Urban design International,* 2008, f.13, 21-47.
[2] Hakim, Besim S., *Julian of Ascalon's Treatise of Construction and Design Rules from Sixth-Century Palestine, 2010,* fq. 9.
[3] *Po aty, fq.9.*
[4] Alia, Lutfi, "Kanuni - Kodi i të drejtës zakonore shqiptare", botuar në *Zemra Shqiptare*, 2012.
[5] *Po aty*
[6] *Historia e Shqipërisë,* vëllimi 1, 2002, f. 212.

DO NOT COPY

me rëndësi për vijimin e studimit tonë, është fakti se shumë norma dhe institucione, të pasqyruara në "Ligjin Bujqësor", u përfshinë në të drejtën dokësore dhe si të tilla mbijetuan, u trashëguan dhe u bënë pjesë e të drejtës zakonore që ka mbijetuar deri vonë në fshatin shqiptar. Sipas këtij ligji, fshatarët kishin tokën e tyre, arën, vreshtat, kopshtet dhe së bashku më shtëpinë e me bagëtinë, përbënin pasurinë kryesore të familjes fshatare.

*"Gjithçka është kanu i trashëguem prej të parëve"*
*Kanuni i Lek Dukagjinit*

Kjo frazë ka bërë që shumë studiues shqiptarë dhe të huaj, të thellohen në studimet e tyre rreth origjinës së kanunit, dhe të dalin në mendimin e përbashkët se zanafilla e kanunit duhet kërkuar në kohët antike, kur formohej etnosi ilir e në vazhdim ai shqiptar. Këto ligje të pashkruara vazhduan të jenë aktivë, duke u përshtatur, modifikuar, konsoliduar nën ndikimin e të drejtës romake, ligjeve të bizantit, atyre normane etj., në një rrugëtim të gjatë derisa në shek. XV u kodifikuan nën emërin e Lek Dukagjinit. Schewering e konsideron Kanunin "*përmbledhje dokesh dhe ligjesh, ndofta ndër më të vjetrat në Evropë",* ndërsa Faik Konica shprehet se "*Kanuni përfaqëson atë që ka mbetur nga mendimi juridik i Shqipërisë së mesjetës, por mendoj se i ka rrënjët më përpara se mesjeta*". At Xhiusepe Valentini shkruan: "*kanuni i maleve ka shumë elemente që e lidhin me të drejtën romake"*, ndërsa Ernest Koliqi, duke e studiuar këtë vepër gjen shumë elementë, që janë të ngjashëm me Kodin Teodozian, me Jus Diokleciani dhe me Jus Justiniani[7]. Duke reflektuar mbi citatet e sipërpërmendura, nuk mund të mos konsiderojmë argumentin se origjina e Kanunit, si korpusi ligjor që rregullonte marrëdhëniet në shoqërinë rurale shqiptare, qëndron në lashtësi; këto ligje të së drejtës zakonore, me kalimin e kohës janë ndryshuar e influencuar edhe nga të huajt: fillimisht nga romakët, më pas nga ligjet bizantine, normane, osmane e me radhë. E përfundoj këtë argument me citimin e studiuesit Kazuhiko Yamamoto i cili shkruan:

*"Kanuni ngjan me veprat filozofike të Platonit dhe të Aristotelit dhe për më tepër, në Kanun gjejmë koncepte etike të shoqërisë greke, të asaj periudhe, ku mungonte autoriteti i shtetit, çka të bind të mendojmë së kanuni ka origjinë të lashtë".*

Ku qëndron origjinaliteti i kanunit dhe a ka ngjashmëri me kodet e të drejtës të popujve të tjerë?

Dihet se pas ndarjes se Perandorisë Romake në dy pjesë, në vitin 395 pas Krishtit, trevat ilire bënë pjesë në perandorinë e Bizantit. Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti i njësive administrative të krahinave të ndryshme nën sundimin e perandorisë së Bizantit rregullohej në bazë të ligjeve qendrore, por dhe të ligjeve lokale. Por, në shekullin V-VII pas Krishtit, perandori Justiniani I shpalli një sistem ligjesh *Corpus Juris Civilis*, që do të përbënte tashmë bazën juridike të Perandorisë së Bizantit dhe që ishte shumë aktiv në trojet iliro-arbërore. Kodi i Justinianit (Codex Justinianus, i vitit 534 pas Krishtit, i të njëjtit vit me shkrimin e traktatit të Julianit të Askalonit) dhe sipas studimit të detajuar që i është bërë nga profesor Lutfi Alia, sjell në vëmendjen tonë ngjashmërinë e strukturës mes këtij kodi dhe Kanunit të Lek Dukagjinit, të përbërë nga 12 libra dhe mbi 1600 konstitucione. Jo vetëm struktura por, dhe përmbajtja e ligjeve kanë ngjashmëri mes tyre. Kjo na tregon se e drejta zakonore ilire-arbërore ka marrë shumë nga këto ligje, i ka përshtatur dhe i ka përfshirë në korpusin e saj, gjithnjë duke i aplikuar në kushtet specifike të rajonit ku aplikoheshin.

Nga sa më sipër, për marrëdhënien e ndërsjellë mes ligjeve të bizantit dhe të drejtës zakonore shqiptare, le të hedhim një vështrim më të kujdesshëm mbi korpusin ligjor popullor që rregullon marrëdhëniet shoqërore në fushën e të drejtës së pronësisë, lidhur kjo me të drejtën dhe kufizimet në nevojën për ndërtim dhe marrëdhëniet e fqinjësisë në mjedisin e vendbanimeve. Nga njëra anë do të përcjellim përmbledhjen që studiuesi Besim S. Hakim i bën traktatit të Julianit të Askalonit *(fig. 1),* i cili merret me ndryshimet në mjedisin ndërtimor dhe nga ana tjetër do të përmbledhim konceptet lidhur me çështjet ndërtimore që trajton e drejta zakonore shqiptare. Qëllimi i të dy korpuseve është të sigurohet një ekuilibër në në mjedisin ndërtimor gjatë proceseve të rritjes e të ndryshimit.

Në vijim kemi thelbin e traktatit të Julianit të Askalonit të këtij kodi, që sipas studimit të bërë nga Besim S. Hakim, qëndron në shtatë pika kryesore:

• Ndryshimi në në mjedisin ndërtimor duhet të pranohet si një proces natyral dhe një fenomen i drejtë. Përgjatë ndryshimeve është e rëndësishme të ruhet një ekuilibër i drejtë dhe i paanshëm në në mjedisin ndërtimor.

[7] Hakim, Besim S., *Julian of Ascalon's Treatise of Construction and Design Rules from Sixth-Century Palestine, 2010,* f. 7.

DO NOT COPY



*Fig 1. Traktati i Askalonit (Besim Hakim, Julian of Ascalon's Treatise of Construction and Design Rules from Sixth-Century)*

• Ndryshimi, sidomos ai që ndodh mes fqinjëve të afërt, krijon potencial për konflikt dhe dëmtime të banesave ekzistuese dhe funksionit të tyre. Prandaj, disa masa janë të nevojshme për të parandaluar ndryshimet që:

a) rezultonin poshtëruese për integritetin social dhe ekonomik të fqinjëve ngjitur apo pronave të tyre;

b) krijonin kushte që do të preknin integritetin e fqinjëve;

c) destabilizonin paqen dhe qetësinë mes fqinjëve.

• Në parim, pronarët gëzojnë të drejtën të veprojnë të lirë brenda kufijve të pronës së tyre. Shumë prej funksioneve janë të lejuara, sidomos ato që lidhen drejpërdrejtë me çështjet e jetesës. Megjithatë, liria për të vepruar brenda kufijve të pronës është e kufizuar nga kushtet para-ekzistuese të pronave fqinje dhe të drejtat e fqinjësisë për shërbime.

• Në qytete është i nevojshëm aplikimi i ndërvarësisë mes qytetarëve, sidomos atyre që janë fqinjë të afërt. Kjo sjell përgjegjësi mes këtyre fqinjëve, sidomos lidhur me çështjet ekonomike.

• Pamja dhe panorama janë të rëndësishme dhe duhen ruajtur sepse ato i falin kënaqësi pjesëtarëve të komunitetit dhe janë bartëse të domethënies kulturore të një vendbanimi. Përdorimi i burimeve natyrore brenda kufijve të pronës tënde, si grumbullimi i ujërave të shiut apo mbjellja e pemëve, etj. duhet inkurajuar.

• Përdorimi i materialeve më të përparuara të ndërtimit duhet inkurajuar sepse rritet vlera e tokës.

• Hapësira publike nuk mund të jetë objekt i dëmtimeve që rezultojnë nga veprimtaria në pronën private apo nga lëvizjet e kafshëve.

Ndërsa më poshtë, le të përmbledhim pikat që trajtojnë çështjet lidhur me mjedisin ndërtimor, bazuar në korpusin ligjor popullor shqiptar përfshirë Statutet e qyteteve dhe Kanunet e shoqërive fshatare:

DOWNLOAD COPY



Pjesa I

NORMA TË PËRGJITHSHME

Kreu I –
Kuptimi. Objekti. Detyrat. Qëllimet, etj.

Neni 1. Kuptimi

Kanuni i Labërisë është tërësia e normave të së drejtës zakonore (rregullave të sjelljes), të pashkruara e të vendosura kohë pas kohe, të përcjella në traditën gojore brez pas brezi, që shërbejnë për rregullimin e marrëdhënieve juridike në mes njerëzve në fushën e ndryshme të jetës në një të tokësore të vetëqeverisjes vendore të Labërisë.

Neni 2. Objekti

Kanuni, ka për objekt sanksionimin e parimeve kryesore të jetës shoqërore, rregullimin e organizimit tokësor e shoqëror, të rendit shoqëror - marrëdhëniet familjare e martesore, të rendit ekonomik - pronësisë, trashëgimisë, detyrimet, kontratat, si dhe rregullimin e marrëdhënieve në fushën penale, procedurale dhe administrative.

Neni 3. Detyrat

Normat e së drejtës zakonore të mbledhura në këtë Kanun kanë për detyrë vetëmbrojtjen e rendit, të qetësisë e të sigurisë të bashkësisë në një të tokësore të vetëqeverisjes vendore, të veprimtarisë së rregullt të organizmave të vetëqeverisjes, të jetës, të shëndetit, nderit e dinjitetit të njerëzit, të rendit shoqëror e ekonomik, pasurisë, si dhe të të drejtave të tjera të njohura e të siguruara nga ky kanun.

Neni 4. Qëllimet

Kanuni, në përshtatje me normat e moralit dhe vlerat e pranuara nga bashkësia, ka për qëllim të veprojë mbi njerëzit që të ullen mirë, të mësojnë ndërin personal, të familjes, vëllazërisë e të fisnikut, të duan e respektojnë njëri-tjetrin, të bashkëjetojnë e punojnë me ndershmëri e drejtësi, të ndihmojnë njëri-tjetrin në nevojë e në fatkeqësi, t'i dalin të keqes perpara, të mos bëjnë vepra të këqija dhe të zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet, duke u bazuar në të drejten zakonore.

Neni 5. Burimet

Burimet e Kanunit të Labërisë janë në mënçurinë popullore, në zakonet e të parëve, të trashëguara në shekuj, venomet, adetet, zakonet e reja të pranuara nga gjithë bashkësia, precedentu gjyqësor, vendimet e mjitra nga pleqtë e zakonit apo kuvendet e burrave, edhe në kushtet e dhëllimit të diferencimit ekonomiko-shoqëror, por të bazuara në drejtësinë popullore.

Neni 6. Interpretimi

1. Interpretimi i normës së Kanunit, kur ajo është e paqartë ose ka dy kuptime, kërkohet nga pala e interesuar në konflikt apo mosmarrëveshje.
2. Interpretimi bëhet vetëm nga pleqtë e zakonit ose Kuvendi i burrave që ka shqyrtuar konfliktin ose mosmarrëveshjen dhe askush tjetër, apas kohës apo interesave të tij, as nga parta, as nga vegëlia.
3. Interpretimi i normës së Kanunit synon të krijojë bindje e pajtim dhe jo kundërshtim e grindje.

Neni 7. Vendosja e normave të reja

1. Vendosja e normave të reja dhe zëvendësimi ose ndryshimi i normave të vjetra në Kanun, bëhet nga pleqtë e zakonit ose Kuvendi i burrave, me pëlqimin e krejt bashkësisë në një të tokësore të vetëqeverisjes vendore.
2. Në rast se bashkësia bën vërejtje ose propozime, pleqtë e zakonit apo Kuvendi i burrave i mbajnë parasysh dhe kur i pranojnë i përshëndesin: «Sa frofsh, pleqëtofsh».

Neni 8. Veprimi në kohë dhe hyrja në fuqi e normave të kanunit

1. Në Kanun përfshihen norma nga lashtësia, rendi ijanor, mesjeta dhe veçanërisht shtresëzime të reja në shekujt XVIII dhe deri në fillimet e shekullit XX.
2. Në rast se një vendosen në Kanun hyjnë në fuqi menjëherë. Ato u bëhen të njohura pleve me bashkësinë se nëse tokësore të vetëqeverisjes vendore, me anë të lajmeve ose me anë të pllakat a mehalles.

Neni 9. Veprimi në hapësirë i normave të kanunit[3]

1. Normat e këtij Kanuni veprojnë në territorin e Labërisë, nga Lumi Vjosë deri në dekin Jon, në fshatrat e Lumit të Vlorës, Gryken e Dukatit, në Hanaré, Bregdetin në tërësi, në Kurvelesh, në Brezonik, Kardhiq, trezë e Tepelenës, në zonat e tjera ku jetojnë e banojnë bashkësi labe, në Mallakastër e më gjerë.
2. Veprimi në hapësirë i Kanunit të Labërisë me kufizime shtrihet deri në qytetet e Gjirokastrës, të Delvinës, Tepelenës dhe të Vlorës, për rregullimin e marrëdhënieve të ndryshme juridike në mes të njerëzve.
3. Përveç normave të përgjithshme e të përbashkëta për Labërinë, veprojnë edhe norma e zakone të vendit, sipas rregullit "fshat e zanat, shtëpi e nasihat", që lanë fuqi detyruese brenda territorit të asaj njësie vendore. Sipas vendit bëhet kuvendi.

Neni 10. Respektimi dhe zbatimi i normave të Kanunit

1. Pjesëtarët e bashkësisë së njësisë vendore pa dallim shtrese, feje, moshe e seksi kanë për detyrë kryesore të respektojnë e të zbatojnë me vetëdije normat e këtij kanuni, sipas traditës së trashëguar "Kështu kanë vepruar të parët tanë, kështu do veprojmë edhe na".
2. Për respektimin dhe zbatimin e Kanunit kështu e kërkojnë normat e moralit të trënjosura në psikologjinë dhe vetëdijen e pjesëtarëve të bashkësisë së njësisë tokësore të vetëqeverisjes vendore, që t'i binden me vullnet të lirë e të veprojnë në bazë të tij, se kështu e do ndeti.
3. Për zbatimin e përpiktë të normave të Kanunit veprojnë edhe feja dhe organizmat e vetëqeverisjes vendore: Këshilli i pleqve (pleqësia), gjyqi i pleqve dhe Kuvendi i burrave, të cilet ushtrojnë autoritetin e tyre dhe vendosin sankzione deri ato penale për mosrbatim të kanunit, si bykotimin, dëbimin, dënime të tjera deri dënimin me vdekje (vrasje) të fajtorit.

Neni 11. Zbatimi me analogji

1. Normat e vendosura nga Këshilli i Pleqve (pleqësia), gjyqi i pleqve apo Kuvendi i burrave, zbatohen me analogji edhe për zgjidhjen e rasteve

[3] Nëshs Xh. D nga Gjirokastra thotë se: Qytani i Gjirokastrës ka patur një zakon me Labërinë, por zakonet në qytet nuk kanë gjetë aq të patura, se këto vendosnë qysetra turke, e cila ndërlyesn me lagje e saj, me shoqatat për rregullimin e çështjeve familjare. Megjithatë Turqia ndaje punet me lagje e saj, kurse me me zakonet tona.

DO NOT COPY

*Fig. 2. Kanuni i Labërisë, Kreu 1*

• Në një mjedis ndërtimor pranohet nevoja për ndryshim si një kusht i detyrueshëm nga zhvillimi për përmirësimin e cilësisë së jetës në një bashkësi. Lejohen ndërhyrje me karakter ndërtimor, rregullime, shtesa, veçanërisht për veprimtari ekonomike, gjelbërim, kopshtije (të cilat inkurajohen), shkallë të jashtme, etj. që kanë më tepër lidhje me përmirësimin e jetës së një familjeje brenda kufijve të pronës së vet.

• Çdo ndërhyrje në mjedisin ndërtimor duhet të ketë synim:

a. Të mos shkaktojë dëmtime në objektet ekzistuese private apo publike;

b. Të mos krijojë shkak për mosmarrëveshje dhe konflikte shoqërore ndërmjet fqinjëve;

c. Të mos prekë mirëqenien dhe veprimtarinë ekonomike të fqinjëve që ndodhen në zonë.

• Zotëruesit e pronës kanë të drejtën të bëjnë çdo gjë që u nevojitet në pronën e tyre. Megjithatë, kjo liri veprimi brenda pronës vetjake kufizohet nga kushtet ekzistuese të fqinjësisë. ***Mund të ndërtosh, por pa dëmtuar fqinjin, dhe për pasojë edhe veten.*** Më poshtë rendisim disa nga të drejtat dhe kufizimet për ndërtimet:

a. E drejta e përparësisë për të përcaktuar rregulla për të tjerët, por edhe e drejta e blerjes së pronës i pari nga fqinjët;

b. Mosprekja e pronës private dhe e kufijve të fqinjit;

c. Mosdëmtimi i pronës së fqinjit nga veprimet në pronën tënde;

d. Mosprekja e udhës së përbashkët;

e. Moszënia e diellit dhe e panoramës;

f. Moscënimi i intimitetit të banorëve fqinjë duke kufizuar e shikimin nga prona jote drejt të tyrës kur hapin dyert apo dritaret, por duke respektuar kushtin e atij që ka ndërtuar i pari;

g. Mosderdhja e ujërave të bardha apo të zeza në pronën fqinje;

h. Fqinji nuk duhet të dëmtohet nga mbjellja e pemëve apo mbajtja e gjësë së gjallë në pronën tënde;

i. Ndërtimi me mur të përbashkët lejohet me marrëveshje ku përcaktohet pronësia mbi murin, nisur nga fakti se kush ka ndërtuar i pari, apo kush dhe si paguan.

• Të mos dëmtojë mjedisin dhe pronën publike me zënien e saj apo nëpërmjet hedhjes së mbeturinave të pronës private. Nxitja e sjelljes së mirë dhe e bashkëpunimit në dobi të së mirës së përbashkët.

Ajo ç'ka vërejmë nga dy përmbledhjet e mësipërme, të korpusit ligjor ndërtimor bizantin të aplikuar në vendet e Mesdheut dhe korpusit ligjor të bazuar në të drejtën zakonore të vendit tonë, është ngjashmëria në koncepte dhe qëllime.

### 3. Gjirokastra

Procesi qytet-formues i qyteteve të traditës dhe karakteri i theksuar lokal.

Më poshtë do të shtjellojmë temën në kontekstin territorial ku ka vepruar Kanuni i Labërisë *(fig. 2)*. Duke u bazuar në këtë të dhënë, do të studiojmë marrëdhëniet konkrete të qytetit të Gjirokastrës me Kanunin e Labërisë ose siç njihet ndryshe Kanuni i Papa Zhulit pasi:

*Kanuni i Labërisë, ose Kanuni i Papa Zhulit, vepronte në territorin e Labërisë, nga lumi Vjosë e deri në detin Jon, duke e shtrirë veprimin e tij deri në qytetin e Gjirokastrës, Delvinës, Tepelenës e Vlorës, për rregullimin e marrëdhënive të ndryshme juridike në mes të njerëzve*[8].

Të drejtën zakonore të Labërisë, me origjinë që nga lashtësia, gojëdhëna popullore ia atribuon Papa Zhulit nga Zhulati, shek. XI, i cili mendohet se ka qenë prift dhe prijës i Kurveleshit, i njohur nga normanët gjatë pushtimit të tyre në 1081. Figura e Papa Zhulit i takon kohës së Bizantit, çka dëshmon se gjurmët e Kanunit të Labërisë gjenden qysh atëherë dhe kanë vepruar në praktikë krahas monokanonit bizantin[9].

Ndodhemi përballë një dualizmi juridik, ku nga njëra veprojnë ligjet e shtetit qendror (ligjet byzantine, sheriati dhe ligjet e Perandorisë Osmane) dhe nga ana tjetër, ku marrëdhëniet mes pjesëtarëve të komunitetit rregulloheshin sipas normave të Kanunit, pavarësisht nga sfera e veprimit. Prandaj, me qëllim analizimin e rregullave që kanë ndikuar në rregullimin e çështjeve të mjedisit të ndërtuar në qytetin e Gjirokastrës, ky studim nuk mund të mos përfshijë edhe rregullat dhe normat të cilat rregullonin jetën shoqërore të banorëve që e populluan këtë vendbanim. Studime të mëtejshme janë të nevojshme për të konstatuar pikëtakimin mes ligjit, zakoneve lokale dhe formës së ndërtuar.

Çfarë thuhet për themelimin, lindjen e qytetit?

Qyteti i Gjirokastrës pozicionohet në luginën e Drinos, i ndërtuar në krahun e majtë të luginës, rrëzë Malit të Gjerë. Që në kohët më të lashta Gjirokastra gjithnjë ka pasur marrëdhënie reciproke ekonomiko-shoqërore me qendrat e tjera të banuara të Krahinës së Labërisë, së pari, duke qenë ajo kryeqendrër dhe kryqëzim i rrugëve të lashta, që e lidhnin Vlorën, Janinën, Bregdetin, Kurveleshin, Dropullin etj.

Gjirokastra është një qytet mesjetar i cili e ka zanafillën e tij tek kështjella, dhe për të cilën na vijnë të dhënat e para për ndërtimin e saj në gjysmën e shek. XIII. Të dhënën e parë për Gjirokastrën na e sjell kronisti J. Kantakuzeni në vitin 1336[10]. Në gjysmën e dytë të shek. XIV bëhet qendra e zotërve feudalë të Zenebisë, derisa pushtohet nga turqit në 1419. Gjatë shek. XV caktohet kryeqendra e Sanxhakut të Shqipërisë. Nga sa më sipër, mund të arrijmë të datojmë kalimin e Gjirokastrës nga kështjellë në qytet, pra, të daljes së qytetit nga muret rrethuese të kalasë dhe fillimin e krijimit të qytetit të hapur me lindjen e varoshëve të parë, në gjysmën e parë të shek. XIV. Pra, ndryshe nga shumë qendra të tjera qytetare, të lindura në kohët antike, Gjirokastra është qytet mesjetar, i cili nis të dalë jashtë mureve të kalasë në fillim të shek. XIV, pastaj në shek. XV pëson një rënie ashtu si edhe shumë qendra të tjera qytetare, kjo, për pasojë e pushtimit Osman, për të vijuar më tej në shek. XVI me rritjen e mëtejshme e zhvillimin; kjo rritje vazhdon duke arritur kulmin e lulëzimit të vet në shek. XVII, kur qyteti arrin fizionominë që ka sot, kuptohet, me një dendësi shumë më të vogël ndërtimesh.

Ajo çka është interesante është përkimi i lindjes së qytetit të hapur me kohën e veprimit të Kanunit të Labërisë.

Faktorë si, zgjerimi i qytetit dhe dalja e tij nga muret rrethuese të kalasë, pushtimi turk, caktimi i tij si kryeqendër e Sanxhakut të Shqipërisë, shoqërohen me rritjen e popullsisë, e cila u përqendrua në këtë qendër të banuar. Për të shpjeguar këtë, duhet të përmendim më parë disa fakte lidhur me gjithë këto ndryshime dhe transformime që i kanë ndodhur qytetit.

Rritja e qytetit në shekuj u shoqërua me një rritje të theksuar mekanike të popullsisë, kryesisht me të ardhur nga fshatrat përreth. Këto dyndje drejt qytetit ndodhin për shkak të sigurisë që ofronte qyteti si qendër administrative e perandorisë otomane. Këtu erdhën pronarë tokash, ofiqarë të administratës turke dhe plot të tjerë si shërbyes e tregtarë. Gjirokastra kurdoherë mbeti një qendër administrative dhe tregtare pa zhvilluar zejet dhe prodhimin. Mbeti një qytet pronarësh tokash dhe nëpunësish të administratës turke. Në qytet funksiononin vetëm zejtarë të vegjël dhe njësi shërbimesh të domosdoshme për banorët. Kjo popullsi u përqendrua në varoshet e krijuara

[8] Elezi, Ismet, *Kanuni i Labërisë,* neni 9, pika 1 dhe 2, 2006.
[9] Elezi, Ismet, *Kanuni i Labërisë,* parathënie, 2006.
[10] Riza, Emin, *Gjirokastra, Qytet-muze,* Tiranë, 2004.

DO NOT COPY

jashtë kalasë, duke realizuar formimin e shpejtë të qytetit të hapur qysh në gjysmën e parë të shek. XIV.

Të ardhurit e shumtë sigurisht ishin nga trojet përreth qytetit me kuptimin më të gjerë të mundshëm, që përfshin gjithë krahinën e Labërisë, në mes të së cilës ndodhej gjeografikisht qyteti. Sipas Kanunit:

***Njerëzit në zonat e vetëqeverisjes vendore janë të lirë të lëvizin dhe të ndryshojnë vendbanim e vendqendrim sipas nevojave të tyre.***

(Neni 15. pika1. Kanuni i Labërisë).

Është më se logjike të pranojmë këtu se ardhja e të huajve në qytet, kryesisht nga fshatrat përreth solli me vete mënyrën e tyre të jetuarit e për rrjedhojë mënyrën e të konceptuarit të banesës, si në aspektin funksional edhe atë ndërtimor. Kjo dallon qartë në ngjashmërinë e banesës fshatare tip kullë të krahinës së Labërisë me banesat e thjeshta tip kullë me një mjedis në kat të qytetit. Por, gjithsesi duhet theksuar se zanafilla e tyre është në zonën fshatare, që nga banesat e Kamenicës (shek. XII para Kr.) dhe ato të mëvonshme në vendbanimet fshatare bashkëkohëse me qytetin.

Më poshtë, disa shembuj të banesës në krahinën e Labërisë dhe të tipeve të para të banesës gjirokastrite *(fig. 3,4,5)*.




*Fig. 3. Banesë në fshatin Salari, Kurvelesh i Sipërm, Tepelenë* (Riza, E., *Ndërtimet fshatare në Labëri*)




*Fig. 4. Banesë në Gjirokastër* (Riza, E., *Qyteti-Muze i Gjirokastrës*)




*Fig. 5. Banesë në lagjen Palorto, Gjirokastër* (Riza, E., *Qyteti-Muze i Gjirokastrës*)

DO NOT COPY




*Fig. 6. Harta e Krahinës së Labërisë*
(Riza, E. *Ndërtimet fshatare në Labëri*)

Qyteti zhvillohet më shpejt se fshati, si rezultat i pozicionit strategjik të favorshëm, si rezultat i sigurisë që ofron për veprimtaritë ekonomike, si kryeqendër administrative dhe falë tërheqjes që ushtron ndaj popullsisë nga zonat fshatare përreth. Gjithë ky zhvillim dallohet së pari në faktin që banesa e thjeshtë rritet dhe zmadhohet në plan e lartësi, pasurohet me elementë funksionalë dhe dekorative, duke u përkthyer në shprehje të pozitës ekonomiko-shoqërore të familjes.

Zhvillimi i qytetit është proces afatgjatë që jep mundësi të përpunimit dhe konsolidimit të gjuhës shprehëse arkitekturore. Gjatë këtij procesi të gjatë në kohë realizohet kalimi gradual, nga tipet e thjeshta të fillesës në ato më të arrira dhe komplekse, si në anën funksionale dhe atë strukturore e dekorative.

Ky zhvillim është i domosdoshëm të studiohet njëkohësisht si proces dhe produkt.

**Së pari, me proces do të kuptojmë tërësinë e veprimeve për të arritur në vendimmarrje**. Në formën e strukturës urbane të qytetit të Gjirokastrës dallon qartë ndikimi i normave të Kanunit të Labërisë. Shumë nene në Kanun flasin për të drejtat që gëzon anëtari i bashkësisë brenda kufijve të pronës private, flasin për mënyrën e ndërtimit në parcela, flasin për kufizimet, distancat ndërmjet objekteve, përmasat e rrugëve kryesore apo të shërbimit, trajtimin e mbetjeve etj.

**Së dyti, me produktin do të kuptojmë rezultatin e arritur si në strukturën urbane të një vendbanimi edhe në vlerat e peizazhit historik të tij.** Do të kuptojmë rezultatin e arritur në tipologjitë ndërtimore të banesës, në formulimin e hapësirës private në eksterier dhe interier, në nivelin teknologjik të ndërtimit, por dhe në vlerat estetike e arkitektonike të cdo modeli ndërtimor. Produkti i realizuar në objektin urban, në rastin tonë qyteti i Gjirokastrës, vlerësohet për unitetin e gjuhës shprehëse, individualitetin urban në tërësi, të veçantën dhe mospërsëritjen e modeleve ndërtimorë dhe peizazhin urban unikal.

a. **Procesi.** Veçori të strukturës urbane të qytetit të Gjirokastrës.

Do të mundohemi të dallojmë konceptet formë-krijuese në strukturën urbane të qytetit, duke i vendosur përballë neneve të Kanunit të Labërisë. Gjithmonë duke e konsideruar qytetin si kryeqendër të Krahinës së Labërisë *(fig. 6)*.

***Neni 55. 1. Krahina është njësia etnokulturore dhe tokësore më e madhe që përbëhet nga tërësia e fshatrave që kanë të përbashkëta gjuhën (dialektin), zakonet, traditat, kulturën, me kufij të caktuara e rrugë ndërlidhëse me fshatrat e saj dhe me krahina të tjera.***

1. Lagjet e para qytetit të Gjirokastrës, organizohen mbi bazë farefisnore. Bazuar në të dhënat historike të lindjes së qytetit të hapur, kemi krijimin e lagjeve të para të formuara në bazë gjinie, me banesa të një farefisi, por gjithnjë duke qëndruar si njësi të veçanta, karakteristikë e njohur gjerësisht në fshatrat e lashtë shqiptarë. Shembujt që na vijnë në ditët e sotmë janë lagjet "Manalat" e "Dunavat", të cilat janë shumësa kolektivë, gjurmë të jetës së dikurshme

DO NOT COPY

fisnore, fenomen i përhapur gjerësisht në fshatrat e krahinës së Labërisë[11].

***Neni 54.*** *Fshati është njësia kryesore tokësore, që* përbëhet nga tërësia e shtëpive *të të gjitha mëhallave dhe përbëhet nga disa vëllazëri e fise*[12].

***Neni 52.*** Mëhalla përbëhet nga një njësi tokësore e caktuar, ku banojnë bashkësi shtëpish, të një ose disa vëllazërive, që rrjedhin nga një trung i përbashkët, ose dhe të vëllazërive të ndryshme, apo të familjeve të veçanta *të ardhura, me të drejta e detyrime të barabarta.*

2. Në qytetin e Gjirokastrës, ndarjet klasore të popullsisë ishin të theksuara. Dallon hirarkia qytetare. Kemi shtresat e pasura - pronarët e tokave, ofiqarët; klasa e mesme dhe klasa e varfër. Bazuar në ecurinë e zhvillimit në kohë të banesës së fortifikuar të Gjirokastrës, në modelet e shumta e të papërsëritëshme të banesës, madhësinë e tyre, pasurinë e elementeve arkitekturorë dhe strukturorë dhe përzgjedhjen e truallit të ndërtimit, mund të konkludojmë se një tendencë për dukje e prestigj gjallonte mes familjeve. Ka qenë kjo garë për më të mirën, më të madhen, më të dukshmen, që ka realizuar kryeveprat që shohim sot. Ekzistenca e kësaj hierarkie qytetare është e përcaktuar dhe e lejuar edhe në Kanun.

***Neni 130. Banesa e familjes.*** *1. Në varësi nga lloji i familjes dallohet edhe banesa, në të vogël, të mesme apo të madhe, oxhaqet, der' e madhe, der' e parë. 2. Bujqit që punojnë e banojnë në tokën e pronarit të tokës nuk lejohet të mbajnë oxhak.*

3. Gjirokastra është qytet tipik vernakular. Ajo është zhvilluar, në aspektin urban jashtë çdo influence të stileve të Perandorisë Osmane, duke u ndikuar në çdo aspekt vetëm nga përshtatja me vendin, gjeomorfologjinë, klimën por dhe funksionalitetin ekstrem.

Është vështirë të dallosh bllokun e banimit, siç ai kuptohet në përgjithësi, në planimetrinë e qytetit. Gjirokastra organizohet në lagje mbi kurrizet e kodrinave *(fig. 7)*, ku lagjet, duke mos qenë aspak uniforme mes tyre, organizohen duke patur rrugën kryesore si shtyllë kurrizore të lëvizjes. Në këtë kategori rrugësh dallon formulimi hapësinor i elementit rrugë.

Blloku i banimit në Gjirokastër nuk arrin ta formulojë rrugën nëpërmjet organizimit të ndërtimeve *(fig. 8)*. Ndërtimet janë larg saj dhe kontakti i rrugës është kurdoherë me oborrin, murin rrethues dhe portën e avllisë.

Kjo përshtatje dhe ky organizim i lagjeve lineare dhe bllokut të banimit i jep strukturës urbane të veçantën dhe unikalen. Nuk kemi të bëjmë më përzgjedhje orientimesh, rregullash për trasimin rrugor etj. por, gjeomorfologjia e terrenit ka përcaktuar mënyrën e ndërhyrjes ndërtimore në të.

4. Banesa gjirokastrite ndërtohet brenda një rrethimi (një trualli të caktuar me kufij të qartë), i cili përbën oborrin e saj. Ajo gjithnjë ka oborrin e vet, duke dalë në këtë mënyrë shumë rrallë drejtpërdrejtë në rrugë. Ky oborr është një element i rëndësishëm, pasi brenda tij zhvillohet jeta e familjes dhe ekonomia e saj, një karakteristikë domethënëse për prejardhjen fshatare dhe ekonominë shtëpiake vetë funksionale *(fig. 9)*. Elemente të tjera funksionale të banesës gjirokastrite janë: odajashta, hauri, furra, kopshti etj. Oborri, duke patur tërë këto funksione, si pjesë e banesës, mbrohet me ligjet e kanunit njësoj si banesa.

***Neni. 372. Shtëpia (banesa).*** *1. Ndër objektet e pronës private, vendin kryesor e zë shtëpia, që shërben për plotësimin e nevojave të banimit të pjesëtarëve të saj dhe për pritjen e miqve. 2. Shtëpia bën pjesë në mëhallë e në fshat me të drejta e detyrime të barabarta. 3. Shtëpia mund të jetë përdhese, me një ose më shumë oda, kasolle, konak, oxhak, mjafton që të banojnë njerëz, të nxjerrë tym dhe të jetë e rrethuar me avlli, mur, gardh, kopsht.*

***Neni 375. Trualli i shtëpisë.*** *1. Me truall shtëpie kuptohet toka që zë shtëpia (banesa) dhe çdo pronë tjetër që bën pjesë ngjitur me shtëpinë, si oborr, kopsht, pemët drufrutorë, vatha e bagëtisë, vatha e bletëve, koteci, kasollja e qenit, mullarët me bar. 2. Prona quhen dhe vreshtat, livadhi, ara që është ngjitur ose jo me shtëpinë.*

***Neni 380.*** *Oborri i shtëpisë është i rrethuar me avlli, mur, apo me gardh dhe mbrohet njëlloj si vetë shtëpia, është i paprekshëm.*

5. Siç tregojmë edhe në pikën 1, që lagjet gjirokastrite kanë pasur karakter farefisnor, një karakteristikë interesante dhe e veçantë për qytetin e Gjirokastrës është ndërtimi i çdo banese si një njësi më vete *(fig. 10)*, ku nuk gjejmë raste të banesave me çati apo mure të përbashkëta, ndryshe nga qytete të tjera ku ky fenomen haset (Berat, lagjja Mangalem). Është e ndaluar me kanun ndërtimi i mureve të përbashkët ashtu siç përcaktohen dhe distancat minimale mes ndërtesave.

[11] *Po aty.*
[12] Elezi Ismet, *Kanuni i Labërisë, 2006.*

DO NOT COPY




*Fig. 7. Fragmente harte të rrugëve mbi kurrizet e kodrave në Gjirokastër*




*Fig. 8. Shembuj të blloqeve të banimit në Gjirokastër (Cfakë, Palorto, Dunavat)*




*Fig 9. Genplane të banesave Angoni, Zekatët dhe Kabili në Gjirokastër (Riza, E., Gjirokastra, Qytet-muze)*

DO NOT COPY



*Fig. 10. Fragmente lagjesh në Gjirokastër (a. Dunavat, b. Manalat, c. Pazari i Vjetër)*

***Neni 377. Ndërtimi i shtëpisë së re.*** *3. Largësia e mureve të shtëpisë do të jetë aq larg kufirit të tjetrit, sa që do të zërë vend streha e shtëpisë q*ë do të ndërtohet. 4. Ndërtimi i *shtëpisë me një mur të përbashkët nuk lejohet për të mënjanuar çdo ngatërresë midis dy pronarëve.*

***Neni 428. Ndërtimi i shtëpisë.*** *2. Shtëpia e re ndërtohet në një largësi nga kufiri i shtëpisë së tjetrit sa që të mos e dëmtojë atë.*

6. Rrjeti rrugor i Gjirokastrës kushtëzohet së tepërmi nga terreni i aksidentuar. Ato përgjithësisht ndjekin vijat rrushkulluese por edhe ndërtohen mbi kurrizet e kodrinave nëpër të cilat zhvillohen lagjet e qytetit. Pavarësisht faktit se kemi rrugë kryesore dhe rrugë sekondare, ajo çka është me interes për ne është dallimi i sistemit rrugor sipas dy kategorive, rrugët e kalimit dhe rrugët qorre. Kategoria e parë ndahen në rrugë kryesore dhe sekondare, të përdorimit të përgjithshëm (njerëz dhe kafshë), ndërsa rrugët qorre janë të përdorimit privat *(fig. 11)*, të cilat hyjnë për në një ose në disa banesa. Nga ana tjetër, ky rrjet rrugor është i papërcaktuar si drejtim, pasi në të kalojnë njerëzit dhe kafshët e ngarkesës në të njëjtën hapësirë; ajo çka përcaktohet është gjerësia funksionale.

***Neni 417. E drejta e kalimit në udhë.*** *1. Udha është vendi I kalimit që lidh një vend me një tjetër, ose brenda njësisë tokësore vendore. 2. Udhët janë të përcaktuara që moti dhe nuk mund të ndryshohen. Kalimi në udhë është i lirë për cilindo se është kadimi (e drejta e fituar nga të parët), se këtej kanë kaluar të parët që nga kohët më të lashta, këtej kalojnë edhe tani. 3. Udha e madhe e fshatit është aq e gjerë sa mund të kalojë kali me ngarkesë, kurse udhët e mëhallës ose shtëpive mund të jenë më të ngushta, nuk ka përcaktim. 4. Çdo ndryshim i udhës mund të bëhet vetëm me pëlqimin dhe marrëveshjen e bashkësisë së mëhallës, për ato brenda saj. 5. Udha e madhe është e lirë për të kaluar kushdo.*

***Neni 418. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e udhëve.*** *1. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e udhëve e të urave të fshatit a të mëhallave, lagjeve bëhet përkatësisht nga banorët e fshatit apo të mëhallës. 2. Prishja e udhës para shtëpisë së ndonjërit detyrimisht ndreqet nga i zoti i shtëpisë. 3. Udhët ndahen në: udhë e madhe e përgjithshme, dhe udhë mëhalle, shtëpie ose are, udhë qorre. Çdo shtëpi ka udhën e saj. Udha e një ose disa shtëpive nuk është udh e tërë fshatit. Udhë qorre është ajo që vazhdon deri në një vend të caktuar e nuk ka dalje tjetër. Udha qorre mund të ndryshojë nga pronari i tokës.*

DO NOT COPY



*Fig. 11. Foto e rrugicës "Shapllo", lagjia "Pazari i Vjetër"*

7. Hapësira publike është e shenjtë. Ajo mbrohet, mirëmbahet dhe është në përdorim të të gjithë pjesëtarëve të komunitetit. Hapësira publike nuk preket, në të kundërt, duhet leja e komunitetit. Në kanun, nenet lidhur me pronën publike janë të shumta ashtu si dhe sanksionet lidhur me dëmtimin e saj.

***Neni 367. Prona e përdorimit të përbashkët.*** *1. Janë pronë e përdorimit të përbashkët që gëzohen nga banorët e bashkësisë vendore uji, çezmat, vija e mullirit, vija e ujit për ujitje të arave, mulliri, dërstila, udhët, koria, pylli, mushaja, kullotat malore.*

***Neni 394. Përdorimi i përbashkët i pronave.*** *1. Prona e përdorimit të përbashkët zotërohet në mënyrë të barabartë nga të gjithë banorët e bashkësisë vendore. Kudo vepron rregulli "**sot kam unë, nesër ke ti.**" 2. Asnjë pjesëtar nuk ka të drejtë të shesë a të blejë pjesë të kories, të mushasë a të pyllit. 5. Çdo shtëpi ka pjesë në pronën e përbashkët.*

***Neni 418. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e udhëve.*** *1. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e udhëve e të urave të fshatit a të mëhallave, lagjeve bëhet përkatësisht nga banorët e fshatit apo të mëhallës. 2. Prishja e udhës para shtëpisë së ndonjërit detyrimisht ndreqet nga i zoti i shtëpisë.*

8. Kontributi dhe detyrimet në komunitet. Të gjithë pjesëtarët e komunitetit jepnin kontributin dhe ndihmesën e tyre në punët e përbashkëta të komunitetit, si në ndërtimin e shtëpisë apo dhe në punët komunitare, mbjellje, korrje, etj. Ky fenomen sanksionohet me nene nga kanuni që i përcakton si detyrime të çdo pjesëtari.

***Neni. 53. Të drejtat dhe detyrat e pjesëtarëve të mëhallës. 2****. Ata kanë për detyrë të respektojnë e të zbatojnë vendimet e Këshillit të pleqve të mëhallës apo të fshatit, për rendin e sigurinë, për punimet apo shërbimet e përbashkëta,...*

***Neni 137. Detyrat e kryefamiljarit.*** *11. Përgjigjet për krahë pune në detyrimet e përbashkëta të mëhallës apo të fshatit.*

***Neni 418. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e udhëve.*** *1. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e udhëve e të urave të fshatit a të mëhallave, lagjeve bëhet përkatësisht nga banorët e fshatit apo të mëhallës.*

***Neni 428. Ndërtimi I shtëpisë.*** *1. Ndërtimi i shtëpisë bëhet me ndihmën e të gjithë bashkësisë vendore.*

***Neni 451. Detyrimet ndaj bashkësisë.*** *2 Çdo burrë si pjesëtar i bashkësisë ka detyrim të marrë pjesë në punime të përbashkëta të bashkësisë, si për ndërtimin udhe, të vijës së ujit, të vijës së mullirit.*

***Neni 483. Kontrata e ndihmës për njëri-tjetrin.*** *1. Kontrata e ndihmës për njëri-tjetrin, pa shpërblim ndërmjet banorëve të bashkësisë, realizohet me vullnet të lirë në ndërtimin e shtëpive (hedhjen e themeleve, ngritjen e mureve, të çative), në mbjelljen e korrjen e bereqetit në ara, në djegjen e kaminës, kur qethen dhentë e posaçërisht në raste dasmash e fatkeqësish familjare e natyrore, ...*

9. Transmetimi i përvojës ndërtimore bëhet nëpërmjet mjeshtrit popullor. Mjeshtri ndërtimor ishte njëkohësisht krijues dhe realizues, mjeshtëri të përfshira në të njëjtin person, i cili ishte detyrimisht njohës i mirë i mënyrës së jetesës dhe normave sipas të cilave jeta shoqërore

DO NOT COPY

funksionone. Nga ai pritej të njihte rregullat e kanunit për fqinjësinë, zakonet e vendit, dhe traditat e praktikës ndërtimore. Mjeshtri popullor duhet të përshtaste dhe të fliste gjuhë të qartë me porositësit, terminologjia e ndërtimit duhet të ishte e njëjtë për të shmangur çdo keqkuptim gjatë marrjes së porosisë apo sqarimit të idesë së asaj që do realizohej. *(odatë, tataposhi, kameriet, oxhaku, minderet, musandaratë, dhipato, sokaku, porta, odajashta, avllia dhe kopshti, hauri, stera, dërrasat, dhoga, etj. etj,).* Roli dhe pozicioni i mjeshtrit popullor është shumë i rëndësishëm në momentin që nuk ka një projekt urbanistik apo ndërtimor, por ka rregulla që sigurojnë mbarëvajtjen e punës, realizimin e porosisë mbi modele të realizuar më pare, që mund të shërbejnë si fillim i konceptit të shtëpisë. Mjeshtri popullor bën të mundur që me eksperiencën e tij të shmangë që në fillim çdo konflikt me fqinjët dhe me qytetin.

***Neni 872. Sigurimi i zbatimit të tyre.*** *Zbatimi i rregullave të vendosura sigurohet nga forca e traditës dhe ndikimi i organizmave të vetëqeverisjes vendore, duke parashikuar,* për shkelësit e tyre*, ndëshkimin me gjobë ose me "faqen e zezë", nxjerrjen para këshillit të pleqve ose Kuvendit të Burrave, ose përpara mbledhjes së përgjithshme të bashkësisë së njësisë vendore.*

10. Të gjithë kanë të drejtë të veprojnë të lirë brenda kufijve të pronës së vet, të ngrejnë banesën e ndërtimet ndihmëse në përputhje me nevojat e jetës familjare dhe më klasën shoqërore. Porositësi komunikon me mjeshtrin ndërtimor popullor lidhur me kërkesat që ka. Në realitet, krijohet një raport në tre nivele: mjeshtri ndërtues – porositësi - komuniteti. Porositësi shpreh kërkesat e tij lidhur me ndërtimin dhe në përputhje me klasën shoqërore që bën pjesë, mjeshtri popullor i përkthen këto kërkesa në elementë ndërtimorë bazuar në gjuhën lokale. Për këtë arsye, mjeshtri duhet të jetë njohës shumë i mirë i mënyrës së jetesës dhe i normave që duhen respektuar, në mënyrë që të mos cënohen të drejtat e pjesëtarëve të komunitetit gjithnjë duke plotësuar kërkesat e porositësit. Pra, në këtë proces, komuniteti duhet të japë pëlqimin e tij. Kjo, në rastin konkret është e përkthyer në ceremonitë që organizohen lidhur me procesin e fillimit e mbarimit të punimeve. Këto ceremoni kanë forcën e kontratës, janë ceremoni ku porositësi pranon planin e mjeshtrit për çfarë ka kërkuar, janë ceremoni ku mjeshtri fillon apo dorëzon punën, janë ceremoni ku ndërtimi pranohet nga fqinjët që sjellin dhurata…

***Neni 377. Ndërtimi shtëpisë së re.*** *6. Kur hapen themelet theret nje dash ose një cjap kurban i themeleve. Kur ngrihet kulmi i çatisë, si rregull, vihen shami me lule. 7. Në mbarimin e saj (shtëpisë) shtrohet darkë për ustallarët, miq e dashamirë dhe u jepet shpërblimi sipas marrëveshjes ndërmjet tyre, si dhe ndonjë sasi të hollash peshqesh (dhuratë). Me rastin e mbarimit të shtëpisë bëhet urimi: "E gëzofsh me djem e me të gjithë ç'ke."…*

b. **Produktin**, në kuptimin e rezultatit të pritshëm në strukturën e një vendbanimi, që është rezultat i kombinimit të varianteve e tipologjive kompozicionale të aplikuara dhe mbi të gjitha marrëdhënia që vendoset mes tyre *(fig. 12)*.

Objekti urban gjirokastrit është produkt i:

1. Terrenit ku është ngritur;
2. Materialit ndërtimor;
3. Traditës ndërtimore të ardhur nga fshatra të krahinës me nivel të lartë urbanizimi;
4. Kërkesës për hierarki shoqërore;
5. Mirëqënies ekonomike në periudhën e mesjetës së vonë në Shqipëri.

Në këto kushte, shoqëria gjirokastrite përpunoi një tipologji banese tërësisht të veçantë por me potencial shumë të lartë transformues. Banesa gjirokastrite, para se të jetë një model është një koncept ndërtimor modular, i lidhur me vendin si materialisht edhe shpirtërisht. Në interierin e saj nuk mund të përjashtohen ndikimet otomane por edhe këtu ka një element që e largon pjesërisht prej saj. Në banesën gjirokastrite nuk ndahej femra nga jeta e familjes dhe miqtë. Edhe kjo është një referencë e kanunit të labërisë ku në shekullin e XIX u rishikua roli i femrës në jetën shoqërore.

Banesa gjirokastrite si karakteristikë ka ndërtimin modular. Pavarësisht shkallës së zhvillimit tipologjik, elementët përbërës që kanë bërë të mundur krijimin e gjithë varianteve dhe nënvarianteve të kësaj banese janë blloku i banimit, ku zhvillohen ambientet e jetës së familjes, korpusi qendror me funksion më së shumti qarkullues dhe shërbimi, si dhe kameria, një bllok i jashtëm që ka fillimisht funksion mbrojtës dhe më tej fiton edhe funksionin soditës. Më poshtë do të evidentojmë skemat e zhvillimit tipologjik të banesës gjirokastrite ku kemi tipin më të thjeshtë me kullën me një bllok dhe volum të vogël shtesë shërbimi, më

DO NOT COPY



*Fig. 12. Panorama të qytetit të Gjirokastrës*

tej shtimin e kameries volumit fillestar, variantin me një krah dhe nënvariantet e veta derisa arrihet në variantin më të zhvilluar të kullës qytetare, atë me dy krahë, ku kameria përfshihet në korpusin qëndror duke u kombinuar me të.

Në planin arkitekturor banesa gjirokastrite është produkt i tre elementëve

- Blloku i banimit
- Blloku i lëvizjes vertikale dhe shërbimit
- Kameria si element me funksion mbrojtës dhe çardaku si element panoramik çlodhës. Me rënien e funksionit mbrojtës të kameries, kjo e fundit fiton funksione panoramike duke u kombinuar me çardakun.

Zhvillimi tipologjik i banesës gjirokastrite përbëhet nga tre variante kryesore: varianti perpendikular ose me gjysëm kat, variant me një krah dhe variant me dy krahë. Këta tre variante pasurohen me nënvariantet e tyre, duke arritur kështu në shkallën më të lartë të zhvillimit të banesës qytetare gjirokastrite. *(fig. 13)*.

Peizazhi i një qyteti kombinon veçoritë e dallueshme të një sipërfaqeje të caktuar, ku përfshihen elementët fizikë të relievit me elementët njerëzorë të ndërhyrjes në të. Në rastin e Gjirokastrës, peizazhi do të trajtohet në dy këndvështrime: kundraja nga banesa dhe qyteti drejt natyrës dhe peizazhi urban me elementët e tij unifikues.

Kundrajë *(fig. 14)* është një term i cili ka lidhje me gjithë pamjen që soditet dhe është nën kontroll nga banesa, është termi që tregon vendosjen e banesës në territor, orientimin e saj dhe këndin e soditjes nga çardaku apo nga odat. Kushtëzuar nga gjeotopografia e qytetit që vjen duke u lartësuar në drejtim të jugut, vendosja e banesës në truall i kushtëzon asaj pamjen nga veriu duke kundruar luginën e Drinos përballë dhe kur ndodhemi në lagjet e sipërme, kjo kundrajë kombinohej edhe me çatitë e lagjeve të poshtme.

Peizazhi urban historik me elementet e tij unifikues është rezultat i kombinimit të gjeotopografisë me ndërhyrjet shumëshekullore të njeriut në këtë terren. Ai pasqyron thelbin e identitetit lokal. Ky identitet, para së gjithash dallohet në përdorimin e materialeve lokale ndërtimore, që na sjellin përkatësinë me vendin dhe marrëdhënien e njeriut me një territor të caktuar. Në këtë unitet pamor *(fig. 15)*, elementet e dallueshme janë:

- çatitë me rrasa guri, linjat horizontale që ato krijojnë, të para nga larg;
- konstruksionet e guximshme me gurë në formën e harqeve ritmikë apo të veçuar;
- ritmi i dritareve, dhe i pjesëve të dukshme të muraturës;
- shtrirja e ndërtimeve dhe silueti i ansamblit që ndjek

DO NOT COPY






*Fig. 13. Tabelë përmbledhëse e tipologjive të banesës qytetare gjirokastrite*

*Fig. 14. Skicë, Kundraja*

DO NOT COPY



DO NOT COPY

*Fig. 15. Panoramë e Gjirokastrës, Kalaja dhe lagjja "Pazari i Vjetër"*

përgjithësisht linjën e kurrizeve të terrenit, duke krijuar linja shumë dinamike;

- materiali mbizotërues që përcakton strukturën ndërtimore është guri, i përdorur gjerësisht në konstruksionet mbajtëse dhe në elementë të fasadës. Ky material përbën bukurinë e katit të poshtëm, madhështinë e portave kryesore të banesave dhe unitetin harmonik të çative që krijojnë fasadën e pestë në banesën gjirokastrite.

Ligjet vendore, kushtet e vendit dhe njerëzit me kulturën e tyre krijuan Gjirokastrën- qytet në Shqipëri, e ndërtuar nga mjeshtërit shqiptarë për porositës shqiptarë dhe për një formë të caktuar marrëdhëniesh shoqërore të përcaktuara nga ligje kanunore më tepër se ato shtetërore.

Por, nuk mund të themi se ky është një fenomen dhe realizim i vetëm në mjedisin shqiptar. Vlera dhe identitet lokal ka në çdo vendbanim. Në secilin prej tyre, edhe në ata pa vlerat e larta që kanë Gjirokastra, Berati, Korça a ndonjë qytet tjetër, brenda shumëllojshmërisë dhe mospërsëritjes, mund të dallosh harmoninë dhe unitetin, pra të përbashkëtën kompozicionale, të përbashkëtën në mendim, të realizuar nga:

**E veçanta e peizazhit natyror dhe e gjeomorfologjisë së terrenit**;

**Identiteti morfologjik i strukturës urbane tërësore të qytetit**;

**Identiteti i hapësirës urbane në tërësinë e saj publike dhe private**;

**Identiteti i konceptimit dhe organizimit të bllokut të banimit**;

**Identiteti arkitekturor dhe hapësinor i elementit *Rrugë*;**
**Identiteti arkitekturor dhe hapësinor i elementit *Shesh*;**
**Simbolet dhe toponomastika urbane;**
**Identiteti i çdo modeli arkitekturor të banesës.**
**Identiteti i organizimit hapësinor në interierin e veprës arkitekturore;**
**Identiteti i organizimit të hapësirës së jashtme private;**
**Deri tek identiteti i portës së hyrjes në banesë, kufi shumë domethënës i kalimit nga hapësira publike në atë private.**

Është pikërisht principi i shumëllojshmërisë brenda karakterit unik të së tërës dhe lirisë brenda rregullit, që siguron identitetin morfologjik të Gjirokastrës, duke realizuar një harmoni konceptuale, produkt i të cilës është identiteti arkitekturor, estetik dhe shoqëror i këtij vendbanimi, identiteti i peizazhit historik urban të tij, i realizuar nëpërmjet një gjuhe shprehëse urbane, arkitekturore dhe kulturore të papërsëritëshme.

Kjo krijon dallueshmërinë dhe të veçantën e çdo vendbanimi në tërësinë kombëtare të trashëgimisë kulturore. E veçanta brenda karakterit të së tërës dhe liria brenda rregullit janë principe të ndikimit të ndërsjellë të ligjeve ndërtimorë në jetën shoqërore dhe anasjelltas, i ndikimit të psikologjisë së jetës mbi formën fizike dhe hapësinore të vendbanimit. Në këtë mënyrë, peizazhi kulturor krijon atë tërësi, ku ritualet si përjetime psikologjike të paprekshme, dhe artefaktet si kuadër i objekteve të prekshëm që i mbështesin ato, janë në harmoni dhe ekuilibër.

**Duhet të theksojmë se "Liria brenda rregullit", si princip udhëheqës dhe si fenomen i përgjithshëm në urbanistikën vernakulare, i dukshëm qartë në objektin urban të Gjirokastrës, e bën këtë qytet thellësisht produkt të kodeve ndërtimorë vendorë që janë aplikuar me konsekuencë shekullore në zhvillimin e tij në shekuj.**

Duke u bazuar në rastin Gjirokastra, ky rezultat mahnitës si pasuri e jona e papërsëritëshme, natyrshëm lind pyetja **"A mund të ndërtojmë sot kode vendorë?".** Mendoj se **PO,** për disa arsye:

1. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë sepse legjislacioni modern i urbanistikës dhe arkitekturës nuk është kurdoherë plotësisht i zbatueshëm në ndihmë të karakterit, identitetit vendor dhe kontekstit të trashëgimisë kulturore të vendbanimeve të veçantë me traditë dhe jetëgjatësi historike. Ky legjislacion është i ndërtuar për qytete që projektohen dhe jo për ata ku produkti urban dhe arkitekturor është rezultat i veprimtarisë së bashkësisë qytetare;

2. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë për të ruajtur identitetin kulturor të trashëguar në vendbanimet tona, veçanërisht sepse ndërhyrja sot në ta është kryesisht pjesore, rinovuese, rijetëzuese, përveçse zhvilluese. Kodet vendorë mbrojnë vlerat lokale nga presioni i ndërkombëtarizimit;

3. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë për të siguruar një nivel të lartë dhe kompetent në projektimin urban, për të mos rënë në përgjithësime, importim idesh dhe principesh projektuese ndërkombëtare, që zhdukin vlerat vendore;

4. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë sepse kurdoherë, dhe veçanërisht në mjedise me vlera kulturore, duhen ligje dhe principe që udhëheqin drejt projektimin urban dhe arkitekturor;

5. Ne duhet të ndërtojmë kode të rinj vendorë sepse ata gjithsesi ekzistojnë të materializuar në morfologjinë e qyteteve tanë dhe nuk mund t'i fshijmë apo neglizhojmë. Nuk mund të veprojmë vetëm mbi bazën e rregulloreve urbanistike të ndërkombëtarizuara apo rregulloreve të projektit të hartuar nga individë;

6. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë sepse ata prekin jo vetëm projektuesit urbanë por dhe shumë specialitete dhe fusha të tjera veprimi që ndërhyjnë në rijetëzimin dhe ruajtjen e vlerave në qytetet tona;

7. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë në ndihmë të vendimmarjes lokale dhe komunitetit të banorëve, sepse kur ato hartohen nga arkitektë, historianë, antropologë dhe inxhinierë të profileve të ndryshme, të nivelit të lartë, dhe pas një pune të madhe njohëse dhe analizuese të problemeve, ndihmojnë dhe orientojnë krijimtarinë dhe planifikimin urban në rrugën e duhur;

8. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë sepse ata sigurojnë diversitetin e mjedisit urban dhe jo njëfunksionalizimin e tij;

9. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë sepse nëpërmjet tyre ne marrim në konsideratë njeriun dhe psikologjinë e tij të brumosur historikisht nga mjedisi dhe konteksti kulturor vendor;

10. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë për të mundësuar pjesëmarrjen e kujtdo në planifikim dhe projektim. Kodet vendorë nuk duhen konsideruar si kufizim

DO NOT COPY

i krijimtarisë por si ide dhe koncepte udhëzuese të saj. Kodet vendorë sigurojnë shumëllojshmëri dhe identitet kombëtar, rajonal apo qytetas në urbanistikë dhe arkitekturë;

11. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë për të zhvilluar më tej cilësinë e jetës në qytet, ndjenjën e bashkësisë, dhe varësinë e ndërsjellë të njeriut dhe hapësirës publike;

12. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë në ndihmë të zhvilluesve dhe investuesve për të orientuar drejt politikat e zhvillimit të qëndrueshëm të vendbanimeve;

13. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë për të luftuar prirjen individualiste dhe arrogancën e arkitektëve dhe projektuesve urbanë për vetëvlerësim dhe formalizëm komercial, por dhe për të eliminuar paaftësinë dhe joprofesionalizmin;

14. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë në ndihmë të shkollave të arkitekturës në procesin e përgatitjes së arkitektëve të rinj;

15. Ne duhet të ndërtojmë kode vendorë për të rritur nivelin e gjithëpërfshirjes në problemet e jetës në objektin urban.

Mund të ketë dhe shumë argumenta të tjerë, por gjithsesi, thelbi qëndron në krijimin e një korpusi të favorshëm ligjesh nga lart dhe kodesh vendorë në ndihmë të proceseve rijetëzuese, transformuese dhe zhvilluese në tërësinë e qyteteve tanë dhe jo vetëm në ata të mbrojtur me ligje të veçantë. Studimi i kanuneve, si përvoja të vërtetuara nga koha, dhe i marrëdhënieve të tyre me proceset urbane ndihmon në formulimin e drejtë të legjislacionit të ndërtimit, por dhe të kodeve qytetare apo të rregulloreve të veçanta të çdo vendbanimi të kohës sonë. Në çdo vendbanim shekullor ka vlera urbane, arkitekturore apo peizazhi që duhen ruajtur dhe zhvilluar në përputhje me kohën, pa eliminuar vlerat e traditës, por duke i zhvilluar këto vlera të papërsëritshme në harmoni me trashëgiminë kulturore dhe veçantitë që identifikojnë çdo qytet.

DO NOT COPY

Joli MITROJORGJI

DO NOT COPY

# BUILDING CODES IN ALBANIA
# CITY -FORMING PROCESS OF TRADITIONAL SETTLEMENTS. GJIROKASTRA

Many traditional settlements in our country have a life expectancy over 2500 years old, but how is it possible to resist through time, for so long. Which are the factors that have made possible the continuity of social and cultural life of the traditional Albanian cities? The Albanian society has been developed and transformed in accordance to the state organizations of the civilizations that have left their traces all over our territory but, another form of legislation, that of the *canon law,* has coexisted with the central power.

As for the building environment, we will show a historic document, the byzantine building code, the treatise of Ascalon from Palestine, written between 531-533 A.D., that widened its influence in the Balkan countries; on the other hand, we will numerate the building codes incorporated in the Canon Law that have contributed in the creation of the build environment of the traditional settlements, such as Gjirokastra.

First of all, the main issues discussed in the Treatise of Ascalon can be summarized as below: the change in the build environment is a natural process, but in the face of ongoing change, it is necessary to maintain an equitable equilibrium in the built environment; change, particularly that occurring among proximate neighbors, creates potential for damages to existing dwelling and other uses; in principle, property owners have the freedom to do what they are pleased on their own property, but constrained by preexisting conditions of neighboring properties; the compact built environment of ancient towns necessitates the implementation of interdependence rights among citizens, principally among proximate neighbors; the public realm must not be subjected to damages that result from activities or waste originating in the private realm; the panorama is important to preserve because they give pleasure to the community and they carry cultural values of a traditional settlement; public realm is protected from all damages.

Second of all, Albanian popular legal corpus treats issues such as: the change in the built environment is accepted as obligatory condition for the development and improvement of social and community life; intervention in the built environment must avoid damages in the public realm; the freedom to act within the boundaries as long as this activity prevents damages to others; the public realm must not be damaged and cooperation is stimulated for the common good.

The analysis of the city-formation process of Gjirokastra will be based on the direct relations with the Canon of Labëria, as central city of the region. The study of the city development has to be viewed as a process and as a product. The process implies the entirety of actions for the decision-making, and on the other side, the product implies the results in the urban structure of a settlement and the values of the historical landscape.

Based on Gjirokastra key-study, the amazing result of this world heritage property, we think that we should sustain our building process in some local codes because: the legislation is not always applicable for the good of local identity of the traditional settlements, we shall

preserve the inherited cultural identity, we shall take in consideration the man and his psychology deeply embodied in the cultural and historical environment, and we shall improve life quality, the sense of community and the interdependency of man with the public space. Many arguments can be listed, but the purpose is to create a favorable law corpus from the top and local codes from below to help the revitalization, transformative and development process. The study of the canon and their relations with the urban processes helps in the right formulation of building legislation, but also of the city codes or specific regulation of every living settlement.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Lejla HADZIC
Elena MAMANI
Kreshnik MERXHANI

DO NOT COPY

# RESTAURIMI I BANESËS BABAMETO, MONUMENT KULTURE I KATEGORISË I GJIROKASTËR

## 1. Hyrje

Projekti i restaurimit i banesës së familjes Babameto, Monument Kulture i kategorisë së parë (më tej Babameto I) ishte pjesë e një projekti bashkëpunimi më të gjerë i ashtuquajtur "Gjirokastra 2009 - 2011", që përfshinte restaurimin e dy monumeteve të kategorisë I e II në Gjirokastër, organizimin kampeve të restaurimit si dhe trajnimin e profesionistëve të rinj vendas në fushën e restaurimit.

CHwB është një Fondacion Suedez, i themeluar në vitin 1995 për të reaguar ndaj shkatërrimeve të trashëgimisë kulturore në rajonin e Ballkanit. CHwB e ka shtrirë aktivitetin e saj në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, duke hapur në vitin 2009 degën e saj edhe në Shqipëri. Gjatë këtyre 20 viteve CHwB ka ngritur modele bashkëpunimi në rajonin e Ballkanit që nuk kufizohen vetëm në dhjetra projekte restaurimi të monumenteve të kulturës të këtyre vendeve, por ka si qëllim edhe ngritjen e marrëdhënieve me profesionistët e rinj të fushës si dhe komunitetet lokale. CHwB ka krijuar disa rrjete të rëndësishme bashkëpunimi midis muzeve kombëtare të rajonit të Ballkanit dhe midis organizatave më aktive që punojnë në këto vende në fushën e trashëgimisë[1].

Banesa madhështore e Babametove është pjesë e rëndësishme e peizazhit urban-arkitektonik të Gjirokastrës dhe në qendër të zonës së mbrojtur, pjesë e trashëgimisë botërore. I braktisur plotësisht pas vitit 1997, ky monument i kategorisë I degradoi shumë shpejt dhe u fut në listën e prioriteteve për ndërhyrje restauruese. Me investime shtetërore në vitin 2005, u rindërtua çatia e banesës si dhe pjesë të tjera të rrënuara, por këto ndërhyrje nuk ishin të mjaftueshme dhe banesa mbeti edhe pas kësaj në një gjendje shumë të keqe, deri ne fillimin e punimeve restauruese nga CHwB (Fig. 1). Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte restaurimi i plotë i monumentit dhe kthimi i hapësirave që ai ofronte në shërbime hotelerie, por edhe për aktivitete të tjera publike (hapësira për seminare dhe ekspozita).

Si një element kryesor i zonës më të gjerë të pazarit të Gjirokastrës, restaurimi i shtëpisë së Babametove ka sjellë një lëvizje të re në këtë zonë tregtare - duke plotësuar një kompleks më të gjerë arkitektonik ku përfshihen dhe ndërtesa të tjera me vlera si xhamia, amfiteatri, dhe kinemaja. Ndërtesa tani, së bashku me monumentin e kategorisë së dytë Babameto, restauruar po nga CHwB, funksionon si një Qendër Kulturore për qytetin e Gjirokastrës dhe si *bujtinë* për vizitorët e tij.

## 2. Babameto I, vështrim i shkurtër historik

Banesa Babameto, pavarësisht se ka pamjen e një objekti të vetëm, përbëhet nga dy banesa të bashkëngjitura, ku secili krah i përkiste familjes së dy vëllezërve. Nga mbishkrimet mbi secilën nga dy portat hyrëse mund të datojmë ndërtimine saj në dy faza, në vitin 1885 dhe 1887[2]. Në kompozimin volumor të banesës

[1] www.chwb.org

[2] Riza, E., *Qyteti Muze i Gjirokastrës*, Bot. i 2-të, Toena, Tiranë, 2004



*Fig. 1. Foto Babameto I, monument kulture kategoria I, para ndërhyrjeve restauruese*

ndërtesa i është përshtatur terrenit, duke ndryshuar kështu zhvillimin planimetrik për secilin kat. Një karakteristikë tjerër e veçantë e banesës është dhe përdorimi i elementit të erkerit i cili nuk është shumë i përhapur në banesat gjirokastrite. Banesa duket se ka pësuar ndryshime në vite dhe më e dukshmja është mbyllja me mur i harkut të madh në volumin perëdimor duke zmadhuar hapësirën e dhomës së katit të parë por në mungesë të raporteve apo fotove të vjetra nuk mund të japim një datim të saktë për këto ndërhyrje.

Meqënëse në terrenin ku është ndërtuar banesa gjendeshin ujra nëntokësorë, nuk ka qenë i nevojshëm ndërtimi i një stere siç ndodh në pjesën më të madhe të banesave të Gjirokastrës por uji sigurohej nëpërmjet një pusi të ndërtuar në anën lindore të oborrit.

Rreth viteve ’60, gjysma e banesës është shtetëzuar (krahu perëndimor i saj), për t’u kthyer në kopësht fëmijësh dhe më pas në apartamente të banuara nga familje të ndryshme. Ndërsa gjysma tjetër është banuar vazhdimisht nga familja Babameto që e kishte në pronësi. Kjo qe arsyeja që gjysma perëndimore pësoi ndryshime, si mure ndarës të hapësirave të odave, për t’iu përshtatur funksionit të ri, ndërsa pjesa tjetër që i ngeli familjes ka pasur pak ndërhyrje duke ruajtur konfiguracionin autentik.

Pas rënies së sistemit diktatorial në ndërtesë nuk u krye më asnjë ndërhyrje mirëmbajtëse dhe rreth viteve 1997-1998, u abandonua plotësisht dhe u grabitën shumë elementë autentikë si dekoracionet e tavaneve etj. Braktisja e ndërtesës pati si rrjedhojë degradimin e shpejtë të saj, dëmtimin e çatisë deri në rrëzimin e rreth 60 % të saj dhe si pasojë dëmtimin e muraturës, deformim të mureve vertikalë, humbje dhe dëmtim të ndërkateve, tavaneve etj. Situatë më të rënduar paraqiste volumi perëndimor i ndërtesës.

DO NOT COPY




*Fig. 2. Planimetria e katit përdhe, Babameto I, rilevim i gjendjes ekzistuese (para ndërhyrjeve restauruese)*

Në ndërhyrjet e vitit 2005 u rindërtua pjesë e muraturës së volumit perëndimor dhe çatia, duke ruajtur vetëm pak elementë autentikë, trarë të tavanit në dy odat e krahut lindor, dhe në odën e mirë të krahut perëndimor.

### 3. Mbrojtja ligjore

**Ndërtesa e Babameto I** është Monument Kulture i kategorisë I, shpallur me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në 10.06.1973[3], pjesë e kompleksit të Pazarit të që ndodhet në Qendrën Historike të Qytetit.

**Qënda Historike** është pjesa më me vlerë e qytetit muze të Gjirokastrës dhe ruhet në tërësi si kompleks monumental, urbanistik-arkitektonik dhe ambiental.

Monumentet e kategorisë I luajnë një rol të rëndësishëm në tërësinë e ansambleve urbanistike, arkitektonike dhe ambientale të qendrës historike. Këto monumente dëshmojnë vlerat më të spikatura të arkitekturës së kohës së tyre në qytetin e Gjirokastrës. Janë dëshmi e mënyrës së jetesës në atë kohë dhe e arritjeve teknike. Ato ruhen në tërësinë e përbërësve të tyre arkitektonikë dhe teknikë[4].

[3] Lista e monumenteve të Kulturës kat. I, DRKK Gjirokastër.

[4] *Ligji nr. 9048, datë 7.04.2003 i ndryshuar, Neni 28, pika 1.*

DO NOT COPY




DO NOT COPY

*Fig. 3. Prerje B-B, Babameto I, rilevim i gjendjes ekzistuese (para ndërhyrjeve restauruese)*

## 4. Faza e dokumentimit

Projekti i restaurimit i banesës Babameto I ka qenë i përbërë nga disa etapa të cilat janë mbikqyryr jo vetëm nga autoritetet shqiptare por edhe nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Si fillim, ekipi i punës ka kryer një punë të gjerë kërkimorë në arkivat e institucioneve të ndryshme të shtetit shqiptar, për të grumbulluar informacion mbi dokumentimin ekzistues të banesës lidhur me planimetritë, hartat, fotografi të vjetra, dokumentet e pronësisë, historikun e mbrojtjes dhe të kategorizimit të monumentit, ndërhyrjet e mëparshme restauruese etj. Për më shumë, ekipi i punës ka kryer intervista dhe diskutime me pronarët dhe banorët e Gjirokastrës lidhur me gjendjen e mëparshme të objektit.

Përveç punës kërkimore nëpër arkiva, vetë monumenti ishte burimi më i vlefshëm i informacionit dhe dokumentimi i tij i hollësishëm si dhe analizat e ndryshme: të materialeve, gjendjes strukturore, analiza e vlerave etj., ishin baza për ngritjen e projekt propozimit.

Ekipi i punës ka kryer rilevimin e plotë të objektit përmes fotografive dhe matjeve të imtësishme në terren të të gjitha elementeve kryesore strukturore dhe estetike të objektit.




DO NOT COPY

*Fig. 4. Fasada veriore, Babameto I, rilevim i gjendjes ekzistuese (para ndërhyrjeve restauruese)*

Ky dokumentim i imtësishëm i objektit ka shërbyer për të qartësuar gjendjen aktuale përmes materialeve grafike (planimetri, prerje, pamje, detaje etj.), si dhe për të nxjerrë në pah problematikat e objektit (Fig. 2, 3, 4).

Dokumentimi i lartpërmendur është plotësuar përmes dy analizave të rëndësishme të kryera nga ekspertë ndërkombëtarë: (1) Analiza statike, e kryer nga kompania Angleze "Scott & Wilson"; dhe (2) Analiza e materialeve e kryer nga eksperti i konservimit/restaurimit Z. Nihad Cengic. Të dyja këto analiza janë të përfshira në dokumentacionin e këtij projekt restaurimi.

## 5. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese të monumentit, analiza statike

Mungesa e mirëmbajtjes si dhe abandonimi i plotë i ndërtesës kishin si rrjedhojë degradimin e shpejtë të tij, sidomos të volumit perëndimor. Depërtimi i ujit të shiut nëpërmjet çatisë solli shëmbjen e saj si dhe degradimin në shkallë të lartë si të muraturës së gurit ashtu edhe të dyshemeve e tavaneve të drurit.

Në **muraturë** ekzistonin çarje të shumta të përmasave të ndryshme, nga ato më të voglat e deri në ato që arrijnë një

gjerësi prej 5 cm. Probleme më të mëdha paraqiste muratura e volumit perëndimor. Në gjendje më kritike ishte muri i mesit të këtij volumi dhe qëndrueshmëria e tij rrezikohej edhe më shumë nga peshat e çatisë që transmetoheshin në të.

Muratura me **konstruksion druri** (çatma) e fasadës ballore të katit të sipërm paraqiste gjithashtu problematika, sidomos në pjesën perëndimore të monumentit. Dëmtimi i suvasë kishte lënë të pambrojtur elementët e drurit, duke kalbur plotësisht listelat por dhe krijuar probleme edhe në elementët strukturorë (kolonat).

**Dyshemetë dhe tavanet e drurit** ishin të dëmtuara nga insektet apo nga ndikimi i rreshjeve. Një pjesë e madhe e tyre në volumin perëndimor mungonin plotësisht, duke humbur kështu edhe lidhjen me muraturën (përforcimi horizontal në nivel dyshemeje).

Përveç shkallës së volumit lindor që të çonte nga kati i parë në kat të dytë, shkallët e tjera të ndërtesës mungonin plotësisht.

Zbukurimet e tavaneve (*rozetat dhe elementë të tjerë*) ishin grabitur, por gjurmët kishin mbetur në ngjyrat blu dhe të kuqe me të cilat është lyer tavani. Në të gjithë ndërtesën mungonin edhe pjesë të tjera të dekoruara, si dyer të dollapeve të murit apo të musandarave.

Në banesë gjendeshin lloje të ndryshme **dritaresh dhe dyersh** që ruheshin në gjendje të mirë po kishte dhe të tjera që mungonin plotësisht.

**Suvatë** ruheshin në një masë të madhe, megjithatë shumë pjesë të tyre paraqisnin problematika si lagështi, çarje, shkëputje apo dhe pjesë që mungojnë plotësisht. Problematika më e madhe paraqitej përsëri në volumin perëndimor, ku mungonin sipërfaqe të mëdha suvaje sidomos në pjesën e rindërtuar në vitin 2005. Megjithatë, materiali i suvasë së gjetur në objekt ishte i mjaftueshëm përsa i përket informacionit që duhej për riaplikimin e tij në pjesët që mungonin.

## 6. Përshkrimi i materialeve të identifikuara në monument

*Guri*

Në objekt identifikohen tre lloje gurësh:

- gur i zakonshëm gëlqeror vendas;
- gur gëlqeror gjysme-kristalor me prejardhje nga përroi i Çullos;
- gur i zi silikat vendas.

Në muraturë është përdorur **guri i zakonshëm gëlqeror** vendas me trashësi të ndryshme ashtu si gjendej ne terren. Trashësia më e vogël 1.5 - 3cm ishte përdorur për mbulimin e çatisë.

**Guri gëlqeror gjysëm-kristalor** me prejardhje nga përroi i Çullos gjendej në kornizat e portave të hyrjes në banesë. Kjo për arsye se ky lloj guri ishte më i përshtatshëm për gdhendje të detajuara.

**Guri i zi** gjendet i përdorur gjerësisht në shtrimin e pllakave të dyshemeve të katit përdhe, sidomos në dy ambientet hyrëse, për secilën pjesë të banesës dhe në pjesën e jashtme të oborrit. Në ambientet e tjera të katit përdhe si dhe në ambientin e kuzhinës së katit të dytë gjejmë një përdorim të gurit të zi dhe gurit të bardhë së bashku.

*Suvaja*[5]

Në muret e ndërtesës kemi identifikuar disa shtresa suvaje nga periudha të ndryshme. Në përgjithësi, ekzistojnë dy tipe suvaje që janë përdorur mbi muraturën, dhe një tip i tretë është përdorur më rrallë për të kryer mirëmbajtjen. Një tip i katërt suvaje i përdorur mbi hyrjen kryesore ishte me përbërje çimento, i aplikuar në ndërhyrjet e vitit 2005.

Dy tipet e para të suvasë janë identifikuar si autentike, pasi ato kanë karakteristika identike në teknologjinë tradicionale që është përdorur për përgatitjen e tyre.

Të dy tipet e suvasë janë të përbërë nga dy shtresa të ndryshme. Shtresa e parë më e ashpër është bërë me gëlqere të shuar dhe është e mbushur me rërë në ngjyrë kremi dhe fibra bimore në raportin mesatar 2.5 mbushje : 1 gëlqere. Shtresa e dytë më e hollë e ashtuquajtur është bërë me gëlqere të shuar dhe fibra shtazore (lesh dhie) në raportin 1:1. Shtresa e dytë është përforcuar me proteina shtazore në raporte të ndryshme.

Në varësi të ngjyrës dhe kokrrizave, në të dyja shtresat mund të dallojmë përzierjen tradicionale me hi druri dhe pluhur terrakote në raporte të ndryshme.

*Druri*[6]

Ndërtesa është e pasur me punime druri. Pisha është druri me përdorim më të madh në ndërtesë. Pishë është përdorur në muret ndarëse, në dysheme dhe tavane, në konstruksionin

[5] Analiza e Materialeve e kryer nga eksperti i konservimit/restaurimit Z. Nihad Cengic.

[6] Nihad Cengic, *Vep. Cit.*

DO NOT COPY

e çatisë, në mobilje dhe dyer e dritare, ndërsa për disa prej zbukurimeve të drurit është përdorur druri i qershisë dhe i manës. Në shkeljet e shkallëve të volumit lindor të banesës (ato që çojnë nga kati përdhe në katin e parë), dhe kapakët e dritareve të odës së katit të parë po në të njëjtin volum, si dhe në të dy portat kryesore, u gjet përdorimi i drurit të arrës, një dru shumë i shtrenjtë, që me sa dukej tregonte prestigjin e familjes.

Në elementë konstruktivë si brezat e drurit në muraturë apo disa kollona të mureve të çatmasë (ato origjinalë) është përdorur dru lisi.

Mënyra tradicionale për mbrojtjen e sipërfaqeve të drurit ka qenë përmes përdorimit të vajit të linit dhe kremrave të bëra me dyll dhe rrëshirë. Druri që përdorej zakonisht nuk trajtohej paraprakisht në mënyrë të veçantë, përveç lustrimit të tavanit dhe të disa dollapeve. Në përgjithësi, është pranuar se druri është një material i qëndrueshëm dhe jetëgjatë nëse nuk është nën ndikimin e luhatjeve të ujit dhe lagështirës, dhe për pasojë ai nuk ka nevojë për masa mbrojtje shtesë.

*Shtresat e lyera me bojë*[7]

Ekzistojnë shumë shtresa boje, që në përgjithësi janë monokromatike. Analizat e kryera nuk kanë nxjerrë prova të ekzistencës së ndonjë vizatimi apo imazhi zbukurues, dhe në shumicën e rasteve këto shtresa kanë qenë të lyera me gëlqere. Për t'i dhënë një ngjyrë në të kuqërremtë, gëlqeres i janë shtuar pigmente të oksidid të bakrit, ndërsa ngjyra e verdhë është krijuar në varësi të proteinave të shtuara, kurse ngjyra gri është krijuar në varësi të prezencës së hirit. Megjithëse në disa vende të veçanta ky numër është më i madh, në përgjithësi ekzistojnë 30-40 shtresa boje. Dallojmë që në disa raste në katin përdhes, zona të caktuara janë lyer me bojë me kazeinë deri në lartësinë 35 cm, duke i shtuar bojës edhe pigmente toke, oksid hekuri dhe hi të zi. Këto shtresa boje në katin përdhes janë më të vonshme. Shtresat e bojës kanë kryesisht një përbërje me qumësht gëlqereje dhe gëlqere të shuar të tretur në ujë me hi dhe në disa raste në vend të hirit është përdorur edhe terrakota.

**7. Analiza e vlerave**

Një nga analizat më të rëndësishme në procesin e restaurimit është dhe analiza e vlerave te monumentit e cila shërben si bazë për vlerësimin e tij në tërësi apo të elementëve të veçantë si dhe mbështetet propozimi i ndërhyrjeve.

*Vlera të Prekshme*

Babameto I është i pozicionuar në njërën prej rrugëve më të frekuentuara të lagjes Partizani (Teqe), me një pamje në formën e një ballkoni mbi lagjet Palorto, Pazar, Dunavat por edhe mbi luginën e Drinos dhe gjithë peizazhit natyror që krijon Mali i Gjerë dhe Çajupi. Është në këmbët e Kalasë së qytetit dhe ka një pamje të mirë drejt saj, kryesisht nga krahu lindor. Pamja e gjerë dhe evidentimi i kësaj banese në peizazhin që e rrethon i jep **vlera skenike dhe panoramike**.

**Vlera Arkitektonike – Teknologjike.** Nga pikpamja teknike dallohen dekorimet e tavanit në Odën e Mirë, lindore, të cilat dëshmojnë një teknikë të lartë në gdhendjen e drurit si dhe në përdorimin e gjeometrisë (Fig. 5, 5.1). Dekorimet përmbajne





*Fig. 5, 5.1. Hollësi e rozetës dhe e fashaturës së tavanit, oda e miqve, Volumi lindor, Babameto I*

[7] Nihad Cengic, *Vep. Cit*.

DOKTORATURË COPY



*Fig. 6. Dera hyrëse, krahu lindor, Babameto I*

elementë nga fauna dhe flora, të stilizuar. Të gjitha këto elemente i përgjigjen rregullave arkitektonike si ritmi, simetria, linjat gjeometrike etj. dhe karakterizojnë frymën e kohës për sa i përket trajtimit të interierit të banesave. Gjithashtu dallohen për një teknikë të lartë të përpunimit të gurit dyert hyrëse e veçanërisht korniza dhe qemeri i gurtë i tyre (Fig. 6).

Elemente të tjera të dallueshme për zgjidhjen tekniko-arkitektonike dhe realizimin e tyre janë oxhakët në krahun lindor. Oxhakët kanë një dhomë ajri në kreun e tyre që ndihmonte daljen e tymit. Si tipologji në qytetin e Gjirokastrës është shumë e rrallë. Oxhakët dëshmojnë për një arritje teknike për kushtet dhe kohën kur janë ndërtuar (Fig. 7, 7.1).

*Vlera të Paprekshme*

Një monument, përveç vlerave materiale që e karakterizojnë mbart dhe vlera shpirtërore që burojnë nga historia e tij, nga përdorimi etj. Për evidentimin e vlerave jemi bazuar mbi një literaturë dhe dokumenta të caktuara[8].

**Vlera Sociale.** Duke qenë se Babameto I është në qendër të Pazarit, pjesa më e frekuentuar e Zonës Historike, kjo ndërtesë ka potencialin për t'u shndëruar në një vend ku njerëzit takohen shpesh me njëri – tjetrin, dhe funksioni i ri i propozuar synonte pikërisht në këtë objektiv. Mënyra se si është konceptuar rijetëzimi i monumentit garanton krijimin e nje hapësire sociale. Pjesa e hostelit shërben si një vend ku njerëz nga vende të ndryshme takojnë njëri-tjetrin dhe ndajnë përvojat e tyre. Hapësira për ekspozita, konferenca etj. i jep mundësinë banorëve të Gjirokastrës të gjejnë një kënd ku mund të shprehin përmes artit apo mënyrave të tjera, nevojat dhe idetë e tyre.

Funksioni i ri i jep një pjese të monumentit një **Vlerë Ekonomike**. Pozicioni shumë i mirë i banesës, siguron që vizitueshmëria të jetë e kënaqshme. Babameto ofron një përvojë unike për vizitorët, të cilët duan të përjetojnë monumentin në gjithë dimensionin e tij dhe të paguajnë për këtë shërbim. Hapësira sociale gjithashtu ndihmon në promovimin e banesës dhe në tërheqjen e vizitorëve apo aktiviteteve të ndryshme ekonomike (panaire të artizanatit, koncerte të polifonisë, panaire të kulinarise etj.).

## 8. Projekti i zbatimit

Me përfundimin e fazës së dokumentimit dhe analizën e situatës ekzistuese, kishim materiale të mjaftueshme mbi të cilat do të bazoheshim për propozimet tona lidhur me ndërhyrjet konservuese në monument.

Për formulimin e projektit të restaurimit u bazuam në kriteret e mëposhtme:

- Ruajtja e sa më shumë prej materialeve autentikë që ishte e mundur;
- Përdorimi i materialeve dhe teknikave të njëjta me ato ekzistueset për elementet që do të zëvendësohen apo plotësohen;
- Respektimi i elementeve të shtuara në kohë.

Projekt propozimi mbështetej plotësisht në analizën e detajuar që iu bë monumentit në fazën e dokumentimit dhe analizat e materialeve. Propozimi për elementët që mungonin (p.sh. shkallët) u bazua në rilevimet dhe fotot e arkivës si

[8] Derek Worthing and Stephen Bond, *Managing Built Heritage: The Role of Cultural Significance, Blackwell Publishing, 2007.* Jukka Jokilehto and Bernad Fielden, *Management Guidelines for World Heritage Sites*, ICCROM, 1998.

DO NOT COPY




*Fig. 7, 7.1. Ilustrime të formave të oxhakëve dhe funksionimit të tyre, Babameto I*



dhe në shembuj të ngjashëm elementësh brenda monumentit (tavane, dysheme të ngjashme). Elementët që u propozuan për t´u shtuar ishin në funksion të rijetëzimit të monumentit, nuk cënonin autenticitetin e tij dhe ishin lehtësisht të riheqshëm.

Për dhomat e përcaktuara, si ato me vlera më të larta historike, u propozua ruajtja në kushtet në të cilat u gjetën, duke restauruar integritetin e tyre hapësinor. Ndërsa për dhomat me potencial më të lartë shfrytëzimi u propozuan modifikime të vogla për të përmirësuar kushtet atmosferike brenda tyre (p.sh. termoizolimi në dyshemetë midis kateve). Ndërtesa e Babametove nuk mund të analizohej si një njësi uniforme, pasi hapësirat e saj i ishin nënshtuar transformimeve të shumta gjatë viteve të ekzistencës së tij.

Projekt propozimi ishte ndarë në katër nivele ndërhyrjesh:

- Propozim për ndërhyrje konsoliduese;
- Propozim për ndërhyrje konservuese;
- Propozim për ndërhyrje restauruese;
- Propozim për funksionin e ri, pamja e monumentit pas restaurimit.

Edhe pse projekt propozimi ishte shumë i plotë, ai nuk përjashtohej nga ndryshime apo propozime shtesë, që mund të dilnin gjatë implementimit të punimeve.

DO NOT COPY

### 9. Propozimi për funksionin e ri

Në bazë të ligjit "Për Trashëgiminë Kulturore", monumentet e kulturës mund të rijetëzohen për qëllime administrative dhe social-kulturore, me kusht që funksioni i ri të mos dëmtojë vlerën e monumentit. Kushtet dhe kriteret paraprake të rijetëzimit dhe të shfrytëzimit të monumenteve të kulturës miratohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës[9].

Propozimi për funksionin e ri u bazua dhe në analizën e vlerave të ambienteve të ndërtesës. Çdo dhomë e monumentit u vlerësua duke marrë parasysh elementët historikë, krahasuar me materialet arkivorë dhe mbi këtë vlerësim u propozuan funksionet e reja për secilin ambient.

**Funksioni i ri** i propozuar për ndërtesën Babameto I ndërthur në vetvete elementin ekonomik me atë edukativ, social dhe kulturor. Ideja mbi funksionin e ri të ndërtesës Babameto I është një ide që buron nga vetë sugjerimet e dhëna nga pronarët e këtij objekti, nga organizata që ka kryer punimet restauruese (ChwB) dhe nga përdoruesit, dhe ky propozim përputhet edhe me rekomandimet e paraqitura në raportin "Preliminary Technical Assessment"[10]. Është menduar që funksioni i ri i kësaj ndërtese të jetë i përbërë nga dy elemente, si në vijim:

Një hapësirë me funksion shërbimin e cila do gjenerojë të ardhura për të mirëmbajtur hapësirën me funksion social-kulturor. Funksioni i kësaj pjese do jetë një Hostel dhe do të zërë vend në katin përdhe, atë të parë dhe një pjesë të katit të dytë.

Funksioni i dytë, ai social – kulturor, zë vend në katin e dytë në hapësirën më të ruajtur dhe autentike, duke i dhënë mundësi publikut të prekë nga afër pjesën më me vlerë të monumentit dhe në të njëjtën kohë të jetë një hapësirë lehtësisht më e kontrollueshme dhe më afër autenticitetit pasi Odat e mira ishin ato që ju dedikoheshin veçanërisht miqve dhe vizitorëve. Në këtë pjesë do të jetë dhe një hapesirë me funksionin e një salle koferencash ku të interesuarit do kenë mundësi të organizojnë takime të ndryshme. Për këtë funksion është zgjedhur hapësira e gatimit e pjesës lindore të ndërtesës e cila për arsye të thyerje së terreni qëndron mbi tokë dhe dyshemeja e saj është e shtuar me pllaka guri. Në këtë kat ka hapësirë dhe për një zyrë të administratës që do meret me menaxhimin e monumentit.

### 10. Zbatimi i punimeve

Punimet restauruese filluan në Prill 2012 me **ndërhyrje përforcuese** të strukturës. Për të ndërhyrë në muraturën e gurit si dhe konstruksionin e çatmave duhej fillimisht të shkarkohej çatia nga pesha e mbulesës prej guri. Ndërhyrjet për përforcimin e strukturës konsistuan në:

- Ndërhyrje në muraturën e gurit të dëmtuar duke përdorur teknikën qep-shqep apo duke mbushur çarjet me copa guri dhe llaç me përbërje rërë-gëlqere.
- Zëvendësimin aty ku ishte e mundur e brezave të drurit të dëmtuar
- Zëvendësimin e arkitrarëve të drurit të kalbur mbi dyer dhe dritare
- Ndërhyrje në konstruksionin mbajtës të drurit (çatma) (Fig. 8)
- Vendosja e tirantave metalikë për përforcimin e strukturës së volumit të djathtë të ndërtesës. Tirantat u vendosën në të dy nivelet e dyshemesë.
- Ndërhyrje përforcuese në konstruksionin e çatisë: zëvendësim i brezave të dëmtuar, përforcimi i lidhjes së strukturës së çatisë me muraturën, zëvendësim i trarëve të tavaneve që ishin të deformuar.
- Përforcime të dyshemeve të drurit, zëvendësim të trarëve të dëmtuar dhe plotësim të pjesëve që mungonin plotësisht (Fig. 9).

Ndërhyrjet vijuan me restaurimin e dyshemeve dhe tavaneve të drurit (fig. 10, 11). Ky proces filloi me pastrimin e pjesëve të dëmtuara dhe ngritjen e dyshemeve të deformuara që në disa pjesë kishin arritur ulje deri në 25cm. U tregua kujdes i veçantë për të zëvendësuar vetëm pjesët e dëmtuara si dhe të ruheshin sa më shumë elementët origjinalë. Për elementët e rinj të shtuar u përdor i njëjti lloj druri me atë ekzistuesin dhe u respektuan përmasat e elementëve të gjetur në objekt. Aty ku dyshemetë apo tavanet mungonin plotësisht u ndërtuan të reja duke respektuar tipologjinë e atyre të gjetura.

[9] *Ligji nr. 9048, datë 7.04.2003 i ndryshuar, Neni 39.*

[10] *Preliminary Technical Assessment* është raporti mbi Vlerësimin Paraprak Teknik mbi banesën Babameto I, i cili është punuar nga ekspertë ndërkombëtarë dhe ekspertë shqiptarë në vitin 2005. Ky raport është përpiluar në kuadër të programit të përbashkët të Komisionit dhe Këshillit Evropian me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe është pranuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si pjesë e strategjisë së saj në nëntor të vitit 2005.

DO NOT COPY



*Fig. 8. Ndërhyrje në strukturën e çatmasë, zëvendësimi i pjesëve të dëmtuar, Babameto I*



*Fig. 9. Ndërhyrje në dyshemenë e drurit, zëvendësimi i trarëve të dëmtuar, Babameto I*



*Fig. 10. Ndërhyrje në dysheme, zëvendësimi i dërrasave të dëmtuara, oda e miqve, volumi lindor, Babameto I*



*Fig. 11. Restaurimi i elementëve dekorativë të drurit, tavani në odën e miqve, volumi lindor, Babameto I*

DO NOT COPY

Shkallët e vetme të ruajtura në objekt ishin ato të volumit lindor që të çonin nga kati përdhe në katin e parë, dhe ato në gjendje të keqe. Për rindërtimin e shkallëve të tjera shërbyen rilevimet e vitit 1961 si dhe foto të vjetra .

Në objekt ruheshin një shumëllojshmëri **dyersh, dritaresh e kapakë druri**, por kishte dhe të tjera që mungonin plotësisht. Materiali i drurit të përdorur në këta elementët e gjetur në monument ishte pishë përveç dyerve kryesore dhe kapakëve të drurit në dritaret e një prej odave të katit të parë (volume lindor) ku ishte përdorur duri i arrës. Disa prej dritareve dukeshin më të vjetra dhe disa të një faze të mëvonshme. Pavarësisht këtij fakti, të gjitha elementët u ruajtën në maksimum, duke zëvendësuar vetëm pjesët shumë të dëmtuara të tyre. Për riprodhimin e elementëve që mungonin plotësisht u morën për bazë materialet arkivore si dhe modelet e ruajtura në objekt (Fig. 12). Në të njëjtën mënyrë u veprua edhe me elementët e tjerë të drurit si musandara, dollape muri e elementë të tjerë dekorativë. Atje ku informacioni për pjesët e munguara mungonte plotësisht u morën për bazë elementët më të thjeshtë për riprodhimin e pjesëve të reja (Fig. 13).

Për trajtimi e drurit u përdor vetëm vaj linin në disa shtresa. Dyshemetë u trajtuan me llak me bazë uji. Elementët e drurit u lanë në ngjyrën e tyre natyrale për dy arsye: e para sepse elementët ekzistues nuk ishin trajtuar me ngjyrues (përveç disa pjesëve të tavanit në odën e mirë, volumi lindor) dhe e dyta për të qenë e dallueshme ndryshimi midis elementëve origjinalë dhe atyre të shtuar. Me këtë veprim donim të transmetonim një mesazh të qartë të mënyrës së restaurimit "ruajtjes të sa më shumë elementëve autentikë".

Gjatë procesit të hartimit të projektit të restaurimit u bë një studim i hollësishem i gjithe tipeve të suvave të gjetura në objekt (shiko raportin e Nihad Cengiç). Kjo analizë u morr për bazë në procesin e restaurimit të sipërfaqeve të suvatuara.

Puna filloi me përforcimin dhe pastrimin e suvasë ekzistuese. Pjesët e suvasë që ishin kishin filluar të shkëputeshin nga muratura u konsoliduan duke bërë injektime në pika të ndryshme. Injektimi u bë kryesisht me gëlqere te holluar me lesh dhie por sipas rastit, në pjesë më delikate dhe me të rrezikuara u përdor edhe kazeina.

Gjithashtu, sipërfaqja e suvasë ekzistuese u pastrua nga shtresat e gëlqeres të lyer ndër vite. Këto shtresa kishin filluar të plasariteshin dhe të shkëputeshin nga sipërfaqja e murit. Pas pastrimit të këtyre shtresave u krijua një ide më e qartë për situatën në të cilën ato ndodheshin.

Aty ku suvaja kishte plasaritje ato u konsoliduan duke përdorur gëlqere me lesh dhie apo injektime (Fig.14).

Pjesët e suvasë që mungonin u plotësuan duke përdorur tipe të ndryshme suvash, sipas rastit (Fig. 15).

Për të marrë një vendim për nivelin e suvasë në fasadat e jashtme, iu referuam përsëri vizatimeve dhe fotove të marra nga arkiva e IMK.

*Instalimet e rrjeteve inxhinierike*

**Instalimet elektrike** të ndodhura në objekt ishin plotësisht jashtë funksionit. U bënë instalime të reja elektrike në të gjithë objektin duke u nisur dhe nga funksioni i ri që ai do ketë pas restaurimit. Në pjesët e objektit ku mungonin suvatë tubat e instalimeve elektrike u mbështeten mbi muraturën e gurit pa e dëmtuar atë dhe më pas u mbuluan me suva ndërsa në pjesët ku suvaja ruhej të gjitha instalimet u bënë të dukshme mbi suva, pa dëmtuar kështu suvanë autentike.

Për **instalimet hidraulike** u veprua në të njëjtën mënyrë, duke vendosur instalimet mbi muraturën e gurit apo duke vendosur tubat e shkarkimit brenda kanalizimeve ekzistuese të shkarkimit e gjetura në muraturë (këto kanalizime janë ndërtuar që me ndërtimin ekzistues).

Në objekt ekzistonin vetëm katër banja. Për arsye të funksionit të ri të objektit, si hostel, ishte e nevojshme të shtoheshin dhe banja të tjera. Banjat që u shtuan në të gjitha katet, duke shfrytëzuar pjesët ku ishin kryer ndërhyrjet më të reja dhe nuk kishin ngelur elementë autentikë. Ndërtimi i tyre u bë në mënyrë të tillë që të jetë lehtësisht i riheqshëm, pa dëmtuar konstruksionin e objektit. Në banjat ekzistuese u vendosën tubacione për të larguar ujrat e zeza pasi ato largoheshin nëpërmjet kanaleve në brendësi të muraturës vertikale.

U bë dhe lidhja me ujin e pijshëm, pasi nuk ishte funksionale. (Fig. 16)

## 11. Ekipi i punës

Arkitekti përgjegjës: Ark. Rest. Lejla Hadzic

Rilevimi dhe projekt propozimi: Aleksandër Pesha (Ing.), Elena Mamani (Ark.), Kreshnik Merxhani (Ark.) dhe Mirlinda Droboniku (Ark);

Për të katër këta profesionistë të rinj ky projekt ka qenë jo vetëm një përvojë pune, por edhe një proces edukimi në fushën e restaurimit. Ekipi i punës ka përfituar nga

DO NOT COPY



*Fig. 12. Restaurimi i dritareve, Babameto I*



*Fig. 14. Injektime për konsolidimin e suvasë së shkëputur*



*Fig. 13. Restaurimi i elementëve dekorative prej druri, Babameto I*



*Fig. 15. Restaurimi i sipërfaqeve të suvatuara*

këshillimet e përditshsme nga Ark. Rest. Lejla Hadzic dhe ato periodike (një herë në 6 javë) të këshilltarit për trashëgiminë për CHwB për këtë projekt, Z. Dick Sandberg (Ark. Rest.), si dhe nga këshillat e konsulentit shqiptar për trashëgiminë Z. Emin Riza (Prof. Dr.).

Ky projekt restaurimi është financuar kryesisht nga CHwB përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe me një kontribut të vogël nga GCDO përmes Institutit "Packard Humanitites".

Zbatimi i punimeve restauruese: Kompania "Martini" sh.p.k.

Supervizim: IMK

Monitorim i përditshëm i punimeve: Ark. Rest. Lejla Hadzic, Ark. Elena Mamani, Ark. Kreshnik Merxhani.

DO NOT COPY



*Fig. 16. Babameto I, pas restaurimit*

DO NOT COPY

Lejla HADZIC
Elena MAMANI
Kreshnik MERXHANI

DO NOT COPY

# BABAMETO 1ST CATEGORY MONUMENT RESTORATION, GJIROKASTRA

The grand residential house of Babameto is an historic vestige of Gjirokastra's urban-architectural landscape and central to the World Heritage historic zone. Completely abandoned following the 1997 national crisis, this 1st category monument quickly fell into disrepair, eventually becoming a priority for conservation. In 2004, the state invested in the reconstruction of the roof and other ruined elements; however, the house remained in poor condition until conservation interventions conducted by Cultural Heritage without Borders (CHwB). CHwB is independent non-governmental organization operating in the field of cultural heritage across the Western Balkans.

The primary aim of this project was the complete conservation of the monument and the conversion of the space into a hostel and public facility (used for seminars and exhibitions). However, while embarking on an exciting conservation project, the investigation on the owners of the house has lead us to understand that there are 72 private owners. Hence, the project has turned into a two-fold venture. Designing the conservation proposal, alongside which the mapping of the owners and the visioning of a post-conservation management were conducted.

Gjirokastra is a designated World Heritage Site since 2005, however yet to this date, there is no clear guideline provided by the Government as to how to treat multiple ownership, and this remains to be the largest obstacle for possible investors. Especially considering that out of 650 monuments in Gjirokastra, 87% are privately owned, while 42, 14% are owned by multiple owners.

Furthering the conservation project the finalization of the works on the Babameto house has brought renewed vitality to the commercial area of Gjirokastra's historic center – complementing other community buildings such as the mosque, amphitheatre, and cinema. The building now operates as a tourist hostel and temporary residence for camp participants during CHwB's Regional Restoration Camps. Additionally, the surrounding walls of the building are being reconstructed by camp participants, providing practical, hands-on experience for architecture students and young professionals in traditional restoration practices in stonework.

The complete process of developing a conservation proposal and the implementation of works was the educational exercise for young Albanian architects engaged. The technique and the materials used were traditional and historical to the zone of Gjirokastra.

Following the conclusion of the works the 72 owners were mapped and a contract was signed with 34 representatives, agreeing on 5 years period of time during which the local Non-Governmental Organization, Foundation Gjirokastra would manage the monument. Having the function of a hostel is to create revenue, which is to be used for self-sustaining the NGO operations and further invest in preservation of cultural heritage in Gjirokastra.

DO NOT COPY

**monumentet**
**53/2015**

Dashmir ÇUBERI

DO NOT COPY

# MOTIVET TRASHËGIMORE TË ORNAMENTIKËS NË BANESËN GJIROKASTRITE

Në dekoracionet e banesave të vjetra qytetare, disa figura luajnë një rol të rëndësishëm si elementë formulues me karakter të spikatur dinamik, format koloristike e plastike të të cilave ndihmojnë në evidentimin dhe kuptimin e motivit. Ndërkohë, këto figura, me anë të formës shkaktojnë efektin emocional, mënyrë kjo e komunikimit, që vjen drejtpërdrejtë nga motivi dhe nëpërmjet tij nga bota shpirtërore e formimit artistik të mjeshtrit krijues. Këtë dinamizëm krijuesi popullor e krijon me anë të lëvizjes së lirë të formës, brenda motivit, kur është fjala për gdhendjen ose kalimet e tonaliteteve nga ngjyrat e ngrohta në ato të ftohta, apo ndjeshmërisë së plasticitetit. Në kompozime, mjeshtri përdor forma të ndryshme të organizimit të motiveve. Ato i shikojmë të veçuara, vargëzuara e të grupuara, ku mjeshtri fut më tepër ornamente, të cilët gjatë bashkëveprimit pamor shtojnë tensionin ritmik dhe si pasojë edhe ngacmimin emocional. Motivet futen në marrëdhënie dekorative në mënyrë aktive, duke na dhënë përfytyrime figurative të elementëve të natyrës, që në një farë mënyre transmetojnë fantazinë e krijuesit dhe i japin kompozimit ritëm e dinamizëm dekorativ. Forma apo nuanca koloristike e ornamentit përcakton natyrën e materialit dhe mjetet, me të cilat ato janë shprehur figurativisht. Forma nuk shprehet njësoj si me ngjyrë dhe me daltime. Forma e realizuar me anë të daltës arrin në tredimensionale, ndërsa ajo e realizuar me anë të ngjyrës është dydimensionale, që arrihet me anë të dritëhijes. Motivet e shprehura në forma të larmishme si në gdhendje ashtu dhe në ngjyrë, i japin dekorativitetit domethënie figurative dhe pasurojnë e shtojnë efektin pozitiv emocional.

*Motivet trashëgimore* i kemi të gjeometrizuara, floreale e bimore, me simbole të natyrës qiellore, motive shpendësh, kafshësh etj. Motivet gjeometrike përfaqësojnë vija të veçanta e të dyfishuara, të gjata, me ndërprerje e zikzake, rrathë, trekëndësha, katrorë, rombe, forma konike e forma svastike. Motivet e zbukurimit floreal e bimor janë: trëndafila, tulipanë, karafila, zambakë, lule bajame e shege, lule dele, gjethe lisi, lastarë, e tufëza të ndryshme burbuqesh e dredhëzash, pemë qeparisi e dafine. Kurse simbole të njohura të natyrës qiellore kemi: diellin, hënën e yllin, të stilizuara në forma të ndryshme. Në figura shpendësh e kafshësh paraqiten përfytyrime si, pëllumbi, shqiponja, skifteri, sorkadhja, luani, gjarpëri, bukla. Këto motive të ideuara e trajtuara me cilësi të lartë nga mjeshtri popullor, janë vendosur në dekoracion sipas simbolikave dhe rëndësisë së tyre. Motivet nuk janë të rastësishme, ato përzgjidhen me kujdes, sipas domethënies por dhe efektit dekorativ që duhet krijuar.

Motivet floreale janë lule të terrenit vendas, të organizuara e trajtuara herë me vërtetësi e herë të stilizuara e të kombinuara sipas rëndësisë dhe kërkesave të kompozimit, natyrisht që këtu hyn edhe mjeshtëria e artistit popullor. Mjeshtri përgjithësisht i njeh mirë psikologjinë dhe kërkesat e qytetarëve, të cilat i merrte në konsideratë. Dekoracionet, me motivet frutore dhe floreale të ndërthurrura, përveçse krijojnë një atmosferë të gëzueshme, shprehin njëkohësisht edhe mirëqënie e mendësi të re dhe njëkohësisht tregojnë statusin familjar në shoqërinë vendase. Ornamentikën e ndeshim kryesisht në banesat e shtresave të pasura ose të mesme qytetare. Për vetë karakterin e tyre, motivet janë të pranishme në ambientet e banimit, kompozohen të veçanta,

të grupuara e vargëzuara. Ato i gjejmë të pranëvëna me korniza ndërmjetëse, që kanë motive të gjeometrizuara dhe të pikturuara me dredhëza e lastarë, që përdoren për të krijuar dinamizëm në formulimin e përgjithshëm të ornamentikës.

Motive që të tërheqin dhe kanë interes janë ato simbolike, që lidhen me një mendim të caktuar. Shpesh, me anën e motiveve shfaqen besimet ndaj objekteve dhe fenomeneve të natyrës me fuqi të mbinatyrshme. Dielli, Hëna dhe Yjet janë motive të trashëguara e të njohura që në lashtësi. Të parët tanë, ilirët, besonin në fuqinë hyjnore të diellit, i cili ka qenë objekt adhurimi, si burim jete, shëndeti e pjellorie. Simbolika lidhej me jetën, mbrojtjen, pasurinë, ndaj, figuracionet duhej të zotëronin cilësi të tilla, për t›u vendosur në vendet më të dukshme të banesës dhe parapritëse të syrit të keq. Prandaj, këtë psikologji popullore të kohës, mjeshtri e njihte mirë dhe e harmonizonte me motivet e tjera.

*Motivi i diellit* në banesat gjirokastrite filloi të aplikohet në fillim të shek. XIX, në forma të thjeshta, në odat e banimit të banesës së Zekatëve (1811-12) në lagjen Palorto. Atë e shikojmë të ndërtuar në formë rrethore me listela të thjeshtë, që imitojnë rrezet e diellit të vendosur në tavanin e çardakut dhe të divanit përbri tij. Formën më të pasur të tij ky motiv e arrin në rozetën e qoshkut të odës së miqve (fig. 1). Ndërsa në ambientet e banimit të përditshëm po kjo rozetë rrethore është e vendosur brenda një kornize të thjeshtë katrore. Më vonë, ky motiv paraqitet me forma më të zhvilluara në banesën e njohur të Skëndulajve 1823. Në këtë banesë, motivit diellor i rezervohet dhoma kryesore e banimit, ajo e miqve. Në qoshkun e odës së mirë kemi dy rozeta diellore me rreze të formuara nga stilizimi i gjetheve të lisit, të kufizuara nga korniza dekorative tetëkëndore me shkallëzim. Ky motiv shfrytëzohet edhe në trekëndëshat e tavaneve të dhomave të banimit, por me forma më të thjeshta. Diellin si motiv në këtë banesë e gjejmë të gdhendur me mjeshtëri në harkorët e parapetave të drunjta të dyerve të parahyrjes së dhomave të banimit (fig. 3). Përmendim këtu rozetën rrethore të banesës së Resajve, me gjethet karakteristike të lisit, e qarkuar nga korniza tetëkëndore me tetë cepa yllore, e ngjashme me rozetën e banesës së Sinoimerit në lagjen Dunavat i dytë. Të dyja rozetat vendosen përkatësisht në odat e miqve dhe kanë njëkohësisht, përveç gdhendjes, edhe trajtim të thjeshtë me ngjyrë. Këta elementë të formës, na bëjnë të mendojmë se në të dyja rozetat diellore kemi të bëjmë me të njëjtin mjeshtër. Po kështu, motiv të tillë gjejmë edhe në banesën e Angonit në lagjen Dunavat i dytë. Në banesën e Kikinos, në njërën nga odat e banimit, rozeta diellore paraqitet me 23 rreze të përbëra nga gjethet e stilizuara të lisit.

Gjatë shekullit të XIX në banesën gjirokastrite shfaqen dy lloje rozetash. Një lloj rozete është rrethore, e thjeshtë, me rreze të realizuara nga shirita listelash dhe lloji tjetër paraqitet më i avancuar, ku rrezet me listela të thjeshta zëvendësohen me gjethe lisi të stilizuar në teknikat e



*Fig. 1. Rozetë me motiv diellor (Zekatët)*



*Fig. 2. Svastika me motiv floreal (Çabej)*

DO NOT COPY

gdhendjes dhe pikturimit. Stilizimin e diellit e vërejmë edhe në sendet e zbukurimit, në furka, sëndukë, në djep, dantella e qëndisje. Motivi i diellit është shumë i përhapur në banesat qytetare të Shkodrës e Beratit. Në Shkodër, motivet i kemi në forma më të zhvilluara dhe me nivel të lartë artistik.

*Motivi i yllit* është një nga motivet e preferuara, mjaft i përhapur në banesën gjirokastrite. Karakteristikë e këtij motivi janë format e shumta të stilizimit të tij të aplikuara në vende të ndryshme të banesës. Ai hyn në motivet trashëgimtare, i vlerësuar prej komunitetit. Forma e thjeshtë fillestare formohet nga kryqëzimi i dy trekëndëshave barabrinjës. Kjo formë pëson transformime, nëpërmjet formave të shumta, që krijohen nga kombinime figuracionesh floreale dhe gjeometrike. Forma yjesh vendosen në qemerët e gurtë të portave kryesore të banesave të Kikinos, Zekatëve, Kabilatëve, Shajkos, Karehman Pashës në Pejë, në objekte kulti në Berat. Në brendësi, format yllore zbatohen në rozeta tetë dhe gjashtëkëndore, me korniza të formuara nga listela dhe gdhendje të motiveve floreale. Këto i gjejmë në banesat e Resajve, Sinoimerit, Skëndulajve, Angonit e Çabejve, ku ka punuar mjeshtri i njohur Gjikë Bashari. Ky motiv, përveç qemerëve të gurtë të portave kryesore, aplikohet në harkorët e dyerve të brendshme të odave të banimit, në kuadratet e tavane dhe në rozeta.

***Motivi svastikës*** është një formë e gjeometrizuar dhe e thjeshtuar e helikës, e trajtuar gjerësisht në kanatet e dollapëve e dyerve të brendshme në të gjitha qytetet shqiptare dhe më tej, në Maqedoni dhe Greqinë veriore. Svastika, që ndryshe njihet si kryqi grepç është ushtruar në forma të thjeshta e të ngarkuara. Pjesëza të veçanta kuadrative të formateve të ndryshme bashkohen në trajtë svastikoide, duke formuar një, dy ose tre rombe bashkëqëndrorë brenda kanatit të një dere. Kjo vendosje e copëzave krijon një dinamikë të brendshme në mënyrë të vazhdueshme me efekt të spikatur dekorativ. Në përgjithësi, odat e mira kanë sipërfaqe të mëdha të punuara me motivin e svastikës, ku përfshihet edhe kompleksi musandër-dhipato. Punime të drurit me svastikë kemi në përgjithësi në të shumtën e banesave gjirokastrite, këtu veçojmë disa prej më të shquarave si, Zekatët, Skëndulajt, Sinoimeriatët, Angonatët, Resajt, Çabejve, Hajrot, Karaullajt etj. Pjesë të veçanta të zemrave të svastikës zbukuroheshin me gdhendje lulesh gjashtë e tetëpetalëshe (fig. 2). Forma svastikoide përdorej për efektin dekorativ të saj, e cila shkonte paralel dhe harmonizohej me punimet dekorative të tavanit. Kjo kërkonte ndërkohë një punë me precizion të lartë në konstruktim dhe montim. Për format svastike shquhen edhe banesat e qyteteve të Beratit, Shkodrës, Elbasanit e Krujës.Trajta të svastikës në vula qeramike janë getur gjatë gërmimeve arkeologjike në Maliq, që i përkisnin mijëvjeçarit të tretë para Krishtit. Shumë svastika i gjejmë të ndërtuara me gurë mozaikësh në bazilikën e Linit.

*Motivi i rrathëve bashkëqendrorë.* Në morinë e formave të ndryshme të ndërtuara në tavane e rozeta, krahas kuadrateve drejtkëndore shquhen korniza me rrathë bashkëqendrorë, të zbukuruara me gjethe lisi dhe të stilizuara me përdredhje përqark kornizave. Modelim të tillë rrathësh kanë në përgjithësi rozetat e odave të banimit, të trajtuara edhe me elemente të gjeometrizuar, të shoqëruara me gjethe të stilizuara të dafinës. Rrathët bashkëqendrorë përdoren edhe në qemerët e gurtë të portave hyrëse, si në banesën e Kikinos. Dy rrathë të skalitur janë stilizim i përfytyrimit figurativ të syrit, që paraprin, sipas besimit popullor, syrin e keq. Rrathët bashkëqendrorë janë elementë të rëndësishëm të dekoracionit. Ato ndikojnë me formën e tyre rrethore në lëvizjen e përgjithshme dinamike të dekoracionit në tërësi.

**Motivet me kuptime simbolike**

Në banesa të vjetra gjirokastrite të shek. XVIII-XIX, ashtu si dhe në qytete të tjera si në Berat, Shkodër, Pejë, Janinë, Prizren etj., ka zbukurime me kuptime simbolike virtytesh e të karakterit kultik, që kanë evoluar e janë ruajtur nga kohët e lashta. Në ornamentikë janë të pranishme simbolika në lidhje me kafshët e egra, me drurë të veçantë, janë trajtuar simbole për yjet, diellin, hënën e për shpendë të veçantë. Këto elemente të ndryshme të besimeve kanë gjetur pasqyrim në banesat gjirokastrite, të ruajtura në kompozimet e punimeve artistike të gdhendjes në dru e në gur të ambienteve të banimit, të portave e dyerve, në forma motivesh, në disa raste të pranëndodhura me elemente të krishtere e islame.

Këto forma të elementëve të lashta të besimeve kanë të bëjnë me forcat dobiprurëse të dukurive të natyrës, si pasqyrim i raporteve midis njeriut dhe natyrës. Mund të themi se këto vlera të natyrës së virgjër janë pasqyruar në përpjekje të banorëve për t›i vënë ato në dobi të tyre. Me domethënie kultike janë: dielli, hëna, yjet, dragoi, gjethet e lisit të artë, gjarpëri, qeparisi, zogu.Të njëjtat motive i gjejmë edhe në varre. Këto motive nuk janë thjesht për

DO NOT COPY

zbukurim por kanë atribute kulti, mbijetojat e të cilit kanë arritur deri në kohën tonë.

*Motivi i Diellit* (fig. 3). Besimi i stërgjyshërve tanë, ilirëve, ka qenë paganizmi. Ata besonin në fuqinë hyjnore të diellit, se nga ai kishin shumë të mira për jetën e tyre[1]. Kohët e vona dielli ka qenë objekt adhurimi si burim jetese, shëndeti, burim pjellorie dhe si objekt mbrojtës dobiprurës.

Shqiptarët betoheshin për diell, për hënë e qiell e jo për perëndi[2]. Rreth këtij motivi kanë shkruar Sh.



*Fig. 3. Motivi i diellit (Skëndulaj)*



*Fig. 4. Stilizim i dragoit (Çabej)*

[1] Tirta. M., *Mitologjia ndër shqiptarë*, Tiranë, 2004, f. 51-52.
[2] Pasha. V. Efendi., *E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*, Tiranë, 1935, f. 42-43.



*Fig. 5. Gjethe të lisit të artë (Zekatët). (2)*



*Fig. 6. Motivi i gjarpërit (Skëndulaj)*



*Fig. 7. Figura e kaprollit (Skëndulaj)*

DO NOT COPY

Gjeçovi e E. Durhami, duke u përpjekur të shpjegojnë origjinën ilire e trake të kësaj dukurie. Shqiptarët i faleshin diellit sipas besimit pagan[3]. Këto raporte të diellit me popullsinë vendase mendojmë se shpjegojnë dhe orientimin e banesave nga lindja dhe përdorimin e këtij motivi në vende të veçanta të banesës, në hyrjet kryesore të jashtme dhe të brendshme të saj.

Dielli, si motiv i stilizuar në ornamentikën e banesës gjirokastrite filloi të zbatohet më gjerësisht në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XIX. Këtë motiv e gjejmë në trajta të thjeshta në rozetat e divanit, çardakut dhe dhomave të banimit në banesën e Zekatëve të ndërtuar më 1811-1812. Rozetat rrethore paraqiten në dy forma të imazhit të diellit. Fusha rrethore e njërës përshkohet nga 24 rreze të realizuar nga listela të trajtuar dekorativisht me vija të gdhendura pjerrtas, që bashkohen në qendër të saj. Tipi tjetër realizohet me kryqëzimin e listelave afër qendrës, ku ndodhet një rreth më i vogël, që krijon imazhin e diellit. Këtë tip e gjejmë në rozetat e odës së mirë të banesës së Skëndulajve të ndërtuar më 1823.

*Motivi i Hënës.* Po kështu, Hëna del si hyjni e natyrës së virgjër dhe mbrojtëse e grave. "Është e vërtetë se motivet e hënës në ornamentikë, në një masë të dukshme të tyre janë rrjedhim i ndikimeve të islamizmit, por kjo natyrisht e mbështetur në një traditë të fortë vendase. Këtë e vërteton dhe fakti se të tilla motive të hënës i gjejmë me shumicë në zona që ishin nën ndikimin e krishterë e ku nuk kanë depërtuar shumë elementët e islamizmit."[4]

*Dragoi* është figurë e demonologjisë shqiptare. Ku ka dragua, ka mbarësi, përparon familja, fisi e krahina.Veprimet e dragoit për të ndalur furtunat, breshërin, përmbytjet, shembjet që prishin prodhimet bujqësore, janë veprime mbrojtëse. Pra ai, përveçse simbolizon forcën e trimërinë, del edhe me tiparet e hyjnisë mbrojtëse të prodhimit agrar. Figurën e Dragoit e gjejmë në gdhendje tavanesh e portash të banesave. Shquajmë këtu tavanin e odës së mirë në banesën e Çabejve (fig. 4).

*Lisi i artë.* Druri i lisit të artë sipas besimit popullor paraqitet me gjethe ngjyrë ari[5]. Ngjyrat e gjetheve të këtyre lisave lidhen me legjendën e mitizuar rreth tyre.

Për gjethet e arta ka një sërë besimesh me burim pagan e me rrjedhë nga kohë të lashta. Gjethet e lisit dhe të bredhit i gjejmë të pikturuara dhe të gdhendura në odat e miqve të banesave të Gjirokastrës (fig. 5)

*Gjarpëri* (fig. 6) në mendësi e kushte të veçanta besohet si një gjë e shenjtë dhe e pa cënueshme. Te figura e gjarpërit mendësitë popullore gjejnë veti të mbinatyrshme. Ai është simbol i mbrojtjes së vatrës familjare, i njerëzve dhe pasurisë, simbol i pjellorisë, qeni hyjnore e tokës dhe nëntokës[6]. Çdo banesë e vjetër ka gjarpërin e vet mbrojtës, i cili nuk duhet të vritet pasi ndjell fatkeqësi. Duke iu referuar Arbëreshëve të Italisë e më tej, "Vitorja është një gjarpër i vogël, që zakonisht gjendet nëpër shtëpi dhe për të ka një besim të mbinatyrshëm si ruajtës i shtëpisë"[7]. Figurën e gjarpërit e gjejmë të stilizuar në vija të lakuara në oxhakë dekorativë, në kufijtë ndarës midis tavanit të qoshkut dhe tavanit të madh të odës së miqve, në porta të banesave, në objekte balte e qëndisje veshjesh, bastune e varre.Të famshme janë bastunet e patriotit Idriz Guri me gdhendje simbolesh të ndryshme, ku binte në sy edhe koka e gjarpërit.

*Kaprolli* (fig.7). Është kafshë e egër kulti e njohur në të gjithë vendin tonë. Me interes është të shënohet se edhe ndër ilirë kaprolli del si kafshë kulti dhe që ka të bëjë me kultin e diellit. Sipas besimeve thuhet se sorkadhja para se të ngordhë, kthehet e lutet nga lindja dhe lëshon lot si njeri.

*Qeparisi dhe bredhi* janë drurë gjithmonë të gjelbër dimër e verë, janë simbole të përjetësisë me origjinë nga Orienti e nga kohët antiko-romake. Qeparisi ose selvia, si simbol i përjetësisë gjen përdorim të gjerë në qendër të qemerëve të gurtë të portave kryesore të banesave të vjetra. Shpesh ai shoqërohet me dy figura zogjsh (fig. 8). Në banesën Jaho qeparisi gjen përdorim të gjerë në zbukurimin

[3] Nopça. F., *Shqipëria. Pikëpamjet fetare*, Arkivi i Institutit të Historisë, f. 46-47.
[4] Tirta. M., *vep. cit.*, f. 79-80.
[5] Harapi. M. Z., *Pushka e tradhtarit*, Shkodër, 1914, f. 156-157.
[6] Tirta. M., *vep. cit*., f. 169-170.
[7] Kamarda. Dh., *Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prati, 1866, f. 70-71.

DO NOT COPY



*Fig. 8. Qeparisi dhe zogjtë (Vehbiu)*



*Fig. 9. Figura e shqiponjës (Resaj)*



*Fig. 10. Figura e buklës (Kikino)*

DO NOT COPY

e oxhakut dhe kamareve të odës në katin e parë të banimit. Ai merr pjesë në formulimin kompozicional të zbukurimit, së bashku me motivet floreale e gjeometrike.

*Shqiponja* (fig. 9). Është shpend kulti, për të cilin shqiptarët kanë vlerësim të veçantë[8]. Shqiponja me dy krerë është simbol i atdhetarizmit.

*Bukla*. Ndryshe kjo njihet nga vendasit si nuselala. E gjejmë në banesën gjirokastrite të gdhendur në qemerët e portave hyrëse, të jashtme dhe të brendshme. Kjo gjallesë e shkathët dhe e bukur, në traditën popullore njihet si qenie me cilësi të mbinatyrshme, fatsjellëse. Për të ruhet një kult i veçantë, disa herë me natyrë totemike. Sipas besimeve, çdo shtëpi ka buklën e vet (fig. 10).

[8] Durham. E., *Some tribal origins, laws and customs of the Balkans,* London 1928, f. 140-144.

Dashmir ÇUBERI

# INHERITED ORNAMENTAL MOTIVES OF GJIROKASTRA'S HOUSE

**Summary:** Motifs are important visual elements, with variable rhythmic presence in decorative works. They occupy a relatively large number of varied special features in the ornamentation of housing by participating in the organization and establishment of the overall harmony. These elements within them have treatments of forms, conditioned by the material with which they are worked. Decorating techniques are defined and associated with specific materials, the properties of which the decoration masters adapted quite well with their creations and concerns. Motives inherit specific feature techniques in accordance with the artistic opinion of the popular masters. They have their symbols and are selected considering the mentality of the requirements of purchasers, but always within the overall tradition. The symbolism of the traditional motives is very popular and artistically applied in visible places of residence, in support of the opinion of highlighting the main imagery. The data is based on factual materials and various informations in this field. Research methodology consists of qualitative and quantitative methods of research.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

**monumentet**
**53/2015**

Elena MAMANI
Kreshnik MERXHANI

DO NOT COPY

# STERAT NË MONUMENTET E KULTURËS NË GJIROKASTËR

## 1. Hyrje

Mënyra e mbledhjes së ujit të shiut nga çatitë në stera është përmendur për herë të parë në shekullin e XVII-të, kur kronikani i njohur osman Evliya Çelebi, përshkruante se si banorët e kalasë mblidhnin ujin e shiut për ta përdorur për nevojat e tyre të përditshme[1].

Studimet e para shkencore mbi ndërtesat popullore të Gjirokastrës filluan pas shpalljes si "qytet muze", në vitin 1961. Artikulli i parë mbi sterat e ujit në Gjirokastër u shkrua nga Thanas Kamberi në vitin 1975[2]. Pas tij, në vitin 1981 Emin Riza publikoi një monografi të titulluar "Qyteti Muze i Gjirokastrës", i cili përmbante një përshkrim të përgjithshëm mbi qytetin dhe ndalet në një analizë të thelluar të arkitekturës së banesës gjatë periudhës Osmane. Sterat e ujit janë pjesë e këtij studimi, por si pjesë e kompozimit arkitektonik të banesës. Valter Shtylla gjithashtu publikoi në vitin 1981 një studim mbi furnizimin me ujë të qytetit, duke u ndalur kryesisht në ujësjellësin e kalasë.

Në vitin 1984, autoritetet lokale kryen një studim për identifikimin, klasifikimin dhe restaurimin e sterave dhe puseve, dhe kjo për arsye ushtarake[3]. U listua një numër i madh pusesh dhe sterash (rreth 500). Ky aksion ishte pjesë e masave mbrojtëse për sigurimin e ujit në rast sulmi ose lufte. Përveç kësaj, ambientet e sterave të ndërtuara me mure guri me trashësi të madhe si dhe të mbuluara me qemer guri përbënin ambiente me strukturë të forte, që do mund të shërbenin edhe si vende strehimi.

Instituti Kombëtar i Projektimit në Tiranë (ISP) ka publikuar manuale të ndryshme projektimi si "Elemente Projektimi, Lagështia", me një kapitull të veçantë dedikuar lagështisë në banesat popullore, me Gjirokastrën si shembull i ilustruar. Ky publikim përfshin një përshkrim për sterat e ujit, por ky është i vetmi rast ku ato përmenden. Kjo është një pasqyrë e studimeve që i referohen sterave në Gjirokastër.

## 2. Elementët që ndikojnë në arkitekturën e sterave

Pavarësisht se qyteti shtrihet në zonën më të thatë të luginës, brenda tij gjenden disa zona ujëmbledhëse, ku në mënyrë të veçantë përmendim pjesën e lagjes Partizani (Teqe), Pazar, Varosh dhe Meçite (Fig. 1). Në këto zona kryesisht banesat janë të pajisura me puse.

Një tjetër mënyrë e furnizimit të qytetit me ujë ishte nëpërmjet disa ujësjellësave. Ata më të vjetrit (para periudhës së Ali Pashës 1811-1812) janë më pak të evidentuar. Sipas Th. Kamberit ata furnizonin pjesë të veçanta të qytetit[4].

[1] Çelebi, E. (Ni Muhamet Dhil - Li Ibni Dervishi), *Shqipëria para tre shekujsh*, botimet BESA, Tiranë, (2000), f. 30

[2] Kamberi, Th., "Si furnizohej me ujë qyteti i Gjirokastrës", *Monumente të Kulturës në Shqipëri*, Shtëpia Botuese 8 Nëntori, Tiranë, 1975

[3] Ky studim nuk është i publikuar. Dokumenti ndodhet në arkivën e Shtetit, Gjirokastër.

[4] Kamberi, Th.: *Vep. Cit.* "Afër Qafës së Pazarit gjendet akoma edhe sot ujësjellësi nëntokësor i ndërtuar me durim dhe mjeshtëri të rrallë nga të parët tanë. Ky krua njihet me emrin "Kroi i Pazarit"…Mbeturinat që janë gjetur tregojnë që duke shfrytëzuar një burim në Malin e Gjerë, që njihet akoma sot me emrin "Uji i Blirit" është ndërtuar një ujësjellës (para shek. XVII) nëntokësor, me tuba qeramike, që furnizonte Qytetin në tri pika… Nga ana tjetër Pukëvili, kur përmend marrjen e qytetit të Gjirokastës nga Ali Pasha, shkruan: "Megjithatë, sapo ushtritë e Vezirit këputën ujësjellësin dhe rrënuan mullinjtë, banorët kërkuan të dorëzohen..."






*Fig. 1, 1.1, Hartë e zonave ujëmbledhëse në Gjirokastër. Foto panoramike e zonës ujëmbledhëse në lagjen Meçite*



*Fig. 2. Skicë e Edward Lear ku duket i vizatuar dhe ujësjellësi i kalasë, (burimi 1ds.lib.harvard.edu)*



*Fig. 3. Foto nga pusi i banesës Xhelili, Pazar i Vjetër*

Kryesisht përmendet ujësjellësi i ndërtuar nga Ali Pasha, një ndërtim madhështor, që furnizonte kalanë[5] (Fig. 2).

Pjesa më e madhe e qytetit shfrytëzonte ujin e shiut duke e mbledhur atë në stera. Ndërtimi i një stere kishte kosto të mëdha dhe jo të gjithë qytetarët kishin mundësi për t'a ndërtuar. Prandaj kishte dhe stera familjare që përdoreshin dhe nga banorët e lagjes përreth. Nuk mungon dhe rasti i sterave publike si rasti i sterës së Baboçatëve, një dhuratë e kësaj familje për komunitetin.

Terreni mjaft i thyer gjithashtu ishte një faktor mjaft i rëndësishëm për përcaktimin e pozicionit të sterës brenda banesës, por nuk ka qenë i vetmi. Në disa banesa, për dy familje (si rasti i banesës Çabej, Sinani etj.) shfrytëzimi më i mirë i sterës nga të dy familjet përbënte kriterin kryesor pavarësisht se ky pozicion nuk përputhej me pjesën më të ulët të terrenit.

Duke parë të gjithë këta faktorë, jemi përpjekur të bëjme një klasifikim të sterave si më poshtë:

**A) Mënyra e furnizimit me ujë:**

1. *Me ujërat e shiut,*

Kjo ndeshet më shumë në sterat e qytetit.

[5] Shtylla, V.: "Ujësjellësi i vjetër i Kalasë së Gjirokastrës", *Monumentet*, 1980, 20.

DO NOT COPY

2. *Me ujë burimesh nëntokësore dhe ndihmohen me ujët e shiut nga çatia*

Kjo kategori është shumë e rallë. Janë një gjendje mes pusit dhe hauzit, furnizohen me ujra nëntokësorë, por edhe me ujrat e shiut të mbledhura nga shtëpitë në krah (stera në bashtenë e banesës Çani).

**B) Pronësia:**

1. *Pronësi familjare për përdorim vetëm të familjes*,

Uji përdorej vetëm nga familja që kishte në pronësi banesën, të cilës i përkiste dhe stera. (p.sh. Zekate, Fico, Reso etj.)

2. *Pronësi familjare por që e ndan ujin dhe me banorë të tjerë të lagjes*

Këto stera kishin akses nga ana a jashtme e mureve të banesës (brenda oborrit të shtëpisë) dhe disa herë edhe nga ana e brendëshme e banesës. (p.sh. Kabili, Babaramo, Skënduli etj.)

3. *Pronë publike* (Stera e Baboçatëve)

Stera vetëm me përdorim publik. I vetmi shembull i kësaj kategorie është stera e Baboçatëve, e cila i ishte dhuruar komunitetit nga familja Baboçi.

**C) Pozicioni i sterës në lidhje me banesën:**

1. *Stera si pjesë e banesës*

Formë drejtëkëndore; furnizim me ujë shiu

2. *Stera si ndërtim i veçantë në bashkët e banesës*

Furnizimi ishte po me ujë shiu mbledhur nga çatitë e banesave. (p.sh. Çani, Ponde, Çenko).

**D) Pozicioni i sterës brenda banesës:**

1. *Perimetral*

Ky është rasti më i përhapur ku dy ose më shumë mure të sterës janë edhe muret e jashtme të banesës. Në këto raste, dritarja e kontrollit të sterës dhe tubi i shkarkimit nga ujrat e tepërta ndodhet në perimetër të banesës. Në këto raste gjejmë dhe marrjen e ujit me muslluk të brendshëm dhe të jashtëm. Tab. I

2. *Qëndror*

Stera pozicionohet në qendër të volumit të banesës. Vetëm një nga muret e sterës është dhe muri i jashtëm i banesës. Në këto raste shfrytëzimi i sterës bëhet me muslluk të brendshëm. Gjithashtu dhe dritarja e kontrollit të sterës dhe tubi i shkarkimit nga ujrat e tepërta ndodhet në brendësi të banesës, pikërisht mbi *"muslluk"*. Tab. I

**E) Mënyra e marrjes së ujit nga stera:**

1. *Me "muslluk"*

Uji merret përmes një rubineti "*fitit*" në një nga muret perimetralë, atje ku është dhe niveli më i ulët i strerës. Ky është rasti më tipik dhe më i përhapur.

2. *Me grykë pusi "kokërdhok"*

Uji merret nëpërmjet një gryke pusi e ndërtuar në pjesën e sipërme të sterës (qemerit) duke përdorur kova. Banesa Xhelili në lagjen Pazar i Vjetër është një nga shembujt më përfaqësues të kësaj kategorie (Fig. 3). Kjo zgjidhje ka ardhur si pasojë e pozicionit të volumit të sterës nën nivelin e katit përdhe duke mos pasur kështu mundësi tjetër (muslluk). Në këto raste gryka e pusit shërbente edhe si vend hyrje për pastrimin e sterës.

3. *Me të dyja mënyrat ("kokërdhok" dhe "muslluk")*

Në raste të rralla gjejmë të dyja mënyrat e marrjes së ujit nga stera (p.sh. banesa Braja, Kabili, Kadare etj.).

**F) Pozicioni i sterës në lidhje me terrenin:**

1. *Tërësisht nën nivelin e tokës*

I gjithë volumi i sterës është brenda terrenit (p.sh. Xhelili, Fig. 3)

2. *Pjesërisht nën nivelin e tokës*

Kjo është dhe mënyra që ndeshet më shpesh në ndërtimin e sterave, ku një pjesë e volumit të saj gjendet brenda terrenit.

3. *Mbi nivelin e tokës*

Kjo tipologji haset më rrallë. Në këto raste muret e jashme të sterës përforcohen me kontraforta duke i përforcuar ato për të përballuar presionin e ujit. (p.sh. stera në banesën Muhedini dhe Lili (ish Çabej).

### 3. Elementet e sistemit të mbledhjes së ujit

Grumbullimi i ujit të shiut e mandej përdorimi i tij realizohej nëpërmjet disa elementeve:

*1. Çatia:*

Çatitë e banesave të Gjirokasrës mbuloheshin me rrasa të holla guri të vendosura njëra mbi tjetrën duke filluar nga më të mëdhatë nëpër strehë dhe duke vazhduar me pllaka më të vogla në drejtim të kulmeve. Arsyeja për këtë ishte se rrasat e gurit në strehë mbajnë një sasi më të madhe uji duke qenë se grumbullojnë dhe atë të ardhur nga gjithë siperfaqja e çatisë mbi to. Pjerrësitë e ndryshme të çatisë orientojnë ujin të largohet, ndërkohë që strehët mbrojnë muraturën nga rreshjet.

DO NOT COPY



*Fig. 4. Pronari i banesës Skënduli duke kthyer ullukun vertikal në mënyrë që të kontrollojë ujin që shkon në sterë. Shtator, 2012*



*Fig. 5. Prerje skematike e volumit të sterës*

*2. Ullukët:*

Ullukët janë horizontal dhe vertikal. Ata nuk vendoseshin në gjithë perimetrin e çatisë por vetëm në pjesën e çatisë që ishte më pranë sterës në mënyrë që të shfrytëzohej rruga më e shkurtër e mundshme pasi ullukët ishin të kushtueshëm dhe nuk gjendeshin me lehtësi. Kjo tregon për një karakter racional të zgjidhjes.

*Ullukët horizontal* vendoseshin rreth strehëve pikërisht poshtë dy rrasave të para në mënyrë që uji të shkarkohej në mesin e tij. Montoheshin me ganxha metalike që nguleshin në bishtat e strehës ndërkohë që sot fiksohen nën petavra. Në këndë, atje ku bashkohen ullukët horizontal të dy faqeve të ndryshme me atë vertikal) vendoset **honi** (*gjimi*), një element pak më i gjerë se ullukët që lejon dhe mbledhjen e një sasie më të madhe uji si dhe kalon ujin në ullukun vertikal.

*Ulluku vertikal* që vjen poshtë honit është i lëvizshëm. Fillimisht në 2-3 shirat e parë (kur çatia është ende e papastër e mbushur me pluhurin e verës), ulluku rrotullohet dhe lejon derdhjen e ujit në oborr. Pas dy-tre shirave, kur konsiderohej se çatia ishte pastruar, ai rrotullohej dhe lidhej me ullukun që çon ujin në sterë (Fig. 4).

Ulluku diagonal, përshkon objektin deri sa futet në sterë. Ka raste kur një rresht me pllaka guri të dala konsol nga muri lejojnë që ulluku të mbështetet aty dhe të mos përkulet nga pesha gjatë kohës kur uji kalon në të.

*3. Stera (depozita):*

Stera është vendi ku grumbullohet e ruhet uji për t'u përdorur. Në përgjithësi sterat janë të mbuluara me qemer (*kube*) gjysmë cilindrike, të suvatuara zakonisht deri në nivelin ku nis qemeri dhe të përforcuara gjithashtu po në këtë nivel me tiranta druri (lis, rrobull etj.). Përforcimi është i natyrshëm në një sipërfaqe e cila do të mbajë një sasi të madhe uji si dhe duke marrë parasysh dhe efektin që ka dallgëzimi i ujit në konstruksion në raste lëvizjesh sizmike, apo kur ka mbi mbushje të sterës (Fig 5).

Dyshemeja e sterës ka një pjerrësi drejt vendit ku ndodhet *muslluku*, (vendi ku meret uji), me qëllim që uji të drejtohet drejt atij pozicioni dhe të shfrytëzohet më mirë për marrjen e tij.

*Fiti* (rubineti) vendoset rreth 30 cm më lart se dyshemeja me qëllim që papastërtitë të precipitojnë e mos të kalojnë në fit. Gjithashtu, në nivelin e dyshemesë në këtë pjesë, poshtë *Fitit,* ka një vrimë që lejon pastrimin nga papastërtitë nëse këto e kalojnë nivelin e kuotës së Fitit. Ky element është prej bronxi ose tunxhi dhe ndahet në dy pjesë, rubineti (*Fiti*) dhe një tub po tunxhi që përshkon gjithë trashësinë muraturën dhe ku montohej Fiti.

Fiti në vetvete përbëhet nga tubi ku kalon uji dhe një element në formën e një koni me një çarje në mes që sipas pozicionit të tij lejon ose jo kalimin e ujit. (Fig. 6).

DO NOT COPY





*Fig. 6,6.1. Pamje dhe prerje e Fitit të Musllukut. Elementi lëvizës (vizatimi) kontrollon kalimin ose jo të ujit*



*Fig. 7. Muslluk, banesa Skënduli*

Në pjesën e sipërme të njërit prej mureve (ai prej të cilit mundet të hyhet për pastrim) vertikal të sterës ndodhej një dritare e vogël që shërbente për pastrimin e saj apo për të kontrolluar ujin nëse do ishte e nevojshme.

*4. Muslluk* quhet e gjithë pjesa ku del uji (Fig. 7). Në përgjithësi është e ulur me 4-5 këmbë shkallë që të çojnë në nivel më poshtë se niveli i katit përdhe. Kjo për arsyet e përmendura më lart.

Muslluku në përgjithësi në pjesën e fitit ka një kamare me qemer e cila në qendër ka një kamare ku vendosej kandili. Në pjesën e fitit ka një ulje 30-40 cm për t'u futur ena e të mbushet. Në nivelin më të ulët të hapësirës së musllukut (poshtë fitit) vendoset një vrimë që përshkon gjithë trashësinë e murit të sterës. Ajo mbulohet me një gur dhe fiksohet me llaç. Niveli i saj përkon me nivelin më të ulët të dyshemesë së sterës dhe shërben për të pastruar atë nga papastërtitë e mundshme të grumbulluara.

Uji nga muslluku largohet përmes kanaleve të quajtura "llagëme".

*5. Llagëmet:*

Janë kanale të veshura me rrasa guri përmes të cilave largohet uji i tepërt. Kanali kalon në nivelin e dyshemesë së katit përdhe dhe oborrit dhe përfundon në kanalin e përgjithshëm të shkarkimeve (të cilat në murin perimetral kishin një qemer).

DO NOT COPY

## 4. Teknikat dhe materialet e ndërtimit

*1. Muret*

Muret e sterave janë të ndërtuara me të njëjtin gur lokal që është përdorur dhe për gjithë ndërtimin e banesave. Si material lidhës i muraturës është përdorur llaçi me përbërje rërë: gëlqere në raport 2:1. Trashësia e mureve varion në dhe 1.2m[6]. Kjo trashësi e muraturës nuk ishte vetëm për të mbajtur peshën e mureve të kateve të sipërme por edhe për të përballuar presionin e ujit brenda në stera.

*2. Qemeri/ kubeja (kupolë gjysmë cilindrike)*

Ambientet e sterave mbuloheshin me qemerë guri. Materiali lidhës i qemerit është llaçi i përdorur dhe në muraturën vertikale[1]. (Fig. 8)

*3. Përforcimi, Tiranta*

Konstruksioni i qemerit përforcohet me tiranta druri të vendosura në nivelin ku ai fillon.

Ato kanë një seksion prej 10-12 cm dhe janë prej dru lisi apo gështenje për arsye të karakteristikave të tyre mekaniko-elastike. Këto tiranta janë pjesë e një strukture më të madhe përforcuese në të gjithë muraturën e banesës. Ato janë të mbështetura dhe të bashkuara me brezat përforcuese prej druri të vendosura brenda mureve. E gjithë kjo strukturë shërbente për rritjen e rezistencës së banesës në forcat sizmike horizontale dhe në veçanti në ambientet e sterave për forcat horizontale të shkaktuara nga lëvizjet e ujit brenda tyre (Fig. 8).

*4. Suvaja*

Muret vertikale të sterave janë të suvatuara përgjithësisht deri në një nivel prej 1 m mbi nivelin maksimal të ujit. Hasim edhe raste ku suvatohet edhe qemeri, por shtresat nuk janë më me llaç horasan në këtë pjesë. Suvaja e qemerit ka përbërje gëlqere dhe rërë[1], ndërsa muret vertikale suvatohen me një përbërje llaç specifik të quajtur "*horasan*". Horasani ka si përbërje tullë të thërmuar dhe gëlqere në raport 1:1. Sipërfaqja e sipërme lyhej me një përbërje të bardhë veze dhe vaj ulliri të aplikuar 3-4 herë[7].

*5. Dyshemeja*

Dyshemeja e sterave ndërtohej me kalldrëm duke përdorur të njëjtën teknikë si rrugët e Gjirokastrës, ku



*Fig. 8. Ambienti i brendshëm i sterës, tirantat e drurit, banesa Beja*

gurët vendosen në drejtimin vertikal njëra pas tjetrës. Kjo strukturë mbulohet me të njëjtën suva "horasan" të aplikuar dhe në muret vertikalë. Këndet në pjesën ku dyshemeja takonte muraturën suvatohen në formë të lakuar për të lejuar një pastrim më të lehtë. E njëjta ndodhte dhe në këndet e muraturës, të cilat në pjesën e mbushur me ujë ishin patjetër në formë të lakuar.

## 5. Mirëmbajtja dhe përdorimi

*1. Rituali i mbledhjes së ujit*

Një ritual shumë rigoroz ndiqej për mbledhjen e ujit. Ky ritual fillonte çdo vjeshtë, kur pllakat e çatisë ishin mbuluar me pluhurin e periudhës së thatë të verës, gjethet e para të vjeshtës apo ndotje të tjera. Përpara se të mblidhej uji i shiut rituali kërkonte pastrimin e çatisë nga këto papastërti dhe kjo bëhej duke e i lënë shirat e para ta pastrojnë atë. Pas këtij procesi, pjesa e lëvizshme vertikale e ullukut (*luku*) lidhej përsëri me ullukët horizontal dhe uji i shiut fillonte të mbushte sterën. Kur stera mbushej me ujë deri në lartësinë e përcaktuar ulluku shkëputej përsëri dhe e derdhte ujin jashtë sterës tashmë.

*2. Monitorimi*

Në pjesën e sipërme të mureve anësorë, mbi nivelin e pjesës që mbushej me ujë, stera kishte një dritare të vogël që mund të ishte brenda ambienteve të shtëpisë apo dhe në muret e jashtëm të saj. Kjo dritare përdorej për të hyrë në sterë për

[6] Kamberi, Th., *Si furnizohej me ujë qyteti i Gjirokastrës*, "Monumente të Kulturës në Shqipëri", Tiranë 1975.

[7] Grup autorësh, *Elemente Projektimi, Lagështia; Dritaret*, botuar në ISP Nr.1

DO NOT COPY

ta pastruar por gjithashtu edhe për të monitoruar nivelin e ujit brenda saj. Nëse uji e kalonte nivelin e lejueshëm, uji do të derdhej jashtë nëpërmjët një vrime të vogël me diametër 7-10 cm. Kjo ishte gjithashtu një shenjë për të treguar se duhej zhvendosur ulluku vertikal për të mos lejuar ujin të vazhdonte të mbushte sterën.

*3. Pastrimi i sterës*

Stera pastrohej zakonisht në fund të periudhës së verës - fillim vjeshte kur ishte shpenzuar pothuajse gjithë uji, por edhe sepse periudha e shirave fillonte shumë shpejt, kështu që do të kishte mundësi të rimbushej. Uji që mund të kishte mbetur brenda saj zbrazej nëpërmjet një vrime të vogël poshtë fitit të musllukut. Pas zbrazjes së ujit, muret dhe dyshemeja e sterës laheshin me një copë të leshtë dhe me sapun. Pas larjes, vrima e vogël që përdorej për të zbrazur ujrat e fundit lihej e hapur në mënyrë që ujrat e para që do fillonin të grumbulloheshin në sterë të mund të lanin mbetjet e sapunit.

## 6. Shfrytëzimi tradicional i sterave si dhe përdorimi i sotëm i tyre

*1. Cili ka qenë përdorimi i sterave.*

*"...Kur shirat vazhdonin tri-katër ditë rresht, im atë e shkëpuste lugun që stera të mos mbushej më tepër se ç'duhej. Stera ishte e madhe... dhe në qoftë se shpërthente mund të përmbyste në fillim kubenë dhe pastaj të shkallmonte krejt themelet e shtëpisë..." Ismail Kadare "Kronikë në gur"*

Sterat e ujit ishin një pjesë shumë e rëndësishme e banesave gjirokastrite, gjithashtu dhe pjesë organike e kompozimit të hapësirave të këtyre banesave. Ambienti i dhomës në krah të sterës kishte gjithashtu temperaturë të ulët dhe për këtë arsye përdorej si frigorifer natyral, për depozitimin e ushqimeve (*zahireve*) gjatë verës si djath, mish, gjalpë etj.

Hapësira e sterës zinte zakonisht 20% të gjithë hapësirës së katit përdhe, një hapësirë kjo e konsiderueshme krahasuar me gjithë vëllimin e banesës, dhe shumë herë zinte dhe pjesë të katit të parë. Familjet më të mëdha dhe më të pasura kishin zakonisht dhe stera më të mëdha. Kjo referohej gjithashtu dhe numrit të banorëve për shtëpi që ndonjëherë arrinte edhe në 25-35 persona.

Uji i shiut që mblidhej në stera ishte i pastër dhe pa kripëra (i distiluar). Për këtë arsye kishte dhe shumë përdorime; për larjen e rrobave, larjen e enëve, pastrimin e shtëpisë dhe shumë herë përdorej dhe si ujë i pijshëm. Uji i sterës përdorej dhe për vaditje pasi banesat gjirokastrite kishin oborret dhe hapësirat përreth të mbjella me pemë dhe lule të ndryshme. Në këtë mënyrë sistemi i përdorimit të ujit ishte i qëndrueshëm dhe ai shfrytëzohej në mënyrë efektive me të gjitha mënyrat e ofruara nga vetë natyra.

*2. Përdorimi aktual*

Sot ekzistojnë akoma banesa të cilat i kanë në funksion të plotë musllukët si banesa Skënduli, por në shumicën e rasteve janë të pa përdorshme. Furnizimi me ujë nga rrjetet e qytetit i ka lënë mënjanë këto struktura tepër interesante. Në mjaft raste janë mbushur me mbeturina apo nuk mirëmbahen ose uji i tyre shërben vetëm për vaditje. Veçanërisht në banesat e braktisura rubinetat (*fiti*) janë grabitur. Ka dhe raste kur banorët i kanë adoptuar në depo, duke hapur dyer në pjesën ku ka qenë muslluku apo i kanë kthyer në kthina banimi.

Që nga listimi i vitit 1984 sot nuk kemi një inventar të gjendjes aktuale të sterave dhe një studim i tyre është mjaft i nevojshëm, jo vetëm për arsye historike, por për potencialin që kanë sterat për të pasur një qëndrueshmëri në përdorimin e ujit, freskisë që këto struktura gjenerojnë etj.

DO NOT COPY

Shembuj Stera perimetrale

Banesa Çano




Banesa Babaramo




Shembuj Stera perimetrale

Banesa Zekate




Shembuj Stera qëndrore dhe perimetrale

Banesa Angoni.




Shembuj Stera qëndrore

Banesa Çabej,




Banesa Çabej,




DO NOT COPY

*Tab. 1. Shembuj, planimetri me sterë qendrore dhe perimetrale*

Elena MAMANI
Kreshnik MERXHANI

DO NOT COPY

# WATER CISTERNS IN HISTORICAL HOUSES, GJIROKASTËR

Gjirokastra features 1200 stone buildings, making it one of the most important cultural heritage sites in Albania. In 1961 Gjirokastra was declared a Museum City, and in 2005 it became part of the World Heritage List (UNESCO).

Born in a period of turmoil, the 'City of Stone' was first mentioned in a chronicle on the uprising against the Byzantine Empire in 1336. In these difficult periods people were forced to balance defensive concerns with other life needs, such as water, food, etc. The defensive needs prevailed, and the people chose to establish the town in the most protected, but also the driest, part of the Drinos Valley. Given these conditions, the provision of water was a problem that required an urgent solution. For this, people devised an ingenious method of collecting rainwater in private cisterns, a technique we still find in all kinds of homes built in Gjirokastra from the end of the 18$^{th}$ century until World War II.

Water collection was such an integral part of life for the people of Gjirokastra that it shaped even the design of their homes, as well as their daily routine, such as cleaning/ treating the cisterns and distributing the rainwater.

Water cisterns contribute to our understanding of sustainable architecture and the way people throughout history have creatively used natural resources. We are dealing with organic architecture strongly related to local characteristics, materials, topography, geography and particular needs of that place, as well as the technical skills of that time. Today the efficient use of natural resources is of main interest, and the maintenance and restoration of these monuments is urgently needed. Such studies, therefore, help us understand the nature and technique of these buildings increase the effectiveness of restoration interventions and teach us more about our heritage.

DO NOT COPY

Agron DORACI

DOKTORATURA

# RESTAURIMI I BANESËS KADARE, GJIROKASTËR

Banesa e Kadaresë ndodhet në zonën e poshtme të lagjes Palorto në qytetin e Gjirokastrës, në rrugën që lidh qytetin me krahinën e Labërisë. Në këtë rrugë ka një sërë banesash me vlera arkitektonike muzeale, duke filluar nga ajo e Cicos, Ficos, Kadaresë, Toros, Xhaxhiut, Kokalarit, të cilat mbyllin konturin e poshtëm të kësaj lagjeje. Në këtë rresht banesash, ajo e Kadaresë është më e arrira për nga trajtimi arkitektonik dhe në pozicion më të dukshëm. (Fig. 1)

Banesa ka qenë e vjetër, për pasojë mjaft e amortizuar. Familjet gjirokastrite, gjatë gjysmës së parë të shekullit të kaluar, megjithëse ruanin fisnikërinë, nivelin kulturor e arsimor të trashëguar, nuk kishin më fuqinë ekonomike për të mirëmbajtur banesat e tyre tip kështjellë. Halit Kadareja (babai shkrimtarit), që zotëronte më pak se gjysmën e banesës, pjesën veriore të saj, me sakrifica kreu një restaurim serioz, e rinovoi atë pjesë, duke i qëndruar besnik strukturës origjinale të saj. Ana jugore administrohej nga trashgimtarë të tjerë të familjes Kadare, të cilët nuk e përballuan investimin që kërkonte restaurimi, kështu, banesa në këtë zonë, pjesërisht u shemb. Megjithë ndërhyrjet e shumta, transformimin e madh dhe djegjen e banesës, mjaft elementë strukturorë bazë të fazës fillestare nuk u shkatërruan. Mbi këtë bazë, dhe mbi dokumentacionin teknik e filmik të ruajtur, u ndërtua projekti i plotë i restaurimit të banesës Kadare. (Fig. 2)

## Zgjidhja funksionale e banesës Kadare

Banesa është trekatëshe, me një kat pjesërisht nën dhé. Stera e ujit që ushqehet nga grumbullimi i ujrave të shiut në çati, zë pjesën qendrore të banesës në bodrum. Shfrytëzimi i ujit të sterës bëhet nga pusi në dyshemenë e nëndivanit dhe me rubinetë të vendosur në fundin e shkallëve që çojnë në qilarin e vogël në bodrum. Pusi shërben edhe si hyrje në sterë gjatë pastrimit të saj. Nga kati përdhe, nëpërmjet një galerie me qemer guri, zbritet në bodrum, ku ndodhet qilari i vogël, mbuluar po ashtu me qemer guri. Në këtë qilar depozitoheshin rezervat ushqimore dimërore, në enë prej balte të mëdha, qypa dhe fuçi druri. Për të lehtësuar shërbimin, në këtë mjedis janë ndërtuar platforma me mur guri të ngritur 60 cm nga dyshemeja, ku vendosen enët me rezerva ushqimore. Guri në sipërfaqe të këtyre platformave gdhendet në formë gote për të rritur qëndrueshmërinë e enës. Qilari i vogël, duke qenë në pjesën më të madhe nën tokë, i rrethuar me mure guri të trasha, ka kushte të mira termoizoluese, duke u kthyer në një frigorifer natyral, në kushtet e një vere mjaft të nxehtë që ka qyteti. Përballë shkallës që të shpie në qilarin e vogël, ka një dritare, që së bashku me dritaren e qilarit, krijojnë kushtet për një ventilim natyral mjaft të efektshëm.

Nën tokë, ngjitur me qilarin e vogël, gjendet një galeri e fshehtë, me qemer guri. Hyrja për në këtë mjedis bëhet nëpër një brimë 60x60 cm, e maskuar në dyshemenë e qilarit të dytë në katin përdhe. Ky mjedis duhet të ketë shërbyer për ruajtjen e materialeve të çmuara, armëve dhe të njerëzve në rast rreziku. Ai ka gjatësinë 3,5 m x 1,55 m, mbuluar me qemer guri, në të ka tre kamare të mëdha për depozitim. (Fig. 3)

Në katin përdhe, në pjesën e prapme ka dy mjedise, secili me dalje të veçantë në rrugë. Mjedisi në anën jugore ka derë të vogël, aq sa njeriu duhet të kërruset shumë për të hyrë në të. Ky mjedis duhet të ketë shërbyer si depozitë



*Fig. 1 Gjurmë të çardakut, pamja nga jashtë*



*Fig. 2 Gjurmë të çardakut pamja nga brenda*



*Fig. 3. Gjurmë të çardakut*

bari për kafshë. Mjedisi nga ana veriperëndimore përmban hyrjen kryesore, me përmasa që pranon kalimin e kafshëve. Ky mjedis shërbente si katoq për qëndrimin e kafshëve dhe është i mbuluar me qemer guri.

Në katin përdhe, në anën veriore ndodhet qilari i madh, i cili shërbente për depozitimin e produkteve bujqësore, që pronarët gjirokastritë e merrnin nga fshatari si detyrim në natyrë. Këto produkte, kryesisht misri dhe qepët depozitoheshin të varura në vargje. Këto produkte bujqësore në këtë mjedis, jo vetëm ruheshin, por edhe thaheshin, prandaj lartësia e katit është e madhe dhe mbulesa është me qemer guri.

Nëndivani në katin përdhe, në pjesën ballore, është komplet i hapur, realizuar nëpërmjet një arkade me katër harqe. Në kolonën midis harqeve ka kamare për vendosjen e fenerëve. Mbulesa e nëndivanit është e vetmja në këtë kat me dysheme druri. Në hapësirën e mesit të arkadës, bëhet dalja për në oborr. Hapësira e fundit e arkadës shfrytëzohet për kamerien, e cila plotësohet edhe me dy harqe të tjerë më të mëdhenj. Shkalla për t'u ngjitur në katin e sipërm është komplet e jashtme, fillon nga nënkamerieja, mbështetet në arkadë dhe mbi harqe të rinj të shkallëzuar, duke ruajtur skemën dhe hapin e harqeve të arkadës. (Fig. 4)

Në katin e sipërm gjenden katër mjedise banimi dhe një shërbimi. Mjediset e banimit që ndodhen në pjesën ballore të banesës quhen oda në Gjirokastër dhe

DO NOT COPY




*Fig. 4. Plani i katit në bodrum*




*Fig. 5. Plani i katit përdhe*

rezervohen për miqtë. Ato pozicionohen në atë pjesë të banesës nga ku pamja jashtë është më e plotë, prandaj odatë shërbenin për raste të ceremonive familjare, si dhe për pritjen e miqve. Këto mjedise kanë përmasa të konsiderueshme dhe ngarkesë artistike ornamentike. Çdo element është i ngacmuar me zbukurime duke filluar nga fashiturat, kornizat, sergjenet, dyert, dollapët e murit, musandaratë, dhipatotë e tavanet, ku trajtimi artistik arrin kulmin. Dy mjediset e tjera të banimit, të vendosura në pjesën e prapme janë dhoma zjarri ose dimërore siç quhen në Gjirokastër dhe kanë ndriçim natyral më të vogël. Midis tyre është mjedisi shërbimit, i cili është i pajisur me oxhak, nerohite (vend për larje enësh). Ky mjedis shërbente si kuzhinë në periudhën e dimrit, për larje e gatim. Çdo mjedis banimi është i pajisur me oxhak, depo (musandara) me nyje sanitare më vete.

Çardaku ose divani është transparent, duke qenë se shkalla është e jashtme, sipërfaqja e divanit mjaft e madhe, luante një rol të rëndësishëm funksional në periudhën e verës së nxehtë. Nga çardaku, me dy këmbë shkallë dilet në kamerie. Ekzistenca e kameriesë, së bashku me çardakun nuk është ndonjë rastësi në rastin konkret, pasi atë e gjejmë në mjaft raste të tjera në banesën Gjirokastrite. (Fig. 5)

**Formulimi arkitektonik**

Në përgjithësi, banesa Gjirokastrite në variantin e saj të plotë është një mrekulli, është një vlerë e veçantë në trashëgiminë tonë të kulturës materiale, në fushën e arkitekturës. Brenda kësaj pasurie, disa banesa, për nga formulimi arkitektonik, volumi i ndërtimit, pozicioni i tyre në terren, mbajnë peshë në vlerën estetike të peizazheve të qytetit. Këtu mund të përmendim në lagjen Palorto banesën e Zekatëve, të Skëndulatëve, dhe atë të Kadaresë. Në banesën Gjirokastrite mund të bëhet diferencim në vlerat estetike, duke u nisur nga harmonizimi i shpërndarjes së masave dhe elementëve arkitektonikë si dhe rregulli në dimensionimin e tyre.

Në banesën e Kadaresë, nuk kemi një shpërndarje kaotike të elementëve arkitektonikë e as një dimensionim arbitrar, përkundrazi shpërndarje dhe dimensionim të menduar mirë, të ndjerë e realizuar me një rregull të plotë harmonik. Në këtë banesë gjejmë në mënyrën më të sintetizuar një krijim arkitektonik, ku dallohet rregulli i ndërtuar mbi module gjeometrike. Masa volumore është në harmoni me peizazhin përreth, ka kontraste të fuqishme hije dritë, ndjehet simetria, asimetria, ritmi në shpërndarjen e dimensionimin e të gjithë elementëve arkitektonikë. Në banesat Gjirokastrite, më shumë se kudo në vendin tonë, ka një sintezë të plotë të arkitekturës me artet e aplikuara, çdo element ndërtimor është zbukuruar me një ornamentikë të pasur, megjithëse sot nuk kemi gjurmë, banesa e Kadaresë nuk mund të bënte përjashtim.

DO NOT COPY



*Skica nr. 1*

DO NOT COPY

Planimetria si gjeneruese e formës arkitektonike (skica nr. 1), është ndërtuar mbi bazën e figurës gjeometrike të katrorit, të përsëritur me rregull harmonik. Në pamjen kryesore vërehet gjithashtu një rregull linjash gjeometrike bazuar mbi këndin e drejtë, që i jep veprës jo vetëm vlera estetike, por edhe bindje e siguri për qëndrueshmëri të lartë (skica nr. 2).

Transparenca e arkadës, shkallës së jashtme, nënkalimit dhe çardakut, krijojnë kontrast të fuqishëm hije dritë, duke lehtësuar masën dhe nxjerrë në pah vëllimin në dritë. Drita, në sipërfaqen që mbështjell volumin zbehet e merr intensitet, duke kaluar nga e zbehta e gurit pa suva në katin përdhe, në të bardhën plot dritë të gëlqeres, në suvanë e katit të sipërm. Çdo element në vetvete është i proporcionuar në raporte të caktuara, p.sh harku ruan raportin 1:3, duke marrë theksim vertikal dhe elegancë të madhe. Vet blloku i banimit ruan në gjerësi e lartësi të njëjtin raport. (Fig. 6)

Në rastin e banesës Gjirokastrite nuk kemi të bëjmë me projektime nga arkitektë profesionistë, por krijimtari të pastër nga mjeshtërit popullorë, ku idetë nuk hidhen e përpunohen më parë në letër e pastaj në terren, por raportet dhe dimensionet e elementëve arkitektonikë zotërohen nëpërmjet pamjes dhe matjes reale në terren. Megjithëse shumë gjëra më shumë ndjehen se llogariten, vërtetohet se



*Skica nr. 2*

mjeshtërit popullorë kanë pasur parime që i kanë udhëhequr ata në krijimtarinë e tyre me nivel kaq të lartë estetik.

**Restaurimi i banesës Kadare**

Restaurimi i banesës Kadare shtroi një sërë problemesh të rëndësishme që janë hasur e hasen vazhdimisht në restaurimin e monumenteve në Gjirokastër. Në rastin konkret, këtij restaurimi i shtohej edhe një vështirësi tjetër, që lidhej me funksionin e saj si objekt publik. Kërkoheshin ndërhyrje me detaje e elementë të rinj që siguronin funksionin publik dhe që të ishin në unitet me traditën ndërtimore të monumenteve në Gjirokastër. Struktura bazë konstruktive prej mure guri u ruajt ajo origjinale, por u pa e nevojshme që të futen elementë të rinj, që përforconin qëndrueshmërinë e veprës, duke marrë parasysh se objekti me funksion publik kërkon koeficient më të lartë sigurie. Është mbajtur parasysh fakti që shtesat në elementët strukturorë të jenë të maskuar, të padukshëm në pamjen e jashtme.

Një problem i rëndësishëm ishte trajtimi i rifiniturës dhe dekoracionit të brendshëm. Ndërhyrjet e vazhdueshme pa kriter, djegja e objektit kishin shkatërruar plotësisht strukturat dhe elementët arkitektonikë të brendshëm prej druri, si rezultat, në objekt nuk kishte gjurmë të tyre. Gjithë ai dekoracion origjinal i brendshëm ishte zhdukur plotësisht. Pra, shtrohej problemi i gjetjes së masës, shpërndarjes dhe motivet e këtij dekoracioni. Volumi i banesës nuk të lë të dyshosh për ekzistencën dhe ngarkesën e këtij dekoracioni. Ngarkesa, shpërndarja, motivet e këtij dekoracioni u përcaktuan me kujdes, në raport me banesat e tjera *monumente kulture* në këtë qytet, të së njëjtës kategori. Më kryesore nga të gjitha ishte ruajtja e masës së këtij dekoracioni për të realizuar një restaurim serioz e sa më afër realitetit me traditën që ruhet në qytetin muze.

Në traditë, të gjitha banesat muzeale në Gjirokastër, të kësaj kategorie, me tre kate, me dy krahë, kanë dekoracion të ngarkuar, por të shpërndarë vetëm në mjediset e pritjes së miqve, pra në dy odatë dhe më pak në divan. Ky rregull e parim u ndoq edhe në banesën e Kadaresë. Në mjediset e tjera u ruajt thjeshtësia e plotë që karakterizon traditën në qytetin muze.

Praktikisht, odaja e madhe në banesën Kadare ka ngarkesën më të madhe dekorative. Tavani ka dy breza

DO NOT COPY



*Fig. 6. Pamja e përgjithshme, varianti fillestar*

në kontur më të ulëta me gjerësi 20 cm, me elementë të gdhendur me motive floreale. Gjithashtu, kornizat e piqet në këtë tavan janë me kanelina, ku vendosen elementë të tjerë më të vegjël, të gdhendur. Ngarkesë ka rozeta tetëkëndëshe në qendër të tavanit, sergjenet, musandaraja me gjashtë kamare, dollapët e kornizat. Pra, çdo element në oda është e punuar me dekoracion floreal e gjeometrik. (Fig. 7)

Odaja e vogël ka të njëjtin trajtim, në ndryshim nga oda e madhe, ndarja e musandarasë është me çatma e jo prej druri. Tavani i odasë së vogël është po ashtu me dy breza më të ulët në kontur, por, këto breza ndahen midis tyre me me një shirit suvaje me gjerësi 14 cm në formë ulluku të përmbysur. Kontrasti i ngjyrës së drurit me të bardhën e gëlqeres së shiritave në formë ulluku krijojnë gjendje emocionale të veçantë tek vizitori. Edhe në këtë oda, sergjenet, dollapët, kornizat janë të gdhendura me motive floreale e gjeometrike.

Punimet e drurit në mjediset e tjera janë të thjeshta e pa dekoracion. Vetëm në divan, tavani ka një farë ngarkese me dekoracion. Ky tavan është me kuadrate 14 x 14 cm, me piqe të holla 1.5 cm, me dy rozeta me dekoracion gjeometrik me *piqe* të holla. (Fig. 8)

Dritaret janë trajtuar si në të gjitha banesat e tjera gjirokastrite, në çatma janë me hapje vertikale të shoqëruara me taraba po me hapje vertikale dhe zgara druri dekorative. Dritaret në muret e gurit në oda janë gjithashtu me zgara druri, dritare me dy nervolina dhe hapje horizontale. Këto dritare mbyllen me kanata druri me zemra të thjeshta, për të komanduar sipas rastit dritën natyrale në mjedisin e brendshëm. Dritaret në mjediset e tjera janë të thjeshta, me kasë binari, me hapje horizontale.

DO NOT COPY

Vlen për të theksuar se është ruajtur dimensionimi tradicional i elementëve në dritare, duke i bërë ato me trashësi të nervolinave 3 cm të gjera.

Dyert e katit përdhe janë sipas traditës të thjeshta, me dërrasa, pa zemra, të shoqëruara me aksesorët metalikë tradicionalë. Dyert e dhomave dhe të divanit janë me zemra me dimensione të vogla, ndërsa tek ato të odave, zemrat janë me zbukurime me motive floreale.

Sergjenet, fashaturat, kamaret, musandaratë dhe dollapët u trajtuan me kujdes, në detaje, dekoracion dhe pozicionin e tyre në mjediset ku u vendosën. Shtresat e katit përdhe janë me pllaka me gur të zi të skuadruara, po ashtu dhe pragjet e shkallëve. Vëmendje iu kushtua sterës, u kontrollua imtësisht, u provua me ujë pasi u krijua bindja se stera ishte në gjendje të mirë teknike, vetëm u pastrua dhe u la në strukturën origjinale të saj. U restaurua vetëm gryka e pusit që ishte e dëmtuar. Konturi i sipërm i grykës së pusit u bë si në variantin origjinal, me tre gurë të zi të rrumbullakët, të lidhur me elementë metalikë, me derdhje me plumb.

Nënkalimi me qemere guri, i vetmi ky në Gjirokastër, gjithashtu u restaurua, përveç qemereve me gurë të punuar. U restaurua edhe kalldrëmi në këtë zonë, duke respektuar me rigorozitet strukturën dhe formën origjinale të tij.

Rifinitura në banesën Kadare nuk ka vlerën e autenticitetit, por nuk ka dyshim për ekzistencën e saj, prandaj ajo u mendua të përfaqësojë dekoracionin tipik të banesës karakteristike të qytetit muze të Gjirokastrës.



*Fig. 7. Tavani, oda e madhe, punë në proces*



*Fig. 8. Tavani, oda e vogël, punë në proces*

DO NOT COPY

Agron DORACI

DO NOT COPY

# THE RESTORATION OF THE KADARE HOUSE

*Kadare House* is found in the lower section of the *Palorto quarter*, in the town of Gjirokastra. It is located on what was once the main road that led out of the town toward the region of *Laberia*. There are a number of houses of historical value along this section of the road, including the houses of the *Cico*, *Fico*, *Kadare*, *Toro*, *Xhaxhi*, and *Kokalari* families, which form the lower limit of this neighborhood. Among this group of houses, the Kadare House is certainly the finest, both from the point of view of architectural value as well as its most favorable position.

Kadre House is a first class category monument. This house occupies a significant place in the characteristic buildings conserved in the museum city of Gjirokastra, both for the volume of construction works and the functional solutions they represent. This building also attracts everybody's attention in terms of its architectural formulation.

In this building, we find a fully synthesized architectural creation, where we discern the rule of building on geometric models, something that proves both architectural thought and purpose. In the case of Gjirokastra houses, we are not talking about designs provided by professional architects, but pure creation from masterful craftsmen. These skilled craftsmen didn't sketch out and work through their ideas on paper first and then put them into practice, but we see that the architectural elements of size and dimension were commanded by the skilled eye and controlled by crude measurement as they built .Despite the fact that the many architectural elements seem to have been calculated by intuition, rather than coolly measured out on paper, we find ample evidence that the old craftsmen held to principles which guided them well and allowed them to produce building work of fine esthetic quality.

In the year 1999 the house burnt down. Despite the considerable damage, the fire did bring to light some of the original architectural characteristics of the building. A number of elements that had been masked by later alterations were once again unveiled. After meaningless delays, the restoration of the house finally began in 2014, under the direction of UNESCO. The building structure was made in accordance with the original version, based on the technical documentation and the actual material in the site.

One of the main issues was the treatment of the finishes and interior decoration. There were no traces of the original wooden interior elements, this due to numerous inappropriate interventions and the fire. Under these circumstances, the issue was to find the amount, distribution and motif of the interior decoration. The solution to these aspects was given in relation to the examples found in other monuments of the same category in the city of Gjirokastra. The volume of the house leaves no room for doubt on the presence and density of the original decoration. Having a sense of mass, amount of decoration, was of the highest importance in order to have a serious restoration, as closer as possible to the tradition that is preserved in the museum city.In Gjirokastra's museum houses's tradition of this category, three floors and two sides, the decoration is in a large quantity, but it is present mainly in the main *oda*-s and a less in the *divan*. This principle was followed during the restoration of Kadare House. The characteristic simplicity of the museum city's tradition was kept in the other areas of the house. The decoration was focused only on the ceiling, the *musandara*, the in-wall furniture and on the *sergjene* of the two main *oda*-s. Each element of these two rooms was decorated with floral and geometric motifs. With this restoration, Kadare House regains its former brilliance.

Prof. dr. Emin RIZA

DO NOT COPY

## ALI MUKA, *KULTURA POPULLORE DHE KOHA, VËSHTRIME ETNOLOGU*, VËLLIMI I, II. TIRANË, 2014

Prof. dr. Ali Muka, në vazhdën e hulumtimeve sistematike në fushën e etnologjisë, e cila kohësisht përfshin rreth katër dhjetëvjeçarë, natyrshëm në rritje të vijueshme profesionale, po shfaq një veprimtari të gjerë botuese vitet e fundit. Kjo dukuri e kuptueshme, e cila synon përgjithësime në trajtim temash shumërrafshëse, shfaq fazën fundore të veprës së tij prej etnologu të përkushtuar, duke i dhënë shkas studimeve prej brezash të tjerë studiuesish, me qëllimin e afrimit sa më shumë ndaj së vërtetës, thelbit të çdo fushe kërkimore.

Natyrshëm, studiuesi serioz dhe njëherazi lartsynues, Prof. dr. Ali Muka në monografitë e përmendura ka arritur ,pas kërkimesh shumëvjeçare, duke shkelur hapësira të gjera të trojeve historike dhe aktuale shqiptare, të cilat shkallërisht i ka trajtuar me një varg të gjerë artikujsh botuar kryesisht në revista shkencore apo dhe organe të tjera të karakterit të përgjithshëm. Padyshim, në veprat e fundit, autori është mbështetur, madje është bazuar, mbi arritjet pararendëse, siç përmendëm, mjaft prej tyre të botuara. Por ai, besojmë me të drejtë, mendon mbi tema, të themi pjesore, dhe e ka parë të arsyeshme botimin apo ribotimin e një sërë artikujve dhe shkrimeve në një njësi më vete titulluar "Kultura popullore dhe koha në vështrime etnologu". Kjo vepër përmbledhëse e ndarë në dy pjesë përkatësisht, e para e formuar prej dy grupesh dhe e dyta prej katër të tillësh. Fakti që këto shkrime të karaktereve të ndryshme, të cilat i bashkon fusha e gjerë e etnologjisë, janë të shpërndara në botime të ndryshme, madje disa botohen së pari në këtë përmbledhje studimesh, është i rëndësishëm sepse arsyeton botimin në shqyrtim. Monografitë e gjëra tematike, synim i kuptueshëm për çdo studiues, krahas përparësisë thelbësore të trajtesave konkluduese për tema hapësirëgjëra, nuk mund të zëvendësojnë trajtesat e veçanta për çështje të themi specifike. Më tej, studiuesit e rinj, synuesit e përligjur për tejkalimin profesional të paraardhësve, ndihmohen bindshëm kur krahas monografive madhore sintetizuese, kanë parasysh veprimtaritë e pjesshme dhe njëherazi vargëzuese, sipas temave, të studiuesve. Janë pikërisht këto veprimtari, thelbi i asaj që emërtohet veprimtari gjurmuese-studimore në fushën e etnologjisë dhe përgjithësisht në fusha kërkimore drejt të vërtetave në hapësirën shkencore joekzakte. Nga sa u parashtrua më sipër, padyshim theksohet mendimi ynë se botimi i kësaj përmbledhje konstatimesh, meditimesh, qëndrimesh vlerësuese, apo kritike, referimesh, leksionesh, udhëheqje diplomash, zëra të FESH etj, është një ndihmesë me vlera të dyfishta të studimeve, apo veprimtarive vlerësuese në fushën e etnologjisë dhe karakterit mësimdhënës të tyre për brezin e ri dhe ata pasardhës të studiuesve.

Duke pasur parasysh nivelin profesional të autorit, ne nuk do të ndalemi në trajtimin e ndihmës së tij në këtë botim, sipas secilës temë, por do të ndalemi në karakterizimin tërësor të veprës, gjithë duke pasur parasysh temat e trajtuara.

Prof. dr. Ali Muka mes të tjerash dallohet për interesimet shumëplanëshe të veprimtarisë gjurmuese, duke theksuar rrethanat e kryerjes së kërkimit, ndodhi shoqëruese si dhe konsiderata të karakterit emotiv, të cilat, pa cenuar rreptësinë e zbatimit të metodës kërkimore, pasqyrojnë më bindshëm veprimtarinë kërkimore në fushë të etnologjisë. Gjithë duke e cilësuar prozën e prof. dr. Ali Mukës, prozë kërkimore, ajo, në dallim prej shumë të tjerëve bart edhe vlera letrare, duke lehtësuar përvetësimin, larg thatësisë akademike, e cila nuk

është lehtë e pranueshme për lexuesin jo profesionist.

Ndarja e parë e vëllimit të parë titulluar "Kundrime etnologu" paraqet vlera të karakterit përgjithësues, duke marrë në konsiderim edhe ndihmesë të autorëve të huaj evropianë në kontekstin e përfshirjes së kulturës shqiptare në shekuj në këtë kategori të gjerë dhe të larmishme vlerash. Në këtë pjesë, autori, nëpërmjet çështjeve të trajtuara, të cilat kanë karakter përgjithësues shfaq qëndrimin e tij lidhur me kategori sa gjithpërfshirëse si kulturat kombëtare, emërtimi i tyre si shfaqje e konceptimit mbi karakterin e këtyre kulturave, në rastin në shqyrtim, asaj shqiptare, veçoritë e kërkuesit etnolog, ecurinë në kohë të dukurive etnografike, domosdoshmërinë e ruajtjes së tyre etj. Në mbarë këto mbarështrime vërehet qartësi mendimesh dhe përgjithësisht qëndrime bashkëkohore të karakterit konceptual, drejtuese të sigurta të veprimtarisë praktike kërkimore. Edhe në ndarjen e dytë, autori qëndron në tematika përgjithësuese, duke rikonfirmuar se gjithë duke qenë profesionist i një fushe të caktuar të fushës së etnokulturës, formimi i gjerë kulturor është i domosdoshëm për arritje që synojnë argumentueshëm drejt zbulimit të vërtetave. Në pjesën e tretë, të vëllimit të parë, autori paraqet qëndrime ndaj veprash të kolegëve, larg synimit thjeshtë përshkrimor por atij përkrahës, apo edhe kundërshtues.

Në vëllimin e dytë autori i kushtohet më dukshëm fushës së tij profesionale, studimit të fshatit dhe banesës shqiptare të së kaluarës, kur ajo përfshihej në kategorinë popullore, kohësisht deri në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XX. Kjo pjesë trajtohet në katër grupe, duke përfshirë shkrime në vite, leksione të Universitetit të Prishtinës, udhëheqje diplomash universitare dhe së fundi trajtesat titulluar: "Mbresa në vite". Në këtë pjesë Prof. Ali Muka na shfaqet më prektas, ashtu siç është thelbësisht, gjurmues dhe studiues profesionist dhe i përkushtuar i veprimtarisë ndërtimore popullore fshatare në shekuj. Ajo që bie në sy është shumësia e fushave të trajtuara të cilat drejtpërdrejt, apo tërthorazi shqyrtojnë në mënyrë të ndryshme, për vetë karakterin e tyre, probleme të trashëgimisë së pasurisë sonë ndërtimore të së kaluarës. Duke qenë kjo veprimtari në ndërlidhje të ndryshme me lexues profesionistë, auditorë universitetesh, të interesuar për trashëgiminë e kulturës sonë materiale etj, ato shfaqin angazhimin shumëplanësh të autorit për të sensibilizuar sa më gjerë mbarë të interesuarit, përherë në rritje, lidhur me vlerat historike-kulturore të trashëgimisë sonë në fushën e kulturës materiale.

Botimi "Kultura popullore dhe koha në vështrime etnologu", vjen si një lloj disi e veçantë në botimet, përherë dhe në rritje, në fushën e etnologjisë, një prej fushave të rëndësishme të shkencave albanologjike. Prof. dr. Ali Muka edhe në këtë botim shfaq prekshëm shkallën e lartë të profesionalizmit në fushën e vlerave të fshatit dhe banesës fshatare tradicionale shqiptare. Këto vlera mbështeten në punën e gjerë e të kujdesshme për gjurmimin e palodhur të sa e sa vendbanimeve dhe ndërtimeve fshatare, njohjen e imtë të tyre, dokumentimin, mbledhjen e të dhënave gojore dhe më pas klasifikimin, karakterizimin urbanistiko-arkitekturor, dhe vendosjen e dukurisë në kontekstin historiko-shoqëror shqiptar dhe më gjerë. Tezat dhe hipotezat e autorit janë të mbështetura, pra i japin veprës tiparet e qenësishme të vërtetësisë kërkimore. Kjo e vërtetë siguron qëndrueshmërinë e saj në kohë gjithë duke u pasur natyrshëm me ndihmesa të reja, prej të dhënash të reja dhe analizash mbi metoda novatore, natyrisht të pritshme në kushtet e progresit të shpejt të analizave të materialeve burimore. Kjo vepër krahas të tjerave, prej autorit prodhimtar prof. dr. Ali Muka dhe kolegëve të tij e vendosin kërkimin shqiptar, në fushën në shqyrtim, në vendet e para ballkanike dhe më gjerë.

DO NOT COPY

Prof. dr. Zyhdi DERVISHI

DO NOT COPY

## ALI MUKA, *STUDIUES DHE STUDIME PËR ETNOKULTURËN SHQIPTARE, MBRESA E URIME, SHËNIME E VLERËSIME*. TIRANË, 2014

## LIBËR MJAFT I ARRIRË I NJË LLOJI TË VEÇANTË

Një libër i një lloji të veçantë për 12 personalitete të shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare. Në aureolën e besimeve të krishtera numri 12 ka domethënie të veçantë mbarësie. Urojmë që edhe ky libër të jetë një ogur i mbarë për një rrugëtim të mbarë jo thjeshtë në botën e kërkimit në fusha të ndryshme të albanologjisë, por në më pak të dukshmen, dhe gjithsesi shumë të rëndësishmen, në rrjetën e marrëdhënieve njerëzore ndërmjet atyre, që për më shumë se gjysmë shekulli mbajtën mbi supet e tyre barrë të rënda për themelimin dhe lëvrimin e disiplinave dhe nëndisiplinave të veçanta të kërkimit në fusha të ndryshme të studimeve albanologjike.

Përgjithësisht për jetën vetjake të shkrimtarëve, të artistëve të shquar në vendin tonë ka fare pak botime serioze të artikuluara me gjuhë shkencore. Ndërkohë për jetën e shkencëtarëve, të studiuesve të shquar ka edhe më pak. Madje, disa prej tyre janë fare të sipërfaqshëm.

Në mjaft aspekte libri "Studiues të etnokulturës shqiptare" (Mbresa e urime, shënime e vlerësime) shënon fillimin ose konsolidimin profesional të një tradite fare të re në literaturën studimore shqiptare. Me sytë e shpirtit dhe të zemrës prof. dr. Ali Muka përmes faqeve të këtij libri ka rilevuar sistemin e marrëdhënieve shoqërore me 12 personalitete të shkencës, të cilët ia kushtuan gjithën jetën e tyre kërkimeve teorike dhe empirike në disa fusha të kulturës materiale e shpirtërore, të traditave të hershme dhe të zhvillimeve më të vona shoqërore e psikokulturore të popullit shqiptar: Prof. dr. Abaz Dojaka dhe akademik Alfred Uçi, akademike Andromaqi Gjergji dhe akademik Emin Riza, kulturologu i shquar Franc Nopça dhe Prof. Oksana Budina, akademik Mark Krasniqi dhe Prof. dr. Pirro Thomo, profesorët Qemal Hashihasani dhe Rrok Zojsi, Spiro Shkurti dhe Zija Shkodra. Dhjetë shqiptarë e shqiptare dhe dy me përkatësi kombëtare joshqiptare: gjeologu, paleontologu dhe etnografi hungarez Franc Nopça (1877- 1933) dhe ebreja moskovite Oksana (Roksana) Budina.

Autori i këtij libri, Prof. dr. Ali Muka nuk ka pasur komunikime të drejtpërdrejta vetëm me Franc Nopçën. Ndërsa me të tjerët është parë sy në sy në mjedise të ndryshme pune e ceremonish familjare, veprimtarish kulturore e argëtuese, angazhimesh shoqërore e politike, mjaft prej të cilave të diktuara nga koha: në çaste të stuhishme qarkullimesh politike dhe përgjatë ditëve të mundimshme të ekspeditave në fshatrat më të skajshëm të vendit, në tryezat e punës në institute ose në bisedat mes miqsh rreth filxhanit të kafesë ose gotës së rakisë, në terrenet e vështira të punës prodhuese, vullnetare ose në bisedat vesh më vesh që të mos dëgjonin edhe muret e politizuara prej diktaturës totalitare, në ceremonitë familjare të gëzimeve ose të hidhërimeve, në udhëtimet stresante përtej kufijve të Republikës së Shqipërisë ku silueta e kolegut më të afërt dhe e mikut më të mirë të tjetërsohej në uniform të padëshirueshme të bashkëpunëtorit të sigurimit të shtetit, pra në çdo stinë të vitit e në çdo ditë të javës.

Duke rilevuar 12 portrete të studiuesve nga më të shquarit të fushave kryesore të albanologjisë autori i këtij libri prof. dr. Ali Muka hedh dritë, si të thuash, në tërë relievin e minibotës së trazuar të shkencave albanologjike, në dinamikën e lidhjeve

të saj me gjithë pjesët e tjera të rëndësishme të shoqërisë. Para së gjithash dhe mbi të gjitha ky libër zbulon gjithë gamën e funksioneve të rëndësishme që realizonin lidhjet shoqërore të sinqerta, miqësitë e pastra ndërmjet studiuesve, të cilët pjesën më të madhe të kohës ndodheshin mes dy fronteve të luftës: përpara fronti i vështirë i kërkimit, i cili bëhej edhe më i vështirë nga mungesat gjithfarëshe dhe rritja e përshkallëzuar e izolimit të vendit; prapa krahëve fronti i ngatërresave politike të shumëllojshme, të cilat i shumëfishonin streset e provokuara nga sfidat e kërkimit.

Rrjeta e lidhjeve të shumëfishta shoqërore, miqësore ndërmjet studiuesve kryente funksione të rëndësishme në rrafshin shoqëror dhe politik, shkencor dhe arsimor.

Së pari, përmes lidhjeve shoqërore qarkullonte literaturë e ndaluar ose që vinte me shumë vështirësi, privatisht, ilegalisht ose, së paku, gjysmëilegalisht nga vendet e zhvilluara të Perëndimit. Një literaturë e tillë i ndihmonte albanologët shqiptarë të përditësonin në dinamikë me arritjet më të përparuara të shkencave shoqërore në vendet perëndimore më të urbanizuara.

Së dyti, përgjatë periudhës së regjimit socialist totalitar, lufta e klasave realizohej me baticat dhe zbaticat e veta. Sidomos në vitet më të trazuara të luftës së klasave organet përkatëse partiako-shtetërore shikonin me lente zmadhuese të ashtuquajturat njolla ose kleçka në biografi të artistëve e studiuesve, përgjithësisht të sajuara artificialisht nga regjimit socialist totalitar. Në kohë të tilla më të tensionuara sistemi i lidhjeve miqësore e shoqërore të sinqerta e dashamirëse ndërmjet punonjësve shkencorë shërbente si shqyt i padukshëm, por mjaft i sigurt për punonjësit shkencorë që mbikëqyreshin me dyshime më të rënduara nga organet përkatëse të diktaturës së proletariatit. Pa këtë funksion jetik, të dukshëm dhe të padukshëm të miqësisë së sinqertë, disa prej protagonistëve të këtij libri, do të ishin viktimizuar, nuk do të realizonin veprimtarinë e tyre aq të vyer në shërbim të shkencave albanologjike shqiptare, të kulturës e të popullit shqiptar. Këtë aspekt të jetës së studiuesve autori i këtij libri e njeh shumë mirë sepse ai personalisht, duke u udhëhequr gjithnjë nga morali i shëndoshë tradicional i popullit tonë, ka qenë gjithnjë në krah të njerëzve të ndershëm që me aftësi profesionale dhe përkushtim i shërbenin dhe i shërbejnë atdheut.

I çliruar totalisht nga demonët ngasës për nga karriera politike, prof. dr. Ali Muka i është kundërvënë gjithnjë qëndrimeve politike të skajshme në emër të mbrojtjes së shkencave albanologjike, të mbrojtjes së studiuesve që përballeshin me sfidat e kërkimeve të tilla mjaft të ndërlikuara, por me rëndësi të madhe teorike e praktike, sidomos për përcaktimin e statusit të gjuhës dhe të kulturës shqiptare në ansamblin e gjuhëve dhe të kulturave evropiane dhe me gjerë.

Së treti, gjatë periudhës së regjimit socialist totalitar, si të thuash, ndër punonjësit shkencorë ishin formatuar dy piramida hierarkie vlerash kulturore e shkencore: e para, zyrtare, më e dukshme, e përcaktuar kryesisht nga përkushtimi dhe besnikëria ideopolitike ndaj regjimit socialist totalitar dhe fare pak nga arritjet vetjake në fushën e kërkimit; e dyta, hierarkia reale, më pak e dukshme, por më e qëndrueshme dhe realisht më e vlerësuar, e ngritur vetëm mbi bazën e rezultateve në punën kërkimore-shkencore. Një hierarki e tillë formatohej natyrshëm përmes qarkullimit të respektit të ndërsjellë të punonjësve shkencore në sistemin e lidhjeve miqësore e shoqërore. Kjo hierarki reale e vlerave shkencore ravijëzohej qartë, me profesionalizëm dhe me shumë dashamirësi në faqet e këtij libri.

Së katërti, ky libër i kundërqëndron dhe davarit një mjegull të dendur paragjykimesh për studiuesit veçanërisht për ata më të shquarit, më të zellshmit në vendin tonë. Organet përkatëse partiako-shtetërore përpiqeshin të maskonin ose të mbulonin goditjet që i jepnin herë pas here intelektualëve, veçanërisht artistëve e punonjësve shkencorë, me krijimin dhe përhapjen e paragjykimeve së gjoja ata ishin viktima të pikëpamjeve dhe të qëndrimeve egoiste të smirës dashaligë dhe urrejtjes së ndërsjellë të njëri-tjetrit. Madje, jo rrallë organet partiako-shtetërore që ndëshkonin më rëndë punonjësit shkencorë përpiqeshin ta paraqisnin veten në rolin e avokatit që i mbronte punonjësit shkencorë nga egoizmat perverse të njëri-tjetrit. Në faqet e këtij libri afrohet një tablo krejt tjetër e marrëdhënieve ndërmjet punonjësve shkencorë, marrëdhënie krejt të emancipuara, që karakterizohen nga vlerësime me objektivitet i arritjeve të secilit, nga vlerësimi i korrektësisë në punë, i ndershmërisë profesionale dhe shoqërore, nga gatishmëria për t'u përballuar edhe me forcën imponuese të organeve përkatëse të diktaturës në përpjekjet për të mbrojtur punën krijuese, dinjitetin profesional e njerëzor të kolegut etj., pavarësisht nga bindjet e orientimet politike.

Çdo faqe e këtij libri e përshkon si një ind i dukshëm dhe i padukshëm vlerësimi fisnik për punën kërkimore

DO NOT COPY

në fushat e albanologjisë, vlerësimi njerëzor për ata që kanë realizuar një mundim të tillë. Vetëm burra fisnikë e të realizuar në punën e vetme kërkimore shumëvlerëshe si prof. dr. Ali Muka mund të shkruajnë libra të tillë që pasqyrojnë dhe emetojnë mirësi e fisnikëri. Urojmë që ky libër i një lloji të veçantë të pasohet edhe nga libra të tjerë, të cilët të vënë në piedestalin e merituar punonjësit shkencorë të vendit tonë, që kanë luajtur dhe luajnë rol të rëndësishëm, të pazëvendësueshëm për zhvillimin e mendimit shkencor, për emancipimin e shoqërisë shqiptare në tërësi.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Prof. dr. Ali MUKA

DO NOT COPY

## PIRRO THOMO, *KORÇA-URBANISTIKA DHE ARKITEKTURA*, TIRANË, 2012

## NJË MONOGRAFI QË BART VLERA HISTORIKE E AKTUALE PËR TRASHËGIMINË TONË URBANISTIKO-ARKITEKTONIKE

Kohët e fundit doli në qarkullim monografia *Korça, Urbanistika dhe Arkitektura* e studiuesit të njohur, prof. dr. Pirro Thomos, historian i arkitekturës sonë tradicionale. Ai vjen me këtë libër, të një niveli solid profesional e shkencor, pas një pune të shumëanshme, gjurmuese, përshkrimore-dokumentuese, studimore, restauruese e botuese, që shtrihet, në vështrim kohor, në disa dhjetëvjeçarë, duke filluar që nga vitet '60-të të shekullit të kaluar e duke ardhur deri në ditët tona. Materiali kompleks i mbledhur prej tij, lidhet jo vetëm me *arkitekturën tonë tradicionale* (fshatare e qytetare), por dhe me ndërtimet e kultit në përgjithësi dhe ato kristiane në veçanti. Këtu e quaj me vend të theksoj gjithashtu se, lidhjet e tij me qytetin e Korçës, janë sa të shtrira në kohë, aq edhe komplekse e domethënëse për nga përmbajtja. Mjaft të kujtoj se, për disa vjet me rradhë, ai ka qenë drejtues i Degës së Monumenteve të këtij qyteti, duke u marrë aty edhe me hartimin e projekteve të reastaurimit e konsolidimit të lidhura me objekte konkrete të trashëgimisë ekzistuese, por dhe me zbatimin e këtyre projekteve me nivel të lartë tekniko-profesional e shkencor.

Monografia, përveç aparatit ndihmës e plotësues (të formatit shkencor që kërkon koha), është e organizuar në shtatë kapituj. Kam bindjen se, nuk do ta ekzagjeronja, po të pohoja që secili prej këtyre kapitujve, përbën një 'mini' monografi, duke qenë njëherazi kapitujt që formojnë veprën, vazhdim e plotësim i njëri-tjetrit, nga i pari e deri te i fundit. Këtë realitet e bën akoma më bindës edhe zbërthimi e organizimi i secilit kapitull, në nënçështje, të cilat, të marra së bashku, arrijnë në tridhjet e nëntë të tilla.

Pasi ndalet në *kreun e parë*, në një vështrim gjeografiko-historik për Korçën e rrethinat e saj, në pesë kapituj që pasojnë, autori vë në fokus të analizave e të shqyrtimeve, tiparet urbanistike e arkitektonike të këtij qyteti dhe raporte të tij jo vetëm me qendra të tjera qytetare brenda trojeve shqiptare, por dhe hedh dritë për lidhje e analogji apo ngjashmëri me qendra të tjera qytetare të vendeve e popujve përreth. Ky vështrim me natyrë komplekse analize e shqyrtimi, i ka dhënë mundësi autorit, që të zbulojë e të evidentojë tipare me nota të qarta individualiteti, që bart e materializon Korça, urbanistika dhe arkitektura e saj. Aty del qartë rruga historike e zhvillimit të kësaj qendre qytetare, nga themelimi e deri në ditët tona, me theks zhvillimin urbanistiko-arkitektonik, vështruar pa e shkëputur nga konteksti historik e karakteri ekonomiko-shoqëror. Ky këndvështrim kompleks ka bërë të mundur që të dalin në pah: ngjizja e fizionomisë urbanistiko-arkitektonike e qytetit, cilët qenë faktorët që mundësuan këtë zhvillim, duke na dalë përpara një qytet i ri me fizionomi që dallon qartazi nga qytetet e tjera shqiptare. Autori na bën me dije se Korça, ndonëse nuk hyn në grupin e qyteteve të lashta të këtyre trojeve, i zbulon vlerat e veta shkallë-shkallë, duke nxjerrë në dritë fizionominë e një qyteti të tipit të ri. Mjaft të kujtojmë se në vështrim urbanistik, tipar dallues është struktura e rregullt gjeometrike e lagjeve që formojnë këtë qytet, çka

hedh dritë mbi zbatimin e një kriteri të ri bashkëkohës, siç është *sistemi ortogonal*. Ndërsa në aspektin arkitektonik, thelbësore mbetet përhapja e një tipi të ri banese, që dallohet për një skemë të thjeshtë kompozicionale e për një zgjidhje racionale funksionale.

Një moment tjetër, duke përcjellë mesazhe mjaft domethënëse, e shënon kapitulli i shtatë dhe njëherazi i fundit, me titull : "Zhvillimi i sotëm i Korçës dhe jeta e qytetit të vjetër". Është ky kapitull, do të thosha pa as më të voglën droje, që ia rrit ndjeshëm soliditetin e jetëgjatësinë veprës, duke e bërë atë jo vetëm me domethënie historike për trashëgiminë tonë urbanistiko-arkitektonike, por njëherazi edhe me vlera përherë aktuale. Përmes këtij kapitulli, i cili nuk mund të përfytyrohet pa pasur në konsideratë ata paraprirës, brezat e sotëm dhe ata që do të vijnë në vazhdimësi natyrore të tyre, do të kenë mundësi të ushqejnë *kujtesën*. Duke iu kundërvënë *harresës*, që do ta quaja *ogurzezë*, pa as më të voglin hezitim.

Për sa më sipër, i bindur në mirëkuptim, do të theksoja se, vepra që kemi në dorë, dëshmon në mënyrë mjaft bindëse se, cilido popull dhe cilado trashëgimi e vyer e secilit prej tyre, mbetet pjesë e dukurive të sotme e të nesërme me natyrë globaliste. Ç'ka do të thotë se nuk mund të flitet për injorim vlerash apo rrafshim të tyre, por për bashkëjetesë. Mund të flitet për UNITET në DIVERSITET. Shkurt, respektim të vlerave e të trashëgimisë pozitive të secilit popull a etni, duke i kundruar ato si pasuri universale të njerëzimit mbarë.

Pa u ndalur më gjatë, desha të theksoj në mbyllje se autori ka botuar para jo pak vitesh (mbi dy dekada më parë), edhe një libër tjetër për Korçën, me të njëjtin titull, sikurse dhe ky që kemi në dorë. Ndonëse ruhen të paprekura përfundime të arritura në atë botim edhe në librin që kemi në dorë, ky i riu qëndron shumë më lartë se ai (duke qenë edhe thjesht si vëllim sa dyfishi i tij), ku, jo vetëm janë shmangur mangësi të botimit të parë, por dhe është sjellë një analizë më e gjerë dhe me një përmbajtje të re, cilësore e teknike-profesionale, materiali grafik dhe fotografik, duke ia rritur dukshëm vlerat dokumentare librit. Aq më tepër që, siç na bë me dije nga autori, jo pak shembuj banesash e kompleksesh banimi janë dëmtuar këto dy-tre dekadat e fundit, kryesisht nga mungesa e ndërhyrjeve restauruese.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

# RREGULLORE

## PËR MBROJTJEN, KONSERVIMIN E INTEGRUAR DHE ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE DHE ZONËS SË MBROJTUR NË QYTETIN E GJIROKASTRËS

### Neni 1
### Qëllimi dhe objektivat

Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar, dhe administrimin e vlerave historiko - kulturore dhe vlerave të peizazhit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Gjirokastrës.

Për vlerat e rëndësishme historiko-kulturore, Gjirokastra historike, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 172, dt. 02.06.1961, është shpallur "**qytet - muze**" dhe vënë në mbrojtje shtetërore.

Për vlerat e pakrahasueshme universale Qendra Historike e Gjirokastrës është shpallur Pasuri Botërore në vitin 2005 në bazë të kritereve (iii) dhe (iv)[1], dhe është zgjeruar në vitin 2008 duke përfshirë edhe Qendrën Historike të Beratit cilësuar të dyja "pasuri në seri" si shembuj të rrallë të arkitekturës tipike të periudhës osmane (shek. XVI-XX).

Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë :

1. Mbrojtja, konservimi, mirëmbajtja dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të qendrës historike të Gjirokastrës
2. Administrimi i Qendrës Historike të Gjirokastrës sipas zonifikimit të paraqitur në hartën që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje si pjesë integrale e saj.
3. Mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Gjirokastrës për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe të peizazhit të qendrës historike të Gjirokastrës.

### Neni 2

Kjo rregullore është në përputhje dhe i nënshtrohet:

Kushtetutës së Shqipërisë, Ligjit Nr.9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore" i ndryshuar me ligjin Nr.9882 datë 28.02.2008 dhe ligjit Nr.9386, datë 04.05.2005 "Për Muzetë", "Kartës Shqiptare të Restaurimit" miratuar me VKM 426, dt. 13.07.2007, marrëveshjeve dhe kartave ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor të ratifikuara sipas legjislacionit shqiptar.

---

[1] Për t'u përfshirë në Listën e Pasurive Botërore sitet duhet të paraqesin vlera të pakrahasueshme universale dhe të përmbushin të paktën një nga kriteret e përzgjedhjes. Kriteri (iii) – Dëshmi unike apo e jashtëzakonshme e një tradite kulturore apo qytetërimi akoma të gjallë apo që është zhdukur. Kriteri (iv) – Shembull i veçantë i një tipi ndërtimi apo ansambli arkitektonik apo teknologjik që është tregues një (disa) faze (ave) të rëndësishme në historinë e njerëzimit.

**Neni 3**
**Hapësira urbane në mbrojtje**

Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Gjirokastrës përbëhet nga :

1. Qendra historike
2. Zona e mbrojtur

Brenda këtyre zonave përfshihen Ansamble historike, Zona të gjelbëra, Monumente të kategorisë së parë dhe Monumente të kategorisë së dytë.

Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Gjirokastrës detyrimisht duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së zonifikimit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur.

**Neni 4**
**Qendra Historike dhe kufijtë e saj**

Qendra Historike është pjesa më me vlera urbanistiko - arkitektonike e qytetit të Gjirokastrës. Ajo ruan gjini të ndryshme ndërtimore si ndërtime mbrojtëse, ndërtime shoqërore, kulti dhe banesa popullore. Këto ndërtime janë të lidhura me peizazhin urbanistiko / arkitektonik historik tradicional i cili është pjesë e Qendrës Historike.

Qendra Historike përbëhet nga Kalaja , Ansambli i Pazarit të qytetit, pjesë të lagjeve: "Pazar i Vjetër", "Pllakë", "Hazmurat", "Teqe", "Varosh", "Meçite", "Palorto", "Dunavat i I-të", "Dunavat i II-të", "Manalat" dhe "Cfakë", dhe zonat e gjelbëra të përfshira brenda tyre.

Kufijtë e Qendrës Historike janë:

| | GJATËSI | | | GJERËSI | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **pika** | **gradë** | **minuta** | **sekonda** | **gradë** | **minuta** | **sekonda** |
| **1** | 20 | 8 | 0.05 | 40 | 4 | 29.61 |
| **2** | 20 | 8 | 1.22 | 40 | 4 | 30.1 |
| **3** | 20 | 7 | 59.42 | 40 | 4 | 31.19 |
| **4** | 20 | 7 | 58.19 | 40 | 4 | 31.83 |
| **5** | 20 | 7 | 58.57 | 40 | 4 | 32.17 |
| **6** | 20 | 7 | 57.93 | 40 | 4 | 32.67 |
| **7** | 20 | 7 | 58.09 | 40 | 4 | 33.38 |
| **8** | 20 | 8 | 1.43 | 40 | 4 | 35.41 |
| **9** | 20 | 8 | 2.94 | 40 | 4 | 36.67 |
| **10** | 20 | 8 | 6.99 | 40 | 4 | 35.14 |
| **11** | 20 | 8 | 8.98 | 40 | 4 | 34.52 |
| **12** | 20 | 8 | 9.4 | 40 | 4 | 35.05 |
| **13** | 20 | 8 | 10.15 | 40 | 4 | 35.18 |
| **14** | 20 | 8 | 10.68 | 40 | 4 | 35.17 |
| **15** | 20 | 8 | 11.27 | 40 | 4 | 34.97 |
| **16** | 20 | 8 | 12.49 | 40 | 4 | 35.96 |

DO NOT COPY

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **17** | 20 | 8 | 13.54 | 40 | 4 | 36.67 |
| **18** | 20 | 8 | 14.63 | 40 | 4 | 36.9 |
| **19** | 20 | 8 | 14.13 | 40 | 4 | 38.63 |
| **20** | 20 | 8 | 14.88 | 40 | 4 | 38.69 |
| **21** | 20 | 8 | 16.7 | 40 | 4 | 41.14 |
| **22** | 20 | 8 | 17.68 | 40 | 4 | 41.38 |
| **23** | 20 | 8 | 19.06 | 40 | 4 | 40.03 |
| **24** | 20 | 8 | 20.96 | 40 | 4 | 39.74 |
| **25** | 20 | 8 | 22.65 | 40 | 4 | 39.44 |
| **26** | 20 | 8 | 22.99 | 40 | 4 | 38.88 |
| **27** | 20 | 8 | 23.6 | 40 | 4 | 38.99 |
| **28** | 20 | 8 | 25.11 | 40 | 4 | 41.44 |
| **29** | 20 | 8 | 27.29 | 40 | 4 | 41.47 |
| **30** | 20 | 8 | 27.49 | 40 | 4 | 42.56 |
| **31** | 20 | 8 | 31.63 | 40 | 4 | 44.86 |
| **32** | 20 | 8 | 32.22 | 40 | 4 | 45.42 |
| **33** | 20 | 8 | 35.79 | 40 | 4 | 48.07 |
| **34** | 20 | 8 | 36.91 | 40 | 4 | 47.86 |
| **35** | 20 | 8 | 37.53 | 40 | 4 | 47.1 |
| **36** | 20 | 8 | 37.96 | 40 | 4 | 46.09 |
| **37** | 20 | 8 | 37.35 | 40 | 4 | 45.72 |
| **38** | 20 | 8 | 36.37 | 40 | 4 | 45.54 |
| **39** | 20 | 8 | 35.24 | 40 | 4 | 43.56 |
| **40** | 20 | 8 | 30.62 | 40 | 4 | 39.05 |
| **41** | 20 | 8 | 27.5 | 40 | 4 | 35.02 |
| **42** | 20 | 8 | 30.81 | 40 | 4 | 35.21 |
| **43** | 20 | 8 | 31.67 | 40 | 4 | 33.9 |
| **44** | 20 | 8 | 33.05 | 40 | 4 | 32.15 |
| **45** | 20 | 8 | 37.29 | 40 | 4 | 35 |
| **46** | 20 | 8 | 42.09 | 40 | 4 | 38.75 |
| **47** | 20 | 8 | 44.43 | 40 | 4 | 39.73 |
| **48** | 20 | 8 | 45.6 | 40 | 4 | 39.05 |
| **49** | 20 | 8 | 46.07 | 40 | 4 | 38.34 |
| **50** | 20 | 8 | 45.79 | 40 | 4 | 37.83 |
| **51** | 20 | 8 | 43.44 | 40 | 4 | 36.09 |
| **52** | 20 | 8 | 44.19 | 40 | 4 | 35.09 |
| **53** | 20 | 8 | 41.98 | 40 | 4 | 33.79 |
| **54** | 20 | 8 | 41.88 | 40 | 4 | 28.9 |

DO NOT COPY

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **55** | 20 | 8 | 41.96 | 40 | 4 | 28.24 |
| **56** | 20 | 8 | 41.04 | 40 | 4 | 27.09 |
| **57** | 20 | 8 | 39.94 | 40 | 4 | 26.02 |
| **58** | 20 | 8 | 41.96 | 40 | 4 | 25.57 |
| **59** | 20 | 8 | 44 | 40 | 4 | 24.55 |
| **60** | 20 | 8 | 42.97 | 40 | 4 | 23.23 |
| **61** | 20 | 8 | 43.33 | 40 | 4 | 22.66 |
| **62** | 20 | 8 | 41.73 | 40 | 4 | 22.08 |
| **63** | 20 | 8 | 40.96 | 40 | 4 | 22.23 |
| **64** | 20 | 8 | 39.65 | 40 | 4 | 21.67 |
| **65** | 20 | 8 | 38.86 | 40 | 4 | 20.36 |
| **66** | 20 | 8 | 31.66 | 40 | 4 | 17.97 |
| **67** | 20 | 8 | 31.23 | 40 | 4 | 17.55 |
| **68** | 20 | 8 | 27.27 | 40 | 4 | 16.16 |
| **69** | 20 | 8 | 25.46 | 40 | 4 | 14.93 |
| **70** | 20 | 8 | 25.03 | 40 | 4 | 13.96 |
| **71** | 20 | 8 | 23.46 | 40 | 4 | 14.57 |
| **72** | 20 | 8 | 20.82 | 40 | 4 | 13.1 |
| **73** | 20 | 8 | 20.58 | 40 | 4 | 10.52 |
| **74** | 20 | 8 | 18.72 | 40 | 4 | 9.17 |
| **75** | 20 | 8 | 17.69 | 40 | 4 | 9.87 |
| **76** | 20 | 8 | 11.34 | 40 | 4 | 9.61 |
| **77** | 20 | 8 | 7.91 | 40 | 4 | 9.9 |
| **78** | 20 | 8 | 6.28 | 40 | 4 | 12.06 |
| **79** | 20 | 8 | 4.84 | 40 | 4 | 12.94 |
| **80** | 20 | 8 | 4.58 | 40 | 4 | 13.79 |
| **81** | 20 | 8 | 3.13 | 40 | 4 | 15.09 |
| **82** | 20 | 8 | 2.3 | 40 | 4 | 15.04 |
| **83** | 20 | 8 | 2.03 | 40 | 4 | 15.53 |
| **84** | 20 | 8 | 0.88 | 40 | 4 | 16.67 |
| **85** | 20 | 8 | 4.78 | 40 | 4 | 16.83 |
| **86** | 20 | 8 | 8.51 | 40 | 4 | 17.36 |
| **87** | 20 | 8 | 8.19 | 40 | 4 | 18.46 |
| **88** | 20 | 8 | 6.71 | 40 | 4 | 18.75 |
| **89** | 20 | 8 | 6.31 | 40 | 4 | 21.96 |
| **90** | 20 | 8 | 6.86 | 40 | 4 | 24.37 |
| **91** | 20 | 8 | 5.03 | 40 | 4 | 25.11 |
| **92** | 20 | 8 | 5.95 | 40 | 4 | 26.77 |
| **93** | 20 | 8 | 0.88 | 40 | 4 | 28.73 |
| **100** | 20 | 8 | 0.05 | 40 | 4 | 29.61 |

DO NOT COPY

Koordinatat gjeografike janë marrë me aparat GPS referuar WGS 84 / UTM 34N. Kufijtë e Qendrës Historike me koordinatat gjeografike përkatëse paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Gjirokastrës, e cila është pjesë përbërëse e pandarë e kësaj rregulloreje.

**Neni 5**
**Ndërhyrjet e lejuara në Qendrën Historike**

Në Qendrën historike nuk lejohen ndërtimet e reja. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko - arkitektonike dhe të peizazhit të Qendrës Historike, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

1. Ndërhyrje sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes sipas parimeve të konservimit të integruar.
2. Ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore dhe të peizazhit kulturor duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve dhe bimësisë tradicionale.
3. **Konservimi i rrënojave** të ndërtimeve me konture të qarta murature, në hapësirën e Qendrës Historike, për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre. **Kur rrënojat ruhen në lartësi mbi 3m dhe** cënojnë dukshëm njësinë e Ansambleve, brenda të cilëve përfshihen, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin vëllim, mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetralë) me objektiv primar ruajtjen sa të jetë e mundur të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale të ndërtimit.
4. Në raste fatkeqësish natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, **rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese**, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, me objektiv primar ruajtjen sa të jetë e mundur të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik dhe grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik si dhe teknikën tradicionale.
5. Ndalohen ndërtimet e reja në Qendrën Historike me përjashtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore, rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikat më sipër.

**Neni 6**
**Zona e mbrojtur dhe kufijtë e saj**

Zona e Mbrojtur shtrihet përreth Qendrës Historike. Ajo me vlerën e saj historiko-kulturore, plotëson, pasuron dhe mbron vlerat e Qendrës Historike. Zona e mbrojtur ruhet në mbarë përbërësit urbanistikë, arkitektonikë dhe vlerat e peizazhit.

Si pjesë e rëndësishme e peisazhit historik të qytetit, në zonën e mbrojtur përfshihen hapësirat e gjelbërta të lagjeve sipas hartës së zonifikimit me koordinatat përkatëse e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Kufijtë e Zonës së Mbrojtur janë:

| | GJATËSI | | | GJERËSI | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **gradë** | **minuta** | **sekonda** | **gradë** | **minuta** | **sekonda** |
| **1** | 20 | 7 | 50.04 | 40 | 4 | 11.66 |
| **2** | 20 | 7 | 50.23 | 40 | 4 | 12.77 |
| **3** | 20 | 7 | 50.26 | 40 | 4 | 14.28 |
| **4** | 20 | 7 | 50.61 | 40 | 4 | 14.61 |

DO NOT COPY

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **5** | 20 | 7 | 53.26 | 40 | 4 | 16.31 |
| **6** | 20 | 7 | 55.12 | 40 | 4 | 15.68 |
| **7** | 20 | 7 | 56.38 | 40 | 4 | 15.77 |
| **8** | 20 | 8 | 0.23 | 40 | 4 | 15.68 |
| **9** | 20 | 8 | 1.12 | 40 | 4 | 18.1 |
| **10** | 20 | 7 | 59.39 | 40 | 4 | 22.27 |
| **11** | 20 | 7 | 55.78 | 40 | 4 | 25.64 |
| **12** | 20 | 7 | 50.44 | 40 | 4 | 29.72 |
| **13** | 20 | 7 | 50.6 | 40 | 4 | 30.32 |
| **14** | 20 | 7 | 52.85 | 40 | 4 | 32.11 |
| **15** | 20 | 7 | 52.76 | 40 | 4 | 33.05 |
| **16** | 20 | 7 | 53.28 | 40 | 4 | 33.58 |
| **17** | 20 | 7 | 52.74 | 40 | 4 | 33.5 |
| **18** | 20 | 7 | 51.61 | 40 | 4 | 36.42 |
| **19** | 20 | 7 | 50.39 | 40 | 4 | 37.8 |
| **20** | 20 | 7 | 51.41 | 40 | 4 | 38.61 |
| **21** | 20 | 7 | 51.? | 40 | 4 | 39.87 |
| **22** | 20 | 7 | 54.12 | 40 | 4 | 41.6 |
| **23** | 20 | 7 | 55.23 | 40 | 4 | 41.65 |
| **24** | 20 | 7 | 55.77 | 40 | 4 | 43.58 |
| **25** | 20 | 7 | 59.46 | 40 | 4 | 44.63 |
| **26** | 20 | 8 | 2.09 | 40 | 4 | 44.3 |
| **27** | 20 | 8 | 3.95 | 40 | 4 | 43.67 |
| **28** | 20 | 8 | 6.47 | 40 | 4 | 43.75 |
| **29** | 20 | 8 | 8.93 | 40 | 4 | 43.09 |
| **30** | 20 | 8 | 10.07 | 40 | 4 | 40.66 |
| **31** | 20 | 8 | 12.65 | 40 | 4 | 41.72 |
| **32** | 20 | 8 | 15.01 | 40 | 4 | 41.37 |
| **33** | 20 | 8 | 16.44 | 40 | 4 | 43.31 |
| **34** | 20 | 8 | 18.04 | 40 | 4 | 42.8 |
| **35** | 20 | 8 | 18.84 | 40 | 4 | 42.59 |
| **36** | 20 | 8 | 20.57 | 40 | 4 | 40.75 |
| **37** | 20 | 8 | 23.2 | 40 | 4 | 41.68 |
| **38** | 20 | 8 | 24.2 | 40 | 4 | 41.09 |
| **39** | 20 | 8 | 29.68 | 40 | 4 | 45.46 |
| **40** | 20 | 8 | 33.35 | 40 | 4 | 46.47 |
| **41** | 20 | 8 | 38.94 | 40 | 4 | 50.08 |
| **42** | 20 | 8 | 42.65 | 40 | 4 | 48.8 |

DO NOT COPY

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **43** | 20 | 8 | 41.15 | 40 | 4 | 46.8 |
| **44** | 20 | 8 | 40.17 | 40 | 4 | 47.03 |
| **45** | 20 | 8 | 39.39 | 40 | 4 | 45.78 |
| **46** | 20 | 8 | 39.73 | 40 | 4 | 44.9 |
| **47** | 20 | 8 | 39.26 | 40 | 4 | 44.18 |
| **48** | 20 | 8 | 40.77 | 40 | 4 | 42.49 |
| **49** | 20 | 8 | 41.53 | 40 | 4 | 41.44 |
| **50** | 20 | 8 | 54.62 | 40 | 4 | 41.55 |
| **51** | 20 | 8 | 47.08 | 40 | 4 | 40.85 |
| **52** | 20 | 8 | 48.02 | 40 | 4 | 38.87 |
| **53** | 20 | 8 | 47.62 | 40 | 4 | 33.23 |
| **54** | 20 | 8 | 49.99 | 40 | 4 | 32.65 |
| **55** | 20 | 8 | 51.58 | 40 | 4 | 33.17 |
| **56** | 20 | 8 | 52.26 | 40 | 4 | 33.02 |
| **57** | 20 | 8 | 52.8 | 40 | 4 | 32.48 |
| **58** | 20 | 8 | 53.19 | 40 | 4 | 31.72 |
| **59** | 20 | 8 | 53.5 | 40 | 4 | 31.8 |
| **60** | 20 | 8 | 53.06 | 40 | 4 | 27.83 |
| **61** | 20 | 8 | 52.89 | 40 | 4 | 24.8 |
| **62** | 20 | 8 | 50.74 | 40 | 4 | 22.38 |
| **63** | 20 | 8 | 49.4 | 40 | 4 | 22.43 |
| **64** | 20 | 8 | 49.49 | 40 | 4 | 20.96 |
| **65** | 20 | 8 | 47.91 | 40 | 4 | 18.86 |
| **66** | 20 | 8 | 44.9 | 40 | 4 | 17.01 |
| **67** | 20 | 8 | 37.31 | 40 | 4 | 17.12 |
| **68** | 20 | 8 | 36.5 | 40 | 4 | 14.27 |
| **69** | 20 | 8 | 36.46 | 40 | 4 | 9.85 |
| **70** | 20 | 8 | 32.39 | 40 | 4 | 8.38 |
| **71** | 20 | 8 | 32.99 | 40 | 4 | 6.39 |
| **72** | 20 | 8 | 37.87 | 40 | 4 | 3.02 |
| **73** | 20 | 8 | 32.14 | 40 | 4 | 0.15 |
| **74** | 20 | 8 | 22.49 | 40 | 3 | 58.51 |
| **75** | 20 | 8 | 5.8 | 40 | 3 | 57.5 |
| **76** | 20 | 8 | 0.21 | 40 | 3 | 59.18 |
| **77** | 20 | 7 | 59.12 | 40 | 4 | 0.13 |
| **78** | 20 | 7 | 59.06 | 40 | 4 | 0.61 |
| **79** | 20 | 7 | 58.06 | 40 | 4 | 1.11 |
| **80** | 20 | 7 | 57.87 | 40 | 4 | 2.29 |
| **81** | 20 | 8 | 2.92 | 40 | 4 | 5.91 |
| **82** | 20 | 7 | 56.58 | 40 | 4 | 9.18 |
| **83** | 20 | 7 | 51.19 | 40 | 4 | 11.26 |
| **84** | 20 | 7 | 50.04 | 40 | 4 | 11.66 |

DO NOT COPY

Koordinatat gjeografike janë marrë me aparat GPS referuar WGS 84 / UTM 34N. Kufijtë e zonës së mbrojtur me koordinatat gjeografike përkatëse paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Gjirokastrës, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Zona e Mbrojtur ndahet në dy nënzona sipas hartës së zonifikimit pjesë e kësaj rregulloreje.
**Nënzona I – Zona të ndërtuara**
**Nënzona II – Zona të gjelbëra**

**Nënzona I**, shtrihet në:
**a)** Pjesë të lagjeve "Cfakë", "Manalat", "Dunavat"
**b)** Pjesë të lagjeve "Palorto", "Varosh"
**c)** Pjesë të lagjeve "11 Janari", "Hazmurat"
**d)** Pjesë e lagjes së Punëtorëve

**Nënzona II**, shtrihet në:
**a)** Pjesë e lagjes "Cfakë"
**b)** Pjesë e lagjes "Partizani"
**c)** Pjesë e lagjes "11 Janari"
**d)** Pjesë e lagjes "11 Janari"

**Neni 7**
**Ndërhyrjet e lejuara në zonën e mbrojtur**

Nënzonat brenda Zonës së Mbrojtur do t'u nënshtrohen masave të ndryshme mbrojtëse specifike për secilën, duke u bazuar në karakteristikat dhe gjendjen egzistuese të secilës zonë.

Ndërhyrjet e lejuara në Nënzonën I (a,b c d):
Në këtë nënzonë përfshihen objekte me status "Monument Kulture" në të cilat lejohen ndërhyrjet e mëposhtme:
1. Ndërtesat me status "Monument Kulture" që ndodhen brenda kësaj zone, i nënshtrohen vetëm ndërhyrjeve të mirëmbajtjes, konservimit dhe restaurimit.
2. Konservimi i rrënojave të ndërtimeve me konture të qarta murature, në hapësirën e Zonës së mbrojtur, për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre. Kur rrënojat ruhen në lartësi mbi 3m dhe cënojnë dukshëm njësinë e Ansambleve brenda të cilëve përfshihen, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin vëllim, mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetralë) me objektiv primar ruajtjen sa të jetë e mundur të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale të ndërtimit.
3. Në raste fatkeqësish natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, me objektiv primar ruajtjen sa të jetë e mundur të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik dhe grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik si dhe teknikën tradicionale.

Brenda kësaj zone lejohen të bëhen ndërtime të reja ose rikonstruksione të ndërtesave ekzistuese. Këto ndërtime do të kenë kufizime në lartësi, vëllim etj., duke respektuar kushtet e mëposhtme:

DO NOT COPY

1. Lejohet të bëhen ndërtime të reja në sheshe bosh të përcaktuara si të tilla në hartën kadastrale.
2. Raporti i pjesëve të mbuluara (ku perfshihen strehët mbi dyer etj.) me sipërfaqen e sheshit të ndërtimit nuk duhet të kalojë 30 %.
3. Lejohen shtesa volumesh deri në 10 % të sipërfaqes së ndërtimit egzistues. Leja për shtesë vëllimi jepet vetëm një herë.
4. Numri i kateve duhet të jetë i njëjtë me mesataren e kateve të ndërtesave përreth, por sidoqoftë jo më shumë se 3 (tre) – 10m deri në kornizën e çatisë, lartësi maksimale e godinës.
5. Distanca minimale midis ndërtesave duhet të respektojë legjislacionin për planifikimin urban por jo më pak se 10 metra.
6. Kompozimi planimetrik dhe plan vendosja në sheshin e ndërtimit duhet të respektojë tipologjinë e ndërtimeve në atë zonë si dhe të jetë i bazuar në një studim të ngushtë për tipologjinë e ndërtimeve tradicionale.
7. Karakteristikat ndërtimore duhet të jenë të tilla që të mos krijojnë kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik tradicional.
8. Nuk lejohen ndërtimi i objekteve me karakter industrial me përjashtim të punishteve të artizanatit.
9. Elementët arkitektonikë të mbulesave, fasadave, rifiniturave, mureve rrethues dhe portave si dhe ngjyrat duhet të jenë në harmoni me elementët morfologjikë të arkitekturës tradicionale. Pjerrësia e çative të jetë 26º - 31º.
   Ndërhyrjet e lejuara në rrugët dhe sheshet e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur pasqyrohen në **Nenin 8** të kësaj rregulloreje.
   Ndërhyrjet e lejuara në zonat e gjelbëruara brenda Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur pasqyrohen në **Nenin 9** të kësaj rregulloreje.

## Neni 8
## Rrugët dhe sheshet në Qendrën Historike dhe Zonën e Mbrojtur

Rrugët dhe sheshet e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur ruhen në formulimin kompozicional urbanistiko / arkitektonik si pjesë organike të këtyre zonave.

**Në Qendrën Historike:**

Ndërhyrjet restauruese në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale. Lejohen ndërhyrje për përmirësimin ose realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, duke hequr elementë origjinalë të rrugëve me kalldrëm dhe duke i rivendosur të njëjtët elementë në të njëjtin pozicion, formë dhe orientim sipas teknikës tradicionale. Projektet për këto ndërhyrje miratohen në KKR.

**Në Zonën e Mbrojtur:**

Ndërhyrjet restauruese në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale.

Lejohet rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe shesheve për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës apo për përmirësimin ose realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore duke përdorur materiale, forma dhe teknika tradicionale. Projektet për këto ndërhyrje miratohen në KKR.

Lejohen ndërhyrje të mobilimit urban me vendosje mbi rrugë të stolave, ndriçuesve, koshave, vazove me lule ose elementëve të tjerë të mobilimit urban, me kusht që të jenë pjesë e një projekti rikualifikimi të zonës, që parashikon vendosjen e elementëve në harmoni me tipologjinë dhe vlerat tradicionale.

Lejohen ndërhyrje për modifikimin e gjurmës rrugore e lidhur me nevojat për funksionim dhe perdorim sa më të mirë të zonës brenda së cilës rruga ndodhet.

Në rastet kur gjurma e rrugës në të cilën ndërhyet, shtrihet në disa zona, ndërhyrja i nënshtrohet kritereve të zonës me mbrojtje më të lartë.

DO NOT COPY

**Neni 9**
**Zonat e gjelbëra brenda Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur**

Këto zona janë pjesë përbërëse e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur, kanë destinacion publik dhe janë elementë që i shërbejnë pamjeve panoramike të Qendrës Historike. Hapësirat ekzistuese të gjelbëra ruhen si të tilla.

Në këto zona lejohen ndërhyrje për rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara ekzistuese nëpërmjet të cilave mund të realizohen parqe urbane. Në këto zona lejohet mbjellja e pemëve, punimet sistemuese, rregulluese dhe realizimet e rrugicave të brendshme me karakteristika të njëjta si të kalldrëmeve origjinale të Qendrës Historike, të cilat do të përdoren vetëm për këmbësorë.

Në këto zona janë të ndaluara ndërtimet me përjashtim të strukturave të vogla me elementë drusorë të çmontueshme, që nuk duhet të kalojnë një kat – 3.5 m, elementëve të arredimit urban ose ato të shërbimit. Projektet për rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara hartohen nga Bashkia Gjirokastër ose nga subjekte të licensuara për këtë kategori punimesh.

Drurët dhe gjelbërimi tradicional i rrugëve dhe shesheve ruhen dhe pas degradimit ripërtërihen me të njëjtët lloje.

**Neni 10**
**Ndarja e monumenteve sipas kategorive**

Monumentet e kulturës në qytetin e Gjirokastrës, sipas vlerës së tyre historiko - kulturore, ndahen në dy kategori, monumente të kategorisë së parë dhe monumente të kategorisë së dytë. Kjo ndarje sipas vlerave, pasqyrohet në shkallën e ruajtjes së tyre si dhe në mënyrat dhe shkallën e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese.

**Neni 11**
**Monumentet e kategorisë së parë**

Monumentet e kategorisë së parë, janë ndërtimet me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitektonike. Monumentet e kategorisë së parë, me shkallë të mirë autenticiteti, ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitektonikë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrethues, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse, janë pjesë organike e monumentit dhe si të tillë i nënshtrohen të njëjtit trajtim.

Monumentet e kategorisë së parë ruhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur dhe në pjesën tjetër të qytetit.

Në monumentet e kategorisë së parë kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike dhe funksionale, nuk mund të ndryshohet, me përjashtim të vendosjes së nyjes higjeno-sanitare kur është e domosdoshme dhe nuk cënon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje monumenti.

Deri në shpalljen e zonës mbrojtëse të monumenteve të kategorisë së parë që ndodhen në Zonën e Mbrojtur apo në pjesën tjetër të qytetit, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me nenin 32 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore“ i ndryshuar, për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, nuk lejohen ndërtime të reja në distancë jo më pak se 50 m larg nga muret rrethues nëse ka apo nga muret e objektit.

Trajtimi i objekteve ekzistuese brenda kësaj rrezeje, të shqyrtohet nga Komisioni i administrimit të Qendrës Historike i cili ia përcjell KKR dhe pushtetit vendor rast pas rasti.

**Neni 12**
**Monumente të kategorisë së dytë**

Monumentet e kategorisë së dytë, janë ndërtimet me vlera historiko- kulturore, kryesisht si bashkëformuese ansamblesh urbanistiko- arkitekturore, por edhe si vepra të veçanta.

DO NOT COPY

Monumentet e kategorisë së dytë, ruhen në volumet e tyre dhe trajtimin e tyre arkitektonik të pamjes së jashtme, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale. Oborri, muret rrethues, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse, janë pjesë organike e monumentit dhe si të tillë i nënshtrohen të njëjtit trajtim. Kur brenda këtyre monumenteve, sidomos në objektet e banimit, ruhen ambiente karakteristike, si dhe gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale, mobilje arkitektonike me vlerë, ose elementë konstruktivë me vlera të veçanta këto specifikohen në aktin e shpalljes dhe ruhen në vendin ku janë.

Në brendësi të monumenteve të kategorisë së dytë, lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimin e teknikave bashkëkohore, pa cënuar integritetin strukturor dhe formulimin e pamjes së jashtme.

DO NOT COPY

**Neni 13**
**Objektet pa status si pjesë e ansambleve arkitektonike të qendrës historike**

Brenda territorit të Qendrës Historike ka objekte pa status mbrojtjeje të cilat nuk kanë kanë vlera për të marrë statusin "Monument" por janë pjesë e ansambleve arkitektonike të Qendrës Historike.

Në rastin kur këto objekte me volumet dhe formulimin e tyre arkitektonik, dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të Qendrës Historike trajtohen nëpërmjet studimesh rehabilitimi ku mund të parashikohen përshtatje në harmoni me ansamblin arkitektonik ku bëjnë pjesë.

Në rastin kur këto objekte nuk dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të Qendrës Historike, ato ruhen në volumet ekzistuese dhe mund të trajtohen në pamjen e tyre të jashtme në harmoni me ansamblin arkitektonik ku bëjnë pjesë. Përsa i perket karakteristikave tipologjiko – arkitektonike, fasadave, rifiniturave, detajeve konstruktive, mbulesave, mureve rrethues dhe portave ato duhet të jenë konform me kontekstin historik dhe në harmoni me elementët morfologjikë të arkitekturës tradicionale.

**Neni 14**
**Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Qendrën Historike dhe monumente të veçanta**

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës brenda Qendrës Historike dhe monumenteve të veçanta që ndodhen në Zonën e Mbrojtur dhe pjesën tjetër të qytetit, bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të liçensuara për këtë qëllim.
   - Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.
2. Zbatimi i punimeve të restaurimit kryhet prej DRKK-ve ose prej subjekteve të liçencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervizorit dhe kolaudatorit, caktuar prej IMK. Për monumentet e kulturës pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve dhe përshtatjeve të përmendura në pikat 3, 4, 5, të nenit 5, ku perfshihen:
   - Ndërhyrje sistematike konservuese, restauruese
   - Ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore dhe të peizazhit kulturor
   - Konservimi i rrënojave
   - Rikonstruksioni mbi strukturat ekzistuese në raste fatkeqësish natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK - Gjirokastër) ose nga subjekte të liçensuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen në fazën projekt ide në Komitetin e Administrimit të Qendrës Historike i cili ia përcjell për shqyrtim Këshillit Shkencor të IMK dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

4. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit për projektet e përmendura në pikën 3 të këtij neni kryhet prej subjekteve të liçensuar në fushën e restaurimeve nën mbikëqyrjen e supervizorit dhe kolaudatorit, caktuar prej IMK dhe investitorit.
5. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Bashkia e Gjirokastrës ose nga subjekte të liçensuar në fushën restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve**.** Projektet hartohen në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK), Gjirokastër. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.
6. Zbatimi i punimeve për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik kryhet prej DRKK-ve ose prej subjekteve të liçencuara për restaurim, dhe të licensuara në këtë kategori punimesh në fushën e ndërtimit, nën mbikëqyrjen e supervizorit dhe kolaudatorit, caktuar prej IMK dhe investitorit.

**Neni 15**
**Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Zonën e Mbrojtur**

1. Studimet për rehabilitimin e Zonës së Mbrojtur hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK) në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastër, ose subjekte të licencuar në fushën e projektimit për këtë kategori Projektet shqyrtohen në Komitetin e Administrimit të Qendrës historike i cili ia përcjell për shqyrtim Këshillit Shkencor të IMK dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.
2. Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë, hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të liçensuar në projektim për kategorinë e mësipërme për fushën e ndërtimit. Këto projekte duhet të mbështeten në studimet për rehabilitimin e imazhit të zonës së mbrojtur sipas pikës 1 të këtij neni. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit
3. Projektet për ndërtimet e reja në këtë zonë, hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të liçensuar në projektim për fushën e ndërtimit. Projektet hartohen me konsultën e DRKK-së Gjirokastër, apo subjekteve të liçensuar për projektim në fushën e restaurimit. Projektet shqyrtohen në fazën e projekt idesë në Komitetin e Administrimit të Qendrës Historike i cili ia përcjell për shqyrtim Këshillit Shkencor të IMK dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.
4. Zbatimi i punimeve dhe mbikëqyrja për ndërtimet e reja pas miratimit të projekteve të specifikuara në pikën 3 të këtij neni kryhet nga subjekte të liçensuar për këtë kategori punimesh në fushën e ndërtimit.
5. Projektet e rikonstruksionit të rrugëve, shesheve dhe infrastrukturës së tyre të përmendura në nenin 8 hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të liçensuar në projektim për kategorinë përkatëse në fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.
6. Në rastet kur kemi ndërhyrje restauruese në infrastrukturën tradicionale, që ruhet brenda kësaj zone, projektet hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK) ose nga subjekte të liçensuar në fushën e restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.
7. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit në infrastrukturë kryhet prej subjekteve ndërtimore që janë të licencuar për këtë kategori punimesh në fushën e ndërtimit. nën mbikëqyrjen e supervizorëve dhe kolaudatorit, caktuar prej IMK dhe investitorit.
8. Zbatimi i punimeve për restaurim në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik kryhet prej subjekteve të liçencuara për restaurim, dhe të licensuara në këtë kategori punimesh në fushën e ndërtimit, nën mbikëqyrjen e supervizorit dhe kolaudatorit, caktuar prej IMK dhe investitorit.

DO NOT COPY

9. Objektet social kulturore në zonën e mbrojtur duhet të respektojnë legjislacionin për kriteret e projektimit të objekteve të këtij lloji. Projektet e rikonstruksionit apo projektet për ndërtime të reja hartohen nga subjekte të licensuara për këtë kategori projektesh në fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

**Neni 16**
**Shfrytëzimi i monumenteve**

Monumentet e kulturës shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar, apo për funksione të tjera me kusht që këto funksione të mos dëmtojnë vlerat për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës, për funksione të ndryshme prej atyre për të cilat janë ngritur, bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR). Kontrata e shfrytëzimit lidhet ndërmjet ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe përdoruesit të monumenteve.

**Neni 17**
**Vendosja e elementëve dekorues dhe reklamave**

1. Në monumentet e Kategorisë së parë dhe të dytë nuk lejohet vendosja në mënyrë të ekspozuar e elementeve të cilat prishin pamjen dhe pengojnë fotografimin, filmimin dhe soditjen normale.
2. Nuk lejohet vendosja e xhamave me ngjyrë tjetër përveç llojit tradicional.
3. Vendosja e materialeve publicitare në objektet monument kulture bëhet në raste të veçanta festive-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm.
4. Veprimtaritë kulturore në objektet monument kulture bëhet vetëm në rastet kur ato nuk rrezikojnë ose cënojnë vlerat e tyre.
5. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, jep lejen për organizimin e veprimtarive kulturore dhe vendosjen e materialeve publicitare.

**Neni 18**
**Lëvizja e automjeteve**

Brenda Qendrës Historike, në rrugët e ngushta, kalldrëme apo në monumente të rëndësishme, si ura të vjetra etj., ndalohet kalimi i mjeteve të rënda, mbi 4 tonë, përveç rasteve emergjente, si dhe kur veprojnë forcat madhore.

DRRK Gjirokastër, në bashkëpunim me Bashkinë e Gjirokastrës, harton dhe përcakton planin për mënyrat e lëvizjes dhe parkimit të automjeteve në hyrje të Qendrës Historike.

**Neni 19**
**Masat për mbrojtjen e monumenteve të kulturës nga zjarri**

Çdo objekt, monument kulture, në pronësi private ose shtetërore, brenda Qendrës Historike të qytetit-muze të Gjirokastrës apo jashtë saj, duhet të jetë i pajisur me fikës zjarri portativë konform dispozitave ligjore në fuqi. Çertifikimi i instalimeve elektrike egzistuese dhe masave të mbrojtjes nga rreziku i zjarrit bëhet nga organet kompetente në bashkëpunim me DRKK'në.

Bashkia e Gjirokastrës si organ i njësisë së qeverisjes vendore, administratore e qytetit, duhet të krijojë kushte për vënien në funksionim të rrjetit të hidrantëve brenda Qendrës Historike.

Studime për evidentimin dhe menaxhimin e riskut në Qendrën Historike të qytetit të Gjirokastrës hartohen nga Bashkia e Gjirokastrës në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Gjirokastër dhe miratohen në KKR.

DO NOT COPY

**Neni 20**
**Komiteti  për koordinimin e Planeve të Menaxhimit të qendrave historike Berat dhe Gjirokastër**

Komiteti  për koordinim dhe administrim të qendrave historike bashkërendon punën për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe për plotësimin e rekomandimeve të vazhdueshme të UNESCO-s.

Kryetar i këtij komiteti është Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik të Trashëgimisë Kulturore dhe Diversitetit në Ministrinë e Kulturës. Anëtarë të këtij komiteti janë Drejtorët e DRKK-ve përkatëse, Kryetarët e Bashkive respektive, Drejtori i Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK) dhe përfaqësues të Ministrisë së Kulturës. Përbërja e Komitetit përcaktohet me Urdhër të Ministrit të Kulturës.

Ky komitet funksionon dhe mblidhet sipas rregullores, e cila miratohet në mbledhjen e parë.

**Neni 20**
**Masat Administrative**

1. Ndërtimet e pa miratuara në KKR brenda  Qendrës Historike evidentohen nga ana e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Gjirokastër, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm dhe ndaj tyre merren masa administrative sipas legjislacionit në fuqi.
2. Nga ana e DRKK Gjirokastër në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës hartohet plan veprimi për kthimin në gjendjen e mëparshme të ndërtimeve të paligjshme i cili miratohet në KKR. Vendimi për trajtimin e tyre merret në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe miratohet nga ana e KKR.

**Neni 21**
**Dispozitat e fundit**

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave ato zgjidhen prej Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK) ose Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Për shkeljen e kësaj rregulloreje zbatohen masa ndëshkuese sipas ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 "*Për trashëgiminë kulturore*" i ndryshuar.

Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të Ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Kësaj rregulloreje i bashkëngjitet harta e Zonifikimit të Qendrës historike dhe Zonës së mbrojtur të qytetit të Gjirokastrës me koordinatat gjeografike përkatëse për kufijtë e zonave. Ngarkohet DRKK Gjirokastër që brenda 6 muajve nga shpallja në fletoren zyrtare të kësaj rregulloreje të përgatisë dokumentacionin dhe listën  e monumenteve të kategorisë  së dytë për shpalljen e tyre nga ministri perkatës si dhe listën e objekteve pa status brenda qendrës historike.

Shkelja e kësaj rregulloreje shkakton përgjegjësi, sipas ligjeve në fuqi.

**Neni 22**
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore, hyn në fuqi menjëherë pas shpalljes së monumenteve të kategorisë së dytë dhe pas përcaktimit të objekteve pa status brenda qendrës historike.

DO NOT COPY

# QENDRA HISTORIKE E QYTETIT TË GJIROKASTRËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

MIRATOHET

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

Z. EDI RAMA

MINISTRIA E KULTURES

MINISTER

Znj. MIRELA KUMBARO

INSTITUTI I MONUMENTEVE TE KULTURES

DREJTOR

Znj. ARTA DOLLANI

Miratuar me Vendim të KKR Nr.___, Datë ___/___/____

LEGJENDË:

QENDRA HISTORIKE E QYTETIT TË GJIROKASTËS

ZONA E MBROJTUR E QYTETIT TË GJIROKASTËS

NËN-ZONA 1

NËN-ZONA 2

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

## SESIONI I 29-të I KOMITETIT TË TRASHËGIMISË BOTËRORE (DURBAN, KORRIK 2005)

## VENDIMI: 29 COM 8B.48

## SHPALLJE E PASURIVE KULTURORE NË LISTËN E TRASHËGIMISË BOTËRORE (QYTETI-MUZE I GJIROKASTRËS)

Komiteti i Trashëgimisë Botërore,

1. Pas shqyrtimit të dokumentave WHC-05/29.COM/8B, WHC-05/29.COM/8B.Add 2 dhe WHC-05/29.COM/INF.8B.1,

2. Bazuar në vendimin e miratuar nga Byroja e Komitetit të Trashëgimisë Botërore në sesionin e tij të 15-të (të UNESCO-s, 1991) dhe raportin e Raportuesit SC-91/CONF.001/2,

3. Përfshin Qytetin muze të Gjirokastrës (Shqipëri) në Listën e Trashëgimisë Botërore në bazë të kritereve kulturore (iii) dhe (iv):

   Kriteri (iii): Qyteti i vjetër i Gjirokastrës është një dëshmi e jashtëzakonshme e një shoqërie dhe mënyre jetese të gjatë të qëndrueshme dhe pothuajse të zhdukur, të ndikuar nga kultura dhe tradita e Islamit në periudhën osmane.

   Kriteri (iv): Qyteti historik i Gjirokastrës është një shembull i rrallë i një qyteti otoman të mirë ruajtur, të ndërtuar nga pronarë të mëdhenj tokash, përreth kalasë së shek të 13$^{të}$. Arkitektura karakterizohet nga ndërtimi i banesave “kullë” (turqisht “Kule”), nga e cila Gjirokastra paraqet një seri shembujsh të shquar.

4. I kërkon Shtetit Palë të Shqipërisë të hartojë një raport të hollësishëm për gjendjen e konservimit të pasurisë, veçanërisht sa i përket zbatimit të masave për të kundërvepruar ndaj ndërtimeve të paligjshme dhe ndryshimeve në kontekstin urban dhe të peizazhit.

DO NOT COPY

**29 SESSION OF THE WORLD HERITAGE COMMITTEE**
**DURBAN, JULY 2005**

**DECISION : 29 COM 8B.48**

**NOMINATIONS OF CULTURAL PROPERTIES TO THE WORLD HERITAGE LIST (MUSEUM-CITY OF GJIROKASTRA)**

The World Heritage Committee,

1. Having examined Documents WHC-05/29.COM/8B, WHC-05/29.COM/8B.Add 2 and WHC-05/29.COM/INF.8B.1,

2. Recalling the decision adopted by the Bureau of the World Heritage Committee at its 15th session (UNESCO, 1991) and the report of the rapporteur SC-91/CONF.001/2,

3. Inscribes the Museum-City of Gjirokastra (Albania) on the World Heritage List on the basis of cultural criteria (iii) and (iv):

   Criterion (iii): The old city of Gjirokastra is an exceptional testimony to a long-lasting, and almost disappeared society and life-style, influenced by the culture and tradition of Islam in the Ottoman period.

   Criterion (iv): The historic town of Gjirokastra is a rare example of a well preserved Ottoman town, built by farmers of large estates, around the 13thcentury citadel. The architecture is characterized by the construction of a type of tower house (Turkish ‘kule’), of which Gjirokastra represents a series of outstanding examples.

4. Requests the State Party of Albania to draw up a detailed report on the conservation of the property, especially on the implementation of measures to counteract illegal construction and changes in the urban and landscape context.

DO NOT COPY

## SESION I 32-të I KOMITETIT TË TRASHËGIMISË BOTËRORE, QUEBEC, KANADA, KORRIK 2008

## VENDIMI: 32 COM 8B.56

**Shqyrtimi i shpalljeve dhe modifikime të vogla të kufijve të pasurive naturore, të përziera dhe kulturore në Listën e Trashëgimisë Botërore - Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës (Shqipëri).**

Komiteti i Trashëgimisë Botërore,

1. Pas shqyrtimit të dokumentave WHC-08/32.COM/8B.Add dhe WHC-08/32.COM/ INF.8B1.Add,
2. Përfshin Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës, Shqipëri, në Listën e Trashëgimisë Botërore në bazë të kritereve kulturore (iii) dhe (iv);
3. Miraton Deklaratën e mëposhtme të shprehjes se Vlerës të Jashtëzakonshme Universale:

Këto dy qendra historike të fortifikuara janë të ruajtura shumë mirë, dhe kjo është veçanërisht e vërtetë për banesat tradicionale. Ato kanë qenë të banuara vazhdimisht që nga kohët e lashta deri në ditët e sotme. Me vendndodhje në Ballkan, në jug të Shqipërisë, dhe pranë njëra-tjetrës, ato dëshmojnë për pasurinë dhe diversitetin e trashëgimisë urbane dhe arkitektonike të këtij rajoni.

Berati dhe Gjirokastra janë dëshmi e një mënyre jetese e cila ka qenë e ndikuar për një periudhe të gjatë nga traditat e Islamit gjatë periudhës osmane, duke përfshirë në të njëjtën kohë ndikimet më të lashta. Kjo mënyrë jete ka respektuar traditat e krishtera Ortodokse të cilat kanë qenë kështu në gjendje për të vazhduar zhvillimin e tyre shpirtëror dhe kulturor, veçanërisht në Berat.

Gjirokastra është ndërtuar nga pronarë të mëdhenj tokash. Rreth kështjellës së lashtë të shekullit 13-të, qyteti ka banesa me kullë (Turqisht: Kule), të cilat janë karakteristikë e rajonit të Ballkanit. Gjirokastra përmban disa shembuj të shquar të banesave të këtij lloji, të cilat datojnë që nga shekulli i 17-të, por edhe shembuj më të përpunuar që datojnë në fillim të shekullit të 19-të.

Berati dëshmon për një qytet i cili ishte i fortifikuar, por i hapur, dhe ishte për një periudhë të gjatë i banuar nga artizanë dhe tregtarë. Qendra urbane pasqyron tipin e banesave tradicionale të Ballkanit, shembuj të cilat datojnë kryesisht nga fundi i shekujve 18 dhe 19. Kjo traditë i është përshtatur stilit të jetës së qytetit, me shtëpitë e vendosura në shpate të pjerrëta, të cilat zhvillohen kryesisht në linja horizontale, duke e përdorur dritën e diellit maksimalisht.

**Kriteri (iii):** Berati dhe Gjirokastra mbajnë dëshmi të jashtëzakonshme të larmisë së shoqërive urbane në Ballkan, dhe për mënyrat e vjetra të jetesës që sot pothuajse janë zhdukur. Planifikimi urban dhe banesat e Gjirokastrës janë ato të një qyteti të ndërtuar përreth kalasë nga pronarë të mëdhenj tokash, interesat e të cilëve ishin të lidhura drejtpërdrejt me ato të pushtetit qendror. Berati mbart gjurmë të një stili më të pavarur jetese, lidhur me artizanatet dhe funksionet e tij tregtare.

**Kriteri (iv):** Së bashku, të dy qytetet e Gjirokastrës dhe Beratit mbajnë dëshmi të jashtëzakonshme të tipeve të ndryshme të monumenteve dhe banesat tradicionale qytetare gjatë periudhës Klasike Osmane, në vazhdimësi të kulturave të ndryshme mesjetare që e paraprinë atë, dhe në një gjendje bashkëjetese paqësore me një pakicë të madhe të krishterë, veçanërisht në Berat.

Integriteti i përgjithshëm i dy qyteteve është i kënaqshëm, edhe pse është ndikuar negativisht nga ndërtimet e paligjshme në fund të viteve '90. Autenticiteti është gjithashtu i kënaqshëm, por menaxhimi i ruajtjes duhet të përforcohet në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare.

Masat e Planit të Menaxhimit dhe autoriteti i krijuar kohët e fundit për koordinimin dhe zbatimin e planit duhet të nxisin politika aktive për ruajtjen dhe konservimin e Vlerës së Jashtëzakonshme Universale të Pasurisë, veçanërisht për sa i përket menaxhimit të ndërtimeve urbane dhe shërbimet e vizitorëve.

4. Kërkon që Shteti Palë të paraqesë një raport në Qendrën e Trashëgimisë Botërore brenda datës 1 shkurt 2009, për zbatimin e masave të mëposhtme:
   a) Duhet të përgatitet një listë e ndërtimeve të paligjshme në fund të viteve '90, së bashku me një plan afatmesëm për masat kundërvepruese ndaj ndërtimeve të tilla të paligjshme;
   b) Duhet të përcaktohen tregues specifikë monitorimi, së bashku me intervalet për përditësimin e tyre;
   c) Duhet të propozohet një program i gërmimeve arkeologjike, në përputhje me standardet ndërkombëtare në fuqi;
   d) Duhet të përmirësohen masat zjarrfikëse në zonën urbane historike;
   e) Duhet të përcaktohet në mënyrë të detajuar plani afatmesëm për zhvillimin e kapaciteteve të faciliteteve turistike.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

## 32ND SESSION OF WORLD HERITAGE COMMITTEE, DURBAN, JULY 2008

## DECISION: 32 COM 8B.56

**Examination of nominations and minor modifications to the boundaries of natural, mixed and cultural properties to the World Heritage List - Historic Centres of Berat and Gjirokastra (Albania).**

The World Heritage Committee,

1. Having examined Documents *WHC-08/32.COM/8B.Add* and *WHC-08/32.COM/INF.8B1.Add,*
2. Inscribes the **Historic Centers of Berat and Gjirokastra**, **Albania,** on the World Heritage List on the basis of **criteria (iii)** and **(iv)**;
3. Adopts the following Statement of Outstanding Universal Value:

These two fortified historic centers are remarkably well preserved, and this is particularly true of their vernacular buildings. They have been continuously inhabited from ancient times down to the present day. Situated in the Balkans, in Southern Albania, and close to each other, they bear witness to the wealth and diversity of the urban and architectural heritage of this region.

Berat and Gjirokastra bear witness to a way of life which has been influenced over a long period by the traditions of Islam during the Ottoman period, while at the same time incorporating more ancient influences. This way of life has respected Orthodox Christian traditions which have thus been able to continue their spiritual and cultural development, particularly at Berat.

Gjirokastra was built by major landowners. Around the ancient 13th century citadel, the town has houses with turrets (the Turkish *kule*) which are characteristic of the Balkans region. Gjirokastra contains several remarkable examples of houses of this type, which date from the 17th century, but also more elaborate examples dating from the early 19th century.

Berat bears witness to a town which was fortified but open, and was over a long period inhabited by craftsmen and merchants. Its urban centre reflects a vernacular housing tradition of the Balkans, examples of which date mainly from the late 18th and the 19th centuries. This tradition has been adapted to suit the town's life styles, with tiered houses on the slopes, which are predominantly horizontal in layout, and make abundant use of the entering daylight.

**Criterion (iii)**: Berat and Gjirokastra bear outstanding testimony to the diversity of urban societies in the Balkans, and to longstanding ways of life which have today almost vanished. The town planning and housing of Gjirokastra are those of a citadel town built by notable landowners whose interests were directly linked to those of the central power. Berat bears the imprint of a more independent life style, linked to its handicraft and merchant functions.

**Criterion (iv)**: Together, the two towns of Gjirokastra and Berat bear outstanding testimony to various types of monument

and vernacular urban housing during the Classical Ottoman period, in continuity with the various Medieval cultures which preceded it, and in a state of peaceful coexistence with a large Christian minority, particularly at Berat.

The overall integrity of the two towns is satisfactory, although this was adversely affected by illegal constructions in the late 1990s. Authenticity is also satisfactory, but preservation management must be stepped up and carefully enforced, in accordance with the highest international standards.

The management plan measures and the recently established coordination authority responsible for implementing the plan should encourage an active policy of preservation and conservation of the property's Outstanding Universal Value, particularly as regards urban construction management and visitor facilities.

4. Requests the State Party to submit a report to the World Heritage Centre by **1 February 2009** on the implementation of the following measures:
   - a) an inventory should be provided of the illegal construction dating from the late 1990s, together with a plan for the removal of such illegal construction in a medium-term perspective;
   - b) specific monitoring indicators should be defined, together with the intervals of their updating;
   - c) a program of archaeological excavations should be proposed, in accordance with the international standards in force;
   - d) the firefighting arrangements in the historic urban zone should be improved;
   - e) the medium-term plan for the development of tourist facility capacities should be set out in detail.

DO NOT COPY